



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR XHUVANI” ELBASAN
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**

DISERTACION

**NJË STUDIM KRAHASUES I FOLJEVE TË LËVIZJES NË GJUHËN
ANGLEZE DHE SHQIPE**

**PUNOI
M.A. Shefqet SHYTI**

**UDHËHEQËS SHKENCOR
Prof. Dr. Vilma TAFANI**

ELBASAN, 2017



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR XHUVANI” ELBASAN
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**

DISERTACION

**Përgatitur nga: Shaqet Shyti
Për marrjen e gradës shkencore: "DOKTOR"**

TEMA

**NJË STUDIM KRAHASUES I FOLJEVE TË LËVIZJES NË GJUHËN
ANGLEZE DHE SHQIPE**

**Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Vilma TAFANI
Mbrotet në dt. __. __. 2017 përpara jurisë së përbërë nga:**

1. _____ Kryetar
2. _____ Anëtar
3. _____ Anëtar (oponent)
4. _____ Anëtar (oponent)
5. _____ Anëtar

ELBASAN, 2017

Abstrakt

Lëvizja është në qendër të përvojës njerëzore; ajo është pjesë e jetës sonë të përditshme, por edhe e nevojave tona komunikuese. Lëvizja është një koncept universal i pranishëm në të gjitha gjuhët e botës. Megjithatë, gjuhët ndryshojnë në shprehjen e tyre gjuhësore të lëvizjes. Vepra e Talmy (1985, 2000) dallon dy lloje të ndryshme gjuhësh duke u bazuar tek mënyra se si elementë të ndryshëm të një ngjarjeje të lëvizjes mishërohen në elementët gjuhësorë: gjuhët me strukturë satelitore, të cilat e shprehin Trajektores, përbërësin kryesor të lëvizjes, me anën e satelitëve, ndërsa Mënyrën e lëvizjes e shprehin tek vetë folja dhe gjuhët me strukturë foljore, të cilat zakonisht e shprehin Trajektores tek vetë folja ndërsa Mënyrën e shprehin me anën e rrethanorëve plotësues.

Vepra e Talmy ka sjellë shumë studime mbi përshkrimet e ngjarjes së lëvizjes. Pavarësisht nga numri i madh i studimeve lidhur me shprehjen gjuhësore të ngjarjeve të lëvizjes, shpeshherë neglizhohet fakti që vetë foljet e lëvizjes mund të përmbajnë edhe informacione të tjera, krahas Mënyrës dhe Trajektores, siç janë modelet më të vogla të lekskalizimit që mund të ndodhin. Për më tepër, në shumë raste, studimi i e foljeve të Trajektores është lënë pas dore, duke favorizuar studimin e foljeve të Mënyrës; kjo për shkak se shprehja e ndryshme e Mënyrës, deri më tani, ka qenë pika më interesante e dallimit midis gjuhëve satelitore dhe foljore. Së fundi, në dijeninë tonë, mungojnë studimet që i janë përkushtuar një analize të thellë krahasuese të semantikës së foljeve të lëvizjes për gjuhën shqipe dhe angleze.

Ky disertacion synon të ngushtojë hendekun në literaturën ekzistuese duke trajtuar semantikën e foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip. Në pjesën e parë të këtij disertacioni ofrohet një analizë e hollësishme dhe sistematike e semantikës së foljeve leksikut të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip nga një këndvështrim krahasues. Aty eksplorojnë modelet e kombinimeve të përgjithshme si edhe nocionet më të imta të trajektores dhe informacioni më i hollësishëm mënyror që mund të mund të përcillet nga foljet e mënyrës në këto dy gjuhë. Krahasimi ndërmjet anglishtes dhe shqipes çon në identifikimin e disa ngjashmërive: (a) Kombinimi i Lëvizjes plus një përbërës semantik shtesë, ose mënyrë ose Trajektores, është modeli leksikalizues me karakteristik për leksikun e foljeve të lëvizjes në të dy gjuhët; (b) të dy gjuhët kanë folje të Trajektores që shprehin, së paku, 13 lloje të Trajektores; ndërmjet tyre, llojet e Trajektores që leksikalizohen më shpesh janë ‘Larg nga Terrenit’, ‘Poshtë / poshtë nga Terreni – Tatëpjetë’, ‘Për tek / drejt Terrenit’ dhe ‘Përmbi/mbi Terren – Përpjetë’, ndërsa lloji që leksikalizohet më rrallë është

‘Jashtë/ nga/prej Terrenit’; dhe (c) të dy gjuhët zotërojnë më shumë folje për të ecurit se sa për të vrapuarit dhe të hedhurit. Këto tendenca sugjerojnë se ka ngjashmëri të rëndësishme në mënyrat se si anglishtja dhe shqipja, dhe mbase edhe gjuhët e tjera, leksikalizojnë fushën e lëvizjes tek foljet e tyre. Gjithashtu, janë vënë re edhe disa dallime ndërgjuhësore: (a) Foljet e mënyrës së lëvizjes në anglisht i tejkalojnë ato të shqipes dhe prirën të shfrytëzojnë disa parametra të mënyrës shumë më shpesh se foljet e shqipes (p.sh., informacioni mënyror për gjendjen mendore dhe fizike të Figurës dhe hollësitë për mënyrën si Figura lëviz këmbët gjatë ecjes, lëvizja duke përdorur mjete, lëvizja gjatë vallëzimit); dhe (b) leksiku i foljeve të Trajektores në shqip është më i madh se i ai i anglishtes, megjithëse të dy gjuhët janë në gjendje të shprehin të njëjtat lloje të Trajektores.

Pjesa e dytë e këtij disertacioni synon të hetojë një nënfushë të rëndësishme të lëvizjes, atë të lëvizjes së njeriut, duke përdorur metodat eksperimentale. Aty raportohen dy studime: detyra e përkufizimit dhe renditjes së veçorive dhe detyra e renditjes së lirë të foljeve. Këto studime sjellin informacion interesant për sa i përket mënyrave si anglishtja dhe shqipja organizojnë leksikun e tyre të foljeve të lëvizjes dhe semantikës komplekse të foljeve të lëvizjes së njeriut. Krahas kësaj, gjetjet ofrojnë mbështetje eksperimentale për disa nga vëzhgimet e bëra gjatë analizës së bërë në pjesën e parë të këtij disertacioni.

MIRËNJOHJE

Në rrugëtimin e gjatë të përfundimit të studimeve të mia të doktoraturës kam pasur fatin të kem në krah shumë persona që më kanë ndihmuar, mbështetur dhe këshilluar. Së pari, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë e njëkohësisht të falënderoj të gjithë ata që ndikuan në ecurinë e mbarë të këtij procesi studimor, të gjithë ata që me mendimet apo sugjerimet e tyre më ndihmuan e më mbështetën për ta çuar deri në fund këtë nismë të rëndësishme.

Në mënyrë të veçantë, dëshiroj të falënderoj udhëheqësen shkencore të këtij studimi, Prof. Dr. Vilma Tafani, pasi mendimet dhe sugjerimet e saj kanë qenë shumë të dobishme gjatë kryerjes së këtij procesi kërkimor.

Së fundi, falënderime pa fund për familjen time, e cila më krijoi mundësinë e një pune të qetë duke më dhënë gjithë mirëkuptimin dhe mbështetjen e nevojshme për të kurorëzuar me sukses këtë përpjekje.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	i
MIRËNJOHJE	iii
PËRMBAJTJA	iv
 KAPITULLI I: HYRJE	 1
 1.1. Problemi	 2
1.2. Hipoteza dhe çështjet kërkimore	3
1.3. Qëllimet dhe metodologjia	4
1.4. Sruktura	5
 KAPITULLI II: GJUHËSIA NJOHËSE DHE TEORIA E MODELEVE LEKSIKALIZUESE	 9
 2.1. Vështrim mbi gjuhësinë njohëse dhe semantikën njohëse	 10
2.1.1. Hyrje.....	10
2.1.2. Gjuhësia njohëse.....	10
2.1.3. Semantika njohëse.....	12
2.1.3.1. Parimet dhe drejtimet kryesore të kërkimit.....	12
2.1.3.2. Semantika konceptuale.....	16
2.2. Teoria e Talmy për modelet leksikalizuese	20
2.2.1. Hyrje.....	20
2.2.2. Ngjarja e lëvizjes.....	22
2.2.3. Tipologjia e trefishtë: Folja.....	25
2.2.3.1. Modeli leksikalizues: Lëvizje+Bashkëngjarje.....	25
2.2.3.2. Modeli leksikalizues: Lëvizje+Trajektorë.....	26
2.2.3.3. Modeli leksikalizues: Lëvizje+Figurë.....	27
2.2.3.4. Modele të tjera më të vogla.....	27
2.2.4. Tipologjia e dyfishtë: Trajektorja e lëvizjes.....	28
2.3. Hipoteza e relativizmit gjuhësor	29
2.3.1. Hyrje.....	29

2.3.2. Hipoteza e relativizmit gjuhësor nga Sapir dhe Whorf.....	31
2.3.3. Të-menduarit-për-të-folur nga Slobin.....	34
2.4. Përfundime.....	36

KAPITULLI III: KLASIFIKIMET DHE ANALIZA E FOLJEVE TË LËVIZJES.....38

3.1. Hyrje.....	39
3.2. Qasja e bazuar në marrëdhënien sintaksë-semantikë.....	39
3.2.1. Hyrje.....	39
3.2.2. Klasat e foljeve të lëvizjes.....	40
3.3. Qasja e bazuar në modelin funksional-leksematik.....	44
3.3.1. Hyrje.....	44
3.3.2. Nënfishat leksikore të lëvizjes.....	45
3.4. Semantika e foljeve të lëvizjes.....	48
3.4.1. Hyrje.....	48
3.4.2. Foljet e mënyrës	50
3.4.3. Foljet e trajektores.....	53
3.5. Përmbledhje.....	56

KAPITULLI IV: SEMANTIKA E LEKSIKUT TË FOLJEVE TË LËVIZJES NË ANGLISHT DHE SHQIP.....58

4.1. Hyrje.....	59
4.2. Qëllimet dhe metodologjia.....	60
4.2.1. Qëllimet.....	60
4.2.2. Korpusi i foljeve të lëvizjes.....	62
4.2.3. Metodologjia.....	64
4.2.4. Disa probleme dhe kufizime.....	69
4.3. Shpërndarja e përgjithshme: kombinimet foljore.....	70
4.3.1. Kombinimet foljore të anglishtes.....	71
4.3.2. Kombinimet foljore të shqipes.....	76
4.3.3. Diskutim dhe përfundime.....	80
4.4. Foljet e Trajektores.....	82

4.4.1. Foljet e trajektores në anglisht.....	84
4.4.2. Foljet e trajektores në shqip.....	87
4.4.3. Diskutim dhe përfundime.....	90
4.5. Foljet e Mënyrës.....	93
4.5.1. Foljet e mënyrës në anglisht.....	95
4.5.2. Foljet e mënyrës në shqip.....	104
4.5.3. Diskutim dhe përfundime.....	112
4.6. Përfundime.....	121

KAPITULLI V: NJË STUDIM EKSPERIMENTAL MBI FOLJET E LËVIZJES SË NJERIUT NË ANGLISHT DHE SHQIP.....127

5.1. Hyrje.....	128
5.2. Kuptimi i foljeve Lëviz, Eci, Vrapoj, Hidhem.....	129
5.2.1. Hyrje.....	129
5.2.2. Metodologjia.....	130
5.2.3. Rezultatet.....	130
5.2.4. Diskutim dhe përfundime.....	135
5.3. Foljet e të ecurit, të vrapuarit, dhe të hedhurit.....	136
5.3.1. Hyrje.....	136
5.3.2. Metodologjia.....	137
5.3.3. Rezultatet.....	137
5.3.4. Diskutim dhe përfundime.....	146
5.4. Përfundime.....	148

KAPITULLI VI: PËRFUNDIME DHE PROPOZIME.....150

6.1. Përfundimet kryesore të studimit.....	151
6.2. Drejtimet e mundshme kërkimore për të ardhmen.....	153
6.3. Kontribute.....	154

REFERENCA.....	156
-----------------------	------------

SHTOJCA 1: Lista e foljeve të lëvizjes në gjuhën shqipe.....	164
SHTOJCA 2: Lista e foljeve të lëvizjes në gjuhën angleze.....	199
SHTOJCA 3: Udhëzime për studimet eksperimentale.....	263
SHTOJCA 3: Foljet e mënyrës nga studimi për renditjen e lirë.....	266

Lista e Tabelave

Tabela 4.1. Shpërndarja semantike e foljeve të lëvizjes në anglisht.....	72
Tabela 4.2. Shpërndarja semantike e foljeve të lëvizjes në shqip.....	76
Tabela 4.3. Shpërndarja semantike e foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip.....	80
Tabela 4.4. Foljet që kombinojnë Terrenin në anglisht dhe shqip.....	82
Tabela 4.5. Shpërndarja e foljeve të trajektores në anglisht.....	84
Tabela 4.6. Shpërndarja e foljeve të trajektores në shqip.....	87
Tabela 4.7. Shpërndarja e foljeve të trajektores në anglisht dhe shqip.....	91
Tabela 4.8. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në anglisht (lëvizje e brendshme).....	96
Tabela 4.9. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në anglisht (lëvizje zhvendosëse).....	98
Tabela 4.10. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në shqip (lëvizje e brendshme).....	105
Tabela 4.11. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në shqip (lëvizje zhvendosëse).....	108
Tabela 4.12. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në anglisht dhe shqip (lëvizje e brendshme).....	113
Tabela 4.13. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në anglisht dhe shqip (lëvizje zhvendosëse).....	114
Tabela 4.14. Kategoritë e imta të mënyrës për foljet e Të Ecurit në anglisht dhe shqip.....	117
Tabela 5.1. Informacioni semantik i përfshirë në përkufizimet për <i>Move</i> – Lëviz.....	131
Tabela 5.2. Informacioni semantik i përfshirë në përkufizimet për <i>Walk</i> – Eci.....	132
Tabela 5.3. Informacioni semantik i përfshirë në përkufizimet për <i>Run</i> – Vrapj.....	133
Tabela 5.4. Informacioni semantik i përfshirë në përkufizimet për <i>Jump</i> – Hidhem.....	134
Tabela 5.5. Shpërndarja e përgjithshme e njësive të renditura për secilën kategori foljore në anglisht dhe shqip.....	141
Tabela 5.6. Foljet e lëvizjes dhe satelitët e renditur si njësi e parë sipas kategorisë dhe gjuhës.....	143

KAPITULLI I

HYRJE

1.1. Problemi

1.2. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore

1.3. Qëllimet dhe metodologjia

1.4. Sruktura

1.1. Problemi

Lëvizja është në qendër të përvojës njerëzore; ajo është pjesë e jetës sonë të përditshme, por edhe e nevojave tona komunikuese. Lëvizja është një koncept universal i pranishëm në të gjitha gjuhët e botës. Megjithatë, gjuhët ndryshojnë në shprehjen e tyre gjuhësore të lëvizjes. Vepra e Talmy (1985, 2000) përcakton dy lloje të ndryshme gjuhësh duke u bazuar tek mënyra se si elementët e ndryshëm të një ngjarjeje të lëvizjes mishërohen në elementët gjuhësorë: gjuhët me kornizë satelitore, të cilat e shprehin Trajektoren, përbërësin kryesor të lëvizjes, me anën e satelitëve, ndërsa Mënyrën e lëvizjes e shprehin tek vetë folja, dhe gjuhët me kornizë foljore, të cilat zakonisht e shprehin Trajektoren tek vetë folja ndërsa Mënyrën e shprehin me anën e rrethanorëve plotësues. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh se tipologjitë më shumë pasqyrojnë tendencat se sa dallimet absolute midis gjuhëve (Berman & Slobin, 1994), pasi si shqipja edhe anglishtja kanë folje që shprehin mënyrën dhe folje që shprehin trajektoren krahas foljeve të tjera që shprehin informacion tjetër semantik i cili i përket ngjarjes së lëvizjes.

Gjatë dy dekadave të fundit vepra e Talmy ka sjellë shumë studime mbi përshkrimet e ngjarjes së lëvizjes. Këto studime e kanë marrë të mirëqenë faktin se dallimi kryesor midis gjuhëve me kornizë satelitore dhe foljore qëndron tek shprehja e ndryshme e Mënyrës së lëvizjes: tek gjuhët satelitore Mënyra shprehet tek vetë folja ndërsa në gjuhët foljore ajo është opsionale. Për pasojë, shumë më pak vëmendje i është kushtuar përbërësit të Trajektores së lëvizjes, i cili, duke qenë thelbi i ngjarjes së lëvizjes, shprehet ose tek vetë folja ose tek satelitët. Pavarësisht nga numri i madh i studimeve lidhur me shprehjen gjuhësore të ngjarjeve të lëvizjes, shpeshherë janë neglizhuar kombinimet e tjera semantike të mundshme tek foljet e lëvizjes (p.sh., Terreni, Figura).

Për sa i përket foljeve të mënyrës, Slobin (1997: 459) thekson se gjuhët duket se kanë leksik me ‘dy nivele’ për foljet që tregojnë Mënyrën e lëvizjes¹: (1) një nivel të përgjithshëm, apo mbizotërues, të përfaqësuar nga folje të përditshme të tilla si *walk*, *run*, *jump*, *fly*, - *eci*, *vrapoj*, *hidhem*, *kërcej*, etj; dhe (2) një nivel shprehës më specifik të përbërë nga mënyra të ndryshme të të ecurit, të tilla si *stroll*, *wander*, ose *shuffle* – *çapit*, *çaloj*; mënyra të ndryshme

¹Kjo duket të jetë veçori jo vetëm e foljeve të lëvizjes por edhe e foljeve të fushave të tjera, si foljet e të shikuarit (me *see* dhe *look* në nivelin mbizotërues dhe *stare*, *gaze*, *glance*, *gape*, etj. Në nivelin specifik); foljet e të qeshurit ose buzëqeshurit (me *guffaw*, *smirk*, *grin*, etj., në nivelin e dytë), foljet e të thënit, foljet e të dëgjuarit, etj. Megjithatë, nevojiten studime të tjera për të provuar nëse gjuhët i kanë të dy këto nivele për shumicën e fushave semantike apo vetëm për disa prej tyre.

të të vrapuarit si *sprint* or *jog* – *vërvitem*, *vërsulem*, etj. Studimet kanë treguar se Anglishtja zotëron një nivel të dytë shumë të gjerë dhe të përpunuar. Lidhur me foljet e trajektores, Özçalışkan (2004: 85) pretendonte se leksiku i foljeve të trajektores në gjuhë ‘formon një kategori të mbyllur leksikore që nuk ofron shumë mundësi për përpunim’ prandaj ajo hodhi hipotezën se gjuhët duket se zotërojnë numër përafërsisht të njëjtë foljesh të trajektores. Megjithatë, pretendimi i saj ende nuk është trajtuar plotësisht nga studimet gjuhësore.

Së fundi, megjithë numrin e madh të studimeve mbi shprehjen gjuhësore të ngjarjeve të lëvizjes në anglisht, nuk ka pothuajse asnjë studim të thelluar të foljeve të lëvizjes në gjuhën shqipe dhe, në dijeninë tonë, nuk ekziston asnjë studim krahasues i këtyre foljeve në të dy gjuhët. Ky studim synon të pasurojë dhe të mbushë një boshllëk në literaturën ekzistuese duke trajtuar me hollësi semantikën e foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip. Një kuptim më i mirë i semantikës së foljeve të lëvizjes është shumë i rëndësishëm jo vetëm për studimin e përshkrimeve të ngjarjeve të lëvizjes në përgjithësi por edhe për studime të cilat shqyrtojnë ndikimet që modelet e ndryshme semantike mund të kenë në njohjen jogjuhësore.

1.1. Hipoteza dhe çështjet kërkimore

Pjesa e parë e këtij studimi synon të japë një pasqyrë sistematike dhe të hollësishme të semantikës së foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip nga një këndvështrim krahasues. Aty do të hulumtohen modele e nocione të përgjithshme semantike si dhe nocione e informacione më të hollësishme të Trajektores dhe Mënyrës të cilat mund të shprehen nga foljet e lëvizjes në këto gjuhë. Krahasimi mes anglishtes dhe shqipes synon të identifikojë disa ngjashmëri dhe dallime të rëndësishme në mënyrën si anglishtja dhe shqipja e leksikalizojnë fushën e lëvizjes tek foljet e tyre.

Pjesa e dytë e studimit synon të shqyrtojë një fushë të rëndësishme të lëvizjes, lëvizjen e njeriut, duke përdorur metodat eksperimentale. Për këtë qëllim do të ndërmerren dy detyra studimore: detyra e parë për përkufizimin dhe renditjen e veçorive të foljeve të lëvizjes dhe detyra e dytë për renditjen e lirë të këtyre foljeve. Këto eksperimente do të ofrojnë të dhëna me interes për mënyrat si anglishtja dhe shqipja organizojnë leksikun e tyre të foljeve të lëvizjes dhe për semantikën komplekse të foljeve të lëvizjes e njeriut.

Në tërësi, gjatë hulumtimit dhe krahasimit të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip ky studim do të synojë të trajtojë pyetjet e përgjithshme kërkimore në vijim, që përbëjnë edhe hipotezat e punës sonë: (1) cilat nocione semantike shprehen në përgjithësi

tek foljet të lëvizjes në anglisht dhe shqip? (2) a kanë anglishtja dhe shqipja leksikë të krahasueshëm të foljeve të trajektores së lëvizjes; në madhësi; në natyrën semantike; 3) a leksikalizojnë anglishtja dhe shqipja informacion të ngjashëm për mënyrën e lëvizjes në foljet e kësaj kategorie? Cilat hollësi të mënyrës përdoren më shpesh në secilën gjuhë; a paraqet anglishtja më shumë hollësi të mënyrës në të gjitha nënfushat e lëvizjes dhe, nëse jo, në cilën nënfushë apo cilat nënfusha shqipja paraqet më shumë hollësi të mënyrës?

1.2. Qëllimet dhe metodologjia

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të ofrojë një vështrim të hollësishëm krahasues të një pjese të konsiderueshme të leksikut të foljeve të lëvizjes për gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe, duke u përqendruar veçanërisht tek foljet jokalimtare, vetvetore dhe joveprore (Talmy, 2000b; 28). Pikënisja e studimit është vepra e Talmy mbi lëvizjen (1985, 2000) e cila përcakton edhe përbërësit e përgjithshëm semantikë të saj: Lëvizja, Figura, Terreni, Trajektorja, Mënyra dhe Shkaku. Analiza do të përqendrohet tek kategoritë e gjera të Trajektores dhe Mënyrës për të kërkuar ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip. Për këtë qëllim do të përdoren një sërë kategorish dhe parametrash të mirëpërcaktuara të cilat janë identifikuar nga studiuesit që punojnë në këtë fushë (p.sh., Ibarretxe-Antuñano, 2006a; Özçalışkan, 2004; Slobin, 2000, 2005).

Duke përdorur listat foljeve që gjenden në literaturën ekzistuese, në fjalorët njëgjuhësh, dygjuhësh, dhe thesarët, u përpilua një listë me 297 folje të lëvizjes për anglishten dhe 290 folje të lëvizjes për shqipen, që përbëjnë korpusin tonë të foljeve të lëvizjes të cilat do të jenë objekt studimi i këtij disertacioni. Foljet e lëvizjes në vëmendje të këtij disertacioni përfshijnë foljet e përgjithshme të lëvizjes (dmth, pa asnjë informacion të veçantë semantik përveç përbërësit Lëvizje, të tilla si, *move*, *lëviz*), foljet e shoqërimit (p.sh., *escort*, *guide*, *lead*, *shoqëroj*, *udhëheq*, *drejtoj*3), foljet e trajektores (p.sh., *arrive*, *come*, *depart*, *enter*, *exit*, *go*, *arrij*, *vij*, *largohem*, *dal*, *hyj*, *iki shkoj*), si dhe foljet e mënyrës. Foljet e mënyrës i përkasin (a) lëvizjes së njerëzve dhe kafshëve (p.sh., *walk*, *run*, *fly*, *hop*, *eci*, *vrapij*, *fluturoj*, *hidhem*), (b) lëvizjes duke përdorur një mjet (p.sh., *bike*, *canoe*, *ferry*, *ship*, *kalëroj*, *galopoj*, *shaloj*), (c) lëvizjes gjatë vallëzimit (p.sh., *waltz*, *foxtrot*, *twist*, *kërcej*2, *vallëzoj*), (d) lëvizjes së objekteve fizike apo figurave të pajetë (p.sh., *revolve*, *roll*, *spin*, *shake*, *swing*, *rrotulloj*, *përdredh*, *kthej*, *rrokullis*) dhe (e) ndryshimit të qëndrimit (*kneel*, *lean*, *recline*, *twist*, *gjunjëzoj*, *përrul*, *shtrij*). Bazuar në përkufizimet e fjalorëve, çdo folje e lëvizjes do të analizohet në lidhje me informacionin

semantik të përgjithshëm dhe të veçantë që ajo përcjell. Më pas, leksikët e foljeve të të dy gjuhëve do të krahasohen për nga (a) shpërndarja e përgjithshme semantike të foljeve, (b) foljet e tyre të trajektores, dhe (c) foljet e tyre të mënyrës. Në tërësi, kjo metodologji do të mundësojë një kuptim më të mirë të mënyrës së organizimit të leksikut të lëvizjes në të dy gjuhët për të nxjerrë në pah ngjashmëritë e dallimet ndërgjuhësore dhe për të formuluar hipoteza për kërkime të mëtejshme psikolinguistike.

Pjesa e dytë e disertacionit ka për qëllim të hetojë një fushë të rëndësishme të lëvizjes, atë të lëvizjes së njeriut, duke përdorur metodat eksperimentale. Kjo fushë mund të strukturohet rreth tre modeleve motore që kanë të bëjnë me lëvizjen në tokë: *Eci*, *Vrapoj* dhe *Hidhem*. Të ecurit është modeli motor më i rëndësishëm dhe themelor i njeriut. Kjo është mënyra më e zakonshme e lëvizjes për njerëzit. Në të kundërt, të vrapuarit dhe të hedhurit janë veprimtari më periferike, pasi njerëzit zakonisht nuk vrapojnë apo hidhen për të shkuar diku. Dy eksperimente psikolinguistike do të shqyrtojnë semantikën e foljeve të lëvizjes së njeriut dhe organizimin e kësaj fushe të lëvizjes. Eksperimenti i parë do të synojë eksplorimin e veçorive përcaktuese për secilin model motor, që do të thotë, cilat hollësi specifike të mënyrës përcaktojnë veprimet e të ecurit, të vrapuarit dhe të hedhurit. Qëllimi i eksperimentit të dytë do të jetë të bëjë një vlerësim psikogjuhësor për disa vëzhgime që rrjedhin nga analiza semantike, përkatësisht, pretendimi se anglishtja dhe shqipja mund ta organizojnë në mënyrë të ngjashme leksikun e tyre të foljeve të lëvizjes së njeriut (p.sh., numër më i madh i foljeve për të ecurit krahasuar me ato për të vrapuarit dhe të hedhurit) pavarësisht dallimeve në numrin e foljeve për secilën nga këto kategori.

1.4. Sruktura

Më tej ky disertacion organizohet në gjashtë kapituj. Kapitulli 2 dhe Kapitulli 3 ofrojnë një shqyrtim të zgjeruar të literaturës që përbën sfondin teorik të këtij disertacioni mbi kërkimet në lëmin e lëvizjes dhe mbi analizat dhe klasifikimet e ndryshme të foljeve të lëvizjes. Kapitulli 4 trajton semantikën e leksikut të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip. Kapitulli 5 raporton lidhur me dy studime eksperimentale mbi foljet që shprehin lëvizjen e njeriut. Së fundi, Kapitulli 6 bën një përmbledhje të gjetjeve kryesore dhe sugjeron drejtimit kërkimore për të ardhmen.

Kapitulli 2 jep një pasqyrë të shkurtër por të përgjithshme të sfondit teorik të disertacionit. Fillimisht ai trajton lindjen dhe parimet kryesore të Gjuhësisë Njohëse në përgjithësi dhe parimet e drejtimit kryesore kërkimore të Semantikës Njohëse duke i

kushtuar një vëmendje të veçantë Semantikës Konceptuale. Në vijim paraqitet teoria e Talmy për modelet leksikalizuese. Synimi kryesor i veprës së Talmy është eksplorimi i marrëdhënieve sistematike midis kuptimit dhe formave gjuhësore me synimin për të zbuluar nëse gjuhët shfaqin një numër të vogël modelesh (dmth., një tipologji) apo një model të vetëm (dmth., një universale). Në shqyrtimin që i bën fushës së lëvizjes ai propozon dy tipologji: tipologjinë e trefishtë dhe tipologjinë e dyfishtë të gjuhëve, të cilët rrjedhin nga dy këndvështrime të marrëdhënieve midis kuptimit dhe formave gjuhësore. Duke u nisur nga lloji i informacionit semantik që shprehet zakonisht tek vetë folja ai propozon tipologjinë e gjuhëve që kombinojnë Trajektoresh, Mënyrën dhe Figurën; duke u nisur nga format gjuhësore që shprehin zakonisht Trajektoresh e lëvizjes, ai propozon tipologjinë e gjuhëve me kornizë satelitore dhe foljore. Së fundi, në këtë kapitull prezantohet hipoteza e Sapir dhe Whorf për relativizmin gjuhësor si edhe një version më i butë i kësaj hipoteze, hipoteza e Slobin mbi të-menduarit-për-të-folur. Fusha e lëvizjes është e përshtatshme për të eksploruar ndikimet e modeleve semantike gjuhësore mbi mënyrën si folësit e një gjuhe flasin dhe mendojnë për lëvizjen. Aty përmbledhet e gjithë gama e studimeve që janë ndikuar nga teoria Talmiane e modeleve leksikalizuese për ngjarjet e lëvizjes.

Këto studime mund të grupohen në dy blloqe: Kërkimet e Slobin mbi të-menduarit-për-të-folur dhe kërkimet për relativizmin gjuhësor. Hipoteza e Slobin mbi të-menduarit-për-të-folur përmbledh shumë drejtime kërkimore në përpjekje për të justifikuar ndikimet e gjëra që ka përdorimi i gjuhës në proceset mendore të lidhura me gjuhën (dmth., të folurin, të shkruar, përkthimin, gjestet, etj). Gjithashtu aty bëhet një vlerësim i relativizmit gjuhësor dhe analizohet gjerësisht çështja nëse dallimet në shprehjen e lëvizjes çojnë në konceptualizime të ndryshme të ngjarjeve të lëvizjes nga folësit e gjuhëve me kornizë foljore dhe satelitore, por rezultatet e këtyre studimeve nuk janë përfundimtare. Gjithashtu sugjerohet që natyra e brendshme e nxitësve (dmth., llojet e Trajektores, llojet e Mënyrës dhe llojet e Figurës) mund të jenë përgjegjëse për rezultatet e ndryshme.

Kapitulli 3 përshkruan disa klasifikime dhe analiza të foljeve të lëvizjes nga (a) këndvështrime të ndryshme teorike, dhe (b) kërkimet mbi ngjarjet e lëvizjes. Ai fillon me një pasqyrë të qasjes së bazuar në Marrëdhënien Sintaksë-Semantikë për analizën e foljeve të lëvizjes, e cila eksploron se si semantika e një foljeje mund të përcaktojë realizimin sintaksor të argumenteve të saj. Më pas paraqiten dy klasifikime apo tipologji të foljeve të lëvizjes sipas qasjes së bazuar në modelin FunkSIONAL-Leksematik dhe

shqyrtohen studimet ndërgjuhësore për foljet e mënyrës dhe të trajektores. Këto studime analizojnë foljet e lëvizjes në mënyrë më të hollësishme se formulimi fillestar i Talmy; studiuesit i ndajnë përbërësit Trajektore dhe Mënyrë në kategori më të imta të cilat mundësojnë një eksplorimin më të hollësishëm të semantikës së trajektores dhe mënyrës midis gjuhëve.

Kapitulli 4 shqyrton natyrën semantike të leksikut të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip dhe bën një argumentim krahasues me vëmendje të veçantë tek dimensionet e trajektores dhe mënyrës së lëvizjes. Ai përshkruan qëllimet, çështjet kërkimore, korpusin dhe metodologjinë e ndjekur dhe bën një pasqyrë të shpërndarjes së përgjithshme të foljeve të lëvizjes në gjuhën angleze dhe shqipe sipas përbërësve të përgjithshëm semantikë që shprehin foljet e tyre. Më tej ky kapitull përqendrohet tek foljet e trajektores me vëmendje të veçantë tek llojet e nocioneve të trajektores që duket se shprehen zakonisht nga foljet e trajektores në këto dy gjuhë, duke vazhduar me trajtimin e natyrës semantike të foljeve të mënyrës në secilën gjuhë dhe llojet e informacionit mënyror që duket se leksikalizohen zakonisht tek folja në anglisht dhe shqip. Së fundi, aty u jepet përgjigje çështjeve kërkimore të trajtuara përgjatë kapitullit dhe përmbledhen përfundimet kryesore duke nënvizuar dallimet dhe ngjashmëritë ndërgjuhësore.

Kapitulli 5 raporton lidhur me dy studime eksperimentale mbi lëvizjen e njeriut. Fillimisht raportohet për studimin e parë (dmth., Detyra e Përkufizimit dhe Renditjes së Veçorive), ku anglishtfolësve dhe shqipfolësve amëtarë u kërkohet të përkufizojnë foljet *move-lëviz*, *walk-eci*, *run-vrapoj* dhe *jump-hidhem*, si edhe të rendisin veçoritë e tyre dalluese. Më pas prezantohet studimi i dytë (dmth., Detyra e Renditjes së Lirë të Foljeve), në të cilin anglishtfolësve dhe shqipfolësve amtarë u jepet një minutë kohë për të renditur folje për të lëvizurit, të ecurit, të vrapuarit dhe të hedhurit. Ky kapitull hedh dritë mbi mënyrat si anglishtja dhe shqipja organizojnë leksikun e tyre të foljeve të lëvizjes së njeriut dhe mbi semantikën komplekse të foljeve të lëvizjes së njeriut.

Kapitulli 6 përmbledh gjetjet kryesore të këtij disertacioni, trajton drejtimet e mundshme kërkimore për të ardhmen dhe sugjeron disa zbatime të punës së paraqitur. Disertacioni përfundon duke sugjeruar nevojën për studime të mëtejshme eksperimentale mbi semantikën e foljeve të lëvizjes dhe studime të mëtejshme ndërgjuhësore për të provuar nëse tendencat e dokumentuara në këtë disertacion vlejnë edhe për gjuhë të tjera.

KAPITULLI II

GJUHËSIA NJOHËSE DHE TEORIA E MODELEVE LEKSIKALIZUESE

2.1. Vështrim mbi Gjuhësinë Njohëse dhe Semantikën Njohëse

2.1.1. Hyrje

2.1.2. Gjuhësia Njohëse

2.1.3. Semantika Njohëse

2.1.3.1. Parimet dhe drejtimet kryesore të kërkimit

2.1.3.2. Semantika Konceptuale

2.2. Teoria e Talmy për modelet leksikalizuese

2.2.1. Hyrje

2.2.2. Ngjarja e Lëvizjes

2.2.3. Tipologjia e trefishtë: Folja

2.2.3.1. Modeli leksikalizues: Lëvizje+Bashkëngjarje

2.2.3.2. Modeli leksikalizues: Lëvizje+Trajektore

2.2.3.3. Modeli leksikalizues: Lëvizje+Figurë

2.2.3.4. Modele të tjera më të vogla

2.2.4. Tipologjia e dyfishtë: Trajektorja e lëvizjes

2.3. Hipoteza e Relativizmit Gjuhësor

2.3.1. Hyrje

2.3.2. Hipoteza e Relativizmit Gjuhësor nga Sapir dhe Whorf

2.3.3. Të-menduarit-për-të-folur nga Slobin

2.4 Përfundime

2.1.1. Hyrje

Një përshkrim i plotë i Gjuhësisë Njohëse dhe semantikës njohëse do të dilte jashtë kufijve të këtij disertacioni, prandaj do të synohet të ofrohet një pasqyrë e shkurtër por e përgjithshme për Gjuhësinë Njohëse e cila qëndron në sfond të këtij disertacioni. Pjesa e mëposhtme merret shkurtimisht me lindjen dhe parimet kryesore të Gjuhësisë Njohëse, që duhet të shihet si një lëvizje e përgjithshme më shumë se si një teori e unifikuar. Gjithashtu bëhet një pasqyrë e parimeve dhe drejtimeve kryesore studimore të Semantikës Njohëse, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë tek Semantika Konceptuale.

2.1.2. Gjuhësia Njohëse

Gjuhësia Njohëse është një qasje ndaj gjuhës që bazohet tek përvoja jonë me botën dhe mënyra se si ne e perceptojmë dhe konceptojmë atë (Ungerer & Schmid, 1996: x).

Në vitet tetëdhjetë, filloi të zhvillohet një qasje e re për studimin e gjuhës: Gjuhësia Njohëse. Kjo shkollë e gjuhësisë lindi si një reagim ndaj qasjeve formale të gjuhës, të tilla si Gramatika Gjenerative e Noam Chomsky (p.sh. 1957, 1965). Gjuhësia Njohëse hedh poshtë pretendimet kryesore të Gjuhësisë Gjenerative se: (1) gjuha është një aftësi njohëse e lindur dhe autonome; (2) të njohësh një gjuhë do të thotë të njohësh gramatikën e saj, e cila përbëhet nga një numër i caktuar rregullash ndërlidhëse; (3) sintaksa (forma) është fokusi kryesor i analizës gjuhësore (dhe kështu semantika (kuptimi) anashkalohet ndjeshëm). Lindja e Gjuhësisë Njohëse i ka rrënjët edhe në shfaqjen e brezit të dytë Shkencës Njohëse në vitet 1970, veçanërisht në kërkimet mbi kategorizimin njerëzor (Rosch, 1973, 1975). Fusha e Gjuhësisë Njohëse përcaktohet nga dy angazhime: (1) Angazhimi Përgjithësues dhe (2) Angazhimi Njohës. Angazhimi Përgjithësues parfaqëson përkushtimin për të karakterizuar parimet e përgjithshme që rregullojnë të gjitha aspektet e gjuhës së njeriut: fonologjinë, sintaksën, semantikën dhe pragmatikën, ndërsa Angazhimi Njohës parfaqëson përkushtimin për të siguruar një karakterizim të atyre parimeve që pasqyrojnë gjithçka që dihet për njohjen njerëzore. Prandaj, studiuesit e gjuhësisë njohëse i përmbahen angazhimit për të karakterizuar parimet e përgjithshme që rregullojnë të gjitha aspektet e gjuhës njerëzore duke i qëndruar besnikë zbulimeve empirike nga disiplinat paralele të shkencës njohëse të tilla si psikologjia njohëse, psikologjia zhvillimore dhe kërkimeve psikofizike për natyrën e mendjes sonë dhe të inteligjencës artificiale.

Gjuhësia Njohëse mban një qëndrim filozofik të quajtur *eksperimentalizëm*, i cili i kundërvihet *objektivizmit*. Objektivizmi ka qenë këndvështrimi mbizotërues në traditën perëndimore që nga koha e Platonit dhe Aristotelit deri në shekullin e XX. Për objektivistët, ekziston një botë e jashtme objektive që është e pavarur nga perceptimet dhe marrëdhëniet tona me të, ndërsa për eksperimentalistët, kjo botë e jashtme nuk është plotësisht e pavarur nga perceptimet dhe ndërveprimet tona. Objektivistët pretendojnë se të menduarit është manipulimi i simboleve. Këto simbole e fitojnë kuptimin nga lidhja e tyre e drejtpërdrejtë me botën e jashtme. Prandaj, mendja jonë është pasqyrë e realitetit dhe e pavarur nga organet tona. Në të kundërt, për eksperimentalistët, të menduarit nuk është një manipulim i thjeshtë mekanik i simboleve; të kuptuarit e botës nga ne nuk është i drejtpërdrejtë, por ai kufizohet ose ndërmjetësohet në masë të madhe nga sistemet tona konceptuale dhe perceptuese. Natyra e veçantë e trupit dhe trurit tonë, veçanërisht sistemi ynë sensor-motor, formësojnë mundësitë tona të vërteta për konceptualizim dhe kategorizim (Lakoff dhe Johnson, 1999: 19-22). Kështu, mendimi dhe gjuha *mishërohen*, dmth, bazohen në përvojat tona me mjedisin ku jetojmë.

Gjuhësia Njohëse duhet të shihet si *lëvizje* ose *sipërmarrje*, dhe jo si një teori e caktuar (Evans & Green 2006: 3; Cuenca & Hilferty, 1999: 22). Ajo është një qasje e cila zbaton një sërë parimesh dhe supozimesh udhërrëfyese, të cilat kanë çuar në drejtime të ndryshme kërkimore dhe në propozimin e disa teorive¹. Supozimet ose parimet themelore të Gjuhësisë Njohëse mund të përmbledhen si më poshtë: (1) Gjuha nuk është një sistem modular në trurin tonë; (2) Gjuha pasqyron parimet e përgjithshme të njohjes; (3) Gjuha dhe njohja mishërohen, dmth, kategoritë tona gjuhësore dhe konceptuale, bazohen në përvojat fizike, sociale dhe kulturore; (4) Gjuha mbi të gjitha ka të bëjë me kuptimin; gjuha është mjet i kuptimit dhe gjithashtu një dritare për konceptualizim; (5) ekzistojnë parime të përbashkëta strukturuese të cilat shtrihen në të gjitha fushat gjuhësore (fonologji, morfologji, sintaksë, semantikë dhe pragmatikë).

Pasi kemi trajtuar lindjen e Gjuhësisë Njohëse dhe supozimet kryesore të saj, le të

¹Evans, Bergen & Zinken (2007) dallojnë dy degë kryesore në lëvizjen për gjuhësinë njohëse: (1) Semantikën Njohëse (Lakoff 1987; Langacker, 1987; Fillmore, 1985; Talmy, 2000a, 2000b) dhe (2) qasjet njohëse ndaj gramatikës të tilla si Gramatika Njohëse e Langacker (1987, 1991, 2005) dhe Gramatika e Ndërtimit (Bergen & Chang, 2005; Goldberg, 1995; Hilferty, 2003; Kay & Fillmore 1999). Disa nga teoritë e zhvilluara në kuadrin e Semantikës njohëse janë Teoria Njohëse e Metaforës dhe Metonimisë (Lakoff & Johnson, 1980; Lakoff, 1987; Turner, 1996; Soriano, 2005), dhe Teoria e Shkrirjes (Fauconnier, 1994; Fauconnier & Turner, 2002).

kalojmë tek një nga fushat kryesore të kërkimit në gjuhësinë njohëse: Semantika Njohëse

2.1.3. Semantika Njohëse

Semantika Njohëse lindi nga pakënaqësia me teoritë formale të kuptimit që bazoheshin në pikëpamjen objektivistike për botën. Në teoritë formale të tilla si semantika e të vërtetës së kushtëzuar, kuptimi shihej si lidhje midis botës dhe fjalëve, tërësisht i palidhur me njohjen njerëzore (Sweetser, 1990: 4). Në të kundërt, semanticienët njohës e konsiderojnë kuptimin gjuhësor si shfaqje të strukturës konceptuale, e cila del nga përvoja trupore. Për pasojë, Semantika Njohëse merret me marrëdhëniet midis përvojës, njohjes dhe gjuhës, duke eksploruar lidhjet ndërmjet përvojës trupore njerëzore, sistemit konceptual dhe strukturës semantike të shprehur nga gjuha.

2.1.3.1. Parimet dhe drejtimit kryesore të kërkimit

Sikurse Gjuhësia Njohëse, edhe Semantika Njohëse nuk është një teori më vete. Më saktë, semanticienët njohës udhëhiqen nga katër supozime apo parime themelore të cilat janë përmbledhur nga Evans & Green (2006: 157):

1. Struktura konceptuale është e mishëruar: Sistemi ynë konceptual lind nga përvojat tona trupore dhe merr kuptim pikërisht nga fakti që bazohet tek këto përvoja. Nga ky supozim rrjedh se çdo teori e strukturës konceptuale duhet të jetë në harmoni me mënyrat se si ne e përjetojmë botën rreth nesh.
2. Struktura Semantike është strukturë konceptuale: Kuptimet që konvencionalisht lidhen me fjalët dhe njësitë e tjera gjuhësore mund të barazohen me konceptet². Kjo nuk do të thotë që struktura semantike dhe struktura konceptuale janë identike: konceptet gjuhësore janë vetëm një pjesë e koncepteve të mundshme në mendjen e folësit.
3. Përfaqësimi i kuptimit është enciklopedik: Fjalët nuk përfaqësojnë ‘tufa kuptimesh të paketuara mjeshtërisht por shërbejnë si pika përfaqëseje në magazinat e mëdha të dijes’ (Evans & Tyler, 2006: 160). Për të realizuar kuptimin e një kumtimi të dhënë, ne

² Në dallim nga qasjet e tjera, studimi i kuptimit të fjalëve të klasës së hapur (emrat, foljet dhe mbiemrat) dhe fjalëve të klasës së mbyllur (parafjalët, lidhësat, ndajfoljet, etj.) hyn në sferën e semantikës njohëse. Në fakt, Talmy përqendrohet kryesisht tek fjalët e klasës së mbyllur ose tek sistemet gramatikore, pasi sistemi i klasës së mbyllur në gjuhë është sistemi më themelor dhe gjithpërfshirës i strukturimit konceptual të saj (Talmy, 2000a: 13).

mbështetemi në njohuritë tona enciklopedike për situatën specifike të përshkruar nga kumtimi për të ndërtuar kuptimin e tij.

4. Ndërtimi i kuptimit është konceptualizim: Kuptimi nuk është diçka fikse, por një çështje ndërtimore dhe konvencionaliteti. ‘Ndërtimi i kuptimit është [...] një proces dinamik ku njësitë gjuhësore shërbejnë si nxitës për një sërë operacionesh konceptuale dhe për rekrutimin e sfondit të dijes. Sipas kësaj pikëpamjeje, kuptimi është më shumë një proces se sa diçka e dallueshme që mund të paketohej’ nga gjuha.’ (Evans & Tyler, 2006: 162).

Tani që kemi parashtruar katër supozimet themelore të Semantikës Njohëse, mund të bëjmë një pasqyrim të shkurtër të disa prej çështjeve kryesore të studiura sipas kësaj qasjeje: natyra enciklopedike e kuptimit, kategorizimi, baza trupore e kuptimit dhe struktura konceptuale.

Natyra enciklopedike e kuptimit

Gjuhësia formale mbron pikëpamjen se kuptimi mund të ndahet në një përbërës fjalësor dhe një përbërës enciklopedik. Përbërësi fjalësor është objekti i vetëm i studimit për *semantikën leksikore*, ndërsa përbërësi enciklopedik është i huaj për semantikën leksikore pasi ai i përket fushës së dijes botërore ose *pragmatikës*. Pikëpamja fjalësore e kuptimit e ndan kuptimin themelor (semantika) nga kuptimet jo-themlore që shfaqen në kontekst (pragmatika). Zhvillimet e studimeve njohëse kanë treguar, se kuptimi dhe struktura e një fjale mësohen në zhvillim, në mënyrë progresive, përmes gjuhës së folur në tekstet e shkruara, përmes aftësimit në të shkruar, modeleve të tingujve dhe koncepteve të të folurit dhe të shkruarit (Thomai, 1989: 107). Për semanticienët njohës nuk ka dallim të tillë ndërmjet semantikës dhe pragmatikës. Ata mendojnë se ka vetëm kuptim enciklopedik, i cili përfshin edhe njohuritë fjalësore (Evans, Bergen dhe Zinken, 2007).

Studimet mbi natyrën enciklopedike të kuptimit janë përqendruar në mënyrën e organizimit të kuptimit të fjalës; njohuritë enciklopedike që ne kemi për një fjalë të caktuar nuk janë një rrëmujë e çorganizuar, por janë të strukturuar. Siç shprehet dhe gjuhëtari Rami Memushaj, ‘kuptimi i fjalës nuk pasqyron vetëm lidhjen e saj me një aspekt të dhënë të botës reale. Në të vërtetë ai duhet marrë si një rezultante e tipareve semantike që dalin nga përkatësia e fjalës, në një apo disa sisteme leksikore. Në kuptimin e fjalës shfaqen lidhje ndërvarësie të ndërlikuara brenda sistemit leksikor dhe me botën e koncepteve, lidhje që përcaktojnë edhe semantikën e fjalëve. Kuptimi i një fjale ka disa aspekte. Konceptet tona mbi gjithçka që na rrethon janë të lidhura në një mënyrë të tillë

që as nuk mund të ekzistojnë dhe as të kuptohen pa njëra tjetrën. Në gjuhën e semantikës këto sisteme konceptesh mbi dukuri apo fjalë që lidhen midis tyre quhen *fusha konceptore*. Secila nga fjalët e një fushe leksikore mbulon një koncept të caktuar të saj. (Memushaj, 2002: 160). Një nga teoritë mbi organizimin e kuptimit të fjalës është Semantika e Kornizës (frame) nga Charles Fillmore (p.sh., 1977, 1985) sipas të cilës kuptimet e fjalëve organizohen në *korniza*: struktura të hollësishme njohurish që krijohen nga përvojat tona të përditshme. Një kornizë e caktuar ndërlidh subjekte që shoqërohen me një situatë të caktuar. Për shembull, korniza BLEJ përbëhet nga blerësi, shitësi, mallrat dhe paratë (Fillmore, 1977: 104). Sipas Fillmore, kuptimet e fjalëve përftohen në bazë të lidhjes së tyre me një kornizë të caktuar. Kështu, kuptimi i foljeve *blej* ose *shes* (shih shembujt më poshtë të marrë nga Fillmore, 1977: 104) nuk mund të përftohet në mënyrë të pavarur nga korniza BLEJ me të cilën ato janë të lidhura. Folja *blej* profilizon blerësin (Peter) përkundrejt të gjithë kornizës, ndërsa folja *shes* profilizon shitësin (Mary).

- (1) a. Peter bought a DVD player from Mary
- b. Mary sold a DVD player to Peter

Me pak fjalë, për të përfutur kuptimin e fjalëve ne doemos evokojmë një kornizë. Një tjetër konstrukt i ngjashëm teorik mund të shihet tek *skriptet* e Schank & Abelson (1977), të cilat Ungerer & Schmid (1996: 231-214) i përcaktojnë si ‘struktura njohurish të projektuara posaçërisht për sekuenca ngjarjesh që përsëriten shpesh’. Për shembull, skripti RESTORANT ndahet në katër skena ose sekuenca: hyrja në restorant, porosia, ngrënia dhe dalja.

Propozime të tjera lidhur me mënyrën se si ne i organizojmë përvojat tona në rrjete njohurish janë edhe *Modelet e Idealizuara të Njohjes* nga George Lakoff (1987), *Hapësirat Mendore* nga Gilles Fauconnier (1994) dhe *Fushat Njohëse* nga Ronald Langacker (1987). Në teorinë e Langacker, ‘fushat janë domosdoshmërisht njësi njohëse: përvojat mendore, hapësirat përfaqësuese, konceptet apo komplekset konceptuale’ (1987: 147). Konceptet tona mund të përshkruhen për nga *profili* dhe *baza*; *profili* i një fjale është pjesa e strukturës së saj semantike që është në qendër të vëmendjes, ndërsa *baza* është pjesa e strukturës së saj semantike e cila nuk është në qendër të vëmendjes por që është e nevojshme për të kuptuar profilin. Ashtu si me kornizat, kuptimi i një fjale mund të përftohet vetëm nëse kuptohet edhe një sistem më i madh konceptesh. Për shembull, koncepti GJURI (profili) nënkupton konceptin e këmbës (baza); për të përfutur kuptimin e fjalës GJURI, duhet të dimë se ajo

është një pjesë apo nyje e veçantë e këmbës.

Kategorizimi

Një fenomen tjetër që ka marrë vëmendje të madhe brenda semantikës njohëse është kategorizimi, dmth, aftësia jonë për të identifikuar njësitet si anëtarë të grupeve ose kategorive. Hulumtimet e bëra nga Eleanor Rosch gjatë viteve 1970 sfiduan pikëpamjen klasike për kategoritë, të cilat shiheshin si tërësia e kushteve të nevojshme dhe të mjaftueshme me kufinj të qartë që favorizojnë organizimin prototip të kategorive. Gjetjet e Rosch treguan se kufijtë ndërmjet kategorive janë të paqartë. Për shembull, për kategorinë ZOG, harabelat ose gushëkuqët konsiderohen si shembuj më të mirë ose si anëtarë prototipikë ndërsa pinguinët dhe strucat konsiderohen më pak zogj.

Nocioni i George Lakoff i për Modelet e Idealizuara të Njohjes (1987) mund të konsiderohet si zbatimi në gjuhë i vëzhgimeve të Rosch për prototipinë. Sipas Lakoff (1987), ne i organizojmë njohuritë tona me anë të strukturave të quajtura Modele të Idealizuara të Njohjes (MINj); anëtarët prototip janë ato që përputhen me supozimet dhe pritshmëritë themelore të MINj për përfaqësimin tonë ideal të botës. Le ta ilustrojmë idenë e MINj me shembullin klasik të fjalës BEQAR: Kazanova do të përputhej në mënyrë të përkryer me MINj tonë të të qenit beqar, sepse ai është i pamartuar por i martueshëm, kurse Papa nuk do të përputhej po aq mirë me këtë kategori. Papa, edhe pse i pamartuar, nuk është një beqar prototip, sepse koncepti Papë kuptohet më shpesh në kuadrin e MINj të KISHËS KATOLIKE ROMAKE, klerikët e të cilës nuk mund të martohen.

Baza trupore e kuptimit: skemat e imazhit

Në librin e tij të vitit 1987, *Trupi në Mendje: Baza Trupore e Kuptimit, Imagjinatës dhe Arësyes*, filozofi njohës Mark Johnson prezantoi nocionin e *skemës së imazhit*. Sipas fjalëve të tij, 'një skemë imazhi është një model i përsëritur dinamik i ndërveprimeve tona perceptuese dhe programeve motore që i jep koherencë dhe strukturë përvojës sonë' (Johnson, 1987: xiv).

Le të marrim një shembull: skema e imazhit ENË. Ne i manipulojmë objektet duke i vendosur ato në enë (filxhana, kuti, çanta, etj.). Po ashtu ne jemi të ndërgjegjeshëm për trupat tanë si enë ku ne fusim ushqim, ujë, ajër dhe nxjerrim gjëra të tjera (ajër, gjak, ushqim, etj.). Në secilin prej këtyre rasteve përsëritet e njejta strukturë hapësinore, përkatësisht skema e imazhit ENË. Skemat e imazhit kanë një sërë cilësish: (a) ato janë parakonceptuale dhe paragjuhësore, dmth, ato rrjedhin nga perceptimi ndijor që mundëson mendimin paraverbal

dhe hedh themelet për përvetësimin e gjuhës (Mandler, 1992, 2004). (b) skemat e imazhit janë të strukturuar; një skemë përbëhet nga një numër i vogël pjesësh që qëndrojnë në marrëdhënie të thjeshta, me anë të të cilave ajo mund të strukturojë një pafundësi perceptimesh, imazhesh dhe ngjarjesh. Kështu, skemat e imazhit përbëjnë bazën e koncepteve tona. (c) Ato nuk janë imazhe të pasura, konkrete apo fotografi mendore; ato nuk kanë veçorinë e imazheve ose fotografive mendore kaq të pasura. Në fakt ato veprojnë në nivelin e përgjithësitimit dhe abstragimit (Johnson, 1987: 23-24).

Struktura konceptuale

Semanticienët njohës nisen nga supozimi se struktura semantike pasqyron strukturën konceptuale. Ata merren me mekanizmat e strukturimit konceptual të pasqyruara në strukturën gjuhësore dhe me mënyrën se si rezultatet që lidhen me përfaqësimin gjuhësor të përmbajtjes konceptuale duhen lidhur me proceset njohëse më të përgjithshme. Sipas semanticienit njohës Leonard Talmy, gjuha është ‘një sistem i funksionimit mendor përmes të cilit mendja mund të studiohet më në përgjithësi’ (Ibarretxe - Antuñano, 2006c: 254). Analiza e strukturës konceptuale dhe gjuhës është e rëndësishme dhe themelore për studimin e njohjes pasi ajo shërben si pikënisje për të kuptuar më tej parimet organizative të sistemeve të tjera, si duke përgjithësuar ngjashmëritë ashtu edhe duke ballafaquar dallimet.

Seksioni i mëposhtëm do të bëjë një përshkrim të hollësishëm të teorisë së Leonard Talmy për strukturën konceptuale.

2.1.3.2. Semantika Konceptuale sipas Talmy

Leonard Talmy është një nga pionierët e gjuhësisë njohëse gjatë viteve 1970. Në hyrjen e tij të dy vëllimeve të vitit 2000 nën titullin e përgjithshëm *Drejt një Semantike Njohëse*, ai në mënyrë të qartë karakterizon kërkimin në semantikën njohëse dhe metodologjinë kryesore që duhet ndjekur: ‘Kërkimi në semantikën njohëse është kërkim në përmbajtjen konceptuale dhe organizimin e saj në gjuhë dhe rrjedhimisht [kërkim] në natyrën e përmbajtjes konceptuale në përgjithësi’ (Talmy, 2000a: 4). Për më tepër, ai pohon se *analiza e brendshme* është metodologjia e duhur për të hyrë në përmbajtjen konceptuale. Duke qenë se objekti i studimit është kuptimi dhe ‘kuptimi gjendet në përvojën e vetëdijshme’, analiza e brendshme e çon studiuesin atje ku gjenden të dhënat subjektive. Ai argumenton se ‘përdorimi i analizës së brendshme duhet pranuar si një metodologji e përshtatshme dhe e nevojshme në shkencën e njohjes, së bashku me

metodologjitë e tjera përgjithësisht të pranuar' (Talmy, 2000a: 6).

Ashtu siç shfaqet në gjuhë, sistemi ynë konceptual përbëhet nga dy sisteme: *sistemi konceptual i përmbajtjes* dhe *sistemi konceptual i strukturimit*. Të marra së bashku, këto dy sisteme kontribuojnë në ndërtimin e aspekteve të ndryshme të të kuptuarit tonë të një skene. Siç sugjerojnë edhe emërtimet e tyre, sistemi konceptual i strukturimit jep skeletin e një skene të caktuar, ndërsa sistemi konceptual i përmbajtjes jep informacion të pasur material. Kështu, kuptimet që lidhen me sistemin konceptual të strukturimit janë mjaft skematike, ndërsa ato që lidhen me sistemin konceptual të përmbajtjes janë shumë të hollësishme. Në gjuhë shfaqja e dy sistemeve të përfaqësimit tonë njohës bëhet nga sistemet *gramatikore* dhe *leksikore*.

Sistemi gramatikor apo *sistemi i klasës së mbyllur* përfshin llojin *e hapur* dhe llojin *abstrakt* ose të nënkuptuar të formave gramatikore. Format e llojit të hapur mund të jenë të lidhura ose të lira. Forma të hapura dhe të lidhura janë mbaresat, fjalët e prejardhura, dhe morfemat e lira. Format e hapura dhe të lira mund të përfshijnë, për shembull, përemrat dëftorë, parafjalët, lidhësat dhe pjesëzat. Talmy mendon se në llojin e hapur mund të përfshihen edhe format mbisegmentale, të tilla si modelet e intonacionit. Lloji abstrakt apo i nënkuptuar i formave të klasës së mbyllur mund të përfshijë kategoritë kryesore gramatikore (p.sh., emër, folje), nën-kategoritë gramatikore (p.sh., emër i numërueshëm, emër kolektiv), marrëdhëniet sintaksore (p.sh., kryefjalë, kundrinor i drejtë), modelet e rendit të fjalëve, etj. 'Ndoshta në klasat e mbyllura mund të përfshihen edhe kategori të caktuara të komplekseve gramatikore, duke përfshirë, për shembull, ndërtimet gramatikore, strukturat sintaksore dhe strukturat plotësuese' (Talmy, 2000a: 23). Nga ana tjetër, *sistemi leksikor* ose *i klasës së hapur*, përfshin morfemat rrënjore të emrave, foljeve, mbiemrave si shprehjet frazeologjike. (Talmy, 2000a: 22).

Në tërësi, nënsistemet gramatikore dhe leksikore duket se specifikojnë pjesë të ndryshme të një përfaqësimi njohës; elementet gramatikore të një fjalie përcaktojnë shumicën e strukturës së saj, ndërsa elementet leksikore së bashku kontribuojnë në shumicën e përmbajtjes së saj. 'Specifikimet gramatikore në një fjali, pra, sigurojnë një kornizë konceptuale apo një strukturë skeletore për materialin konceptual që specifkohet leksikalisht' (Talmy, 2000a: 21).

Megjithëse vepra e Talmy ka shqyrtuar si sistemet leksikore ashtu edhe sistemet gramatikore, ai është marrë kryesisht me semantikën e sistemit të klasës së mbyllur. Ndërsa është e pamundur të propozohet një inventar përfundimtar i koncepteve të klasës së hapur, Talmy pretendon se ekziston një inventar universalisht i disponueshëm

konceptesh të mishëruara në format e klasës së mbyllur. Një gjuhë shpreh një përzgjedhje të këtyre koncepteve, por ajo nuk shpreh domosdoshmërisht të gjitha konceptet e disponueshme. Duke shqyrtuar semantikën e sistemeve të klasës së mbyllur tek gjuhët, ai identifikon një numër *sistemesk skematike* që i japin strukturë sistemit tonë konceptual.

Sistemet skematike

Sistemi i strukturimit konceptual, sipas Talmy, bazohet në një numër *sistemesk skematike*³. Këto sisteme skematike përbëjnë arkitekturën bazë mbi të cilën qëndron kuptimi me përmbajtje të pasur (format e klasës së hapur). Në një intervistë me Ibarretxe-Antuñano (2006), Talmy identifikon pesë sisteme kryesore skematike: (1) Sistemi konfigurues; (2) Sistemi këndvështrimor; (3) Sistemi i Vëmendjes; (4) Sistemi i Dinamikës së Forcës, dhe (5) Sistemi i Gjendjes Njohëse.

Sistemi i parë skematik, *Sistemi Konfigurues*, përfaqëson strukturën për hapësirën ose kohën dhe e ndan skenën në pjesë dhe pjesëmarrës. Ai përfshin shumëçka gjendet brenda skemave që evokohen nga parafjalët hapësinore, nga lidhësat kohore dhe nga treguesit e aspektit dhe kohës. Për shembull, sintagma *në shtëpi* paraqet një pikë në hapësirë, sintagma *për pesë minuta* një shtrirje në kohë, etj.

Ndërsa sistemi i parë skematik krijon përvijimet themelore sipas të cilave strukturohet një skenë apo ngjarje e caktuar, sistemi i dytë skematik, *Sistemi Këndvështrimor*, përcakton këndvështrimin nga i cili shikohet një skenë me sytë e mendjes. Sistemi Këndvështrimor, më së paku, përfshin dallimet konceptuale në vijim: vendndodhjen hapësinore ose kohore brenda një kornize më të gjerë, largësinë nga subjekti referues, ndryshimin ose mungesën e ndryshimit të pikës së tij këndvështrimore në rrjedhën e kohës si dhe trajektoren që ndjek dhe drejtimin e shikimit. Për shembull, në fjalinë (2) kemi një vendndodhje të brendshme këndvështrimore, dmth, sytë e mendjes sonë janë brenda dhomës. Ndërsa në fjalinë (3) skena shihet nga jashtë dhomës, me fjalë të tjera, kemi një vendndodhje këndvështrimore të jashtme.

(2) The room door slowly opened and two men walked in.

(3) Two men slowly opened the room door and walked in.

³ Në pjesën e parë të vëllimit 1 (200) Talmy prezanton nocionin e *sistemesk skematike*. Në tre pjesët e tjera të atij vëllimi ai u kushton kapituj më vete tre sistemesk skematike: Sistemit Konfigurues, Sistemit të Vëmendjes dhe Sistemit të Dinamikës së Forcës. Një përmbledhje e plotë e sistemesk skematike të Talmy gjendet edhe tek Evans & Green (2006: Seksioni 6.2.2, Seksioni 15.2).

Sistemi i tretë skematik, *Sistemi i Vëmendjes*, përcakton si duhet shpërndarë vëmendja në skenë. Në shembullin (4), qendra e vëmendjes është tek shitësi, ndërsa në shembullin (5) qendra e vëmendjes vendoset tek blerësi me vëmendje më të vogël tek pjesa e mbetur.

- (4) The *clerk* sold the vase to the customer.
- (5) The *customer* bought the vase from the clerk.

Për më tepër, ka edhe modele të shpërndarjes së vëmendjes, si *përqëndrimi i vëmendjes*, në të cilat u kushtohet vëmendje më e madhe një ose më shumë pjesëve (të shkëputura) brenda një scene të caktuar. Në shembullin (6) gjejmë një përqëndrim maksimal të vëmendjes mbi të gjithë trajektoren e ngjarjes. Në të kundërt, në shembullin (7) ka një përqëndrim të vëmendjes në fundin e trajektores.

- (6) The box fell *out of* the plane *through* the air *into* the ocean. = përqëndrim maksimal gjatë gjithë trajektores
- (7) The box fell *into* the ocean = përqëndrim fundor i vëmendjes

Të tre sistemet e paraqitura më lart mund të plotësohen nga një sistem i katërt skematik, *Sistemi i Dinamikës së Forcës*, i cili merret me forcat e ushtruara dhe ndërveprimet shkakësore midis subjekteve⁴ në skenën përkatëse. Këtu përfshihen ushtrimi i forcës, rezistenca ndaj kësaj force, kapërcimi i kësaj rezistence, bllokimi i shprehjes së forcës, heqja e këtij bllokimi, etj. Dinamika e Forcës i referohet jo vetëm ndërveprimeve të forcës fizike, por edhe ndërveprimeve psikologjike dhe sociale, të konceptuara si presione psikologjike.

Është edhe një sistem i pestë skematik, *Sistemi i Gjendjes Njohëse*. Ky sistem skematik përfshin vullnetin dhe qëllimin e një vepruesi të ndjeshëm. *Vullneti* është një ngjarje njohëse tek një veprues i ndjeshëm që shkakton disa lëvizje të trupit ose të pjesëve të trupit të vepruesit. Si gjendje e veçantë njohëse, *shtrirja e qëllimit* të vepruesit është shuma e një zinxhiri shkakësor që Vepruesi synon të ndodhë. Një tjetër ndarje e

⁴ Talmy (2000a:413) shprehet se dallimi i parë që gjuha shënon këtu është dallimi i roleve midis dy subjekteve që ushtrojnë forcat. Njëri subjekt veçohet për vëmendje fokale – çështja kryesore në ndërveprim është nëse subjekti është në gjendje të shfaqë tendencën e forcës së tij, ose në të kundërt, ta tejkalojë atë. Subjekti i dytë konsiderohet për ndikimin që ka tek i pari, duke e tejkaluar atë ose jo. Subjekti i forcës fokale quhet *Agonist* dhe elementi i forcës që i kundërvihet atij quhet *Antagonist*.

madhe brenda sistemit skematik të gjendjes njohëse është *epistemika*, e cila i referohet karakterizimeve të gjendjeve të dijes të një subjekti të ndjeshëm. Kjo ndarje përfshin dallimet e llojit dëftore-lidhore, format që shprehin probabilitetin dhe mundësinë, etj.

Në tërësi, këto pesë sisteme skematike lidhen me aspektet themelore të përvojës sonë të mishëruar. Tre sistemet e para skematike (Konfigurues, Këndvështrimor dhe i Vëmendjes) kanë të bëjnë shumë me perceptimin tonë pamor ndërsa dy sistemet e fundit skematike (Dinamika e Forcës dhe Gjendja Njohëse) kanë të bëjnë me përvojën tonë trupore, me forcat, presionet, etj., dhe me qëllimet, njohuritë dhe pritshmëritë tona.

2.2. Teoria e Talmy për modelet leksikalizuese të foljeve të lëvizjes

2.2.1. Hyrje

Në vëllimin II të *Drejt një Semantike Njohëse* (2000), Leonard Talmy shqyrton marrëdhëniet sistematike në gjuhë ndërmjet kuptimit dhe formave të hapura gjuhësore, me fjalë të tjera, procesin e leksikalizimit: ‘Kemi të bëjmë me leksikalizim aty ku një përbërës i veçantë kuptimor shoqërohet rregullisht me një formant gramatikor’ (Talmy, 2000b: 24).

Supozimi i tij themelor është se ne mund të izolojmë veçmas elemente apo përbërës në fushën e kuptimit dhe në fushën e të shprehurit gjuhësor. Më pas, hapi tjetër që ndërmerr një semanticien është që të shqyrtojë se cilat elemente semantike shprehen nga cilët elemente gjuhësore. Talmy vëren se kjo nuk është marrëdhënie një-për-një; një kombinim elementësh semantikë mund të shprehet me një element të vetëm gjuhësor, dhe një element i vetëm semantik mund të shprehet me një kombinim elementësh gjuhësorë. Për më tepër, elemente semantike të llojeve të ndryshme mund të shprehen nga i njëjti lloj elementi sipërfaqësor, dhe i njëjti lloj i elementeve semantike mund të shprehet nga disa elemente të ndryshëm sipërfaqësorë. Për ilustrim, një folje e lëvizjes (element sipërfaqësor) mund të shprehë lloje të ndryshme të informacionit semantik: Mënyrën e lëvizjes (p.sh. , *hidhem*), Shkakun (p.sh. , *shkelmoj*) dhe Trajektoren (p.sh., *dal*, *hyj*). Nga ana tjetër, elementi Trajektore mund të shprehet tek foljet dhe parafjalët (p.sh., *jashtë*, *në*), dmth, nga dy elemente të ndryshëm gjuhësorë. Sipas Talmy, duke kqyrur marrëdhëniet mes kuptimit dhe formave gjuhësore, mund të nxjerrim një varg parimesh universale dhe modelesh tipologjike⁵.

⁵ Talmy (2000b: Kapitulli 2, Seksioni 3) jep një klasifikim shterrues të llojeve të ndryshme të tipologjive dhe universaleve duke përmbledhur dhe organizuar gjetjet e studimeve të tij.

Në tërësi, qasja e tij ndaj leksikalizimit mund të përmbledhet si më poshtë (përshtatur nga (1) tek Talmy (2000b: 22)):

- a. Përcaktohen njësitë⁶ e ndryshme semantike në një gjuhë.
- b. Përcaktohen njësitë e ndryshme sipërfaqësore në atë gjuhë.
- c. Vëzhgohet cilat njësi të ndryshme semantike (a) shprehen me anë të cilave njësi ndryshme sipërfaqësore (b) - në çfarë kombinimi dhe me çfarë marrëdhënieje - duke vënë në dukje çdo model.
- d. Krahasonen modelet e tipit (c) në gjuhë të ndryshme, duke vënë në dukje çdo metamodel (parime universale)
- e. Krahasonen modelet e tipit (c) nëpër faza të ndryshme të së njejtës gjuhë përgjatë kohës, duke vënë në dukje çdo ndryshim ose mosndryshim që mund të udhëhiqet nga një parim i caktuar universal (ose një metamodel i tipit (d).)
- f. Konsiderohen proceset dhe strukturat njohëse që mund të jenë shkak i dukurive të vërejtura nga (a) deri në (e).

Së fundi, për të shqyruar marrëdhëniet kuptim-shprehje gjuhësore mund të zbatohen dy drejtime apo këndvështrime të cilat të kanë rezultuar të frytshme. Një drejtim është që të mbahet e pandryshuar një sipërfaqe apo njësi gjuhësore e përzgjedhur dhe të vëzhgohet cilat njësi semantike shprehen në mënyra të ndryshme prej saj, dhe drejtimi tjetër është të mbahet e pandryshuar një njësi semantike e caktuar dhe të vëzhgohen sipërfaqet ose njësitë gjuhësore ku ajo mund të shfaqet. Nga zbatimi i secilit prej këtyre dy drejtimeve të mundshme rezultojnë edhe dy tipologjitë e propozuara nga Talmy, tipologjia e trefishtë (Talmy, 1972, 1985) dhe tipologjia e dyfishtë e gjuhëve (Talmy, 1991, 2000b), të cilave ne do t'u kushtojmë përkatësisht seksionet 2.2.3 dhe 2.2.4.

Me pak fjalë, shqetësimi i Talmy është të gjejë nëse, për një fushë semantike të veçantë, gjuhët shfaqin një shumëllojshmëri të gjerë modelesh, një numër të vogël modelesh (dmth, një tipologji), apo një model të vetëm (dmth, universale). Një nga fushat e preferuara të hulumtimeve të tij është fusha semantike e Lëvizjes, megjithëse gjetjet e tij përgjithësohen edhe për fusha të tjera⁷. Ai ka shqyrtuar strukturën konceptuale të ngjarjeve të lëvizjes, si edhe modelet tipologjike në të cilat shprehet kjo

⁶Sipas Talmy, njësitë janë elemente, marrëdhënie dhe struktura: si rastet e veçanta ashtu edhe kategoritë e tyre (Talmy, 2000b: 22).

⁷ Talmy (1991) sugjeron se tipologjia e ngjarjeve të lëvizjes shtrihet edhe në pesë ngjarje të tjera: konturimi kohor, ndryshimi i gjendjes, marrëdhënia dhe realizimi i veprimt. Për shembuj, shiko Seksionin 2.2.4. Për një parashtrim të hollësishëm shiko Talmy (1991) dhe Talmy (2000b: Seksionet 2.5, 2.6, 2.7, dhe 2.8).

strukturë konceptuale. Këto çështje do të trajtohen me hollësi në seksionet në vijim.

2.2.2. Ngjarja e Lëvizjes

Para se të përqëndrohemi në semantikën e një ngjarjeje të lëvizjes, duhet të përcaktojmë çfarë është një ngjarje. Sipas Talmy, një *ngjarje* është një pjesë e realitetit e cila shenjohe ose kufizohet nga mendja njerëzore. Siç shpjegon ai: ‘në perceptim apo konceptualizim mendja e njeriut mund të vendosë një kufi rreth një pjese të asaj që përndryshe do të ishte një vazhdimësi e hapësirës ose kohës dhe mund t’i japë kësaj përmbajtjeje cilësinë e të qenit një njësi e vetme’ (Talmy, 2000b: 215). Për më tepër, një ngjarje mund të konceptohet se ka një lloj të veçantë strukture të brendshme dhe shkalle kompleksiteti. Kështu, ka ngjarje komplekse, të cilat përbëhen nga një ngjarje kryesore ose *ngjarje kornizë* dhe një ngjarje e varur apo *bashkëngjarje* (të cilat të dyja ‘konceptohen si ngjarje unitare’), së bashku me marrëdhënien që bashkëngjarja ka me ngjarjen kornizë.

Talmy konsideron *ngjarje të lëvizjes* si situatën që përmban lëvizje ashtu edhe vazhdimësinë e një vendndodhjeje të palëvizëshme. Sipas fjalëve të tij:

Ngjarja bazike e lëvizjes përbëhet nga një objekt (**Figura**) i lëvizshëm ose e i palëvizshëm në lidhje me një objekt tjetër (objekti referues ose **Terreni**). Sipas analizave, Ngjarja e Lëvizjes ka katër përbërës: krahas **Figurës** dhe **Terrenit**, janë **Trajektorja** dhe **Lëvizja**. **Trajektorja** është rruga e ndjekur apo vendi që zë objekti Figurë në lidhje me objektin Terren. Përbërësi i **Lëvizjes** i referohet vetë pranisë së lëvizjes apo vendndodhjes në ngjarje [...] Krahas këtyre përbërësve të brendshëm, një ngjarje e lëvizjes mund të shoqërohet me një **Bashkëngjarje** të jashtme e cila më shpesh mban lidhje të Mënyrës ose Shkakut me ngjarjen kryesore. (Talmy, 2000b: 25).

Le ta ilustrojmë këtë me shembullin e mëposhtëm nga Talmy:

(8) Harry walked down the stairs.

Harry është *Figura*, *stairs/shkallët* janë *Terreni* dhe *down/poshtë* është *Trajektorja*. Folja, *walk-eci* shpreh njëkohësisht faktin e Lëvizjes (ngjarja kornizë) dhe Mënyrën e lëvizjes (Bashkëngjarja). Sipas Talmy ‘Figura është një subjekt në lëvizje ose konceptualisht i lëvizshëm, trajektorja apo vendndodhja e të cilit është në fokus. Terreni

është një kornizë referuese, ose një objekt referues i palëvizshëm brenda një kornize referuese, në marrëdhënie me të cilin karakterizohet trajektorja ose vendndodhja e Figurës' (Talmy, 2000b: 26).

Në këtë pikë, është e rëndësishme të përcaktojmë dy llojet e lëvizjes që gjenden në ngjarjet e lëvizjes: *lëvizja zhvendosëse* dhe *lëvizja e brendshme*. Sipas fjalëve të Talmy (2000b: 35) 'në lëvizjen zhvendosëse, vendndodhja themelore e një objekti ndryshon nga një pikë në një tjetër në hapësirë. Në lëvizjen e brendshme, një objekt ruan vendndodhje të njëjtë ose 'mesatare'. Lëvizja e brendshme përgjithësisht përbëhet nga lëkundje, rrotullime, zgjerim, tkurrje, përdredhje, endje ose prehje'. Le të konsiderojmë shembujt (9), (10) dhe (11) të marra nga Talmy, për të ilustruar këto nocione.

- (9) Rei entered the room
- (10) The butterfly hovered over the flower
- (11) Klara slid through the korridorit

Shembulli (9) përshkruan ndryshimin e vendndodhjes së Figurës nga jashtë në brendësi të dhomës. Në të kundërt, shembulli (10) tregon lëvizje të brendshme; Figura qëndron mbi lule duke lëvizur krahët e saj. Ndonjëherë, është e vështirë të dallosh lëvizjen zhvendosëse nga lëvizja e brendshme, siç e vëzhgojmë në (11). Folja e mënyrës *slide / rrëshqas* përfshin një përbërës fërkimi (dmth, lëvizje të brendshme) midis Figurës (Klara) dhe Terrenit (korridorit). Megjithatë, një fërkim i tillë mund të ekzistojë vetëm përgjatë lëvizjes zhvendosëse të Figurës (përmes sallës). Kështu, në anglisht, veprimtaria e lëvizjes së brendshme shpesh vendoset në kuadrin e lëvizjes zhvendosëse (Talmy, 2000b: 228-229).

Lëvizja e brendshme lidhet thelbësisht me mënyrën e lëvizjes, me fjalë të tjera, me marrëdhënien e Mënyrës midis bashkëngjarjes dhe ngjarjes së lëvizjes. Në marrëdhënien e Mënyrës, bashkëngjarja ndodh bashkë me ngjarjen e lëvizjes, siç e kemi parë në shembullin (11), dhe konceptohet si një veprimtari shtesë që shfaq Figura e ngjarjes së lëvizjes. Kjo veprimtari ka të bëjë direkt me ngjarjen e lëvizjes, por dallohet prej saj. Megjithatë, lidhja midis bashkëngjarjes dhe ngjarjes së lëvizjes nuk mund të kufizohet vetëm tek Mënyra, pasi gama e kësaj marrëdhënieje mund të jetë më e gjerë (Talmy, 2000b: 42-47):

- a. Lidhja shkakore: Bashkëngjarja mund të paraprijë ngjarjen kryesore të Lëvizjes në rastin e shkakësisë fillestare, ose ajo mund të ndodhë bashkë me ngjarjen kryesore të

Lëvizjes në rastin e shkakësisë së shtrirë' (Talmy, 2000b: 44-45).

(12) Our tent blew down into the gully from a gust of wind

(13) I squeezed the toothpaste out of the tube

b. Lidhja Paraprirëse: Bashkëngjarja paraprin ngjarjen kryesore të lëvizjes, por nuk shkakton apo ndihmon ndodhjen e saj. Në shembullin e mëposhtëm, thërrmimi i gotës paraprin por nuk shkakton lëvizjen e gotës mbi qilim.

(14) The glass splintered onto the carpet.

c. Rezultati i njëkohshëm: Bashkëngjarja rezulton nga ose shkaktohet nga ngjarja kryesore e lëvizjes përndryshe nuk do të ndodhte:

(15) The rocket splashed into the water.

d. Lidhja pasardhëse: Bashkëngjarja ndodh menjëherë pas ngjarjes kryesore të lëvizjes dhe mundësohet nga, shkaktohet nga ose është qëllimi i kësaj ngjarjeje të lëvizjes:

(16) I'll stop down at your office (on my way out of the building).

Tani që kemi bërë një përkufizim të ngjarjes së lëvizjes dhe kemi shqyrtuar përbërësit semantikë që janë baza e konceptualizimit të kësaj ngjarjeje dhe marrëdhëniet e saj të ndryshme me një bashkëngjarje, do të trajtojmë modelet karakteristike leksikalizuese për ngjarjet e lëvizjes. Në dy seksionet e ardhshme, do paraqesim me hollësi⁸ dy tipologjitë e modeleve leksikalizuese të propozuara nga Talmy. Siç e kemi përmendur shkurtimisht në hyrje, tipologjia e trefishtë (Talmy, 1972, 1985) dhe tipologjia e dyfishtë i gjuhëve (Talmy, 1991, 2000b) përfaqësojnë një këndvështrim të ndryshëm për marrëdhëniet midis nivelit semantik dhe nivelit morfosintaksor (gjuhësor). Këndvështrimi i parë mbante të pandryshuar një përbërës morfosintaksor, vetë foljen, dhe shikonte se cilët përbërës semantikë vendoseshin zakonisht në të nga gjuhë të ndryshme. U vërejt se shumica e gjuhëve, krahas faktit të Lëvizjes, zakonisht shprehin tek folja ose Trajektoren, ose Bashkëngjarjen (Mënyrën ose Shkakun) ose Figurën. Në

⁸ Megjithëse disa gjuhëtarë europianë, Bally (1965), Tesnière (1959) dhe Wandruzska (1976) kishin theksuar tashmë dallimet në leksikalizimin e lëvizjes në gjuhët frengjisht dhe gjermanisht, ata nuk kishin bërë një parashtrim sistematik apo teorik të fenomeneve të përfshira.

këndvështrimin e dytë, u mbajt i pandryshuar përbërësi semantik i Trajektores, duke e përqendruar analizën tek përbërësit morfosintaksorë në të cilët ai vendosej zakonisht në gjuhë të ndryshme. U vu re se shumica e gjuhëve zakonisht e vendosin përbërësin Trajektores ose tek rrënja e foljes (në gjuhët me kornizë foljore) ose tek satelitët⁹ dhe/ose parafjalët (në gjuhët me kornizë satelitore).

2.2.3. Tipologjia e trefishtë: Folja

Kjo tipologji rezulton nga kqyrja e përbërësve semantikë të cilët në disa gjuhë leksikalizohen zakonisht te vetë folja. Do të prezantojmë tre modele kryesore leksikalizuese tipike për vetë foljen duke konsideruar nëse, krahas faktit të Lëvizjes, folja shpreh ose Bashkëngjarjen (Mënyrën ose Shkakun), ose Trajektores, ose Figurën.

Brenda një gjuhe mund të ekzistojnë edhe kombinime të tjera ose modele më të vogla, edhe pse gjuhët kategorizohen sipas modelit leksikalizues më karakteristik që shfaqin. Në shumicën e rasteve, në shprehjen e saj më karakteristike të Lëvizjes, një gjuhë përdor te folja vetëm një prej këtyre llojeve.

2.2.3.1. Modeli Leksikalizues: Lëvizje+Bashkëngjarje

Në njërin grup të gjuhëve, ku përfshihen gjuha Finno-Ugrike, Kineze dhe të gjithë degët e gjuhëve indo-evropiane (përveç gjuhëve romane), folja zakonisht shpreh njëherazi Lëvizjen dhe një Bashkëngjarje, zakonisht ose Mënyrën ose Shkakun e Lëvizjes.

- (17) Shprehje në anglisht të Lëvizjes së kombinuar me Mënyrën ose Shkakun marrë nga Talmy (2000: 28)

Lëvizje + Mënyrë

Joveprore

- a. The rock *slid/rolled* down the hill

Veprorë

⁹ Sipas Talmy (2000b: 102), sateliti është 'kategoria gramatikore e çdo përbërësi i cili është në marrëdhënie simotër me rrënjën e foljes'. Brenda kësaj kategorie përfshihen pjesëzat foljore të anglishtes, parashtesat foljore të ndashme dhe të pandashme të gjermanishtes dhe parashtesat foljore të rusishtes.

b. I *twisted* the cork out of the bottle

Vetvetore

c. She *wore* a green dress to the party

Lëvizje + Shkak

Joveprore

d. The napkin *blew* off the table.

Veprore

e. I *pushed* the barrel into the storeroom.

Në këtë pikë, është e nevojshme të përkufizojmë termat *lëvizje joveprore*, *veprore* dhe *vetvetore*. Së pari, lëvizja joveprore ka të bëjë me situata në të cilat subjektet që janë të paaftë për lëvizje më vete kryejnë disa lëvizje. Së dyti, lëvizja veprore i referohet një ngjarjeje të lëvizjes Figura e së cilës lëvizet nga një veprues; vepruesi shkakton lëvizjen, por folja mund të shprehë ose Shkakun e saj ose Mënyrën në të cilën lëviz Figura. Së fundi, lëvizja vetvetore i referohet ngjarjeve në të cilat Figurat janë në gjendje të lëvizin vetë.

2.2.3.2. Modeli Leksikalizues: Lëvizje+Trajektore

Në modelin e dytë tipologjik për shprehjen e lëvizjes, folja kombinon faktin e Lëvizjes me Trajektoren. Këtij modeli i përkasin gjuhët semite, polineziane, romane, koreane, turke, tamil dhe caddo.

- (18) Shembuj në Anglisht të Lëvizjes së kombinuar me Trajektoren të marra nga Talmy (2000: 49-51)

Joveprore

a. The bottle floated into the cave

Veprore

b. I rolled the keg into the storeroom

Siç ilustruhet nga shembujt, rrënjët e foljes në anglisht kombinojnë lehtësisht Bashkëngjarjen, por jo Trajektoren. Ky model leksikalizues nuk është karakteristik, megjithëse anglishtja ka edhe folje që kombinojnë Trajektoren, të tilla si *arrive*, *approach*, *circle*, *cross*, *descend*, *enter*, *exit*, *follow*, *join*, *pass*, *rise*, *return*, *separate*, etj.,

por shumica e tyre janë huazime historike nga gjuhët romane.

2.2.3.3 . Modeli i Leksikalizues: Lëvizje+Figurë

Në modelin e tretë tipologjik, rrënja e foljes kombinon Lëvizjen me Figurën. Anglishtja ka fare pak forma që përputhen me këtë model:

- (19) Shembuj anglisht të kombinimit të Lëvizjes me Figurën të marra nga Talmy (2000b: 57)

Joveprore

- a. It *rained* in through the bedroom window

Veprare

- b. I *spat* into the cuspidor

2.2.3.4. Modele të tjera më të vogla

Ndërsa këto tre sisteme kombinimi për foljet e lëvizjes janë me sa duket më kryesoret që gjenden në gjuhë të ndryshme, Talmy (2000b: 62) vë në dukje edhe modele të tjera leksikalizuese të cilat gjithashtu ndeshen nëpër gjuhë krahas disa të tjerëve që nuk ndeshen. Ai vëren disa sisteme të vogla të foljeve veprare që kombinojnë dy përbërës semantikë:

- a. Terren + Trajektorje + Lëvizje, të tilla si *box / fus në kuti* dhe *shelve / vendos në raft* në shembujt e mëposhtëm:

- (20) I boxed the apples = bëj të futen në kuti

- (21) I shelved the book = bëj të vendosen në raft

- b. Figurë + Trajektore + Lëvizje, të tilla si *powder/pluhuros në*:

- (22) She powdered her nose = bëj që pudra të shkojë në

Këto modele kombinimi me shumë përbërës nuk duket se formojnë modele leksikalizuese karakteristike për shprehjen e Lëvizjes në ndonjë gjuhë. Kombinime të tilla

do të kërkonin një leksik shumë të madh foljesh me kombinime semantike shumë të imta (Talmy, 2000b: 62).

Nga ana tjetër, ka disa kombinime të cilat nuk janë të preferuara. Një përbërës i veçantë i ngjarjes së lëvizjes, Terreni, nuk kombinohet vetvetiu me foljen e lëvizjes për të formuar sistemin apo modelin kryesor për shprehjen e Lëvizjes në ndonjë gjuhë. Ndryshe nga përbërësit e tjerë të ngjarjes së lëvizjes, nuk është e qartë pse përbërësi Terren është kaq i papreferuar. Talmy (2000b: 61) mendon se shpjegimi mund të kërkohej tek koncepti i hierarkisë:

Për nga mbizotërimi i tyre në gjuhët e botës, llojet e ndryshme të kombinimeve duket se renditen kështu: kombinimet e Trajektores janë më gjerësisht të përfaqësuara, pasuar nga kombinimet e Mënyrës/Shkakut dhe, kombinimet e Figurës si më pak të përfaqësuara. Prandaj, mundet që edhe kombinimet e Terrenit të jenë një mundësi, por që ka aq pak gjasa sa akoma nuk materializohet në asnjë gjuhë.

Megjithatë, kjo nuk shpjegon në të vërtetë pse leksikalizimi i Terrenit është kaq i papreferuar nga gjuhët. Mbizotërimi i tre modeleve leksikalizuese në gjuhët e botës mund të interpretohet sikur gjuhët i kushtojnë më shumë vëmendje shprehjes së trajektores së lëvizjes, mënyrës se si lëviz Figura dhe madje edhe njësisë që lëviz se sa shprehjes së njësisë referuese. Mund të thuhet se Terreni është elementi më pak i dukshëm i një skene të lëvizjes, prandaj ai edhe nuk favorizohet në leksikalizim; megjithatë, nuk kemi ndeshur akoma ndonjë studim psikolinguistik që të mbështesë këtë ide.

2.2.4. Tipologjia e Dyfishtë: Trajektorja e Lëvizjes

Tipologjia e dyfishtë rezulton nga kqyrja e përbërësve morfosintaksorë që zakonisht kombinojnë përbërësin Trajektore të një ngjarjeje të lëvizjes. Kështu, në gjuhë të ndryshme Trajektorja leksikalizohet tek vetë folja në gjuhët *me kornizë foljore* dhe tek satelitët në gjuhët *me kornizë satelitore* si në shembullin (29):

(23) The bottle floated *out* of the cave

Për kujtesë, sateliti është ‘kategoria gramatikore e çdo përbërësi që ka marrëdhënie simotër me vetë foljen’ (Talmy, 2000b: 102). Satelitët, të cilët mund të jenë

shtesa të lidhura ose fjalë të lira¹⁰ mund kombinojnë jo vetëm Trajektoren e lëvizjes (p.sh. , në anglisht *out, into, away*, etj.) por edhe Trajektore + Terren, Mënyrën dhe Shkakun.

Talmy (199, 2000b: Seksionet 2.5-2.8) sugjeron se përbërësi ku zakonisht shprehet Trajektorja është, në masë të madhe, po ai ku shprehen edhe aspekti, ndryshimi i gjendjes, ndërlidhja dhe realizimi i veprimit. Me fjalë të tjera, tipologjia e dyfishtë për ngjarjet e lëvizjes shtrihet të paktën edhe në katër lloje të tjera ngjarjesh. Kështu, gjuhët me kornizë foljore zakonisht i leksikalizojnë trajektoren e lëvizjes, aspektin, ndryshimin e gjendjes, ndërlidhjen dhe realizimin e veprimit tek folja kryesore, ndërsa në gjuhët me kornizë satelitore ajo shprehet nga pjesëzat foljore ose satelitët. Le ta ilustrim këtë me disa shembuj nga gjuha angleze të marra nga Talmy (2000b):

(24) Ndryshimi i gjendjes

- a. I blew *out* the candle
- b. I burned him *to death*

(25) Ndërlidhja e Veprimit

- a. I played the melody *along* with him
- b. I *out*played him

Në këto shembuj, ndryshimet e gjendjes si dhe ndërlidhja e veprimit në gjuhën angleze shprehen me pjesëza ose satelitë, ndërsa folja kryesore shpreh Bashkëngjarjen (Mënyrën ose Shkakun).

2.3. Hipoteza e Relativizmit Gjuhësor

2.3.1. Hyrje

Pyetja ‘Cila është lidhja midis të folurit për realitetin dhe të menduarit për të?’, me fjalë të tjera, ‘Cila është lidhja mes gjuhës dhe mendimit?’ ka trazuar shumë gjuhëtarë dhe psikologë për shumë dekada. Në literaturë mund të identifikohen dy qasje të përgjithshme në lidhje me natyrën e marrëdhënieve midis gjuhës dhe

¹⁰ Shiko (Talmy, 2000b: Kapitulli 1, Seksioni 3) për një prezantim më të thelluar të kategorisë gramatikore *satelit* dhe llojeve të nocioneve semantike që mund të leksikalizojë ai.

konceptualizimit: qasja *Universaliste/Nativiste* dhe qasja e *Determinizmit/Relativizmit Gjuhësor*.

Para se të fokusohemi në qasjen e Relativizmit Gjuhësor, nevojitet një prezantim i shkurtër i qasjes *Universaliste/Nativiste*. Qasja *Universaliste* ose *Nativiste* thekson ngjashmëritë ndërgjuhësore për shkak të natyrës sonë të përbashkët njerëzore. Noam Chomsky është figura kryesore e kësaj qasjeje universaliste për gjuhën dhe realitetin. Arsyeya e tij për të studiuar gjuhën është:

Gjuha është një pasqyrë e mendjes në një kuptim të thellë dhe të rëndësishëm. Ajo është një produkt i inteligjencës së njeriut... Duke studiuar vetitë e gjuhëve natyrore, strukturën, organizimin dhe përdorimin e tyre, ne mund të shpresojmë të mësojmë diçka në lidhje me natyrën e njeriut; diçka të rëndësishme, në se është e vërtetë që kapaciteti njohës i njeriut është vërtetë karakteristika dalluese dhe më e shquar e species njerëzore. (Chomsky, 1975: 4)

Disa nga parimet bazë të kësaj qasjeje janë (a) strukturat konceptuale janë universale, (b) sintaksa është universale dhe e lindur, dhe (c) ndryshueshmëria ndërgjuhësore nuk pasqyron dallimet konceptuale por thjesht ato gjuhësore. Sipas universalistëve, të folurit e një gjuhe konsiston në përkthimin e *gjuhës së mendimit* (Fodor, 1975, 1983). Siç shprehen Li & Gleitman (2002: 266) ‘njerëzit shpikin fjalë që etiketojnë konceptet e tyre’; kategoritë gjuhësore janë një hartëzim i drejtpërdrejtë nga konceptet universale. Universalistët pranojnë se gjuhët ndryshojnë në mënyrën se si e shprehin realitetin, por pohojnë se kjo ndryshueshmëri ndërgjuhësore nuk pasqyron asnjë dallim thelbësor në mënyrën si njerëzit mendojnë për realitetin.

Nga ana tjetër, gjuhësia/semantika njohëse mban një qëndrim tjetër. Siç kemi vënë në dukje tashmë, një nga parimet themelore të gjuhësisë/semantikës njohëse është se gjuha është një dritare për strukturën konceptuale. Prej këndej vijon pretendimi se ndryshueshmëria ndërgjuhësore pasqyron ndryshimet në konceptualizim. Është pikërisht kjo pika e kundërshtisë mes qasjeve universaliste dhe qasjes së *Determinizmit / Relativizmit Gjuhësor*, me të cilën pajtohet gjuhësia njohëse dhe që do të prezantohet në seksionin në vijim. Megjithatë, në gjuhësinë/semantikën njohëse ka vend edhe për një lloj universalizmi. Dallimet në konceptualizim ‘mendohet se vijnë nga kapaciteti konceptues i përbashkët, që rrjedh nga aspektet e përbashkëta të njohjes njerëzore’ (Evans & Green, 2006: 56). Me pak fjalë, qëndrimi i gjuhësisë/semantikës njohëse për marrdhëniet midis gjuhës dhe njohjes është se, pavarësisht nga të përbashkëtat në mënyrat si njerëzit e përdorin botën dhe në mënyrat si njerëzit mendojnë, gjuhë të

ndryshme mund të krijojnë sisteme të ndryshme konceptuale.

2.3.2. Hipoteza e Relativizmit Gjuhësor nga Sapir dhe Whorf

Çdo student i gjuhës apo shoqërisë duhet të njihet me idenë thelbësore të relativizmit gjuhësor, idenë se kultura, nëpërmjet gjuhës, ndikon në mënyrën se si ne mendojmë, sidomos në klasifikimin tonë të botës që përjetojmë. (Gumperz & Levinson, 1996: 2)

Determinizmi / Relativizmi Gjuhësor lidhet me dijetarët amerikanë Edward Sapir dhe Benjamin Lee Whorf. Ata studiuuan gjuhët dhe praktikat kulturore të disa fiseve vendase amerikane në gjysmën e parë të shekullit 20. Bazuar në studimin e tij, Sapir pohon:

Qeniet njerëzore nuk jetojnë vetëm në botën objektive [...] Fakti është se "bota reale" ndërtohet kryesisht në mënyrë të pandërgjegjshme mbi shprehitë gjuhësore të grupit [...] Ne shohim, dëgjojmë dhe, thënë ndryshe, përjetojmë në masë shumë të madhe ashtu siç bëjmë ne, sepse shprehitë gjuhësore të komunitetit tonë paracaktojnë zgjedhje të caktuara interpretuese. (Sapir 1929: 209)

Në të njëjtën linjë, Whorf pohon:

Ne e analizojmë natyrën përgjatë linjave të përcaktuara nga gjuha jonë amtare. Kategoritë dhe llojet që ne izolojmë nga fenomenet e botës nuk i gjejmë aty sepse ato vështrojnë në sy çdo vëzhgues; përkundrazi, bota paraqitet në një fluks kaleidoskopik përshtypjesh të cilat duhet të organizohen nga mendjet tona - dhe kjo do të thotë kryesisht nga sistemet gjuhësore të mendjeve tona. (Whorf, 1956: 213)

Pikëpamja e tyre është se gjuhët kanë fuqinë që për të njëjtin realitet të krijojnë botëvështrime të ndryshme. Kjo nënkupton, pra, që folësit e gjuhëve të veçanta ndryshojnë për nga mënyra se si mendojnë dhe veprojnë. Pavarësisht konfuzionit të madh akademik lidhur me interpretimin e Sapir dhe Whorf, siç theksohet edhe nga Gumperz & Levinson (1996: 2, 22) dhe Pourcel (2005: 13-14), ata nuk pretendonin se mendimi përcaktohet plotësisht nga gjuha. Pozicioni i tyre duket të ketë qenë se gjuha (si një sistem i strukturuar semantik) ndikon mbi mendimin e zakonshëm.

Sapir dhe Whorf nuk ishin të parët që shprehnin idenë se gjuha ndikon mbi mendimin, pra, mbi të kuptuarit dhe perceptimin tonë të realitetit. Në shekullin 19, Wilhelm von Humboldt ([1836] 1988: 54) e shikonte gjuhën si organi që formon

mendimin. Ai shprehej se mendimi eksternalizohet tek fjala, dhe se ‘për këtë arsye mendimi dhe gjuha janë një dhe të pandarë nga njëri-tjetri’. Për mendjen e tij, çdo gjuhë ka një botëvështrim karakteristik; gjuha hyn midis njeriut dhe botës pasi gjuha i paraqet njeriut botën. Më vonë, antropologu Franz Boas, i cili mori një qasje më pak deterministe ndaj shumëllojshmërisë gjuhësore, vuri re se gjuha ‘përcakton aspektet e çdo përvoje që duhen shprehur’ (Boas, 1938: 127).

Në tërësi, sipas Gentner & Goldin-Meadow (2003: 4), ajo që është quajtur si *hipoteza Sapir-Whorf* thekson se (a) gjuhët ndryshojnë nga mënyra se si ato e skalitin botën; (b) struktura e gjuhës së dikujt ndikon në mënyrën si ai/ajo e percepton dhe e kupton botën; (c) për këtë arsye, folësit e gjuhëve të ndryshme e perceptojnë apo konceptojnë botën në mënyra të ndryshme.

Hipoteza Sapir-Whorf¹¹ në përgjithësi përbëhet nga dy versione: versioni i fortë, i njohur si *Determinizmi Gjuhësor*, dhe versionit i butë, i quajtur *Relativizmi Gjuhësor*. Determinizmi Gjuhësor mbron idenë se gjuha përcakton tërësisht mendimin, konceptualizimin tonë të realitetit, dhe se të menduarit do të ishte i pamundur pa gjuhën. Për ta thënë thjesht, sipas kësaj pikëpamjeje, në qoftë se një gjuhë e dhënë X nuk e ka një kategori gjuhësore, folësit e gjuhës X nuk mund të mendojnë në lidhje me të. Kështu, folësit e gjuhës X e kuptojnë botën në një mënyrë të ndryshme nga folësit e gjuhës Y. Relativizmi Gjuhësor pretendon se gjuha ndikon mbi mendimin por jo në një mënyrë tërësisht përcaktuese. Sipas këtij versioni të butë, gjuha luan rol në njohjen jogjuhësore, për shembull, në mënyrën si folësit mbajnë mend, kategorizojnë dhe arsyetojnë për botën, por kjo nuk përjashton alternativat e tjera.

Versioni i fortë i hipotezës Sapir-Whorf u refuzua nga shumica e gjuhëtarëve mbi bazën e provave negative nga fusha e ngjyrave (Heider & Olivier, 1972; Rosch, 1975, 1978), të cilat treguan se dallimet gjuhësore në emërtimin e ngjyrave midis anglishtes dhe gjuhës Dani nuk pasqyronin asnjë dallim në mënyrën si folësit e të dy gjuhëve kategorizonin dhe mbanin mend ngjyrat. Me fjalë të tjera, gjuha nuk duket se përcakton mendimin.

Pas dekadave të neglizhencës për shkak të dominimit të qasjeve universaliste në gjuhë (dmth., gjuhësisë formale si Gramatika Gjenerative) dhe të skepticizmit si rezultat

¹¹ Shiko Pourcel (2005: Kapitulli 1) për një diskutim gjithëpërfshirës dhe të zgjeruar rreth Relativizmit Gjuhësor. Në këtë kapitull ajo kritikon keqkuptimet e pikëpamjeve të Sapir dhe Whorf në botën akademike. Nga ana tjetër, ajo vëren se këta studiues nuk kanë pretenduar se gjuha përcakton mendimin, megjithëse e vlerësojnë sferën psikologjike të tij. Gjithashtu, ajo konstatoi se parimi i relativizmit gjuhësor nuk konsiderohet më si qëllim i gjuhësisë antropologjike pasi ka ndodhur një kalim nga relativizmi gjuhësor si traditë studimore në relativizmin gjuhësor si hipotezë e diskutueshme.

i gjetjeve negative nga kërkimet për ngjyrat, çështja e gjuhës dhe mendimit është bërë sërish një arenë aktive hulumtimi. Sipas Gentner & Goldin-Meadow (2003), vepra e Talmy (p.sh., 2000, 2000b), Langacker (p.sh., 1987, 1999), Choi & Bowerman (p.sh., Bowerman & Choi, 2001, 2003; Choi & Bowerman, 1991; Choi et al, 1999) dhe Levinson (p.sh., Levinson, 1997; Levinson et al 2002) ndër shumë të tjerë, kontribuoi në përtëritjen e interesit për relativizmin gjuhësor. Këto studiues analizuan sistemet semantike të gjuhëve të ndryshme dhe provuan bindshëm se ekzistojnë ndryshime të rëndësishme në mënyrën si gjuhët e skalitin botën. Si dëshmi e këtij interesi të përtërirë, u botuan dy vëllime për çështjen e Relativizmit Gjuhësor: *Rikonceptimi i Relativizmit Gjuhësor* nga Gumperz & Levinson (1996) dhe *Gjuha në Mendje: Përparimet në Studimin e Gjuhës dhe Mendimit* nga Gentner & Goldin-Meadow (2003), të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash (hapësirën, gjininë, lëvizjen, objektet, substancat, etj).

Studimet për relativizmin gjuhësor shpesh marrin një qasje fushe dhe krahasuese (Lucy, 1992, 1997). Kjo qasje është qasja më efikase, pasi krahasimet midis gjuhëve hedhin dritë mbi ngjashmëritë dhe dallimet në një fushë të veçantë. Kur studiohet relativizmi gjuhësor, parakushti është që të identifikohet një fushë e debatueshme gjuhësore e cila mund të sjellë implikime të mundshme njohëse për folësit përkatës të këtyre gjuhëve në detyrat jogjuhësore (Pourcel, 2002: 126).

Hapësira është një arenë pjellore për kërkime në relativizmin gjuhësor. Për shembull, Levinson (1997) dhe Pederson et al. (1998) treguan se korniza gjuhësore referuese e folësve ndikonte në sjelljen e tyre të ndryshme në detyrat jogjuhësore. Krahas hapësirës, janë realizuar edhe kërkime për relativizmin gjuhësor në kategori gramatikore të tilla si numri ose gjinia. Boroditsky et al. (2003) sugjeron se gjinia gramatikore ka ndikim të gjerë në mënyrën se si njerëzit mendojnë për objektet.

Në përgjithësi, ky hulumtim është pjesë e idesë së *gjuhës si lente*, dmth, gjuha ndikon në mënyrën si e shohim botën. Sipas Gentner & Goldin-Meadow (2003), gjuha mund të shihet edhe si *kuti mjetesh* edhe si *shenjues kategorish*. Si e tillë, gjuha mund të jetë një forcë e fuqishme që lehtëson përfaqësimin dhe arsyetimin (p.sh., Loewenstein & Gentner, 2005), dhe zhvillon koncepte të veçanta (p.sh., Choi & Bowerman, 1991; Bowerman & Choi, 2001, 2003. Në kuadrin e idesë për gjuhën si kuti mjetesh, Loewenstein & Gentner (2005) sugjerojnë se përdorimi i gjuhës relacionale hapësinore është i dobishëm për të menduarit relacional; kur fëmijët e vegjël dëgjojnë gjuhë relacionale hapësinore, ecuria e tyre në një detyrë hartëzimi lehtësohej jashtëzakonisht

shumë. Hulumentimet e mëtejshme për përvetësimin e gjuhës tregojnë ndikimin e gjuhës në zhvillimin e koncepteve ose kategorive relacionale (dmth, gjuha si kategori krijuese). Casasola (2005) dhe Casasola et al. (2006) gjithashtu kanë sjellë prova në favor të idesë se gjuha lehtëson formimin e kategorive abstrakte hapësinore tek foshnjat. Me pak fjalë, hulumentimi i sotëm tregon se gjuha ndikon mbi mendimin në rrethana specifike.

2.3.3. Të-menduarit-për-të-folur nga Slobin

Kërkimi mbi relativizmin gjuhësor është i paplotë pa i kushtuar vëmendje proceseve njohëse që ndeshen vazhdimisht në rrjedhën e përdorimit të gjuhës. (Slobin, 2003 158)

Ka një lloj të veçantë të menduari që lidhet ngushtë me gjuhën - përkatësisht, të menduarit që kryhet vazhdimisht në procesin e të folurit. (Slobin, 1991: 75)

Në vitin 1991 u organizua *Simpoziumi i Fondacionit Wenner-Gren* mbi temën e rikonceptimit të relativizmit gjuhësor. Një arritje e rëndësishme ishte *Të-Menduarit-për-të-Folur* nga Dan Isaac Slobin: Gjuha ndikon mbi mendimin kur dikush mendon me qëllimin për ta përdorur gjuhën. Pavarësisht nga fakti se Slobin ishte i pari që trajtoi idenë e të-menduarit-për-të-folur, duke përcaktuar pasojat e tij dhe duke e bërë atë të pranueshëm për testim empirik, vëzhgime të ngjashme ishin bërë edhe më parë nga Pinker:

Sigurisht Whorf e kishte gabim kur thoshte se gjuha e dikujt përcakton mënyrën se si ai/ajo e koncepton realitetin në përgjithësi. Por ndoshta ai kishte të drejtë në një kuptim shumë më të dobët: Gjuha e dikujt përcakton mënyrën se si ai/ajo duhet ta konceptojë realitetin kur duhet të flasë për të. (Pinker, 1989: 360)

Slobin (1991: 71) thekson se është duke ndjekur një traditë në gjuhësinë antropologjike të ilustruar nga të menduarit e Franz Boas. Siç u përmend më lart, Boas vëzhgoi se gjuha luan rol për sa i përket aspekteve të realitetit që duhen shprehur:

Në çdo gjuhë shprehet vetëm një pjesë e konceptit të plotë që ne kemi në mendje, dhe çdo gjuhë ka një tendencë të veçantë për të zgjedhur këtë apo atë aspekt të imazhit mendor i cili përcillet nga shprehja e mendimit. (Boas, [1911] 1966: 38-39)

Ndoshta Boas e kishte gabim kur mendonte se të gjithë folësit kanë një koncept të plotë të përbashkët në mendjet e tyre. Megjithatë, ai kishte të drejtë kur sugjeronte se

gjuha zgjedh çfarë të komunikojë. Në formulimin e vetë Slobin (199: 76), ‘shprehja e përvojës në terma gjuhësorë përbën të-menduarin-për-të-folur - një formë e veçantë e mendimit që mobilizohet për komunikim’. Ai argumenton se çfarëdo ndikimesh që mund të ketë gjuha jashtë aktit të të folurit, proceset mendore që ndodhin gjatë formulimit dhe interpretimit të kumtimeve nuk janë të parëndësishëm dhe meritojnë vëmendje të veçantë:

Në kuadrin kalimtar kohor të ndërtimit të kumtimeve në të folur njeriu i përshtat mendimet e veta me kornizat gjuhësore që disponon. ‘Të-menduarit-për-të-folur’ përfshin përzgjedhjen e atyre karakteristikave të objekteve dhe ngjarjeve që (a) përshtaten me një konceptualizim të ngjarjes, dhe (b) janë të gatshme për t’u koduar në gjuhë. (Slobin, 1991: 76)

Në procesin e vazhdueshëm të të-menduarit-për-të-folur, folësit e një gjuhe të dhënë i kushtojnë vëmendje aspekteve specifike të realitetit që duhet të verbalizohen në gjuhë. Me fjalë të tjera, gjuha e drejton vëmendjen e njeriut tek aspekte të veçanta të përvojës.

Slobin (2003: 160) e shtrin emërtimin ‘Të-menduarit-për-të-folur’ tek të gjitha format e prodhimit gjuhësor (të folurit, të shkruarit, shenjat), të receptimit (dëgjimi, leximi, shikimi) si dhe tek një varg procesesh mendore (të kuptuarit, imazheria, të mbajturit mend) në përpjekje për të provuar ndikimin e gjerë që ka përdorimi i gjuhës në proceset mendore të lidhura me gjuhën. Për Slobin, kërkimi që lidhet me të-menduarit-për-të-folur duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme (Slobin, 2003: 161):

- a. Kërkimi duhet të trajtojë një *përzgjedhje gjuhësh* dhe një *fushë semantike* që kodohet me një farë shpeshtësie në të gjitha gjuhët.
- b. Fusha semantike duhet të kodohet nga *ndërtime të veçanta gramatikore apo zgjedhje të detyrueshme leksikore* në të paktën disa prej gjuhëve që krahasohen.
- c. Fusha duhet të jetë relativisht *më e kodueshme* në disa nga gjuhët që krahasohen.
- d. Kërkimi duhet të trajtojë një përzgjedhje të *situatave të diskursit* në të cilat fusha semantike aksesohet rregullisht.

Studimi i Slobin mbi të-menduarit-për-të-folur përqendrohet kryesisht tek lëvizja. (a) Fusha semantike e lëvizjes është e rëndësishme për të gjitha gjuhët, dhe siç e kemi parë më herët, (b) ajo shfaq modele leksikalizuese të dallueshme në të gjitha gjuhët. Për më tepër, (c) disa nga dimensionet e lëvizjes, si mënyra e lëvizjes, janë më shumë të kodueshme në disa gjuhë se në të tjerat. Dhe, së fundi, (d) ka shumë situata diskursi me shkrim dhe me gojë në të cilat mund të shqyrtohet kjo fushë. Kështu, fusha e lëvizjes

është e përshtatshme për të shqyrtuar si ndikojnë modelet semantike gjuhësore në mënyrën se si folësit e një gjuhe flasin për lëvizjen.

2.4. Përfundime

Kapitulli 2 bëri një pasqyrë të shkurtër por të përgjithshme të sfondit teorik të disertacionit. Fillimisht ai trajtoi lindjen dhe parimet kryesore të Gjuhësisë Njohëse në përgjithësi dhe parimet e drejtimet kryesore kërkimore të Semantikës Njohëse duke i kushtuar një vëmendje të veçantë Semantikës Konceptuale. Në vijim u prezantua teoria e Leonard Talmy për modelet leksikalizuese. Synimi kryesor i veprës së Talmy është eksplorimi i marrëdhënieve sistematike midis kuptimit dhe formave gjuhësore me synimin për të zbuluar nëse gjuhët shfaqin një numër të vogël modelesh (dmth., një tipologji) apo një model të vetëm (dmth., një universale). Në shqyrtimin që i bën fushës së lëvizjes ai propozon dy tipologji: *tipologjinë e trefishtë* dhe *tipologjinë e dyfishtë* të gjuhëve, të cilat rrjedhin nga dy këndvështrime të marrëdhënieve midis kuptimit dhe formave gjuhësore. Duke u nisur nga lloji i informacionit semantik që shprehet zakonisht tek vetë folja ai propozon *tipologjinë e trefishtë* të gjuhëve që kombinojnë Trajektoren, Mënyrën dhe Figurën; duke u nisur nga format gjuhësore që shprehin zakonisht Trajektoren e lëvizjes, ai propozon *tipologjinë e dyfishtë* të gjuhëve me kornizë satelitore dhe foljore.

Së fundi, në këtë kapitull u paraqit hipoteza e Sapir dhe Whorf për relativizmin gjuhësor si edhe një version më i dobët i kësaj hipoteze, hipoteza e Slobin mbi të-menduarit-për-të-folur. Fusha e lëvizjes është e përshtatshme për të eksploruar ndikimet e modeleve semantike gjuhësore në mënyrën si folësit e një gjuhe flasin dhe mendojnë për lëvizjen. Aty përmbledhet e gjithë gama e studimeve që janë ndikuar nga teoria Talmiane e modeleve leksikalizuese për ngjarjet e lëvizjes. Këto studime mund të grupohen në dy blloqe: Kërkimet e Slobin mbi të-menduarit-për-të-folur dhe kërkimet për relativizmin gjuhësor. Hipoteza e Slobin mbi të-menduarit-për-të-folur përmbledh shumë drejtime kërkimore në përpjekje për të justifikuar ndikimet e gjëra që ka përdorimi i gjuhës në proceset mendore të lidhura me gjuhën (dmth., të folurin, të shkruarin, përkthimin, gjestet, etj). Gjithashtu aty bëhet një vlerësim i relativizmit gjuhësor dhe analizohet gjërësisht çështja nëse dallimet në shprehjen e lëvizjes çojnë në konceptualizime të ndryshme të ngjarjeve të lëvizjes nga folësit e gjuhëve të ndryshme, por rezultatet e këtyre studimeve nuk janë përfundimtare. Gjithashtu sugjerohet që natyra e brendshme e

nxitësve (dmth., llojet e Trajektores, llojet e Mënyrës dhe llojet e Figurës) mund të jenë përgjegjës për rezultatet e ndryshme.

KAPITULLI III

KLASIFIKIMET DHE ANALIZA E FOLJEVE TË LËVIZJES

3.1. Hyrje

3.2. Qasja e Bazuar në Marrëdhënien Sintaksë-Semantikë

3.2.1. Hyrje

3.2.2. Klasat e Foljeve të Lëvizjes

3.3. Qasja e Bazuar në Modeli FunkSIONAL-Leksematik

3.3.1. Hyrje

3.3.2. Nënfishat Leksikore të Lëvizjes

3.4. Semantika e Foljeve të Lëvizjes

3.4.1. Hyrje

3.4.2. Foljet e Mënyrës

3.4.3. Foljet e Trajektores

3.5. Përmbledhje

3.1. Hyrje

Qëllimi i parë i këtij kapitulli është që të shqyrtojë shkurtazi klasifikimet dhe analizat e foljeve të lëvizjes nga këndvështrime të ndryshme teorike për të kuptuar më mirë natyrën komplekse sintaksore dhe semantike të foljeve të lëvizjes.

Kapitulli fillon me një pasqyrë të qasjes së bazuar në Marrëdhënien Sintaksë-Semantikë për analizën e foljeve të lëvizjes, e cila shpjegon se si semantika e një foljeje mund të përcaktojë realizimin sintaksor të argumenteve të saj. Studiuesit në këtë qasje kërkojnë jo vetëm të identifikojnë nocionet semantike që lidhen me strukturën sintaksore (dmth, cilat veçori semantike të foljeve pasqyrohen sintaksisht) por edhe të paraqesin klasat e foljeve të lëvizjes sipas veçorive të tyre semantike dhe sintaksore. Më pas prezantohen dy klasifikimet e foljeve të lëvizjes për anglishten sipas modelit Funkcional-Leksematik. Megjithëse interesohen edhe për veçoritë sintaksore të foljeve të lëvizjes, studiuesit që punojnë me këtë model zbatojnë një qasje me orientim më semantik në organizimin e leksikut të foljeve të lëvizjes.

Qëllimi i dytë i këtij kapitulli është të ofrojë një listë nocionesh më të imta semantike të cilat kanë rezultuar të dobishme për eksplorimin e dallimeve dhe ngjashmërive ndërgjuhësore në leksikun e foljeve të lëvizjes. Siç e kemi paraqitur në Kapitullin 2 (seksioni 2.2.3) tipologjia e trefishtë e Talmy propozonte një klasifikim të gjuhëve bazuar në llojin e informacionit semantik që shprehet zakonisht te vetë foljet e tyre; kështu, ai identifikonte tre lloje kryesore foljesh të lëvizjes: folje që kombinojnë Trajektoresh, folje që kombinojnë Mënyrën dhe folje që kombinojnë Figurën. Megjithatë, foljet e lëvizjes mund të analizohen më tej për sa i përket hollësive më specifike të mënyrës (p.sh. shpejtësia e lëvizjes, mjetet e përcjelljes së lëvizjes, etj.) dhe hollësive të trajektores (p.sh. boshti horizontal, boshti vertikal, lëvizje larg nga/në drejtim të, etj.). Kështu, në pjesën e fundit kapitulli paraqet semantikën e lëvizjes në një mënyrë më të imtësishme se përbërësit e përgjithshëm të Talmy. Gjithashtu, aty shqyrtohen shkurtimisht edhe studimet ndërgjuhësore për mënyrën dhe trajektoren e foljeve të lëvizjes; këto studime sugjerojnë se gjuhët në përgjithësi zotërojnë një numër të ngjashëm foljesh të trajektores, ndërsa ndryshojnë ndjeshëm në numrin e foljeve të mënyrës si dhe në llojin e informacionit të hollësishëm që ato shprehin.

3.2. Qasja e bazuar në marrëdhënien Sintaksë-Semantikë

3.2.1. Hyrje

Shumë teori janë ndërtuar mbi supozimin se realizimi sintaksor i argumenteve parashikohet

në masë të madhe nga kuptimet e foljeve. Fakti që foljet me kuptime të ngjashme tregojnë modele karakteristike të realizimit të argumentit sugjeron se këto modele mund t'i atribuohen veçorive semantike të çdo klase. Qëllimi kryesor i teorive që merren me lidhjen e ngushtë midis sintaksës dhe semantikës është identifikimi i përbërësve përkatës të kuptimit si dhe shpjegimi i lidhjes së tyre me gamën e mundësive të realizimit të argumentit (Levin & Rappaport Hovav, 2005: 3). Në këtë disertacion, këto teori apo qasje grupohen nën rubrikën *Marrëdhënia Sintaksë-Semantikë*.

Foljet e lëvizjes janë një klasë foljesh problematike për të studiuar marrëdhënien ndërmjet sintaksës dhe semantikës pasi ato nuk duket se sillen sintaksisht si një klasë semantike koherente. Në të gjitha gjuhët vihet re se subjektet sintaksore të disa foljeve të lëvizjes ndajnë disa veçori me kundrinorët e drejtë të foljeve kalimtare (dmth, ato veprojnë si Pësues ose si Tema), ndërsa subjektet e foljeve të tjera të lëvizjes sillen si Veprues.

Levin & Rappaport Hovav (1992: 252) sugjerojnë që foljet e lëvizjes do të karakterizoheshin më mirë duke u bazuar në përbërësit kuptimorë që leksikalizohen tek vetë folja se sa duke u bazuar në rolet tematike të argumentit të foljes. Ata arritën në përfundimin se përbërësit kuptimorë të *drejtimit* (Trajektorja e Talmy), *mënyrës* (Mënyra e Talmy) dhe *shkakut të jashtëm të drejtpërdrejtë* (Shkau i Talmy) janë provuar si të dobishëm për përfaqësimin semantik leksikor të foljeve të lëvizjes.

3.2.2. Klasat e foljeve të lëvizjes

Midis klasifikimeve të ndryshme të foljeve të lëvizjes nga këndvështrimi i Marrëdhënies Sintaksë-Semantikë, interes të veçantë paraqet kontributi i Beth Levin dhe Malka Rappaport-Hovav (1992) dhe Levin (1993) për foljet e lëvizjes të anglishtes. Levin & Rappaport-Hovav (1992: 252-253) propozuan këto tre grupe kryesore foljesh jokalmimtare të lëvizjes:

1. Klasa Arrive / Arrij: *arrive, come, go, depart, fall, return*, etj. Këto folje shprehin drejtim të brendshëm, pasi kuptimi i tyre përfshin një drejtim të specifikuar të lëvizjes.
2. Klasa Roll / Rrotulloj: *roll, slide, move, swing, spin, rotate*, etj. Këto janë folje që shprehin Mënyrën e lëvizjes si dhe shkakun e jashtëm të drejtpërdrejtë, dmth, veprimi i shprehur nga folja shkaktohet drejtpërsëdrejti nga një veprues apo forcë e jashtme. Siç theksohet nga autorët, një veçori interesante e foljeve të mënyrës me shkak të jashtëm të drejtpërdrejtë është se ato lejojnë përdorimet kalimtare (dmth, shkakore, veprorë) dhe jokalmimtare. Për shembull, *Andrew rolled Bill down the hill* (lit. Andrew e rrokullisi Billin tatëpjetë kodrës) / *Bill rolled down the hill* (lit.) Bill u rrokullis tatëpjetë kodrës. Ky alternim duket se gjendet në shumë gjuhë (Hale & Keyser, 1987, 1992).

3. Klasa Run / Vrapoj: *run, walk, gallop, jump, hop, skip, swim*, etj. Këto folje shprehin Mënyrën e lëvizjes por edhe mungesën e një shkaku të jashtëm të drejtpërdrejtë (dmth, veprimi i shprehur ndodh spontanisht). Ky grup tregon se subjektet sintaksore kanë kontroll të drejtpërdrejtë mbi veprimet e tyre.

Beth Levin, në librin e saj të vitit 1993 *Klasat e Foljeve në Anglisht dhe Alternimet: Një shqyrtim paraprak*, trajtonte edhe lëvizjen kalimtare. Studimi i saj motivohej edhe nga hipoteza se kuptimi i një foljeje ndikon në sjelljen e saj sintaksore. Ajo tregoi se si identifikimi i foljeve me alternime të ngjashme sintaksore është një mënyrë efektive për të dalluar klasat e foljeve semantikisht koherente. Në lidhje me foljet kalimtare dhe jokolimtare të lëvizjes, Levin (1993: 263-270) propozoi nëntë klasat e foljes në vijim:

1. Lëvizje e brendshme e drejtuar: *advance, arrive, ascend, come, depart, descend, enter, escape, exit, fall, flee, go, leave, plunge, recede, return, rise* dhe *tumble*. Kuptimet e këtyre foljeve përmbajnë një specifikim të drejtimit të lëvizjes (dmth, Trajektoen) edhe në mungesë të kundrinorit të drejtë. Sipas Levin, asnjë nga këto folje nuk specifikon Mënyrën e lëvizjes. Megjithatë, foljet e kësaj klase nuk sillen në mënyrë uniforme në të gjitha aspektet. Foljet ndryshojnë nga mënyra si mund të shprehin qëllimin, burimin apo trajektoren e lëvizjes; në varësi të foljes, këto mund të shprehen me një shprehje parafjalore, me kundrinor të drejtë, ose me të dy mënyrat, siç tregohet në shembullin (1).

- (1) a. The convict escaped from the police.
 b. The convict escaped the police.

2. Leave / Largohem: *abandon, desert, leave*, etj. Këto folje nuk specifikojnë Mënyrën e lëvizjes; ato vetëm tregojnë se ka ndodhur një lëvizje tutje një vendi. Kundrinori i drejtë i këtyre foljeve kuptohet se është vendi prej nga bëhet largimi. Ky vend *nuk* mund të shprehet me një shprehje parafjalore.

- (2) We abandoned the area.

3. Roll / Rrotulloj, Rrokullis: *bounce, drift, drop, float, glide, move, roll, slide, swing*, etj, plus foljet që përshkruajnë lëvizje rreth një boshti: *coil, revolve, rotate, spin, turn, twirl, twist, whirl, wind*, etj. Kjo klasë foljesh përcakton mënyrat e lëvizjes karakteristike për subjektet e pajetë, dmth, Figura nuk kontrollon domosdoshmërisht lëvizjen e vet. Në mungesë të një shprehjeje parafjalore, asnjë nga këto folje nuk tregon Trajektoen e lëvizjes. Levin vuri re se

shumë nga foljet rrotulluese që përshkruajnë lëvizje rreth një boshti marrin një gamë mjaft të kufizuar parafjalësh në krye të shprehjes parafjalore që përshkruan trajektoren e lëvizjes, si në shembullin (3). Shumica foljeve të kësaj klase tregojnë alternimin shkakor/fillestar vetëm nëse lëvizja kontrollohet nga jashtë, si në shembullin (4).

(3) a. The ball rolled down the hill/over the hill/into the gutter.

(4) a. Bill rolled the ball down the hill.

b. The ball rolled down the hill.

4. Run / Vrapoj: *amble, backpack, bolt, bounce, bound, bowl, canter, cavort, charge climb, crawl, dart, dash, float, fly, gallop, goosetep, hike, hop, jump, march, mosey, promenade, race, run, shuffle, sleepwalk, somersault, stroll swim, tiptoe, vault, waddle, walk*, etj. Shumica e këtyre foljeve përshkruajnë mënyrat në të cilat mund të lëvizin subjektet e gjalla, megjithëse disa prej tyre mund të përdoren edhe për të përshkruar lëvizjen e subjekteve të pajetë. Më tej, këto folje nuk nënkuptojnë asnjë drejtim specifik të lëvizjes përveçse kur ato përdoren me një shprehje të qartë drejtimore.

(5) Tom ran the soles off his shoes

5. Foljet që janë emra mjetesh¹: *balloon, bicycle, bike, boat, bobsled, bus, cab, canoe, caravan, chariot, coach, cycle, dogsled, ferry, gondola, helicopter, jeep, jet, motorbike, parachute, raft, rocket, skate, ski, tram, yacht*, etj. Kuptimi i këtyre foljeve sipas Clark & Clark (1979: 55) është ‘të shkosh duke përdorur mjetin që tregon emri’. Në parim, duhet të jetë e mundur që çdo emër mjeti të përdoret si folje e këtij lloji. Së fundi, kjo klasë foljesh nuk nënkupton drejtimin e lëvizjes përveçse kur ka prani të një shprehjeje të qartë drejtimore.

(6) They skated along the canal/across the lake.

6. Foljet që nuk janë emra mjetesh: *cruise, drive, fly, oar, paddle, pedal, ride, row, sail, tack*, etj. Ky grup foljesh tregon lëvizje duke përdorur një mjet, por emri i mjetit nuk përputhet me

¹ Për një diskutim të hollësishëm shiko Clark & Clark (1979). Në punimin e tyre me titull *Kur emrat shfaqen si folje*, ata eksplorojnë grupet e ndryshme të emrave të anglishtes që me kalimin e kohës kanë filluar të përdoren si folje.

foljen. Për shembull, *fly* nënkupton një avion, *pedal* një biçikletë; *cruise*, *row*, *sail* dhe *tack* një anije ose varkë, etj. Në mënyrë të ngjashme me klasën e mëparshme të foljeve, edhe këtu nuk nënkuptohet drejtim specifik i lëvizjes përveçse kur ka prani të një shprehjeje të qartë drejtimore.

(7) They rowed along the canal/across the lake.

7. Waltz / Vallëzoi: *boogie*, *bop*, *cancan*, *clog*, *conga*, *dance*, *foxtrot*, *tango*, *tapdance*, *waltz*, etj. Kuptimi i këtyre foljeve është ‘të kërcesh atë vallëzim’. Edhe këtu nuk nënkuptohet drejtim specifik i lëvizjes përveçse kur ka prani të një shprehjeje të qartë drejtimore. Ashtu si me emrat e mjeteve, duket se çdo emër vallëzimi mund të përdoret si folje e lëvizjes.

(8) They waltzed across/into/through the room.

8. Accompany / Shoqëroi: *accompany*, *conduct*, *escort*, *guide*, *lead*, *shepherd*, etj. Këto folje lidhen me një person i cili çon një person tjetër nga një vend në tjetrin. Sipas Levin, këto folje dallohen semantikisht nga natyra e marrëdhënieve midis dy pjesëmarrësve.

(9) Jackie accompanied Rose to the store.

9. Chase / Ndjek: *chase*, *follow*, *pursue*, *shadow*, *tail*, *track*, *trail*, etj. Këto folje janë zakonisht kalimtare, me ndjekësin si kryefjalë dhe personin e ndjekur si kundrinor. Disa prej tyre lejojnë përdorimin jokalimtar, me ndjekësin si kryefjalë dhe një shprehje parafjalore të kryesuar nga *after* e cila shpreh atë që është duke u ndjekur.

(10) a. Jackie chased the thief.

b. Jackie chased after the thief.

Në përmbledhje, natyra sintaksore heterogjene e leksikut të foljeve të lëvizjes ka sjellë probleme për studiuesit që janë marrë me marrëdhënien midis sintaksës dhe semantikës, duke bërë që ata të propozojnë lloje të ndryshme klasash të foljeve të lëvizjes. Edhe pse disa nga klasifikimet janë më të imta se të tjerat, studiuesit janë të mendimit se çdo klasë e foljeve të lëvizjes përcaktohet nga veçoritë sintaksore dhe semantike.

3.3. Qasja e bazuar në Modelin Funksional-Leksematik

3.3.1. Hyrje

Modeli Funksional-Leksematik u propozua nga Leocadio Martín Mingorance (1998), duke u mbështetur shumë në Gramatikën Funksionale të Simon Cornelis Dik (1980, 1997). Modeli Funksional-Leksematik integron aspektet semantike dhe sintaksore të foljeve brenda një kuadri në të cilin gjejnë vendin e vet si marrëdhëniet paradigmatiche (dmth, marrëdhëniet me foljet e tjera) edhe marrëdhëniet sintagmatike (dmth, marrëdhëniet me elemente të tjerë në fjali). Sipas këtij modeli, bashkëveprimi i boshtit paradigmatic dhe atij sintagmatik krijon një bosht të tretë të quajtur boshti njohës, i cili përbëhet nga një hierarki kategorish konceptuale gjuhësisht të motivuara (Rodríguez-García, 1997: 21).

Pamela Faber & Ricardo Mairal-Uson (1999) dhe Jose Rodríguez-García (1997) ndoqën modelin Funksional-Leksematik për të bërë një inventar të leksikut të foljeve të anglishtes që tregon jo vetëm semantikën e foljeve në mënyrë hierarkike (dmth, fushat dhe nënfushat), por edhe marrëdhëniet midis kuptimeve të foljeve dhe realizimeve sintaksore të argumenteve, nga njëra anë, dhe lidhjen e tyre të ngushtë me konceptualizimin në mendjen e njeriut, nga ana tjetër. Këta autorë pretendojnë se struktura e argumentit motivohet semantikisht (Faber & Mairal-Uson, 1999: 143), dhe prandaj ata nuk marrin sintaksën si pikënisje për klasifikimin e leksikut - në kontrast me qasjet që bazohen tek marrëdhëniet sintaksë-semantike. Në modelin Funksional-Leksematik, organizimi i leksikut të foljeve udhëhiqet kryesisht nga semantika, megjithëse pasqyron edhe veçoritë sintaksore. Për më tepër, argumentohet se një organizim i tillë i leksikut të foljeve është ‘në harmoni me atë që dihet për organizimin e leksikut mendor’ (Faber & Mairal-Uson, 1999: viii). Në tërësi, Faber & Mairal-Uson dhe Rodríguez-García sugjerojnë se organizimi hierarkik i leksikut të foljeve i propozuar prej tyre mund të përputhet me leksikun tonë mendor.

Teoria e roleve tematike e cila njihet edhe si teoria ‘theta’ nënvizon se rolet tematike burojnë nga raportet që krijon folja me argumentet (plotësat) e saj. Le të shqyrtojmë shembujt e mëposhtëm:

- (a) Ana fle.
- (b) Ana lexon një libër.
- (c) Ana i dhuron nënës lule.

Në fjalinë e parë folja *fle* i cakton argumentit të saj Ana rolin tematik të përjetuesit. Në fjalinë e dytë folja *lexoj* i cakton argumentit Ana rolin tematik të vepruesit, ndërsa

argumentit tjetër një libër i cakton rolin tematik të temës (objektit). Në fjalinë e tretë folja *dhuron* kërkon tre plotësa (argumente). Plotësi Ana (subjekt) kryen rolin e vepruesit, plotësi nënës luan rolin e përfituesit, plotësi lule mban rolin e temës (objektit të veprimit).

Teoria ‘theta’, përveç numrit të argumenteve që duhet të marrë një folje, përshkruan dhe rolet apo veçoritë që duhet të ketë një argument. Argumentet (plotësat) pajisen me role tematike nga folja. Këto role tematike janë të lidhura ngushtë me informacionin leksikor që mbart folja. Parimi themelor i kësaj teorie është: ‘Çdo argument bart një dhe vetëm një rol tematik dhe çdo rol tematik i caktohet një dhe vetëm një një argumenti.’ (Memushaj, 2008:160). Teoria ‘theta’ njeh përgjithësisht këto role tematike të cilat kushtëzohen nga informacioni semantik i foljes:

- Agjenti - bërësi i ndërgjegjshëm i një veprimi.
- Aktori - bërësi jofrymor i një veprimi. Çdo agjent është një aktor, por jo e kundërta.
- Pësuesi - objekti i drejtpërdrejtë i veprimit, gjendja e të cilit ndryshon pas veprimit.
- Tema - objekt i veprimit të foljes, njësia që lëviz, n dryshon pozicion ose gjendje nga veprimi.
- Përjetuesi - pjesëmarrësi që përjeton një ndjenjë apo emocion.
- Përfituesi - qenia a madhësia që përfiton nga një veprim.
- Lokativi - hapësira a pika në të cilën ndodh një veprim.
- Pikësynimi - është objekti apo pika drejt së cilës orientohet a shkon lëvizja.
- Burimi - objekti a pika nga e cila rrjedh veprimi.

3.3.2. Nënfishat leksikore të lëvizjes

Faber & Mairal-Uson (1999: 55) shqyrtojnë një fushë të caktuar leksikore për të përfshirë një grup njësish leksikore që ndajnë të njëjtin kuptim (strukturë konceptuale) dhe gjithashtu tregojnë sjellje të ngjashme sintaksore. Ata e ndanë leksikun e foljeve në trembëdhjetë *fusha të mëdha leksikore*²: Ekzistenca, Lëvizja, Pozicioni, Kontakti, Ndryshimi, Perceptimi, Njohja, Ndjenja, E Folura, Tingulli, Drita, Zotërimi dhe Veprimi. Për qëllimet e këtij disertacioni, do të përqendrohemi kryesisht në propozimin që ka të bëjë me organizimin hierarkik të leksikut të foljeve të lëvizjes. Ata e ndanë fushën leksikore të Lëvizjes në 4 kategori kryesore të cilat më tej ndahen si më poshtë:

² Për një listë të hollesishme të fushave dhe nënfushave leksikore shiko Shtojcën 1 tek Faber & Mairal-Uson (1999).

1. Lëvizja e Përgjithshme (move, go, come)

- a. Të lëvizësh në një mënyrë të veçantë: *speed, race, lumber, glide, leap*
- b. Të lëvizësh tutje / larg nga: *separate, leave*
- c. Të lëvizësh drejt një vendi: *go, travel, advance*
- d. Të lëvizësh përmes: *cross*
- e. Të lëvizësh mbi / nëpër : *pass, clear*
- f. Të lëvizësh pa asnjë drejtim të veçantë: *wander, drift*
- g. Të lëvizësh në lidhje me dikë / diçka: *accompany, herd, take, bring, follow*
- h. Të lëvizësh para-prapa midis vendeve: *sway, swing*
- i. Të lëvizësh brenda në një vend: *enter, burgle*
- j. Të lëvizësh jashtë një vendi: *emerge, exit*
- k. Të lëvizësh tek një vend / pozicion tjetër: *change, switch, transfer*
- l. Të mos lëvizësh më, pasi ke lëvizur: *stop, halt*

Lëngu

- a. Të lëvizësh si lëngu në një mënyrë të veçantë: *flow, ripple*
- b. Të lëvizësh në / poshtë nën sipërfaqen e një lëngu: *sink, plunge*
- c. Të lëvizësh mbi lëng: *sail, cruise*
- d. Të lëvizësh lart në sipërfaqen e një lëngu: *surface*

Atmosfera

- a. Të lëvizësh si ajri: *blow*
- b. Të lëvizësh përmes ajrit: *fly, flutter, float*
- c. Të lëvizësh lart/përpjetë në ajër: *rise, soar*
- d. Të lëvizësh poshtë/tatëpjetë në ajër: *swoop, dive*

Toka

- a. Të lëvizësh në një mënyrë të veçantë: *skulk, creep, scamper*
- b. Të shkaktohet lëvizjen e dikujt / diçkaje poshtë në tokë: *trip, tumble*
- c. Të lëvizësh trupin: *gesture, exercise*

Klasifikimi semantik i foljeve të lëvizjes nga Faber & Mairal-Uson përfshinte kryesisht foljet jokalimtare të lëvizjes në të cilat Figura lëviz apo shkon diku vetë. Krahas kësaj, ata marrin në konsideratë disa folje kalimtare të lëvizjes në të cilat Figura lëvizet apo zhvendoset nga një veprues

(p.sh. *change, switch, transfer, pull, drag, push, shove*, të cilat kanë kuptimin ‘të shkaktosh lëvizjen e dikujt / diçkaje në një vend / pozicion tjetër’). Me fjalë të tjera, në veprën e tyre ata trajtuan si foljet vetvetore të lëvizjes edhe foljet veprorë të lëvizjes.

Rodríguez-García (1997: 75-79) u përqendrua vetëm tek foljet kalimtare të lëvizjes në anglisht (p.sh. lëvizje veprorë), megjithëse në analizën e tij ai shqyrtoi edhe përdorimet jokalistare të këtyre foljeve të lëvizjes. Ai dalloi tre nënfusha të Lëvizjes: (1) Lëvizje Pozicionale (Ekzistenca dhe Ndryshimi), (2) Lëvizje Pozicionale dhe Drejtimore, dhe (3) Lëvizje Drejtimore, të cilat ndahen më tej. Për qëllimet e këtij disertacioni, do të përqendrohemi kryesisht në nënfushat (2) dhe (3), të cilat ndahen më tej si më poshtë:

2. Lëvizja Pozicionale dhe Drejtimore³

- a. Të shkaktosh ndryshimin e një kursi/pozicioni të fiksuar: *flip, reverse, diverge, deviate*
- b. Theksi tek mënyrat e lëvizjes:
 - b1. Të shkaktosh lëvizje në mënyrë rrethore: *turn, spin, twirl, revolve, wind*
 - b2. Të shkaktosh lëvizje nga njëra anë në tjetrën: *swing, sway, nod, bob*
 - b3. Të shkaktosh lëvizje poshtë e lart: *bounce, spring, leap, throb*
 - b4. Të shkaktosh lëvizje në të gjitha drejtimet: *spread, cast, sprinkle, distribute*
 - b5. Të shkaktosh lëvizje në një mjedis të lëngshëm: *drip, spray, drain, pour, spill*
- c. Theksi tek shkalla e lëvizjes:
 - c1. Të shkaktosh që dikush / diçka të lëvizë shpejt: *propel, race, rush, gallop*
 - c2. Të shkaktosh që dikush / diçka të lëvizë ngadalë: *decelerate, brake*
 - c3. Të shkaktosh që dikush / diçka të lëvizë papritmas: *dart, dash, shoot*
 - c4. Të shkaktosh që dikush / diçka të lëvizë me gjallëri: *shake, throb, flutter*
 - c5. Të shkaktosh që dikush / diçka të lëvizë pak: *stir, totter, shudder*

3. Lëvizja e Drejtuar

- a. Të lëvizësh / të çosh dikë / diçka larg nga (boshti horizontal): *separate, leave, flee, remove, withdraw*
- b. Të lëvizësh dikë / diçka drejt përpara (boshti horizontal)
 - b1. Duke përparuar: *advance, approach*
 - b2. Duke mbledhur sende: *gather, join, glue, tie*
 - b3. Duke mbledhur njerëz: *crowd, meet*

³ Kjo nënfushë leksikore përfshin foljet e lëvizjes që mund të shprehin si lëvizje pozicionuese apo lokative (dmth., pa ndryshim vendndodhjeje) ashtu edhe lëvizje zhvendosëse.

- c. Të lëvizësh dikë / diçka lart në një pozicion më të lartë (boshti vertikal): *raise, elevate, climb, ascend*
- d. Të lëvizësh dikë / diçka poshtë në një pozicion më të ulët (boshti vertikal): *lower, descend, plunge, sink*

Tani që kemi renditur klasifikimet semantike të foljeve të lëvizjes në fusha dhe nënfusha sipas Faber & Mairal-Uson dhe Rodríguez-García, do të komentojmë shkurtimisht nocionet semantike që duket se janë të rëndësishme për këto organizime të fushës së lëvizjes.

Në tërësi, analizat e Faber & Mairal-Uson dhe Rodríguez-García për foljet e lëvizjes marrin në konsideratë nocionet semantike të Trajektores dhe Mënyrës së lëvizjes. Klasifikimi i Faber & Mairal-Uson i përfshin foljet e Trajektores dhe Mënyrës brenda të njejtës fushë; veçanërisht, fusha e lëvizjes së përgjithshme bashkon foljet që shprehin trajektore të ndryshme (p.sh. *off/away, towards, across, over, through, into, out of*) me foljet që shprehin mënyra të veçanta të lëvizjes (p.sh. *race, lumber, glide*). Për më tepër, analiza e tyre merr parasysh edhe Terrenin, dmth, nëse Figura lëviz në lidhje me tokën, ajrin ose ujin, dhe prandaj ata propozojnë tre fusha të ndryshme. Nga ana tjetër, analiza e foljeve të lëvizjes nga Rodríguez-García i veçon foljet e trajektores nga foljet e mënyrës. Në fushën e Lëvizjes Pozicionale dhe Drejtimore, ai përfshin foljet e mënyrës që shprehin dy grupe mënyrash të ndryshme: Foljet që i referohen lëvizjes së brendshme (dmth, pa ndryshim të vendndodhjes së Figurës) dhe foljet të cilat tregojnë lëvizje zhvendosëse (dmth, Figura lëviz në një vend të papërcaktuar duke lëvizur në një mënyrë të caktuar). E para, dmth, lëvizja e brendshme, përfshin foljet të cilat tregojnë se Figura lëviz në mënyrë rrethore (b1), nga njëra anë në tjetrën (b2) dhe lart e poshtë (b3). E fundit, dmth, lëvizja zhvendosëse, grupon foljet e Mënyrës të cilat nënkuptojnë se Figura zhvendoset, si në rastet (c1), (c2) dhe (c3). Së fundi, në lidhje me foljet e trajektores, Rodríguez-García i klasifikon foljet brenda fushës së Lëvizjes Drejtimore sipas boshteve horizontale dhe vertikale dhe sipas lëvizjes larg nga - drejt një vendi.

3.4. Semantika e foljeve të lëvizjes

3.4.1. Hyrje

Në kapitullin 3, kemi shqyrtuar një masë të madhe të literaturës për ngjarjen e lëvizjes, sidomos nga një këndvështrim ndërgjuhësor. Për të krahasuar shprehjen e ngjarjeve të lëvizjes ndër gjuhë (p.sh. tregimet me shkrim dhe me gojë), studiuesit nevojitet të identifikojnë një numër

kategorish konceptuale si dhe një sërë mjetesh gjuhësore të disponueshme në gjuhë të ndryshme. Kështu, Slobin dhe bashkëpunëtorët e tij krijuan një sistem kodimi. Slobin ofron një listë të kategorive semantike dhe elementeve gjuhësorë që u përfshinë në sistemin e tyre të kodimit.

Këtu, interesi ynë kryesor janë kategoritë kuptimore që propozohen. Slobin dhe bashkëpunëtorët e tij e morën në konsideratë përbërësit e përgjithshëm semantikë të Talmy por i zbërthyen ato me tej në kategori më të thelluara:

- Figura: objekti që lëviz.
 - ✓ Individ ose grup
 - ✓ Lloji: njeri, kafshë, shpend, etj
 - ✓ Qëndrimi: Ndryshimi i qëndrimit në fillim ose në fund të trajektores
- Terreni: subjekti ose subjektet në lidhje me të cilin/të cilët lëviz Figura.
 - ✓ Burimi: Vendndodhja fillestare
 - ✓ Qëllimi: Vendndodhja perfundimtare
 - ✓ Shenja: Vendndodhjet që kalohen gjatë trajektores
 - ✓ Mjedisi, Terreni: fusha, lumi, etj
 - ✓ Mjedise jo të ngurta: ajri, mjegulla, stuhia, errësira, etj.
- Trajektorja: trajektorja e Figurës.
 - ✓ Drejtimi i lëvizjes: përpara, lart, në veri, etj.
 - ✓ Këndvështrimi: Drejtimi në lidhje me këndvështrimin e tregimtarit
 - ✓ Forma: trajektore e lakuar, zigzage, etj.
- Mënyra: mënyra në të cilën kryhet lëvizja.
 - ✓ Modeli motor që nevojitet për të kryer lëvizjen
 - ✓ Dinamika e forcës
 - ✓ Ritmi
 - ✓ Mjetet e kryerjes: me kafshë, me makinë, me aeroplan, etj.
- Shkaku: Çfarë e shkakton vetë lëvizjen.

Për ilustrim, ngjarja e lëvizjes e përshkruar në fjalinë *Dori climbed out of the tree* mund të analizohet si e përbërë nga një qenie njerëzore e drejtuar në një drejtim zbritës, duke u kapur tek një burim i përcaktuar si pema me një objektivë të pacaktuar .

Krahas ngjarjeve të lëvizjes, këto kategori janë të dobishme për të eksploruar semantikën e foljeve të lëvizjes. Megjithatë, siç do të shohim në dy seksionet e ardhshme, hulumtimi ndërgjuhësor i ngjarjeve të lëvizjes ka propozuar edhe kategori më specifike të mënyrës dhe trajektores me qëllim që

të rroken dallimet semantike midis foljeve. Seksioni 3.4.2 përqendrohet tek foljet e mënyrës dhe ofron një listë përmbledhëse të dallimeve më të imta të mënyrës të propozuara nga një numër studiuesish. Së fundi, në seksionin 3.4.3 jepet një pasqyrë e disa studimeve të cilat e drejtojnë vëmendjen e tyre kërkimore tek semantika e foljeve të trajektores, që shpesh janë injoruar nga kërkimi ndërgjuhësor për ngjarjet e lëvizjes. Ashtu si me përbërësin e Mënyrës, edhe këtu propozohen kategori më të imta të Trajektores.

3.4.2. Foljet e Mënyrës

Në literaturën voluminoze për ngjarjet e lëvizjes gjendet një studim ndërgjuhësor interesant që shqyrton mënyrën e foljeve të lëvizjes si dhe të foljeve nga fusha të tjera. Mary Snell-Hornby (1983) krahasoi semantikën e foljeve të lëvizjes për anglishten dhe gjermanishten duke i grupuar ato në nënklasa dhe duke u përqëndruar pastaj në dallimet e imta kuptimore midis foljeve brenda secilës nënklasë. Ajo e përmbledh studimin e saj si më poshtë:

Leksemat shqyrtohen në funksionin e tyre semantik përkundrejt atij të fqinjit të tyre në të njejtën gjuhë, dhe në të njejtën kohë që ato krahasohen me leksema të ngjashme semantike në gjuhë të tjera. (Snell- Hornby, 1983 : 17)

Në analizën e saj të 483 foljeve të gjermanishtes dhe 617 foljeve të anglishtes, ajo propozoi 4 fusha kryesore: Sjellja Njerëzore, Lëvizja & Pozicioni, Tingujt, edhe Shprehja e Fytyrës & Drita. Çdo fushë përfshin një sërë nënfushash të strukturuar. Kështu, fusha e madhe e Lëvizjes dhe Pozicionit ndahet në 3 nënfusha: (1) Të Ecurit dhe të Vrapuarit, (2) Lëvizja në ajër dhe ujë, dhe (3) Statike dhe Negative; këto nënfusha, nga ana e tyre, ndahen edhe më tej (Snell-Hornby, 1983: 80, 133, 142). Këtu, ne do të trajtojmë nënfushat (1) dhe (2) me shembuj foljesh nga anglishtja, pasi këto janë brenda sferës së këtij disertacioni.

1. Të Ecurit dhe të Vrapuarit

- a. I ngeshëm, i paqëllimtë: *wander, ramble, roam, rove, stray, hike, meander, stroll*
- b. I mundimshëm: *trudge, plod, tramp, stump*
- c. I ngathët, i pavendosur: *waddle, toddle, totter, dodder, stagger*
- d. I shkathët, me energji: *trot, trip, skip, frisk, caper, frolic, romp, hop, jump*

2. Ajri dhe e Uji

- a. Shpejtësia: *race, rush, dash, whiz, zoom, sweep, hurtle*
- b. Fluturimi, butësia: *soar, hover, float, drift, waft*
- c. Uji: *ripple, splash, flow, trickle, drip*
- d. Zhytja, rënia: *tumble, topple, pitch, plummet, plunge, dive*
- e. Hedhja: *hurl, fling, toss, dump*
- f. Kthimi: *twiddle, twirl, spin, whirl, swirl*
- g. Tutje - Tëhu: *swing, wave, sway, shake, shiver, tremble*
- h. Lëvizja e papritur: *jump, bounce, jolt*

Për të ilustruar krahasimin e saj ndërgjuhësor të foljeve të anglishtes, do të përmbledhim një pjesë të vogël të analizës së saj për fushën e Të Ecurit dhe Të Vrapuarit dhe nënfushën (a) *Lëvizje e ngeshme dhe e paqëllimtë* (Snell-Hornby, 1983: 133-134). Në këtë grup foljesh të lëvizjes, foljet e anglishtes *amble, saunter* dhe *stroll* përqendrohen tek qëndrimi i ngeshëm i vepruesit. *Amble* përqendrohet tek hapat e lehtë dhe lëvizja e rrejdshme; *saunter* thekson qëndrimin vetëbesues të vepruesit, dhe *stroll* thekson lëvizje të panxituar por jo domosdoshmërisht të rrjedhshme, pasi ajo përfshin edhe ndalesa. Analiza e Snell-Hornby merret me hollësitë e kuptimit të cilat shërbejnë për të kuptuar dhe dalluar kuptimin të foljeve të lëvizjes brenda dhe midis dy gjuhëve. Megjithatë, Snell-Hornby nuk ofron ndonjë listë të hollësive të mënyrës që mund të shërbejnë si bazë për krahasimin e foljeve të lëvizjes nga gjuhë të tjera.

Siç e kemi parë në Kapitullin 3, Slobin (p.sh, 2004, 2006) ka vërejtur se disponueshmëria e një hapësire foljore në gjuhët me kornizë satelitore ka bërë që këto gjuhë të zhvillojnë një leksik foljesh të mënyrës i cili është më i pasur dhe më shprehës se gjuhët me kornizë foljore. Për të shqyrtuar këtë pretendim, prirja e përgjithshme e studimeve ndërgjuhesore për ngjarjet e lëvizjes ka qenë përdorimi i të dhënave nga romanet, tregimet dhe përkthimet. Megjithëse nuk është bërë ndonjë numërimin perfundimtar, Slobin së fundi (2006a: 71) ka vlerësuar rreth disa qindra folje të mënyrës për gjuhët me kornizë satelitore dhe më pak se njëqind për gjuhët me kornizë foljore.

Një nga problemet që del nga kërkimet mbi ngjarjet e lëvizjes është se kategoria e Mënyrës është shumë e përgjithshme; siç e kemi parë më lart, ajo përfshin një gamë të gjerë informacioni: shpejtësinë e lëvizjes, gjendjet psikologjike (zemërim, lodhje), aftësitë themelore të lëvizjes (eci, vrapoj, hidhem, etj.), mjetet e lëvizjes, kontaktin, etj. Në një përpjekje për të hedhur dritë mbi llojet e veçanta të hollësive të mënyrës të cilat shprehen tek foljet dhe/ose tek njësitë e tjera leksikore, Ibarretxe-Antuñano (2004b, 2006a), Özçalışkan (2004), Slobin (2000, 2005), dhe shumë të tjerë, e kanë nën-ndarë Mënyrën në kategori të ndryshme semantike. Iraide Ibarretxe-Antuñano (2006a)

hartoi një listë përmbledhëse të kategorive të imta të mënyrës të cilat propozohen për analizën e foljeve të lëvizjes ⁴:

- Modeli Motor: (aftësitë themelore të lëvizjes):
 - ✓ Mënyrat e të ecurit
 - ✓ Mënyrat e të vrapuarit
 - ✓ Mënyrat e të hedhurit
 - ✓ Mënyrat e të notuarit
 - ✓ Mënyrat e të fluturuarit
- Energjia: qëndrueshmëria e nevojshme për kryerjen e lëvizjes: p.sh, *throw, fling, churn*
- Lëvizja e detyruar: lëvizja kërkon një përpjekje që të kryhet: p.sh, *drag, trudge*
- Lëvizja e fshehtë: qëllim i fshehur apo lëvizje e fshehtë: p.sh, *crawl, creep, sneak*
- Lëvizja e penguar: ka një farë pengese për lëvizje: p.sh, *stumble, trip*
- Lëvizja e butë: lëvizja rrjedh, nuk ka asnjë pengesë: p.sh, *glide, slide*
- Lëvizja e ngeshme: lëvizje për kënaqësi: p.sh, *hike, trek*
- Lëvizja e paqëllimtë: asnjë qëllim i veçantë: p.sh, *roam, saunter*
- Lëvizja e dhunshme: p.sh, *charge, dash*
- Lëvizja e paqëndrueshme: lëvizje e pabalancuar: p.sh, *totter, stagger*
- Ritmi: shpejtësia e lëvizjes (e shpejtë apo e ngadalshme; rritëse apo zbritëse): p.sh, *hurry, dash, zoom*
- Gjendja e Figurës: gjendja fizike ose psikologjike: p.sh, *limp, traipse, stroll, swagger*

Kategoritë ose parametrat e Mënyrës nuk janë reciprokisht ekskluzive, dmth, një folje mund të shprehë më shumë se një hollësi të imët të mënyrës. Për shembull, folja *jog* në anglisht mund të analizohet si model motor i të vrapuarit me shpejtësi të ngadaltë lëvizjeje; folja *stagger* si model motor i të ecurit me lëvizje të pasigurt, etj. Për më tepër, është e rëndësishme të nënvizojmë se Mënyra mund të kombinohet me trajektoren tek vetë folja, si në rastin e *soar*, e cila do të mund të analizohet si model motor i të fluturuarit, me ritëm të shpejtë dhe trajektore të lëvizjes me drejtim lart.

Gjatë eksplorimit të semantikës së foljeve të lëvizjes, shumë shpesh studiuesit e kanë pasur të vështirë të përcaktojnë nëse foljet e lëvizjes shprehin vetëm Mënyrën, apo Mënyrën plus Trajektoren. Autorët shpesh ndryshojnë në analizat e tyre semantike të foljeve të lëvizjes dhe në atë që ata konsiderojnë folje të Mënyrës dhe Trajektores. Nëpërmjet ilustrimit të mëposhtëm le të konsiderojmë

⁴ Ajo përdor këto kategori të mënyrës në analizën e saj të shprehjeve simbolike tingullore për lëvizjen në gjuhën baske.

se si Bernhard Wälchli dhe Seyda Özçalışkan (2004) klasifikojnë disa folje të lëvizjes. Nga njëra anë, Wälchli konsideron se ka folje të ndërmjetme të cilat kombinojnë Mënyrën dhe Trajektoren. Këto raste të ndërmjetme janë folje të mënyrës me drejtim të preferuar, të tilla si *fall* dhe *sink* (zakonisht me drejtim poshtë), *flee* (zakonisht lëvizje larg nga një vend), *climb*⁵ dhe *soar* (zakonisht me lëvizje lart). Nga ana tjetër, Özçalışkan (2004) i kategorizon foljet që kombinojnë Mënyrën dhe Trajektoren (dmth, foljet e ndërmjetme të Wälchli) si folje të mënyrës. Brenda grupit të mënyrës, përfshihen edhe foljet që kombinojnë Mënyrën dhe Terrenin, të tilla si *fly* (Terreni: ajër), *swim* dhe *sink* (Terreni: ujë). Ndryshe nga analiza e Wälchli, Özçalışkan e analizon *sink* si folje që kombinon Mënyrën dhe Terrenin, por jo Trajektoren (lëvizje me drejtim poshtë).

Duhet nënvizuar të paktën dy shpjegime për të mbështetur pozicionet e ndryshme të studiuesve të foljeve të lëvizjes. Nga njëra anë, duke qenë se foljet e mënyrës me drejtim të preferuar (p.sh. *soar*, *climb*, lëvizje me drejtim lart) mund të kombinohen me satelitë të ndryshëm të Trajektores (p.sh. *soar up and down*, *climb to*, *climb across*, *climb down*), duket se informacioni për Trajektoren, më shumë se tek folja, kalon tek satelitët. Prandaj, mund të thuhet se këto folje të mënyrës nuk e kanë përbërësin Trajektore. Nga ana tjetër, fakti se disa folje të mënyrës shoqërohen shpesh me Trajektore të caktuara sugjeron se kuptimi i këtyre foljeve të mënyrës i nënkupton keto trajektore; me fjalë të tjera, mendohet se këto folje kombinojnë si Mënyrën edhe Trajektoren. Kështu, mund të thuhet se folja *soar* tregon ritëm të shpejtë të lëvizjes (Mënyrë) plus trajektore me drejtim lart (Trajektore); folja *climb* shpreh përdorimin e këmbëve dhe/ose duarve (Mënyrë) për t'u ngjitur diku (Trajektore).

Në përgjithësi, për të rrokur dallimet e imta semantike të leksikalizuara tek foljet në gjuhë të ndryshme, studimet ndërgjuhësore që eksplorojnë foljet e mënyrës janë përqendruar tek veçoritë që përbëjnë Mënyrën. Siç është treguar, përbërësi Mënyrë mund të zbërthehet në një numër kategorish të pavarura të cilat kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të skenës së lëvizjes.

3.4.3. Foljet e Trajektores

Megjithë rëndësinë që ka Trajektorja për ngjarjen e lëvizjes, theksi i analizës së foljeve të

⁵ Sipas Fillmore (1982: 32-33) dhe Jackendoff (1985: 279, 2002), folja e anglishtes *climb/ngjitem* është një koncept grupi, dmth., që një situatë të konsiderohet si shembull ngjitjeje ajo duhet të plotësojë dy kushte: (1) lëvizje kacavjerrëse e të mundimshme (duke përdorur gjymtyrët), dhe (2) drejtim nga poshtë lart. Megjithatë, nuk është e thënë dhe as e domosdoshme që këto dy faktorë të ndodhin njëkohësisht, por mjafton secili prej tyre. Për shembull, në anglisht, njeriu mund të kacavirret për t'u ngjitur ose për të zbritur kurse gjarpri mund të ngjitet vetëm lart (plotësohet kushti i drejtimit lart), dhe jo poshtë (pasi nuk plotësohet as kushti i gjymtyrëve mbështetëse as ai i drejtimit lart).

lëvizjes ka qenë zakonisht tek Mënyra e lëvizjes (Ibarretxe-Antuñano, 2003b;). Pra, nuk ekzagjerojmë aspak të themi se është e nevojshme të studiohen si përbërësi semantik i Trajektores ashtu edhe vetë foljet e trajektores.

Për të kuptuar më mirë dallimet ndërmjet foljeve të trajektores, si brenda një gjuhe ashtu edhe midis gjuhëve, është e dobishme të fillohet duke vënë në dukje përbërësit e dallueshëm që përbëjnë këtë element. Sipas Talmy (2000b: 53-56), tre përbërësit kryesorë të Trajektores janë Vektori, Konformiteti dhe Këndvështrimi⁶:

1. Vektori i referohet drejtimit të lëvizjes së Figurës në lidhje me Terrenin, i cili mund të jetë një burim, një objektivë apo qëllim; kështu, Vektori mund të tregojë lëvizje nga një burim (p.sh, *move from*), lëvizje pas ose përgjatë një pikë referimi (p.sh, *move along, via*), dhe lëvizje drejt një pike referimi (për shembull, *move to, towards*).
2. Konformiteti lidhet me gjeometrinë e Terreneve të cilat mund të konceptualizohen si enë (p.sh, *move into, out of*), si sipërfaqe (p.sh, *on*), si pika (p.sh, *past*), etj.
3. Përbërësi Këndvështrim përcaktohet qartë nga Talmy (2000b: 56) si më poshtë: ‘Përbërësi Këndvështrim i Trajektores zakonisht ka vetëm dy nocione: në drejtim të folësit dhe në një drejtim tjetër të ndryshëm nga ai në drejtim të folësit’.

Të tre përbërësit e Trajektores mund të ndodhin edhe njëherazi. Nëse marrim parasysh shembullin (11), sateliti i anglishtes *into* kombinon Vektorin dhe Konformitetin; Figura arrin qëllimin e saj ose pikën fundore të lëvizjes, e cila është një enë.

(11) The ball rolled *into* the box

Slobin propozoi një përbërës të katërt, *Zhvendosjen lidhur me Tokën*. Ky përbërës ka të bëjë me drejtimin e lëvizjes në lidhje me gjeometrinë e tokës: veri-jug-lindje-perëndim, lart-poshtë, dhe koordinata të tjera absolute (në ngjitje, në zbritje). Për shembull, foljet e anglishtes *ascend* dhe *descend* tregojnë lëvizje përgjatë boshtit vertikal.

Në përgjithësi, Vektori, Konformiteti, Këndvështrimi dhe Zhvendosja lidhur me Tokën duhet të shihen si përbërës të Trajektores që janë të dobishëm për eksplorimin e dallimeve ndërgjuhësore në llojin e informacionit për trajektoren të shprehur tek foljet e trajektores. Krahas këtyre, studiuesit kanë propozuar mënyra të tjera për të analizuar më tej foljet e trajektores, që mund t’i shërbejnë po aq mirë qëllimeve të njejta.

⁶ Sipas Talmy (2000b: 53), Trajektorja në gjuhët e folura përbëhet nga tre komponentë (Vektori, Konformiteti dhe Këndvështrimi), ndërsa në gjuhët e shenjave shtohen edhe dy komponentë të tjerë: Konturi dhe Drejtimi.

Wälchli (2001) ofroi një tipologji më të imët të foljeve të trajektores; më saktë, ai propozoi 6 lloje të trajektores apo *lloje kardinale të zhvendosjes*, të cilat ai i emërton me ndihmën e parafjalëve latine:

- a. AD = Figura shkon tek Terreni
- b. IN = Figura shkon brenda në Terren
- c. SUPER = Figura shkon mbi Terren
- d. AB = Figura largohet nga Terreni
- e. EX = Figura del nga Terreni
- f. DE = Figura zbret nga Terreni

Berthele (2004) i përdori llojet e trajektores të Wälchli me disa ndryshime. Në veçanti, në pikat (c) dhe (f), duket se Wälchli përzien zhvendosjen përgjatë boshtit vertikal dhe një lëvizje specifike *në drejtim të një Terreni (onto)* ose *poshtë nga (down from)* një Terren. Sipas Berthele (2004: 99), ky shoqërim mund të shmangët pasi një folje e lëvizjes që shpreh trajektore në zbritje mund të pasohet nga një plotës që tregon ose burimin, si në shembullin (12), ose qëllimin e lëvizjes, si në shembullin (13).

(12) The boy falls *from the tree*

(13) The boy falls *onto the ground*

Kështu, Raphael Berthele propozoi që trajektoret të kategorizohen pa përcaktuar burimin apo qëllimin në dimensionin vertikal (shih klasifikimin e tij më poshtë). Për më tepër, ndryshe nga lista e Wälchli e cila përdor foljet dëftuese *go/shkoj* dhe *come/vij*, Berthele vendosi të përdorë foljen *zhvendos* për të shmangur referencën tek një qendër këndvështrimore e panevojshme. Ja riformulimi i tij:

- a. AD = Figura zhvendoset tek Terreni
- b. IN = Figura zhvendoset brenda në Terren
- c. SUPER = Figura zhvendoset lart
- d. AB = Figura zhvendoset larg nga Terreni
- e. EX = Figura zhvendoset jashtë nga Terreni
- f. DE = Figura zhvendoset poshtë

Në tërësi, kategorizimi i foljeve të trajektores sipas llojeve apo fushave të trajektores është edhe një mjet i dobishëm për analizën ndërgjuhësore. Llojet e propozuara të trajektores përfshijnë Vektorin, Konformitetin dhe Këndvështrimin e Talmy, si edhe Zhvendosjen lidhur me Tokën (boshti vertikal dhe horizontal) të Slobin. Për shembull, *ascend* mund të kategorizohet si folje SUPER (dmth,

Figura zhvendoset lart), ose si një folje që shpreh Zhvendosje lidhur me tokën (p.sh. aksi vertikal: lart); *leave* si folje AB (dmth., Figura zhvendoset larg nga Terreni) ose si folje që shpreh Këndvështrim (p.sh. lëvizje larg nga qendra këndvështrimore).

Së fundi, sugjerohet gjithashtu që leksiku i foljeve të trajektores mund të jetë i mbyllur (dmth, i kufizuar në llojet e nocioneve që mund të përcjellë) dhe që gjuhët, pa marrë parasysh statusin tipologjik, mund të kenë leksik të krahasueshëm foljesh të trajektores. Özçalışkan (2004) konstatoi se anglishtja dhe turqishtja paraqesin një numër të ngjashëm foljesh të trajektores, më konkretisht, 20 lloje për gjuhën angleze dhe 24 lloje për gjuhën turke. Ajo pretendonte se leksiku i foljeve të mënyrës është i hapur (dmth, i hapur për hyrje të reja), ndërsa leksiku i foljeve të trajektores ‘formon një kategori leksikore të mbyllur që nuk ofron shumë mundësi për përpunim’ (Özçalışkan, 2004: 85). Edhe pse të dhënat kërkimore e tregojnë këtë drejtim, pretendimi se leksiku i foljeve të trajektores ndër gjuhë ka madhësi të krahasueshme mbetet akoma për t’u trajtuar.

3.5. Përmbledhje

Foljet levizore kanë qenë subjekt i shumë studimeve nga këndvështrime të ndryshme teorike sepse ato paraqesin veçori interesante semantike dhe sintaksore. Edhe pse foljet e lëvizjes konsiderohen një klasë semantike koherente, ky kapitull tregoi se foljet e lëvizjes shprehin lloje të ndryshme të informacionit semantik dhe shfaqin sjellje të ndryshme sintaksore.

Seksionet 3.2 dhe 3.3 shqyrtuan një numër qasjesh ndaj gramatikës duke u përqendruar tek leksiku i foljeve: Qasja e Bazuar në Marrëdhënien Sintaksë-Semantikë dhe Qasja e Bazuar në Modelin Funksional-Leksematik. ‘Qasja e Bazuar në Marrëdhënien Sintaksë-Semantikë’ përmbledh teoritë të cilat supozojnë se struktura e argumentit parashikohet ndjeshëm nga kuptimet e foljeve, dhe se foljet me kuptime të ngjashme shfaqin sjellje sintaksore të ngjashme. Nga ana tjetër, studiuesit që punojnë në kuadër të ‘Modelit Funksional-Leksematik’ kanë një qasje më semantike për studimin e leksikut të foljeve të lëvizjes. Të dy qasjet na kanë dhënë njohuri interesante për natyrën semantike dhe sintaksore të foljeve të lëvizjes dhe klasat e ndryshme të foljeve të lëvizjes të propozuara sipas këtyre veçorive. Ndryshe nga studiuesit që merren me marrëdhënien Sintaksë-Semantikë, të cilët i identifikojnë klasat e foljeve të lëvizjes bazuar në sjelljen e tyre sintaksore, studiuesit brenda paradigmes Funksionale-Leksematike marrin semantikën, dhe jo sintaksën, si pikënisje për klasifikimin e foljeve të lëvizjes. Megjithatë, ata pohojnë gjithashtu se foljet e lëvizjes brenda të njëjtës klasë jo vetëm ndajnë përmbajtjen semantike por shfaqin edhe sjellje të ngjashme sintaksore. Në përgjithësi, tendenca e përgjithshme për analizën e foljeve të lëvizjes ka qenë veçimi i foljeve të

trajektore nga foljet e mënyrës. Nga njëra anë, foljet e trajektore shpesh ndahen në klasa sipas (1) trajektoreve që përshkruajnë dhe (2) nëse tregojnë ose jo një vendndodhje fundore. Foljet e mënyrës, nga ana tjetër, ndahen zakonisht në dy grupe: (1) foljet e mënyrës që tregojnë lëvizje zhvendosëse (p.sh, *walk/eci*, *run/vrapoj*) dhe (2) foljet e mënyrës që tregojnë lëvizje të brendshme (p.sh, *shiver/dridhem*, *tremble/drithërohem*, *spin/përdridhem*,).

Seksioni 3.4 trajtoi semantikën e foljeve të lëvizjes, duke lënë mënjanë konsideratat sintaksore. Në këtë seksion u shqyrtuan studimet për ngjarjet e lëvizjes, me vëmendje të veçantë tek përbërësit e Mënyrës dhe Trajektores. Mënyra si kategori e përgjithshme semantike është e dobishme për përshkrimin e modeleve leksikalizuese të lëvizjes; veçanërisht kur Mënyra kontrastohet me Trajektoeren. Për më tepër, siç tregohet në seksionin 3.4.2, studimet ndërgjuhësore që eksplorojnë foljet e mënyrës e përqendrojnë vëmendjen tek veçoritë përbërëse të Mënyrës për të rrokur dallimet e imta semantike që leksikalizohen tek këto folje. Kështu, është gjetur që përbërësi Mënyrë mund të zbërthehet në një numër parametrash të pavarura të cilat kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të skenës së lëvizjes si: lëvizja e detyruar, lëvizja e butë, ritmi i lëvizjes, gjendja e figurës, etj. Në të kundërt, Trajektorja e lëvizjes nuk ka marrë aq shumë vëmendje kërkimore. Seksioni 3.4.3 tregoi se edhe Trajektorja mund të ndahet në katër përbërës themelorë (Vektori, Konformiteti, Këndvështrimi dhe Zhvendosja lidhur me Tokën), të cilët shërbejnë për të eksploruar llojet e nocioneve që mbartin foljet e trajektore. Studimet ndërgjuhësore, për më tepër, sugjerojnë që foljet e trajektore mund të kategorizohen sipas llojeve apo fushave themelore të trajektore. Së fundi, është sugjeruar se, në dallim nga leksiku i foljeve të mënyrës që duket se është i hapur për hyrje të reja, leksiku i foljeve të trajektore mund të jetë i mbyllur dhe se gjuhët mund të kenë madhësi të krahasueshme të leksikut të foljeve të trajektore.

KAPITULLI IV

SEMANTIKA E LEKSIKUT TË FOLJEVE TË LËVIZJES NË ANGLISHT DHE SHQIP

4.1. Hyrje

4.2. Qëllimet dhe metodologjia

4.2.1. Qëllimet

4.2.2. Korpusi i foljeve të lëvizjes

4.2.3. Metodologjia

4.2.4. Disa probleme dhe kufizime

4.3. Shpërndarja e përgjithshme: kombinimet foljore

4.3.1. Kombinimet foljore të anglishtes

4.3.2. Kombinimet foljore të shqipes

4.3.3. Diskutim dhe përfundime

4.4. Foljet e Trajektores

4.4.1. Foljet e Trajektores në anglisht

4.4.2. Foljet e Trajektores në shqip

4.4.3. Diskutim dhe përfundime

4.5. Foljet e Mënyrës

4.5.1. Foljet e Mënyrës në anglisht

4.5.2. Foljet e Mënyrës në shqip

4.5.3. Diskutim dhe përfundime

4.6. Përfundime

4.1. Hyrje

Ky kapitull synon të eksplorojë natyrën semantike të leksikut të foljeve të lëvizjes në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe dhe të bëjë një pasqyrë krahasuese me vëmendje të veçantë tek dimensionet e Trajektores dhe Mënyrës së lëvizjes. Megjithë numrin e madh të studimeve mbi shprehjen gjuhësore të ngjarjeve të lëvizjes në anglisht dhe pretendimeve për semantikën e foljeve të saj, nuk ka pothuajse asnjë studim që të ketë bërë një analizë të thellë të leksikut të foljeve të lëvizjes për anglishten, dhe me sa dimë, nuk ekziston asnjë studim krahasues i foljeve të lëvizjes në anglisht me foljet e lëvizjes në shqip. Siç është theksuar në kapitujt e mëparshëm, Slobin (1997: 459) vuri në dukje se gjuhët duket se kanë leksik me ‘dy nivele’ për foljet që tregojnë Mënyrën e lëvizjes¹: (1) një nivel të përgjithshëm, apo mbizotërues, të përfaqësuar nga folje të tilla si *walk*, *run*, *jump*, *fly*, *eci*, *vrapij*, *hidhem*, *fluturoj* etj; dhe (2) një nivel shprehës më specifik të përbërë nga mënyra të ndryshme të të ecurit, të tilla si *stroll*, *wander*, ose *shuffle* – *bredh*, *shëtis*, *sorollatem*, apo; mënyra të ndryshme të të vrapuarit si *sprint* ose *jog*, *vërsulem*, *sulem*, etj. Anglishtja zotëron një nivel të dytë shumë të gjerë dhe të përpunuar. Për më tepër, në një përpjekje për të hedhur dritë mbi llojet e veçanta të hollësive të mënyrës që shprehen tek foljet dhe/ose tek njësitë e tjera leksikore, studiuesit e kanë ndarë Mënyrën në kategori të ndryshme semantike. Për sa i përket foljeve të trajektores, në Kapitullin 3 u theksua se Özçalışkan (2004: 85) pretendonte se leksiku i foljeve të trajektores në gjuhë ‘formon një kategori të mbyllur leksikore që nuk ofron shumë mundësi për përpunim’. Kështu, ajo hodhi hipotezën se gjuhët duket se zotërojnë numër përafërsisht të njëjtë foljesh të trajektores. Megjithatë, pretendimi i saj ende nuk është trajtuar plotësisht nga studimet gjuhësore.

Ky kapitull ka për qëllim ngushtimin e hendeikut në literaturën ekzistuese duke shqyrtuar një grup të konsiderueshëm foljesh të lëvizjes në anglisht dhe në shqip: në mënyrë të veçantë, do të përqendrohemi tek foljet vetvetore dhe joveprorë të lëvizjes (Talmy, 2000b: 28), pra, folje jokallimtare të lëvizjes që gjenden normalisht në ndërtimet ‘Figurë+Folje e lëvizjes’. Studimi përbëhet nga tre pjesë: së pari, do të përqendrohemi në llojin e përbërësve të përgjithshëm semantikë që shprehen në këto folje të lëvizjes; së dyti, do të studiojmë llojet e nocioneve të trajektores të shprehura tek foljet, dhe së treti, do të përqendrohemi në llojin e hollësive të imta të mënyrës që leksikalizohen tek foljet. Për më tepër, studimi ynë ka për qëllim të krahasojë leksikun e

¹Kjo duket të jetë veçori jo vetëm e foljeve të lëvizjes por edhe e foljeve të fushave të tjera, si foljet e të shikuarit (me *see* dhe *look* në nivelin mbizotërues dhe *stare*, *gaze*, *glance*, *gape*, etj. Në nivelin specifik); foljet e të qeshurit ose buzëqeshurit (me *guffaw*, *smirk*, *grin*, etj., në nivelin e dytë), foljet e të thënit, foljet e të dëgjuarit, etj. Megjithatë, nevojiten studime të tjera për të provuar nëse gjuhët i kanë te dy këto nivele për shumicën e fushave semantike apo vetëm për disa prej tyre.

foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip dhe të trajtojë dy çështje të përgjithshme të studimit: (1) çështjen nëse gjuhët angleze dhe shqipe kanë leksikë foljesh të trajektores të krahasueshëm nga ana sasiore (p.sh., numër të ngjashëm foljesh) dhe cilësore (p.sh., të dy leksikët e foljeve të trajektores shfaqin lloje të ngjashme informacioni për trajektoren) dhe (2) çështjen nëse foljet e mënyrës në anglisht dhe shqip shprehin hollësi të krahasueshme të mënyrës pavarësisht nga fakti se foljet e mënyrës së lëvizjes në anglisht mund t'i tejkalojnë ato të shqipes.

Në seksionin 4.2, përshkruhen plotësisht synimet tona, çështjet kërkimore, korpusi dhe metodologjia. Seksionet 4.3, 4.4 dhe 4.5 përqendrohen tek analiza e foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip. Në seksionin 4.3 paraqitet shpërndarja e përgjithshme e foljeve sipas përbërësve të përgjithshëm semantikë që ato shprehin. Seksioni 4.4 përqendrohet tek foljet e trajektores dhe merret me llojet e nocioneve të trajektores që duket se shprehen zakonisht në këto gjuhë. Më pas, seksioni 4.5 shqyrton natyrën semantike të foljeve të mënyrës në secilën gjuhë dhe llojet e informacionit mënyror që duket se leksikalizohen zakonisht në këto gjuhë. Brenda secilit seksion, do të merremi së pari me foljet e lëvizjes në anglisht, pastaj me foljet e lëvizjes në shqip, dhe në fund, do të krahasojmë të dy gjuhët. Seksioni 4.6 i përgjigjet secilës prej pyetjeve studimore të trajtuara përgjatë kapitullit dhe përmbledh përfundimet kryesore të nxjerra nga analizat tona.

4.2. Qëllimet dhe metodologjia

4.2.1. Qëllimet

Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është që të bëjë një pasqyrë sistematike dhe të hollësishme të semantikës së leksikut të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip, dhe t'i krahasojë ato. Pikënisja jonë janë përbërësit e përgjithshëm semantikë të lëvizjes të përcaktuar nga Talmy, por analiza jonë depërton në kategoritë e gjera të Trajektores dhe Mënyrës për të kërkuar dallimet më të imta në leksikun e lëvizjes, të cilat do të na mundësojnë që (a) të kuptojmë më mirë si organizohet leksiku i lëvizjes në këto dy gjuhë, dhe (b) të formulojmë hipoteza për kërkime të mëtejshme psikogjuhësore (disa prej të cilave do të trajtohen në kapitullin 5). Pyetjet studimore që do të jenë objekt i analizës sonë semantike janë si më poshtë:

1. Cilat nocione semantike shprehen në foljet e lëvizjes në anglisht dhe shqip?

Kjo pyetje studimore ka për qëllim të eksplorojë cilat lloje kombinimesh gjenden përgjithësisht tek foljet e lëvizjes në anglisht dhe shqip dhe cilat jo. Përtej llojeve që shprehin Trajektoren dhe llojeve që shprehin Mënyrën, pritet të gjenden edhe modele të tjera leksikalizuese: Lëvizje+Figurë në Bashkëlëvizje (p.sh., *accompany/shoqëroj*, në të cilën disa figura shkojnë së bashku), Lëvizje+Terren (p.sh., *fly/fluturoj*), Lëvizje+Trajektore+Terren (p.sh., *embark* ‘të hipësh në një mjet’, *emigrate/emigroj* ‘të largohesh nga vendi’, *land/ulem2* ‘të ulesh në tokë’), etj.

2. A kanë të dy gjuhët leksikë të krahasueshëm të foljeve të trajektores?

2.1. A janë të krahasueshëm të dy leksikët në numrin e foljeve të trajektores?

2.2. A janë të dy leksikët të krahasueshëm në natyrën e tyre semantike?

2.2.1. Cilat lloje të nocioneve të trajektores leksikalizohen zakonisht në anglisht?

2.2.2. Cilat lloje të nocioneve të trajektores leksikalizohen zakonisht në shqip?

Ne synojmë të provojmë pretendimin e Özçalışcan se leksikët e foljeve të trajektores në gjuhë janë të krahasueshëm në numrin e foljeve. Vëmendja jonë studimore drejtohet në semantikën e foljeve të trajektores në anglisht dhe shqip për të zbuluar ngjashmëritë dhe dallimet ndërgjuhësore. Në përgjithësi, duke ballafaquar leksikun e foljeve të trajektores në anglisht dhe shqip si nga ana sasiore dhe nga ajo cilësore, ne synojmë t’u japim foljeve të trajektores vëmendjen kërkimore që ato meritojnë.

3. A leksikalizojnë këto dy gjuhë tek foljet informacion të ngjashëm për mënyrën e lëvizjes?

3.1. Cilat lloje të hollësive të mënyrës leksikalizohen zakonisht në anglisht?

3.2. Cilat lloje të hollësive të mënyrës leksikalizohen zakonisht në shqip?

3.3. A shfaq anglishtja një shkallë më të madhe hollësish të mënyrës në të gjitha nënfushat e lëvizjes? Nëse jo, në cilën nënfushë /cilat nënfusha shqipja shfaq një shkallë më të madhe hollësish të mënyrës?

Qëllimi ynë është të studiojmë edhe llojet më të imta të informacionit të mënyrës që leksikalizohen në të dy leksikët. Për më tepër, synimi është të gjejmë se cilat lloje të informacionit mënyror shprehen më produktivisht tek foljet. Studimet kanë treguar se anglishtja mund të përdorë emrat e mjeteve dhe emrat e vallëzimeve si folje të lëvizjes. Së fundi, studimi ynë kërkon të zbulojë (a) nëse leksiku i foljeve të mënyrës në anglisht është po aq i pasur dhe i larmishëm për të gjitha nënfushat e lëvizjes që kemi trajtuar (dmth.,

lëvizja e njeriut dhe e kafshëve, lëvizja e objekteve ose sendeve të pajetë, lëvizja në/mbi mjete, etj), dhe nëse jo, (b) nëse leksiku i foljeve të mënyrës në shqip mund të jetë më i pasur se ai i anglishtes për disa nënfusha të veçanta.

4.2.2. Korpusi i foljeve të lëvizjes

Korpusi të cilin ne kemi studiuar përbëhet nga 297 folje të lëvizjes për anglishten dhe 290 folje të lëvizjes për shqipen. Foljet e lëvizjes në vëmendje të këtij disertacioni përfshijnë foljet e përgjithshme të lëvizjes (dmth, pa asnjë informacion të veçantë semantik përveç përbërësit Lëvizje, të tilla si, *move/lëviz*), foljet e shoqërimit (p.sh., *escort, guide, lead, shoqëroj, drejtoj, udhërrëfej*), foljet e trajektoreve (p.sh., *arrive, come, depart, enter, exit, go, arrij, mbërrij, vij, nisem, hyj, dal*), si dhe foljet e mënyrës. Foljet e mënyrës i përkasin (a) lëvizjes së njerëzve dhe kafshëve (p.sh., *walk, run, fly, hop, eci, vrapoj, fluturoj, hidhem*), (b) lëvizjes duke përdorur një mjet (p.sh., *bike, canoe, ferry, ship*), (c) lëvizjes gjatë vallëzimit (p.sh., *waltz, foxtrot, twist / kërcëj, vallëzoj*), (d) lëvizjes së objekteve fizike apo subjekteve të pajetë (p.sh., *revolve, roll, spin, shake, swing, rrotulloj, rrokullis, pështjelloy, tund*) dhe (e) ndryshimit të qëndrimit (*kneel, lean, recline, twist, gjunjëzoj, mbështes, përdredh*).

Berthele (2004: 108-109) thekson se foljet e qëndrimit janë folje të ‘mënyrës së qëndrimit’ pasi shprehin ‘informacion konfiguroes për dimensionet dhe orientimin vertikal e horizontal të Figurës’. Megjithatë, ne vendosëm t’i numërojmë foljet e qëndrimit në korpusin tonë sepse ato shprehin lëvizje të brendshme të figurës. Me fjalë të tjera, Figura lëviz trupin e saj duke ndryshuar qëndrimin ose orientimin e saj edhe pse nuk lëviz në një vend tjetër (p.sh., lëvizje zhvendosëse). Talmy (2000b) e zgjeron kategorinë Qëndrim duke përfshirë ‘qëndrimet ose orientimet që merren nga trupi i njeriut ose nga objektet e trajtuara si të krahasueshme me trupin’. Kështu, objektet e pajetë mund të jenë edhe Figura të foljeve të qëndrimit. Megjithatë, natyrat semantike të foljeve të qëndrimit në anglisht dhe në shqip janë të ndryshme. Siç vëren Talmy (2000b: 80), foljet e qëndrimit në anglisht (*lie, sit, stand, lean, kneel, squat, crouch*, etj.) i referohen ‘të qenit në një gjendje’. Këtyre foljeve u duhet shtuar një satelit për të treguar kalimin në një qëndrim (p.sh., *lie down, kneel down*). Në rastin e foljes *lie*, asaj i duhet shtuar më tej edhe një prejardhje veprorë (*lay down*) për t’iu referuar vënies së gjërave në qëndrimin shtrirë. Në të kundërt, shqipja i leksikalizon nocionet e qëndrimit në joveproren e llojit ‘të vendosesh në një gjendje’ pa pasur nevojë të përdorë satelitë për të treguar kalimin në një qëndrim të caktuar (p.sh., *shtrihem, gjunjëzohem*).

Mënyra e foljeve të lëvizjes kryesisht përshkruan *lëvizje vetvetore* dhe *lëvizje joveprorë* (Talmy, 2000b). Foljet vetvetore janë kryesisht folje jokalimtare të cilat zakonisht tregojnë se Figura ka kontroll mbi lëvizjen e vet, që do të thotë, nuk ka asnjë veprues të jashtëm që të shkaktojë lëvizjen e saj:

- (1) a. He walked/ran/limped down the hall

Nga ana tjetër, foljet joveprorë janë edhe folje jokalimtare, por Figurat e tyre janë subjekte të pajetë, si në shembullin (2). Lëvizja joveprorë zakonisht i referohet lëvizjes ku Figura jo domosdoshmërisht ka kontroll të drejtpërdrejtë mbi lëvizjen e vet (Levin, 1993: 264-265; Morimoto, 2001: 46-47).

- (2) The ball slid/rolled/bounced

Në gjuhën shqipe diateza është ajo kategori gramatikore nëpërmjet të cilës shprehet lidhja midis veprimit të emërtuar nga folja dhe kryefjalës së fjalisë, lidhje e cila shprehet morfologjikisht me formën veprorë dhe atë joveprorë. Kategorinë e diatezës e kanë ato folje të cilat mund të përdoren si në formën veprorë ashtu edhe në formën joveprorë me kundërvëniet kuptimore përkatëse. Por e marrë në një kuptim më të gjerë kjo kategori i përfshin të gjitha foljet edhe foljet të cilat mund të përdoren vetëm në formën veprorë, siç janë foljet jokalimtare, edhe folje të cilat përdoren vetëm në formën joveprorë, siç janë foljet *kollem*, *dukem*, *pendohem* etj. Sipas gramatikës së gjuhës shqipe² mbështetur në llojet e ndryshme të lidhjeve midis veprimit të emërtuar nga folja dhe kryefjalës së fjalisë, si edhe në kundërvënien e formave përkatëse (veprorë - joveprorë), në gjuhën shqipe dallohen katër diateza: diateza veprorë, diateza pësore, diateza vetvetore dhe diateza mesore. Në përgjithësi, foljet e lëvizjes që hyjnë në kuadër të këtij disertacioni janë ato që mund të gjenden në ndërtimet jokalimtare ‘Figurë (subjekt) + Folje e Lëvizjes dhe në ndërtimet kalimtare ‘Figurë (subjekt) + Folje e Lëvizjes + Terren’ (kundra i drejtë), si në shembullin (3), dhe ‘Figurë (subjekt)+Folje e Lëvizjes + Figurë në Bashkëlëvizje’ (sidomos për foljet e të shoqëruarit), si në shembullin (4). Foljet kalimtare të lëvizjes që shprehin lëvizje të shkakuar nuk hyjnë në kuadër të këtij disertacioni.

² Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, 270.

- (3) a. We left work
b. Ne e lamë punën
- (4) a. He accompanied/guided Mary
b. Ai shoqëroi/drejtoi Merin

Për të përpiluar korpusin tonë të foljeve të lëvizjes kemi përdorur listat e foljeve që gjenden në literaturën ekzistuese, në fjalorët njëgjuhësh dhe thesarët. Në literaturën për foljet e lëvizjes në anglisht kemi konsultuar Levin dhe Rappaport-Hovav (1992), Levin (1993) dhe Snell-Hornby (1983). Po ashtu, kemi përdorur fjalorët dhe thesarët anglisht në vijim:

- *Oxford English Dictionary*
- *Cambridge Advanced Learner's Dictionary*, CD-Rom version 1.1. Cambridge University Press. 2003
- *Cambridge Klett Compact*, CD-Rom version 1.0b. Cambridge University Press. 2002.
- *Merriam-Webster Online*, available at <http://www.merriam-webster.com/>
- *The Free Dictionary*, (<http://www.thefreedictionary.com/dictionary.htm>)
- *Longman Language Activator*. Pearson Education. 2002
- *Roget's thesaurus of English words and phrases*, nga <http://poets.notredame.ac.jp/Roget/>

Për të mbledhur korpusin tonë të foljeve të lëvizjes në shqip, kemi shfrytëzuar fjalorët njëgjuhësh, dygjuhësh, enciklopedikë dhe fjalorë sinonimikë:

- *Fjalor i gjuhës shqipe*. Instituti i Shkencave. Tiranë. 1954.
- *Fjalor i shqipes së sotme*. Akademi e Shkencave e Shqipërisë. Botimet Toena. 2002.
- *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Akademia e shkencave e RPSSH. Tiranë. 1980.
- Dhrima, A. Tupja, E. Ymeri, E. (2002). *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*. Botimet Toena.

4.2.3. Metodologjia

Foljet e lëvizjes në anglisht dhe shqip të cilat përbëjnë korpusin tonë të studimit përfshihen në dy tabela të veçanta (shih Shtojca 1 dhe 2). Në secilën tabelë kemi krijuar nëntë kolona. E para i rradhit foljet e lëvizjes sipas rendit alfabetik. Kolona e dytë tregon nëse folja shpreh lëvizje zhvendosëse apo lëvizje të brendshme (Talmy, 2000b: 35). Siç është theksuar në kapitujt e mëparshëm, lëvizja zhvendosëse (p.sh., ndryshimi i

vendndodhjes së përgjithshme të Figurës) transmetohet kryesisht nga foljet e trajektores por edhe nga disa folje të mënyrës. Më konkretisht, foljet e mënyrës të tilla si *walk, tiptoe, jog* dhe *run / eci, vrapoj* (p.sh., Morimoto, 2001) nënkuptojnë ndryshimin e vendndodhjes së Figurës edhe pse trajektorja e lëvizjes mbetet e papërcaktuar. Në të kundërt, lëvizja e brendshme, në shumicën e rasteve, lidhet me foljet joveprore të mënyrës (p.sh., lëvizje e subjekteve të pajetë), të cilat në përgjithësi shprehin luhatje, rrotullim, përdredhje, dridhje, etj., të tilla si *revolve, roll, rotate, swing, sway*, dhe *shake / rrotulloj, pështjelloj, përkund, tund*. Gjithashtu, lëvizja e brendshme lidhet me foljet e qëndrimit, të cilat tregojnë lëvizje të një Figure që mbetet në vendin e saj të përgjithshëm.

Kolona e tretë tregon nëse çdo folje e lëvizjes mund të tregojë lëvizje veprare, dmth, një veprues që shkakton lëvizjen e Figurës:

- (5) He plunged his son into the swimming pool
- (6) He slid/rolled/bounced the ball into the house

Për ilustrim, folja vetvetore *plunge* është një folje jokalimtare që tregon ‘të lëvizësh ose të biesh papritmas dhe shpesh shumë larg përpara, poshtë apo brenda diçkaje’; megjithatë, ajo mund të përdoret si kalimtare në kuptimin ‘të shkaktosh që dikush apo diçka të bëjë këtë gjë’³. Kështu, në kolonën e tretë, ne tregojmë nëse foljet në korpusin tonë mund të shfaqin lëvizje veprare (lëvizje të shkaktuar).

Kolona e katërt tregon përbërësit e përgjithshëm semantikë që shprehen në çdo folje. Folja e lëvizjes mund të shprehë një ose më shumë prej përbërësve të mëposhtëm semantikë⁴:

- Figurën: objektin lëvizës
- Terrenin: subjektin ose subjektet në lidhje me të cilët lëviz Figura
- Lëvizjen: praninë e lëvizjes së mirfilltë
- Trajektoren: trajektoren e Figurës
- Mënyrën: mënyrën në të cilën kryhet lëvizja
- Shkakun: cila është origjina e lëvizjes

Për shembull, folja *arrive/arrij* kombinon Lëvizjen dhe Trajektoren, folja *walk/eci* kombinon Lëvizjen dhe Mënyrën, dhe *blow/fryj* shpreh Lëvizje dhe Shkak (dmth., rryma e

³Këto përkufizime janë marrë nga *Cambridge Advanced Learner's Dictionary*.

⁴Shiko Seksionin 2, Seksionin 2.2.2, për një pasqyrë gjithëpërfshirëse të përbërësve semantikë bazë të ngjarjes së lëvizjes dhe llojeve të marrëdhënieve midis ngjarjes kryesore dhe bashkëngjarjes, dhe Seksionin 2.2.3 për modelet e ndryshme leksikalizuese të identifikuar ndër gjuhë.

ajrit ose e erës). Krahas marrëdhënieve të Bashkëngjarjes Mënyrë-Shkak, në përputhje me qëllimin e këtij disertacioni, ne shqyrtoam edhe nëse foljet shprehin ndonjë marrëdhënie tjetër bashkëngjarjeje (Talmy, 2000b: 42-47). Duke qenë se foljet e lëvizjes natyrshëm shprehin përbërësin Lëvizje, ne qëllimisht e kemi shmangur përsëritjen e saj të vazhdueshme në të gjithë analizën e foljeve në tabelë.

Më tej, në kolonën e pestë, ne llogaritëm numrin e elementeve të kombinuara në çdo folje e lëvizjes. Për shembull, në qoftë se një folje shpreh Trajektores krahas Lëvizjes, atëherë ne e shenjojmë me '1'; në qoftë se një folje shpreh Trajektores dhe Mënyrën krahas Lëvizjes, atëherë ne e shenjojmë me '2', dhe kështu me radhë. Kolona e gjashtë pasqyron llojet e nocioneve të Trajektores dhe llojet e Trajektores, nëse ka, të shprehura prej foljeve të lëvizjes, dhe kolona e shtatë pasqyron hollësitë apo kategoritë e imta të Mënyrës.

Për sa i përket përbërësit të Trajektores së lëvizjes, janë marrë parasysh nocionet e mëposhtme:

- 'Vektori': i referohet largimit (from / nga), kapërcimit (via, along / përgjatë, përmes) ose mbërritjes (toward / drejt) të një Figure në lidhje me Terrenin.
- 'Konformiteti': lidhet me gjeometrinë e Terrenit, nëse ai është një enë (into, out of / brenda në, jashtë nga), një sipërfaqe (onto / përmbi), etj.
- 'Këndvështrimi: drejtimi për tek ose larg nga folësi; p.sh., *come, go / vij, shkoj*
- 'Orientimi lidhur me tokën'⁵: orientimi lart-poshtë, veri-jug-lindje-perëndim, etj.

Të gjitha këto nocione të trajektores mund të shprehen nga llojet e trajektores që renditen më pas:

- Llojet e Trajektores:
 - ✓ Drejt/në drejtim të Terrenit (vendmbërritje, pikë fundore): *reach, arrive / arrij, mbërrij*
 - ✓ Larg nga Terreni (largim, burim): *abandon, depart / braktis, largohem*
 - ✓ Brenda në / në Terren (enë): *enter, immigrate / hyj, imigroj*
 - ✓ Jashtë nga Terreni (enë): *exit / dal*
 - ✓ Përmbi / mbi – Përpjetë Terrenit / lart: *embark, mount, scale / hipi, ngjitem*
 - ✓ Poshtë / poshtë nga Terreni: *descend, sink, fall / zbres, mbytem, bie*
 - ✓ Përmes/përgjatë Terrenit (kapërcim): *traverse, pass, cross / kaloj, kapërcej, kaptoj*
 - ✓ Përpara: *advance / përparoj*

⁵Slobin ia shton këtë dallim të katërt nënkomponentëve të Trajektores së Talmy (Vektori, Konformiteti dhe Këndvështrimi). Nocioni 'Orientimi lidhur me tokën' ka rezultuar i dobishëm për foljet e mënyrës që tregojnë lëvizje të brendshme me një orientim të veçantë, siç janë foljet e qëndrimit.

- ✓ Prapsh tek / sërish në Terren: *back/kthehem, rikthehem*
- ✓ Ndryshim drejtimi: *swerve / dredhoj*
- ✓ Drejtime të shumëfishta nga një pikënisje e vetme: *scatter / shpërndaj*
- ✓ Mbas Terrenit: *follow / ndjek*

Nga ana tjetër, për sa i përket përbërësit të Mënyrës, më poshtë po propozojmë kategoritë më të imta të mënyrës që kanë rëndësi për analizën tonë:

- ‘Qëndrimi’:
 - ✓ Orientim vertikal (lart ose poshtë): *lie, crouch / drejtohem, përkulem*
 - ✓ Orientim horizontal: *lie down / shtrihem*
 - ✓ Orientim i papërcaktuar: *stretch / shtriqem*
 - ✓ Përkul, Përdredh, Kthej: *slouch, twist / përdredh, përkul,*
 - ✓ Në një anë: *careen, dodge / anoj, batoj*
- ‘Tund, lëkund, dredh’⁶: *tremble, sway / dridhem, përkund*
- ‘Rrotulloj, qarkulloj, vërtis’⁷: *roll, spin, twirl, turn / rrotulloj, shtjelloj, kthej*
- ‘Hidhem’: *hidhem*
- ‘Kokëposhtë’: *capsize, flip / përmbys, kapërdihem*
- ‘Lëvizje përsëritëse’: *bob, rebound* (lëvizje përsëritëse lart-poshtë)

Këto kategori të mënyrës kanë të bëjnë kryesisht me mënyrën e foljeve që përshkruajnë lëvizje të brendshme, ndërsa kategoritë e mëposhtme janë të lidhura me foljet që nënkuptojnë lëvizje zhvendosëse (dmth., mënyra të tilla lëvizjeje duket se ekzistojnë vetëm gjatë lëvizjes zhvendosëse të Figurës):

- ‘Forma e Trajektores’⁸:
 - ✓ Trajektore Zigzage ose e lakuar: *zigzag, gjarpëroj*
- Modeli motor (mm): aftësi themelore e lëvizjes për njerëzit dhe kafshët. Trupi merr pozicione të ndryshme gjatë kryerjes së çdo lëvizjeje:
 - ✓ Mënyra të të ecurit (mm-eci)
 - ✓ Mënyra të të vrapuarit (mm-vrapoj)
 - ✓ Mënyra të të hedhurit (mm-hidhem)
 - ✓ Mënyra të të fluturuarit (mm-fluturoj)
 - ✓ Mënyra të të notuarit (mm-notoj)

⁶Në këtë kategori përfshihen edhe ‘Lëvizjet e shkurtra dhe të papritura’.

⁷Siç theksohet nga Levin & Rappaport-Hovav (1992), Levin (1993) dhe Morimoto (2001), foljet e kësaj kategorie mund të gjenden edhe në lëvizjen zhvendosëse.

⁸Siç nënvizuar në Kapitullin 4, ‘Forma e Trajektores’ zakonisht është konsideruar si parametër mënyre.

‘Ritmi’: shpejtësia e lëvizjes; p.sh., *hurry, dash, sprint / nxitoj, shpejtoj, përshpejtoj*

- ‘Lëvizje e sforcuar’⁹: lëvizja kërkon një përpjekje për t’u kryer: *lunge, plunge, thrust, plod, trudge, wade / zvarritem, kacavarem*
- ‘Lëvizje e fshehtë’: qëllim i fshehur ose lëvizje e fshehtë, për të mos u vënë re ose dëgjuar; p.sh. *crawl, creep, sneak / fshihem, vidhem, strukem*
- ‘Lëvizje e penguar’: ka një farë pengese në kryerjen e lëvizjes; p.sh., *stumble / pengohem, ngatërrohem*
- ‘Lëvizje e butë’: lëvizja rrjedh lirshëm, nuk ka pengesa; p.sh., *glide, slide / pluskon, rrejdhe*
- ‘Lëvizje e ngeshme’: lëvizje për kënaqësi; p.sh., *hike, trek /*
- ‘Lëvizje e paqëllimtë’: lëvizje pa ndonjë qëllim të veçantë; p.sh., *roam*
- ‘Lëvizje e paqëndrueshme’¹⁰: lëvizje e pabalancuar; p.sh., *totter, stagger*
- ‘Gjendja e Figurës’: gjendja fizike (p.sh., i/e plagosur) ose psikologjike (p.sh., krenar, i shkujdesur, i zemëruar); p.sh., *stroll*
- ‘Vallëzim’: mënyra të ndryshme të të vallëzuarit, p.sh., *foxtrot, waltz*
- ‘Mjet / Instrument’: lëvizje me anën e një kafshe (p.sh., *trot, gallop / galopoj*) ose me anën e një mjeti (p.sh., makinë (p.sh., *drive / ngas, drejtoj*3), anije, aeroplan, patina, biçikletë, etj)
- ‘Kontakti midis Figurës dhe Terrenit’: *creep, grovel / zvarritem, zhgërryhem*
- ‘Përdorimi karakteristik i pjesës së poshtme të trupit’: *stride, goosestep*
- ‘Përdorimi i duarve/këmbëve’: nëse në lëvizje përfshihen edhe duart e Figurës; p.sh., *crawl, climb, vault / zvarritem, kacavarem*
- ‘Lëvizje në rresht’: *parad / parakaloj*
- ‘Lëvizje në sport’: *dribble / dribloj*
- ‘Lëvizje e gëzueshme/lozonjare’: p.sh., *lodroj, loz*
- ‘Lëvizje e pakontrolluar’: lëvizje pa kontroll; p.sh., *careen, skid*
- ‘Lëvizje e ngathët’: *shamble*
- ‘Lëvizje e zhurmshme’: mënyrë e zhurmshme e lëvizjes; p.sh., *roar, shuffle, stamp / trokëllis, përpjek, përplas*

Siç e kemi parë në Kapitullin 3, kategoritë e mënyrës që kemi përdorur për

⁹Kategoria e mënyrës ‘Lëvizjes e dhunshme’ (p.sh., *charge, plunge*) është përfshirë tek ‘Lëvizja e sforcuar’ pasi duket se të gjitha foljet që tregojnë lëvizje të dhunshme shprehin edhe lëvizje të sforcuar.

¹⁰Në dritën e të dhënave tona, kjo kategori e mënyrës duket se i përket si lëvizjes së brendshme ashtu edhe lëvizjes zhvendosëse.

klasifikimin tonë janë nxjerrë nga Ibarretxe-Antuñano (2006a), Özçaliskan (2004) dhe Slobin (2000).

Kur shqyrtoam llojet e përbërësve semantikë të shprehur tek foljet, ne i bazuam vendimet tona, para së gjithash, në përkufizimet e marra nga fjalorët e cituar më lart. ‘Ka një marrëveshje të përgjithshme për principet themelore që duhen ndjekur lidhur me studimet për njohjen e fjalës. Një kontekst tipik sintaksor është i rrallë. Si rregull ndikimi vjen nga faktorë të kombinuar të sintaksës, leksikut dhe ndonjëherë nga faktorët morfologjikë’ (Stefanllari, 2011). Për qëllimet tona studimore ishin me interes vetëm përkufizimet fjalësore të lëvizjes fizike ose aktuale, duke lënë mënjanë lëvizjen fiktive (p.sh., Talmy, 2000a: 90; Langacker, 1987, Matsumoto, 1996; Rojo & Valenzuela, 2003) dhe kuptimet metaforike (p.sh., Özçaliskan, 2002 2004). Për foljet që kanë kuptime të shumta jo të ngjashme (p.sh., shprehin informacion të ndryshëm semantik) janë krijuar hyrje të veçanta të ndara me numra. Për shembull, folja *drejtoj* ka dy kuptime të veçanta: *drejtoj1* ka kuptimin ‘ngas një automjet ose aeroplan’ dhe *drejtoj2* ka kuptimin ‘i tregoj rrugën dikujt, udhërrëfj’

Kolonat tetë dhe nëntë përfshijnë përkufizimet e foljeve të marra nga fjalorë njëgjuhësh dhe thesarë për gjuhën angleze dhe shqipe të cilat janë përdorur gjatë përpilimit të korpusit tonë të foljeve të lëvizjes. Për më tepër, në këto kolona përfshihet edhe sjellja sintaksore e nxjerrë nga fjalorët, domethënë, nëse foljet janë jokalimtare apo kalimtare.

4.2.4. Disa probleme dhe kufizime

Metodologjia e studimit përballet me disa probleme të cilat duhen trajtuar para se të nisim punën tonë. Siç kemi theksuar në seksionin e mëparshëm, fjalorët jo gjithmonë përputhen në përkufizimet e tyre për foljet e lëvizjes dhe në llojet e hollësive që ato përfshijnë. Për pasojë, në analizën tonë kemi vendosur të marrim në konsideratë ato hollësi të imta dhe ato kuptime të foljes që ishin të pranishme në shumicën e fjalorëve në mënyrë që të pasqyrohet sa më saktë kontributi semantik i vetë foljes.

Një problem tjetër që hasëm është vështirësia për të dalluar (a) atë që *shpreh ose leksikalizon* një folje e lëvizjes dhe (b) atë që thjesht *nënkuptohet*, që lidhet me njohuritë tona gjuhësore për mënyrën se si përdoret një folje e lëvizjes dhe me interpretimin tonë semantik. Shumë shpesh, përkufizimet e fjalorëve përfshijnë informacion në lidhje me llojet e Figurave (të gjalla, jo të gjalla), llojet e Terreneve (ajri, uji, etj.), mënyrat e lëvizjes (ritmi, modeli motor) dhe trajektoret (lart, poshtë, etj.) të cilat zakonisht shoqërohen me foljet e lëvizjes, por

ky informacion jo domosdoshmërisht na jep atë që shprehet ose leksikalizohet tek foljet. Për ilustrim, *dodder* dhe *toddle* janë folje të mënyrës të cilat shprehin mënyra të paqëndrueshme të të ecurit; e para duket se nënkupton që Figura është zakonisht një person i moshuar, ndërsa e fundit nënkupton që Figura është zakonisht një foshnje. Megjithatë, këto folje mund të përdoren me Figura që nuk janë as pleq as foshnje. Një tjetër shembull i mirë është folja *dive*; kjo folje duket se shpreh një lëvizje me kokëposhtë, që zakonisht ndodh në ujë, por jo domosdoshmërisht. Për të zgjidhur këtë problem, ne kemi tentuar të kapim dhe të kodojmë atë informacion semantik për lëvizjen i cili mbahet konstant në të gjithë kuptimet, pavarësisht Figurave, Terreneve, Mënyrave dhe Trajektoreve të preferuara. Kështu, *dodder* dhe *toddle* analizohen si folje që kombinojnë Lëvizjen dhe Mënyrën por jo informacionin për Figurën; në rastin e *dive*, Terreni (uji) nuk merret si i kombinuar te folja.

Së fundi, siç mund të mendojë edhe lexuesi, metodologjia jonë ka një kufizim kryesor: kodimi ynë semantik nuk barazohet me atë që mund ose mund të mos jetë në përfaqësimet mendore të folësve të këtyre gjuhëve lidhur me këto folje. Ne nuk synojmë në asnjë mënyrë të argumentojmë të kundërtën. Rezultatet e analizës sonë kërkojnë studime eksperimentale për të testuar realitetin e tyre psikogjuhësor. Në tërësi, analiza semantike e leksikut të foljeve të lëvizjes në gjuhët angleze dhe shqipe ofron një bazë të shëndoshë gjuhësore për studime të mëtejshme eksperimentale; rezultatet tona ngrenë disa pyetje lidhur atë që mund ose mund të mos jetë në mendjen e folësit. Natyrisht, vlerësimi i plotë psikogjuhësor i gjetjeve tona është jashtë kufijve të këtij disertacioni, i cili, në kapitullin 5, vetëm eksploron nënfushën e lëvizjes së njeriut nga një këndvështrim psikogjuhësor duke përdorur metoda eksperimentale.

4.3. Shpërndarja e përgjithshme: kombinimet foljore

Ky seksion i jep përgjigje pyetjes sonë të parë kërkimore, në mënyrë specifike, *Cilat nocione semantike shprehen në foljet e lëvizjes në anglisht dhe shqip?* Aty përshkruhen plotësisht llojet e ndryshme të kombinimeve të gjetura në korpusin tonë. Siç do të shohim, krahas foljeve të trajektoreve dhe foljeve të mënyrës, janë gjetur edhe modele të tjera, edhe pse ato përbëjnë modele më të vogla në të dy gjuhët.

Foljet e lëvizjes kanë grupuar duke marrë parasysh (a) numrin e përbërësve semantikë të leksikalizuar në çdo folje, dhe (b) informacionin semantik të shprehur prej tyre. Për sa i përket numrit të përbërësve semantikë, foljet e lëvizjes ndahen kryesisht në 4 grupe: (1)

Lëvizje, (2) Lëvizje + 1 përbërës semantik, (3) Lëvizje + 2 përbërës semantikë, dhe (4) Lëvizje + 3 përbërës semantikë. Për sa i përket informacionit semantik të shprehur nga foljet që gjenden në korpusin tonë të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip janë gjetur kombinimet foljore të mëposhtme:

- a. Lëvizje
- b. Lëvizje + Terren
- c. Lëvizje + Figurë
- d. Lëvizje + Trajektore
- e. Lëvizje + Mënyrë
- f. Lëvizje + Shkak
- g. Lëvizje + Rezultati njëkohshëm
- h. Lëvizje + Trajektore + Terren
- i. Lëvizje + Mënyrë + Terren
- j. Lëvizje + Trajektore + Mënyrë
- k. Lëvizje + Figurë+Mënyrë
- l. Lëvizje + Shkak + Mënyrë
- m. Lëvizje + Shkak + Trajektore
- n. Lëvizje + Figurë + Bashkëlëvizje
- o. Lëvizje + Mënyrë + Bashkëlëvizje
- p. Lëvizje + Mënyrë + Rezultat i njëkohshëm
- q. Lëvizje + Trajektore + Terren + Mënyrë
- r. Lëvizje + Shkak + Trajektore + Mënyrë

4.3.1. Kombinimet foljore të anglishtes

Tabela 4.1 përmbledh kombinimet e përgjithshme të gjetura në korpusin tonë të foljeve të lëvizjes në anglisht. Kombinimet foljore apo modelet leksikalizuese tek foljet janë grupuar sipas numrit të përbërësve semantikë. Pastaj, brenda secilit grup, ato janë organizuar sipas frekuencës së tyre të përgjithshme, nga llojet më të shpeshta të modeleve leksikalizuese tek më pak të shpeshtat.

NUMRI I PËRBËRËSVE	PËRBËRËSIT SEMANTIKE	#	%
1	Lëvizje	1	0.34%
	TOTAL	1	0.34%
2	Lëvizje + Mënyrë	203	68.35%
	Lëvizje + Trajektore	44	14.81%
	Lëvizje + Terren	4	1.35%
	Lëvizje + Figurë	2	0.67%
	Lëvizje + Rezultati i njëkohshëm	1	0.34%
	TOTAL	254	85.52%
3	Lëvizje + Trajektore + Mënyrë	20	6.73%
	Lëvizje + Figurë + Bashkëlëvizje	6	2.02%
	Lëvizje + Mënyrë + Terren	4	1.35%
	Lëvizje + Trajektore + Terren	4	1.35%
	Lëvizje + Figurë + Mënyrë	4	1.35%
	Lëvizje + Mënyrë + Bashkëlëvizje	1	0.34%
	TOTAL	39	13.13%
4	Lëvizje + Trajektore + Terren + Mënyrë	2	0.67%
	Lëvizje + Shkak + Trajektore + Mënyrë	1	0.34%
	TOTAL	3	1.01%
	TOTAL	297	100.0%

Tabela 4.1. Shpërndarja semantike e foljeve të lëvizjes në anglisht

Në korpusin tonë është gjetur vetëm një folje që shpreh përbërësin Lëvizje: *move*. *Move* është një folje e përgjithshme e lëvizjes e cila në fjalorë përkufizohet se përfshin edhe ndryshimin e qëndrimit (p.sh., lëvizje e brendshme) dhe ndryshimin e vendndodhjes (p.sh., lëvizje zhvendosëse).

Në lidhje me foljet që shprehin Lëvizje plus vetëm një përbërës semantik shtesë (që i përket ose ngjarjes kryesore të Lëvizjes ose Bashkëngjarjes), vihet re se dy modele leksikalizuese janë më të shpeshta në korpusin tonë, përkatësisht foljet që shprehin Trajektoren (14.81% e foljeve në korpusin tonë të anglishtes) dhe foljet që shprehin Mënyrën (68,35% e foljeve në korpusin tonë të anglishtes). Analizën shteruese të këtyre foljeve do ta shtyjme përkatësisht për në seksionet 4.4 dhe 4.5, ku do të futemi më thellë në semantikën e tyre duke i analizuar ato sipas përbërësve më të imët. Krahës këtyre dy modeleve leksikalizuese foljore, janë vërejtur edhe modelet më të vogla në vijim:

- a. Lëvizje + Terren: (4 folje) *fly*, *hover*, *circuit*, *circulate*

Foljet *circulate* dhe *circuit* tregojnë lëvizje në/përmes/rreth një qarku. Kështu, këto

folje mund të analizohen se shprehin informacion për formën e trajektores së ndjekur gjatë lëvizjes. Nga ana tjetër, foljet *fly* dhe *hover* tregojnë lëvizje në ajër; megjithatë, këto folje ndryshojnë nga lloji i lëvizjes të cilës i referohen. Më konkretisht, *fly* nënkupton lëvizje zhvendosëse ndërsa *hover* do të thotë ‘të qëndrosh pezull në ajër’ dhe, pra, nuk nënkupton lëvizje zhvendosëse.

b. Lëvizje + Figurë: (2 folje) *kick*, *nod*.

Këto folje tregojnë se lëviz një pjesë e caktuar e trupit, në veçanti, këmba ose këmbët e Figurës në rastin e *kick*, dhe koka e Figurës në rastin e *nod*.

c. Lëvizje + Rezultat¹¹ i njëkohshëm: (1 folje) *crash*.

Kjo folje tregon lëvizje, rezultati i të cilës është përplasja e Figurës në/me Terren/in.

Për sa i përket foljeve që krahas Lëvizjes kombinojnë edhe dy përbërës semantikë, janë gjetur modelet e mëposhtme:

a. Lëvizje + Trajektore + Mënyrë: (20 folje) *charge*, *chase*, *climb*, *dive*, *lunge*, *plummet*, *plunge*, *pounce*, *rocket*², *scram*, *skedaddle*, *slink*, *soar*, *stalk*¹, *stampede*, *tail*, *thrust*, *track*, *trail*, *tumble*.

Në përgjithësi, ky grup foljesh tregon informacion për trajektoren apo drejtimin e lëvizjes, si dhe për mënyrat në të cilat lëviz Figura¹². *Charge*, *lunge*, *plunge* dhe *pounce* tregojnë lëvizje të papritur drejt Terrenit, zakonisht në mënyrë të imponuar, të dhunshme dhe me një shpejtësi të madhe. Foljet *plunge* dhe *lunge* mund të shfaqin sjellje veprorë. *Thrust* tregon lëvizje të mundimshme përpara. *Chase*, *stalk*¹, *tail*, *track* dhe *trail* tregojnë se Figura është duke lëvizur pas një Figure tjetër; *chase* tregon se lëvizja është e shpejtë, zakonisht me vrap, ndërsa *stalk*¹, *tail* dhe *track* tregojnë se Figura ndjek Figurën tjetër fshehurazi, në

¹¹Për kujtesë, ‘Rezultati i njëkohshëm’ është një nga llojet e marrëdhënieve që mund të ndodhin midis ngjarjes kryesore të Lëvizjes dhe Bashkëngjarjes. Sipas Talmy, ‘Bashkëngjarja rezulton nga – dmth., shkaktohet nga – ngjarja kryesore e Lëvizjes ose përndryshe nuk do të ndodhte’ (2000b: 49).

¹²Ky grup foljesh është nga më interesantët për studime të mëtejshme në të ardhmen. Në Kapitullin 3, argumentuam se për shumë folje nuk është e qartë nëse shprehin vetëm Mënyrën ndërsa Trajektoren thjesht e nënkuptojnë, pasi këto folje zakonisht ndodhin me trajektore të caktuara. Detyrat emërtuese dhe tipizuese duke përdorur nxitës pamorë dinamikë me trajektore të ndryshuara dhe mënyra të ndryshuara mund të ndihmonin për të zbuluar natyrën semantike të këtij grupi foljesh. Për shembull, a do të emërtohej një ngjarje me foljen *dive* apo, a do të gjykohej ajo ngjarje si tipike e *diving* nëse (a) Figura nuk lëviz në mënyrë të shpejtë dhe shumë energjike dhe (b) nëse Figura nuk ndjek një trajektore me drejtim poshtë?

mënyrë të fshehtë. Së fundi, *trail* tregon se Figura është duke lëvizur ngadalë prapa apo pas Figurës tjetër, zakonisht në kontakt me Terrenin. *Scram*, *slink*, *skedaddle* dhe *stampede* tregojnë se Figura është duke lëvizur larg nga Terreni; *scram* dhe *skedaddle* tregojnë se Figura largohet me shpejtësi të madhe, ndërsa *slink* tregon se Figura lëviz vjedhurazi që të mos vihet re. Tek *stampede*, Figura largohet shpejt sepse është i/e frikësuar.

Në lidhje me boshtin vertikal, dmth, lëvizje me drejtim lart dhe poshtë, *dive* do të thotë të lëvizësh me rrëmbim kokëposhtë në ujë ose në Terren tjetër. *Plummet* dhe *tumble* tregojnë lëvizje me drejtim poshtë; e para kryhet me shpejtësi të madhe, dhe e fundit karakterizohet nga rënia poshtë shpejt dhe pa kontroll. *Rocket2* dhe *soar* përshkruajnë lëvizje të shpejtë përpjetë, ndërsa *climb* tregon se Figura lëviz lart, mbi Terren në mënyrë kacavjerrëse, dmth, përdorim i duarve dhe këmbëve. Siç vërente Jackendoff (1985: 279), *climb* i shpreh të dyja, edhe Trajektoren (lëvizje përpjetë, drejt majës së) edhe Mënyrën (kacavjerrëse), por ‘në raste të veçanta secila prej tyre mund të mungojë’. Kështu, secila nga keto dy veçori semantike mjafton që një ngjarje të emërtohet si ngjitje.

- b. Lëvizje + Figurë + Bashkëlëvizje¹³: (6 folje) *accompany*, *conduct*, *convoy*, *escort*, *guide*, *lead*,

Këto folje i përkasin foljeve të shoqërimit sipas Levin (1993). Ato e përshkruajnë Bashkëlëvizjen sikur një person (Figura) çon një person të dytë nga një vend në tjetrin, duke nënkuptuar lëvizje zhvendosëse. Levin e përfshin foljen *convoy* tek foljet e Mjeteve; megjithatë, sipas fjalorëve, kjo folje nuk shpreh një mjet të veçantë, por një grup mjetesësh ose njerëzish që udhëtojnë së bashku.

- c. Lëvizje + Mënyrë + Terren: (4 folje) *paddle1*, *swim*, *wade*, *waft*

Paddle1, *swim* dhe *wade* tregojnë mënyra të veçanta të lëvizjes në ujë [Terreni]. *Swim* është më e përgjithshme në kuptim pasi ajo vetëm tregon se Figura mban një pozicion të caktuar të trupit për të kryer një veprim të tillë; ky pozicion i trupit varet nga veçoritë trupore të Figurës. *Paddle1* është fjala amerikane për fjalën britanike *wade*, por ato nuk përkufizohen në të njëjtën mënyrë. *Wade* tregon ecje në ujë me një farë vështirësie, ndërsa fjalorët shprehen se *paddle1* tregon lëvizje lozonjare në ujë. *Waft* tregon lëvizje të butë përmes ajrit [Terreni], e cila mund të jetë lëvizje joveprore dhe veprore.

¹³Talmy nuk e përfshin këtë lloj marrëdhënieje të Bashkëngjarjes në teorinë e tij. Në dritën e të dhënave tona, ne vendosëm të krijojmë kategorinë Bashkëlëvizje për t’iu referuar atyre Bashkëngjarjeve në të cilat lëvizin një ose më shumë Figura.

d. Lëvizje +Trajektore + Terren: (4 folje) *disembark, embark, emigrate, immigrate*

Sipas Merriam-Webster Online dhe Oxford English Dictionary, të gjitha këto folje në përgjithësi përbëhen nga një parashtesë që shpreh trajektoren e lëvizjes plus një emër (barca ‘anije’) ose një tjetër folje (migrare ‘të ndryshosh vendbanimin e dikujt, të shkosh nga një vend në tjetrin’). Kështu, foljet *disembark* dhe *embark* tregojnë, përkatësisht, ‘të lësh/të zbresësh nga një anije dhe të hipësh në një anije’ [Terreni]. *Emigrate* dhe *immigrate* tregojnë përkatësisht lëvizje larg nga një vend [Terreni] dhe lëvizje tek një vend tjetër.

e. Lëvizje + Figurë+ Mënyrë: (4 folje) *trample, tread, stamp, step*

Ky grup foljesh tregon lëvizjen e pjesëve të trupit (këmbës dhe/ose këmbëve) në mënyra të veçanta. Sipas fjalorëve, *trample, tread* dhe *step* tregojnë ose nënkuptojnë se Figura është duke ecur gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, ndërsa në rastin e foljes *stamp* Figura nuk është domosdoshmërisht duke ecur. *Stamp* duket se shton edhe informacion lidhur me gjendjen e zemëruar të Figurës. Për më tepër, *trample, stamp* dhe *tread* tregojnë një lloj lëvizjeje të fortë dhe të dhunshme kur këmbët e dikujt vendosen përmbi diçka, gjë që në këtë mënyrë mund të shkaktojë dëm, si në rastin e *trample*. Në të kundërt, *step* duket se i referohet veprimit të të lëvizurit duke ngritur këmbën apo këmbët dhe duke i/e ulur atë/ato përsëri, dmth, të shkosh në këmbë ose të ecësh; në këtë mënyrë, mund të thuhet se *step* ka kuptim më të përgjithshëm se *trample, stamp* dhe *tread*.

f. Lëvizje + Mënyrë + Bashkëlëvizje: (1 folje) *outrun*

Kjo folje do të thotë se Figura vrapon më larg ose më shpejt [Mënyra] se një Figurë tjetër që është duke lëvizur në të njëjtën kohë [Bashkëlëvizje].

Së fundi, janë gjetur katër folje në dy lloje të ndryshme kombinimesh të cilat krahas faktit të Lëvizjes shprehin edhe tre përbërës të tjerë semantikë:

a. Lëvizje + Trajektore + Terren + Mënyrë: (2 folje) *skydive, ford*

Skydive i referohet veprimit të një personi që hidhet [Mënyra] nga një avion dhe bie poshtë, [Trajektore] përmes ajrit [Terreni] për aq kohë sa mundet para se të hapë parashutën. Ndërsa folja *ford* do të thotë të kalosh/kapërcesh [Trajektore] një masë uji [Terreni] duke ecur në këmbë [Mënyra] me një farë vështirësie.

b. Lëvizje + Shkak + Trajektore + Mënyrë: (1 folje) *flee*

Kjo folje mund të tregojë një shkak fizik apo jo-fizik që është origjina e ngjarjes së Lëvizjes; kështu, kjo folje do të thotë se Figura vrapon në çfarëdo drejtimi larg nga Terreni (rreziku).

4.3.2. Kombinimet foljore të shqipes

Tabela 4.2 përmbledh kombinimet e përgjithshme foljore që gjenden në korpusin e foljeve të lëvizjes në gjuhën shqipe. Kombinimet foljore grupohen sipas numrit të përbërësve semantikë (dmth., një, dy, tre ose katër), dhe brenda secilit grup ato renditen siaps frekuencës.

NUMRI I PËRBËRËSVE	PËRBËRËSIT SEMANTIKE	#	%
1	Lëvizje	3	1.03%
	TOTAL	3	1.03%
2	Lëvizje + Mënyrë	148	51.03%
	Lëvizje + Trajektore	89	30.69%
	Lëvizje + Terren	2	0.69%
	Lëvizje + Figurë	4	1.38%
	Lëvizje + Rezultati i njëkohshëm	3	1.03%
	TOTAL	246	84.83%
3	Lëvizje + Trajektore + Mënyrë	18	6.21%
	Lëvizje + Trajektore + Terren	6	2.07%
	Lëvizje + Mënyrë + Terren	5	1.72%
	Lëvizje + Figurë + Bashkëlëvizje	5	1.72%
	Lëvizje + Figurë + Mënyrë	3	1.03%
	Lëvizje + Mënyrë + Bashkëlëvizje	2	0.69%
	TOTAL	39	13.45%
4	Lëvizje+ Trajektore + Terren + Mënyrë	1	0.34%
	Lëvizje+ Shkak + Trajektore + Mënyrë	1	0.34%
	TOTAL	2	0.69%
TOTAL		290	100%

Tabela 4.2. Shpërndarja semantike e foljeve të lëvizjes në shqip

Në korpusin tonë janë gjetur dy folje që shprehin vetëm një përbërës: Lëvizjen: *lëviz* ‘nuk rri në gjendje të qetë, ndryshon qëndrimin a vendin’, *zhvendos* ‘lëviz dikë a diçka nga vendi ku ishte dhe e çoj në një vend tjetër’. *Lëviz*, ashtu si edhe anglishtja *move*, është një folje e përgjithshme e lëvizjes e cila në fjalorë përkufizohet se përfshin edhe ndryshimin e qëndrimit (dmth., lëvizje e brendshme) edhe ndryshimin e vendndodhjes (dmth., lëvizje zhvendosëse).

Në dallim nga *lëviz*, folja *zhvendosem* duket se shpreh lëvizje zhvendosëse, dmth, Figura lëviz nga një vend në një tjetër. Mund të thuhet se kjo folje shpreh/nënkupton lëvizje larg nga Terreni, dmth, Figura largohet nga një vendndodhje e mëparshme për të shkuar në një vendndodhje tjetër.

Për sa i përket kombinimeve foljore të Lëvizjes me një përbërës semantik shtesë, foljet që kombinojnë lëvizjen me trajektoren dhe lëvizjen me mënyrën janë më të shpeshta në korpusin tonë të shqipes dhe të anglishtes. Siç kemi vërejtur tek anglishtja, krahas këtyre dy modeleve mbizotëruese, edhe foljet e shqipes shprehin disa modele më të vogla të cilat po i rendisim më poshtë:

a. Lëvizje + Terren: (2 folje) *fluturoj*, *qarkulloj*.

Folja *fluturoj* shpreh lëvizje në ajër dhe përdoret si për qëniet e gjalla edhe për objektet e pajetë, prandaj mënyra e lëvizjes përcaktohet nga Figura, Kjo është arsyeja përse kjo folje nuk është klasifikuar si folje e mënyrës. Nga ana tjetër, *qarkulloj*¹⁷, tregon lëvizje në/rreth/përreth, një zone e cila nuk përcaktohet dhe për pasojë duhet shprehur qartë në ligjërim. Të dyja foljet shprehin lëvizje zhvendosëse.

b. Lëvizje + Figurë: (3 folje) *shkelmoj*, *grushtoj*, *dorëzoj*.

Foljet e lëvizjes të këtij grupi janë denominale dhe përmbajnë qartësisht pjesën e trupit [Figurën] të përfshirë në lëvizje. Për shembull, *shkelmoj* (*shkelm*) ose *grushtoj* (*grusht*) *dorëzoj* (*dorë*).

c. Lëvizje + Rezultat i njëkohshëm: (3 folje) *përplas*, *përppjek*, *karamboloj*, ‘ndeshem me vrull e me forcë me dikë a me diçka’.

Këto folje të lëvizjes kombinojnë rezultatin e ngjarjes së Lëvizjes, dmth, përplasia midis Figurës dhe Terrenit ndodh si rezultat i lëvizjes së Figurës. *Përplas*, *përppjek* dhe *karamboloj* mund të jenë vetvetore, joveprorë dhe veprorë.

Për sa i përket kombinimeve të Lëvizjes me dy përbërës të tjerë semantikë janë vërejtur modelet e mëposhtme:

a. Lëvizje + Trajektore + Mënyrë: (18 folje) *mësyj*, *sulmoj*, *vërsulem*, *vërvitem2*, *sulem*, *dyndem*, *ngulem*, *çaj*, *rras*, *shtyj*, *shporrem*, *zhdukem*, *shigjetoj*, *zhytem*, *precipitoj*, *ndjek*, *gjurmoj*, *gjëmoj*

Ky grup foljesh përcjell informacion jo vetëm për drejtimin ose trajektoren e lëvizjes por edhe për mënyrat e lëvizjes së figurës. Grupi i foljeve *mësyj*, *sulmoj*, *vërsulem*, *sulem dhe dyndem* krahas lëvizjes në drejtim të Terrenit shprehin edhe se kjo lëvizje është e menjëhershme, e shpejtë dhe e vrullshme. Foljet *mësyj* dhe *sulmoj* shfaqin edhe sjellje veprorë. Foljet *ngulem*, *çaj*, *rras dhe shtyj* tregojnë lëvizje të sforcuar në drejtime të ndryshme. Grupi i foljeve *ndjek*, *gjurmoj*, *gjëmoj* tregon se Figura lëviz pas një Figure tjetër. *Ndjek* dhe *gjurmoj* tregojnë fshehtësi në lëvizje ndërsa folja *gjëmoj* zakonisht tregon se Figura lëviz shpejt dhe me vrap. *Shporrem*, *zhdukem*, tregojnë se Figura largohet nga Terreni kryesisht me të keq apo detyrim.

Për sa i përket lëvizjes në boshtin vertikal me drejtim lart dhe poshtë, foljet *zhytem* dhe *precipitoj* tregojnë lëvizje të shpejtë me drejtim poshtë nga një vendndodhje më e lartë tek një më e ulët ku terreni mund të jetë ujë ose diçka tjetër, ndërsa folja *shigjetoj* përshkruan lëvizje shumë të shpejtë me drejtim lart.

b. Lëvizje + Trajektore + Terren: (6 folje) *zbarkoj*, *imigroj*, *emigroj*, *dëboj*, *përzë*, *degdis*.

Zbarkoj ‘zbres nga anija, nga aeroplani etj’, *emigroj*, *imigroj*, *mërgoj* ‘vij/shkoj e vendosem në një vend të huaj’, *dëboj*, *përzë*, *degdis*, *internoj*, ‘detyroj dikë të largohet nga një vend i caktuar’. Krahas Trajektores që tregon se Figura largohet nga vendi i vet, këto folje shprehin edhe Terrenin.

c. Lëvizje + Mënyrë + Terren: (5 folje) *llokoçis*, *pllaquris*, *llapaçis*, *notoj*, *pluskaj*,

Notoj është më semantikisht më e përgjithshme dhe shpreh se Figura lëviz në ujë në një mënyrë që varet nga lloji i Figurës. Ndërsa foljet *llokoçis*, *pllaquris*, *llapaçis* tregojnë lëvizje të zhurmshme të Figurës në ujë ose në baltë. Së fundi, folja *pluskaj* ‘qëndron sipër e tundet mbi ujë, në ajër etj., dhe nuk bie poshtë’ tregon lëvizje të butë në ujë ose ajër (Terreni). Ndërsa tre foljet e para mund të jenë edhe veprorë, folja *pluskaj* është vetvetore (p.sh. Shishja pluskonte drejt shpellës).

e. Lëvizje + Figurë + Bashkëlëvizje: (5 folje) *shoqëroj*, *përcjell*, *prij*, *pararend*, *paraprij*.

Shoqëroj, *përcjell*, ‘shkoj me një njeri deri në një vend, e përcjell deri në vendin ku duhet të shkojë’, *pararend*, *paraprij*, *prij* ‘i tregoj rrugën duke ecur përpara’. Këto folje tregojnë Bashkëlëvizje pasi Figura çon apo shoqëron një Figurë tjetër nga një vend tek tjetri. Prandaj ato tregojnë lëvizje zhvendosëse.

d. Lëvizje + Figurë + Mënyrë: (3 folje) *shkel*, *shtyp*, *çapit*

Shkel ‘vë këmbën mbi diçka dhe e ngjesh a e shtyp’, *shtyp* ‘i mëshoj diçkaje me dorë, me këmbë’ dhe *çapit* ‘eci me ngadalë ose rëndë, hedh hapat, hedh këmbët me ngadalë ose me vështirësi’. Ky grup foljesh tregon lëvizjen e këmbëve. Tek *shkel* Figura lëviz këmbën/këmbët dhe tek *shtyp* mund të lëvizë edhe duart edhe këmbët dhe në të dy rastet Figura jo domosdoshmërisht është duke ecur. Kështu, këto dy folje mund të shprehin të dy llojet e lëvizjes. Në rastin e foljes *çapit* Figura ecën rëndë e me vështirësi.

f. Lëvizje + Mënyrë + Bashkëlëvizje: (2 folje) *tejkaloj*, *parakaloj*²

Këto folje tregojnë se Figura vrapon ose lëviz më larg ose më shpejt [Mënyra] se një Figurë tjetër që është duke lëvizur në të njëjtën kohë [Bashkëlëvizje]. Figura mund të jetë njeri, kafshë ose mjet.

Së fundi, janë gjetur dy folje në dy lloje të ndryshme kombinimesh të cilat krahas faktit të Lëvizjes shprehin edhe tre përbërës të tjerë semantikë:

a. Lëvizje + Trajektore + Terren + Mënyrë: (1 folje) *parashutoj*

Parashutoj i referohet veprimit të një Figure që hidhet me shpejtësi [Mënyra] nga një avion dhe bie [me drejtim poshtë nga një lartësi, Trajektore] përmes ajrit [Terreni] me parashutë.

b. Lëvizje + Shkak + Trajektore + Mënyrë: (1 folje) *ia mbath*

Kjo folje mund të tregojë një rrezik [Shkaku], që është origjina e ngjarjes së Lëvizjes; kështu, kjo folje tregon se Figura vrapon [Mënyra] në çfarëdo drejtimi larg [Trajektorja] nga Terreni.

4.3.3. Diskutim dhe përfundime

NUMRI I PËRBËRËSVE	PËRBËRESIT SEMANTIKË	ANGLISHT		SHQIP	
		#	%	#	%
1	Lëvizje	1	0.34%	3	1.03%
	TOTAL	1	0.34%	3	1.03%
2	Lëvizje + Mënyrë	203	68.35%	148	51.03%
	Lëvizje + Trajektore	44	14.81%	89	30.69%
	Lëvizje + Terren	4	1.35%	2	0.69%
	Lëvizje + Figurë	2	0.67%	4	1.38%
	Lëvizje + Rezultati i njëkohshëm	1	0.34%	3	1.03%
	TOTAL	254	85.52%	246	84.83%
3	Lëvizje + Trajektore + Mënyrë	20	6.73%	18	6.21%
	Lëvizje + Trajektore + Terren	4	1.35%	6	2.07%
	Lëvizje + Mënyrë + Terren	4	1.35%	5	1.72%
	Lëvizje + Figurë + Bashkëlëvizje	6	2.02%	5	1.72%
	Lëvizje + Figurë + Mënyrë	4	1.35%	3	1.03%
	Lëvizje + Mënyrë + Bashkëlëvizje	1	0.34%	2	0.69%
	TOTAL	39	13.13%	39	13.45%
4	Lëvizje + Trajektore + Terren + Mënyrë	2	0.67%	1	0.34%
	Lëvizje + Shkak + Trajektore + Mënyrë	1	0.34%	1	0.34%
	TOTAL	3	1.01%	2	0.69%
TOTAL		297	100%	290	100%

Tabela 4.3. Shpërndarja semantike e foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip

Për sa i përket numrit të përbërësve të kombinuar, pjesa më e madhe e foljeve të lëvizjes në korpusin tonë (85.52% e foljeve të lëvizjes në anglisht dhe 84.83% e foljeve të lëvizjes në shqip) shprehin një përbërës semantik shtesë krahas faktit të Lëvizjes, ndërsa (a) foljet që shprehin vetëm Lëvizje (0,34% për anglishten dhe 1.03% për shqipen), (b) foljet që kombinojnë dy përbërës semantikë (13.13% për anglishten dhe 13.45% për shqipen), dhe (c) foljet që kombinojnë tre përbërës semantikë (1.01% për anglishten dhe 0,69% për shqipen) janë shumë më pak të përhapura. Për këtë arsye, mund të arrihet në përfundimin se kombinimi i Lëvizjes plus një përbërës semantik është veçoria më karakteristike dhe tipike e leksikëve të foljeve të lëvizjes në të dy gjuhët. Në të kundërt, foljet që shprehin vetëm Lëvizje dhe foljet që kombinojnë ose dy ose tre përbërës semantikë mund të thuhet se janë më pak përfaqësuese. Kjo mbështet vëzhgimin e Talmy (1985: 76) se ‘me sa duket, në një gjuhë sistemet kombinuere të llojit me shumë përbërës kurrë nuk formojnë një sistem kryesor për të shprehur Lëvizjen’.

Për sa i përket informacionit semantik që shprehin foljet e lëvizjes në anglisht dhe shqip, me pak përjashtime, në të dy gjuhët janë gjetur modele të ngjashme leksikalizuese. Foljet e lëvizjes në anglisht dhe shqip duket se janë në gjendje të shprehin një gamë të gjerë informacioni semantik që i përket si ngjarjes kryesore të Lëvizjes ashtu edhe Bashkëngjarjes (dmth, Mënyrë, Shkak, Bashkëngjarje, Rezultat i njëkohshëm, etj.). Shumica e modeleve leksikalizuese të evidentuara në korpusin tonë të foljeve të lëvizjes duket se përfshijnë modele më të vogla në këto gjuhë, që do të thotë, ato nuk janë karakteristike ose tipike as për anglishten as për shqipen. Me fjalë të tjera, marrëdhëniet Lëvizje+Figurë, Lëvizje+Terren, Lëvizje+Shkak dhe kombinimet më komplekse të Figurës, Terrenit dhe Bashkëngjarjeve, ekzistojnë si në anglisht edhe në shqip, por ato nuk duket se formojnë sistemin thelbësor për shprehjen e Lëvizjes në këto gjuhë. Megjithatë, siç tregohet në Tabelat 4.1 dhe 4.2, si foljet që kombinojnë Trajektores ashtu edhe foljet që kombinojnë Mënyrën janë më të shpeshtat në korpusin tonë dhe përfaqësojnë një pjesë të madhe të leksikut të foljeve të lëvizjes (në anglisht, 203 folje të mënyrës, dmth, 68,35% dhe 44 folje të trajektores ose 14.81% e foljeve të lëvizjes në anglisht, dhe në shqip, 148 folje të mënyrës, dmth, 51.03% dhe 89 folje të trajektores, ose 30.69% e foljeve të lëvizjes në shqip). Si rezultat, mund të thuhet se këto dy modele leksikalizuese janë karakteristike të anglishtes dhe shqipes. Në të dy gjuhët, foljet e mënyrës i tejkalojnë foljet e trajektores. Brenda llojeve të foljeve, foljet e mënyrës në anglisht i tejkalojnë foljet e mënyrës në shqip ($203 = 68,35\%$ përkundrejt 148 folje = 51.03%), por foljet e trajektores në shqip i tejkalojnë foljet e trajektores në anglisht (përkatësisht 89 folje = 30.69% përkundrejt 44 folje = 14.81%).

Një tjetër ngjashmëri që vihet re ndërmjet dy gjuhëve është edhe prirja e tyre për të shprehur Terrenin e lëvizjes tek foljet, ose të kombinuar vetëm me Lëvizjen ose me përbërës semantikë shtesë. Talmy (1985: 75-76; 2000b: 60-61) vë në dukje se Terreni nuk kombinohet vetvetiu me foljen e Lëvizjes për të formuar sistemin bazë për shprehjen e Lëvizjes në gjuhë dhe se kombinimet e këtij lloji ‘nuk mund as të formojnë ndonjë sistem më të vogël’. Ai spekuloi se shpjegimi mund të kërkohej tek koncepti i hierarkisë, dmth, modelet e ndryshme leksikalizuese duket ‘se renditen sipas mbizotërimit të tyre në gjuhët e botës, me kombinimin e Trajektores si më gjerësisht i përfaqësuar, më pas të Mënyrës/Shkakut, dhe më pak i përfaqësuar ai i Figurës’. Me sa duket, edhe kombinimi i Terrenit është një mundësi ndër gjuhë, por Talmy argumenton se ‘është shumë e pazakontë që ky kombinim ende nuk materializohet në asnjë gjuhë’ (Talmy, 2000b: 61). Megjithatë, të dhënat tona duket se sfidojnë vërejtjet e Talmy; anglishtja dhe shqipja kanë disa folje të lëvizjes që kombinojnë Terrenin. Edhe pse duket të jetë një model më i vogël në këto gjuhë

(4.82% në korpusin e foljeve të lëvizjes në shqip, dhe 4.71% në atë të anglishtes), prania e këtyre foljeve nuk duhet neglizhuar.

Tabela 4.4 përmban foljet që kombinojnë Terrenin në anglisht dhe shqip (të grupuara në katër modele të ndryshme), si dhe numrin e foljeve për secilin model dhe përqindjen e tyre të përgjithshme për secilën gjuhë në korpusin tonë të anglishtes dhe shqipes.

KOMBINIMET E TERRENIT	FOLJET E ANGLISHTES	#	FOLET E SHQIPES	#
Lëvizje+Terren	<i>circuit, circulate, fly, hover</i>	4	<i>fluturoj, qarkulloj.</i>	2
Lëvizje+Trajektore+Terren	<i>disembark, embark, emigrate, immigrate</i>	4	<i>zbarkoj, imigroj, emigroj, dëboj, përzë, degdis.</i>	6
Lëvizje+Mënyrë+Terren	<i>paddle, swim, wade, waft</i>	4	<i>llokoçis, pllaquris, llopaçis, notoj, pluskoj,</i>	5
Lëvizje+Trajektore+Mënyrë+Terren	<i>skydive, ford</i>	2	<i>parashutoj</i>	1
FOLJE TOTAL		14		14
PËRQINDJA E LEKSIKUT TË FOLJEVE TË LËVIZJES		4.71%		4.82%

Tabela 4.4. Foljet që kombinojnë Terrenin në anglisht dhe shqip

Duke vërejtur shpërndarjen e llojeve që kombinojnë Terrenin mund të thuhet se të dy gjuhët nuk ndryshojnë për nga mënyra si i shpërndajnë foljet e tyre në katër llojet e kombinimeve të Terrenit.

4.4. Foljet e trajektore

Në këtë seksion, do të përpiqemi t'i japim përgjigje pyetjes së përgjithshme studimore: *A kanë anglishtja dhe shqipja leksikë të krahasueshëm foljesh të trajektore.* Ajo zbërthehet në dy pyetje të mëtejshme: *A janë të dy leksikët e trajektore të krahasueshëm në numrin e foljeve? Dhe a janë të dy leksikët e trajektore të krahasueshëm në natyrën e tyre semantike?* E para kërkon të dhëna sasiore dhe deri diku ka marrë përgjigje në seksionin e mëparshëm; në mënyrë specifike, siç tregohet në shpërndarjen e përgjithshme të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip në korpusin tonë, ku janë identifikuar 89 folje të trajektore në shqip përkundërt 44 folje të trajektore në anglisht. Rrjedhimisht, duket se leksiku i foljeve të trajektore në shqip është më i madh dhe në këtë mënyrë, mund të jetë edhe më i pasur apo

i shumëllojshëm se leksiku i foljeve të trajektores në anglisht. Megjithatë, nevojiten të dhëna cilësore para se të mund të nxirret një përfundim i tillë. Mund të rastisë që të dy gjuhët të shprehin lloje të ngjashme nocionesh të trajektores tek foljet e tyre, por shqipja mund të ketë një numër më të madh foljesh që shprehin këto nocione. Mundësia tjetër është që foljet e shqipes të shprehin lloje të trajektores të cilat nuk gjenden tek foljet e anglishtes, duke sugjeruar në këtë mënyrë, që leksiku i foljeve të trajektores në shqip është më i madh në madhësi dhe më i larmishëm në nocionet e trajektores që shprehin foljet e saj. Kjo na çon në pyetjen e fundit studimore: *A janë të dy leksikët e trajektores të krahasueshëm në natyrën e tyre semantike?* Kjo kërkon një analizë cilësore në mënyrë që të evidentohen (a) llojet e nocioneve të trajektores që zakonisht leksikalizohen në anglisht dhe shqip, dhe (b) ngjashmëritë e dallimet ndërgjuhësore në semantikën e foljeve të trajektores. Prandaj, ky seksion përqendrohet kryesisht tek natyra semantike e foljeve të trajektores në anglisht dhe në shqip.

Foljet e trajektores ndër gjuhë grupohen sipas llojeve të trajektores që shprehin. Në përgjithësi, në korpusin tonë janë identifikuar 13 lloje të trajektores:

- Për tek / drejt Terrenit (vendmbrritje, pikë fundore)
- Larg nga Terreni (largim, burim)
- Brenda në / në Terren (enë)
- Jashtë nga / prej Terrenit (enë)
- Lart / mbi Terren – Përpjetë
- Poshtë / poshtë nga Terreni - Tatëpjetë
- Midis / përmes Terrenit (kapërcim, pikë referimi)
- Më afër Terrenit
- Përpara
- Prapsh tek / sërish në Terren
- Ndryshim drejtimi
- Drejtime të shumëfishta nga një fillim unik
- Pas / prapa Terrenit

Dy seksionet e mëposhtme do të fillojnë me shqyrtimin e llojeve të trajektores që leksikalizohen më shpesh tek foljet e trajektores në korpusin tonë të anglishtes dhe shqipes, më pas, do të kalohet tek ato që janë më pak të shpeshta.

4.4.1. Foljet e trajektores në anglisht

Tabela 4.5 përmbledh shpërndarjen e foljeve të trajektores në anglisht sipas llojeve të lartpërmendura të trajektores, të renditura sipas frekuencës së tyre në lidhje me leksikun e trajektores.

LLOJET E TRAJEKTORES	ANGLISHT	
	#	%
Larg nga Terreni	11	25.00%
Përmbi / mbi Terren – Përpjetë	5	11.36%
Pas / prapa Terrenit	4	9.09%
Ndryshim drejtimi	4	9.09%
Poshtë / Poshtë nga Terreni - Tatëpjetë	4	9.09%
Për tek / drejt Terrenit	4	9.09%
Prapsh tek / sërish në Terren	3	6.82%
Përmes / përgjatë Terrenit	3	6.82%
Brenda në / në Terren	2	4.55%
Më afër Terrenit	1	2.27%
Përpara	1	2.27%
Drejtime të shumëfishta	1	2.27%
Jashtë nga / prej Terrenit	1	2.27%
TOTAL	44	100%

Tabela 4.5. Shpërndarja e foljeve të trajektores në anglisht

Siç shihet në tabelë, në korpusin tonë të foljeve të anglishtes disa lloje të trajektores janë shumë më të shpeshta se të tjerët; për shembull, lloji ‘Larg nga Terreni’ është më i shpeshti dhe llojet ‘Jashtë nga Terreni’, ‘Më afër Terrenit’, ‘Përpara’ dhe ‘Drejtime të shumëfishta nga një fillim unik’ janë më pak të shpeshta. Për të shqyrtuar foljet e trajektores që shprehin këto lloje trajektoresh, do të fillojmë me llojet më të shpeshta të trajektores dhe përfundojmë me llojet më pak të shpeshta:

- a. Larg nga Terreni (largim, burim) (11 folje, 25% e foljeve të trajektores në anglisht): *go, abandon, depart, desert, dodge2, escape, leave, recede, retire, retreat, stray*.

Ky grup foljesh në përgjithësi tregon lëvizje larg/tutje nga Terreni. Kjo lëvizje zhvendosëse mund të nënkuptojë që (a) Figura e lë pas Terrenin (si kundrinor i drejtë), ndonjëherë e lë vetëm dhe në situatë të keqe (p.sh., *abandon, desert*); (b) Figura largohet nga Terreni në mënyrë që të jetë i/e lirë ose për të shmangur rrezikun (p.sh., *escape, retreat*); (c) Figura shmang Terrenin duke lëvizur shpejt në njërën anë (*dodge2*) dhe (d) Figura shkon

larg/tutje nga trajektorja e synuar (*stray*). Brenda këtij grupi, vetëm foljet *retire* dhe *retreat* duket se përdoren edhe si folje veprare.

Go, depart dhe *leave* janë më të përgjithshme në kuptim, pasi ato duket se i referohen lëvizjes së Figurës larg, pa implikime të mëtejshme. Sipas Oxford English Dictionary, *go* është folje jokallimtare e lëvizjes e cila ka 3 kuptime bazë: (a) Figura është duke lëvizur larg nga folësi apo nga pika në të cilën ai e vendos veten mendërisht; (b) Figura është duke shkuar drejt një vendi që nuk është i zënë nga folësi, dhe (c) Figura është duke ecur pa lidhje me pikën e tij të nisjes apo të mbrritjes. Kështu, folja *go* në (a) dhe (b) është folje këndvështrimore e trajektores pasi shpreh lëvizje larg nga pozicioni relativ i folësit dhe duket se nënkupton lëvizje ‘për tek / drejt një vendi tjetër’. Në të kundërt, *go* në (c) duket se vepron si folje e përgjithshme e lëvizjes pa ndonjë trajektore të veçantë.

- b. Përmbi / mbi Terren - Përpjetë (5 folje, 11.36% e foljeve të trajektores në anglisht): *arise2, ascend, mount, rise¹, scale*.

Arise2, ascend dhe *rise1* tregojnë lëvizje lart në lidhje me tokën. *Mount* mund të tregojë ngritje dhe lëvizje me drejtim lart, por edhe lëvizje përmbi Terren. Nga ana tjetër, *scale* duket se tregon thjesht lëvizje lart, përmbi Terren.

- c. Pas / prapa Terrenit¹⁴ (4 folje, 9.09%): *follow, hound, pursue, shadow*.

Këto folje tregojnë se Figura është duke lëvizur prapa apo pas një Figure tjetër. Përveç *follow*, e cila duket se tregon vetëm trajektoren, *hound, pursue* dhe *shadow* nënkuptojnë më shumë informacion semantik. Për shembull, *hound* thekson që Figura ndjek pa ndërprerje Figurën e dytë *pursue* shpesh nënkupton që ndjekësi ka ndërmend ta kapë ose ta vrasë Figurën e dytë, por jo domosdoshmërisht; dhe *shadow* duket se nënkupton lëvizje të fshehtë.

- d. Ndryshim drejtimi (4 folje, 9.09%): *divert, swerve, tack, turn2*.

Ky grup foljesh tregon se Figura ndryshon trajektoren e lëvizjes. Në rastin e *tack*, Figura zakonisht duket se është një anije. Nga ky grup, vetëm *divert* dhe *turn2* mund të shfaqin sjellje veprare (lëvizje të shkaktuar).

- e. Poshtë nga / poshtë Terrenit – Tatëpjetë (4 folje, 9.09% e foljeve të trajektores në

¹⁴Një tjetër analizë e mundshme do të ishte kodimi i foljeve të trajektores të kësaj kategorie si folje që kombinojnë edhe Bashkëlëvizjen pasi në ngjarjen e lëvizjes përfshihen së paku dy Figura.

anglisht): *descend, drop, fall, sink*.

Këto katër folje përshkruajnë lëvizje poshtë në lidhje me tokën.

- f. Për tek / drejt Terrenit (vendmbërritje, pikë fundore) (4 folje, 9.09%): *arrive, alight, come, reach*.

Ky grup foljesh në përgjithësi i referohet përmbushjes së lëvizjes së Figurës drejt Terrenit. *Arrive* është një folje trajektoreje që tregon se Figura arrin destinacionin e vet dhe duket se afrohet në kuptim me *reach*. *Alight* gjithashtu tregon se Figura arrin Terrenin, por nënkupton që lëvizja është zbritje nga një kafshë apo mjet. Së fundi, *come* është një folje këndvështrimore e trajektores pasi ajo tregon lëvizje drejt folësit. Sipas Oxford English Dictionary, *come* është folje bazike jokalimtare e lëvizjes që shpreh lëvizje drejt ose në mënyrë që të arrijsh folësin, ose personin me të cilin flet.

- g. Prapsh tek / sërish në Terren (3 folje, 6.82%): *back, return, recoil*.

Foljet *back* dhe *recoil* tregojnë lëvizje prapa, por ato nuk duket se përcjellin ndonjë referencë të qartë për trajektoren drejt Terrenit. Në të kundërt, *return* tregon trajektoren e Figurës që kthehet në një vend të mëparshëm. *Back* dhe *return* mund të jenë edhe folje veprorë.

- h. Përmes/përgjatë Terrenit (kapërcim, pikë referimi) (3 folje, 6.82% e foljeve të trajektores në anglisht): *cross, pass, traverse*.

Këto folje shprehin nocionin e kapërcimit dhe/ose të kalimit përgjatë, ose përtej një pike referimi. Folja *pass* meriton vëmendjen tonë të veçantë pasi, sipas fjalorëve tanë, ajo mund të tregojë tre lloje të ndryshme trajektoreje: (a) të shkosh nga, pas, përtej Terrenit (shihet si pikë referimi) (b) të shkosh përmes, nëpër Terren (shihet si subjekt dy apo tre dimensional i cili mund të përshkohet), dhe (c) të lëvizësh përpara, të vazhdosh, që tregon një lloj trajektoreje 'Përpara'. Nga ana tjetër, *cross* dhe *traverse* tregojnë lëvizje përmes, nëpër Terren, i cili është përgjithësisht një subjekt dy apo tre dimensional dhe jo një pikë në hapësirë.

- i. Brenda në / në Terren (enë) (2 folje, 4.55%): *enter, penetrate*.

Këto dy folje shprehin hyrje në brendësi të një terreni që konceptohet si enë.

- j. Më afër Terrenit (1 folje, 2.27%): *approach*.

k. Përpara (1 folje, 2.27%): *advance*.

Kjo folje shpreh lëvizje përpara dhe mund të shfaqë edhe sjellje veprorë.

l. Drejtime të shumëfishta nga një fillim unik (1 folje, 2.27% e foljeve të trajektores në anglisht): *scatter*.

Kjo është një folje vetvetore, joveprorë dhe veprorë Figura e të cilës zakonisht është një grup subjektësh dhe tregon lëvizje larg në drejtime të ndryshme.

m. Jashtë nga/prej Terrenit (enë) (1 folje, 2.27% e foljeve të trajektores në anglisht): *exit*.

4.4.2. Foljet e trajektores në shqip

Në Tabelën 4.6 paraqitet shpërndarja e foljeve të trajektores në gjuhën shqipe nga korpusi ynë sipas llojeve të trajektores që ato shprehin.

LLOJET E TRAJEKTORES	SHQIP	
	#	%
Larg nga Terreni	14	15.73%
Poshtë / poshtë nga Terreni - Tatëpjetë	14	15.73%
Për tek / drejt Terrenit	11	12.36%
Përmbi / mbi Terren – Përpjetë	9	10.11%
Ndryshim drejtimi	8	8.99%
Drejtime të shumëfishta	8	8.99%
Prapsh tek / sërish në Terren	6	6.74%
Brenda në / në Terren	5	5.62%
Përmes / përgjatë Terrenit	5	5.62%
Më afër Terrenit	3	3.37%
Pas / prapa Terrenit	3	3.37%
Përpara	2	2.25%
Jashtë nga / prej Terrenit	1	1.12%
TOTAL	89	100%

Tabela 4.6 Shpërndarja e foljeve të trajektores në shqip

Disa lloje foljesh të trajektores ndeshen shumë më shpesh se të tjerat në korpusin tonë të foljeve të trajektores; për shembull, lloji i foljeve ‘Larg nga Terreni’, ‘Poshtë / poshtë nga Terreni – Tatëpjetë’ dhe ‘Për tek / drejt Terrenit’ janë ato që ndeshen më shpesh, ndërsa llojet ‘Më afër Terrenit’, ‘Pas Terrenit’, ‘Përpara’ dhe ‘Jashtë nga Terreni’ ndeshen më pak. Shqyrtimi i foljeve të trajektores në gjuhën shqipe do të fillojë me llojet që hasen më shpesh

sipas renditjes në tabelë:

- a. Larg nga Terreni (largim, burim)²¹ (14 folje, 15.73% e foljeve të trajektores në shqip): *arratisem, braktis, dezertoj, distancohem, iki, largohem, lë, ndahem, nisem, shkëputem, shkoj, shpërbëhet, shpërngulem, veçohem*.

Ky grup i madh foljesh tregon lëvizje larg/tutje nga Terreni. Disa nga këto folje mund të nënkuptojnë se (a) Figura lë pas Terrenin, ndonjëherë në situata të vështira (e.g., *braktis, dezertoj*; (b) Figura i shmanget Terrenit duke lëvizur mënjane me shpejtësi (*shmang, dredhoj, evitoj*) dhe (c) Figura fillon lëvizjen e vet larg prej Terrenit (p.sh., *iki, nisem, tërhiqem*). Siç sugjerojnë fjalorët në përkufizimet e tyre, foljet *iki, nisem* dhe *shkoj* mund të tregojnë se (a) Figura largohet nga folësi në një drejtim të caktuar (veçanërisht në një vend), dhe (b) Figura lëviz nga njëri vend në tjetrin në çfarëdo mënyre, për shembull, në këmbë, me mjet, etj.) pavarësisht nga pika e nisjes apo e mbrirjes.

- b. Poshtë / poshtë nga Terreni - Tatëpjetë (14 folje, 15.73% e foljeve të trajektores në shqip): *bie, gremisem, kridhem, lëshohem, mbytem, plandosem, rrëzohem, shembem, ulem1, vithisem, zbres, zdryp, zhytem*,

Në përgjithësi foljet e këtij grupi tregojnë lëvizje me drejtim poshtë në lidhje me terrenin ose nga një vend në një tjetër. Sipas fjalorëve *zbres, zdryp, bie, ulem1* dhe *lëshohem* tregojnë se Figura lëviz nga lart poshtë duke ndryshuar vendndodhjen, ndërsa në rastin e foljeve, *rrëzoj, gremis, vithis, shemb* dhe *përmbys* Figura lëviz me forcë me drejtim nga lart poshtë. Së fundi, foljet *fundosem, mbytem, zhytem, kridhem* tregojnë lëvizje poshtë, ku terreni zakonisht është ujë.

- c. Për tek / drejt Terrenit (vendmbrirje, pikë fundore) (11 folje, 12.36% e foljeve të trajektores në shqip): *ankoruj, arrij, cek, fundosem, mbërrij, prek, sos, takoj, ulem2, vij, sjell1*

Ky grup foljesh përgjithësisht shpreh realizimin e lëvizjes së Figurës drejt Terrenit. *mbërrij, arrij* ‘vij ose shkoj me këmbë a me një mjet në vendin për ku isha nisur, sosem në pikën e fundit të udhëtimit’ *ankoruj* ‘(për anijet) arrij në port’. Folja *vij* tregon se Figura shkon në drejtim të vendit ku ndodhet folësi duke shprehur vendmbrirje.

- d. Ndryshim drejtimi (8 folje, 8.99%): *devijoj, dredhoj, evitoj, kthej, mënjanoj, shmang,*

xhiroj, bishtnoj ‘ndërroj rrugën, ndërroj drejtimin’.

Të gjitha foljet e këtij grupi tregojnë qartësisht se Figura ndryshon trajektoren e lëvizjes.

- e. Përmbi/mbi Terren - përpjetë (9 folje, 10.11%): *brof, çohem, hipi, lartësohem, lartohem, ngrihem, ngjitem, përshkallëzohet, shkallëzohet*,

Në këtë grup, foljet *ngre, çoj* tregojnë lëvizje lart në lidhje me tokën ‘çoj nga poshtë lart; i shtoj lartësinë; e marr nga vendi ku ndodhet dhe e vë diku më lart’; folja *lartësoj* ‘të bësh dikë a diçka të ngrihet lart’, *hipi, ngjitem* mund të tregojnë ngritje dhe lëvizje me drejtim lart, por edhe lëvizje përmbi Terren ‘zhvendosem nga poshtë lart; vendosem në një vend më të lartë nga ku jam; ngjitem, lëviz lart’ (Lagji, 2005) dhe *shkallëzoj, përshkallëzoj* tregojnë lëvizje graduale nga poshtë lart.

- f. Drejtime të shumëfishta nga një pikënisje e vetme (8 folje, 8.99%): *davaris, hallakas, hapërdaj, përhap, përndaj, shkalafis, shpërhap, shpërndaj*,

E përbashkëta që i sjell të gjitha këto folje në këtë grup është se ato tregojnë lëvizje në shumë drejtime ku Figura është një grup apo një masë: ‘të bësh të lëvizë në drejtime të ndryshme’.

- g. Prapsh tek / sërish në Terren (6 folje, 6.74%): *kthehem, prapsohem, rikthehem, smbrapsem, tërhiqem, zbythem*,

Kthehem dhe *rikthehem* tregojnë lëvizjen e Figurës mbrapsht në vendndodhjen e mëparshme. Ndërsa, *prapsoj, zbraps, zbyth, tërheq* tregojnë lëvizje mbrapsht por jo domosdoshmërisht në vendndodhjen e mëparshme.

- h. Brenda në / në Terren (enë) (5 folje, 5.62%): *blokoj, depërtoj, futem, hyj, mbyll*

Foljet e këtij grupi shprehin se Figura lëviz (futet) brenda një Terreni të konceptuar si enë. Në këtë grup *futem, hyj* ‘të shkosh në pjesën e brendshme’, *mbyll, bllokoj* ‘të vendosësh dikë a diçka në një vend të mbyllur’ *depërtoj* ‘arrij të futem diku, duke kapërcyer pengesa a vështirësi’.

- i. Përmes/përgjatë Terrenit (kapërcim, pikë referimi) (5 folje, 5.62%): *kaloj, kapërcej, kaptoj kryqëzoj, përshkoj*, ‘i bie përmes një vendi a hapësire, kaloj matanë’.

Këto folje shprehin nocionin e kapërcimit dhe/ose të kalimit përgjatë ose përtej një pike referimi duke treguar lëvizje nga një vend në tjetrin në lidhje me Terrenin dhe kjo lëvizje mund të ndjekë trajektore të ndryshme; *kapërcej* dhe *kaptoj* ‘kaloj, kërcej e hidhem matanë’

një pengese, një hendeku, etj' tregojnë se Figura ndesh edhe vështirësi në lëvizje për shkak të pengesave.

j. Më afër Terrenit (3 folje, 3.37%): *afroj, avitem, qasem*.

Këto folje tregojnë se figura lëviz më pranë Terrenit.

k. Pas / prapa Terrenit (3 folje, 3.37%): *ndehem, pasoj, qepem* 'i shkoj pas dikujt a diçkaje'.

Foljet e këtij grupi tregojnë se Figura është duke lëvizur prapa apo pas një Figure tjetër. Përveç foljes *pasoj*, e cila duket se tregon vetëm trajektoren, *qepem* dhe *ndehem* nënkuptojnë më shumë informacion semantik pasi duket se tregojnë që figura e dytë përpiket të shpëtojë nga ndjekësi.

l. Përpara (2 folje, 2.25%): *avancoj, përparoj*,

Këto dy folje tregojnë se Figura lëviz përpara .

m. Jashtë nga / prej Terrenit (enë) (1 folje, 1.59% e foljeve të trajektores në shqip): *dal* 'shkoj jashtë'.

Ashtu si në korpusin e foljeve të trajektores në anglisht, edhe në korpusin e foljeve të shqipes gjendet vetëm një folje që tregon lëvizje jashtë një Terreni.

4.4.3. Diskutim dhe përfundime

Tabela 4.7 përmbledh si të dhënat cilësore (p.sh., lloji i trajektores) ashtu edhe të dhënat sasiore (p.sh., numri i foljeve të trajektores për secilin lloj të trajektores dhe frekuencën e tyre brenda leksikut të trajektores) të përfutuara nga analiza korpusit tonë të foljeve të trajektores në anglisht dhe në shqip. Renditja në tabelë fillon nga llojet më të shpeshta tek llojet më pak të shpeshta të trajektoreve që leksikalizohen në anglisht dhe shqip. Në këtë mënyrë, është e mundur të nxirren në pah edhe ngjashmëritë (nëse të dyja gjuhët ndjekin të njëjtën tendencë në leksikalizimin e disa llojeve të trajektores ndaj të tjerëve) edhe dallimet midis dy gjuhëve.

LLOJET E TRAJEKTORES	ANGLISHT		SHQIP	
	#	%	#	%
Larg nga Terreni	11	25.00%	14	15.73%
Përmbi / mbi Terren – Përpjetë	5	11.36%	9	10.11%
Pas / prapa Terrenit	4	9.09%	3	3.37%
Ndryshim drejtimi	4	9.09%	8	8.99%
Poshtë / Poshtë nga Terrenit - Tatëpjetë	4	9.09%	14	15.73%
Për tek / drejt Terrenit	4	9.09%	11	12.36%
Prapsh tek / sërish në Terren	3	6.82%	6	6.74%
Përmes / përgjatë Terrenit	3	6.82%	5	5.62%
Brenda në / në Terren	2	4.55%	5	5.62%
Më afër Terrenit	1	2.27%	3	3.37%
Përpara	1	2.27%	2	2.25%
Drejtime të shumëfishta	1	2.27%	8	8.99%
Jashtë nga / prej Terrenit	1	2.27%	1	1.12%
TOTAL	44	100%	89	100.0%

Tabela 4.7. Shpërndarja e foljeve të trajektores në anglisht dhe shqip

Kjo tabelë synon të sqarojë nëse midis anglishtes dhe shqipes ka dallime të ndjeshme në shpërndarjen e foljeve të trajektores në 13 llojet e trajektores. Edhe pse të dy gjuhët ndryshojnë për nga numri i foljeve të trajektores, midis tyre nuk vërehet ndonjë dallim i madh në shpërndarjen e llojeve të trajektores. Kjo sugjeron se dy gjuhët nuk ndryshojnë në organizimin e leksikut të tyre të foljeve të trajektores.

Duke mbajtur parasysh këtë fakt, mund të fillojmë t'u përgjigjemi pyetjeve kërkimore të studimit tonë në lidhje me foljet e trajektores. Një nga dy pyetjet kryesore të studimit është nëse leksikët e foljeve të trajektores në shqip dhe anglisht janë të krahasueshëm në madhësi. Nëse shikojmë Tabelën 4.6, përgjigja mund të ishte: Jo, nuk janë të tilla; foljet e trajektores në shqip i tejkalojnë foljet e trajektores në anglisht. Në korpusin e shqipes janë gjetur 89 folje të trajektores (që përfaqësojnë 30.69% të korpusit tonë të foljeve të lëvizjes në shqip), kurse në korpusin e anglishtes janë identifikuar 44 folje të trajektores (të cilat përfaqësojnë 14.81% të korpusit të foljeve të lëvizjes në anglisht). Në dritën e të dhënave tona, numri më i madh i foljeve të trajektores në shqip mund t'i atribuohet një grupi foljesh të trajektores që e kanë origjinën nga ndajfoljet (p.sh., *largoj* nga 'larg', *lartësoj* dhe *lartoj* nga 'lart', *smbraps* nga 'mbrapa', *prapsoj* nga 'prapa', *mënjanoj* nga 'mënjane', *afroj* nga 'afër', *përparoj* nga 'përpara', *veçoj* nga 'veç') dhe emrat (p.sh., *distancohem* nga 'distancë', *zbarkoj* 'barkë', *fundos* nga 'fund', *shkallëzohet*³ dhe *përshkallëzohet* nga 'shkallë', *bllokoj*

nga ‘bllok’, *zbyth* nga ‘bythë’, *bishtnoj* nga ‘bisht’, *kryqëzoj* nga ‘kryq’, *gjurmoj* ‘nga ‘gjurmë’). Pyetja e dytë studimore është në se të dy leksikët e trajektores janë të krahasueshëm në natyrën e tyre semantike. Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të llojeve të trajektores që shprehen nga foljet në këto gjuhë, mund të konkludojmë se, megjithëse ndryshojnë në madhësi, të dy leksikët e foljeve të trajektores janë në gjendje të shprehin të njëjtat lloje informacioni të trajektores; në veçanti, të dy gjuhët kanë folje trajektoreje që shprehin të 13 llojet e trajektores të përdorura në analizën tonë por shpërndarja e tyre ndryshon në mënyrë të ndjeshme për të paktën shtatë nga këto kategori. Të dhënat tona tregojnë se foljet e trajektores në shqip i tejkalojnë foljet e trajektores në anglisht në 11 nga 13 llojet e trajektores, përkatësisht, ‘Larg nga Terreni’, ‘Poshtë / poshtë nga Terreni – Tatëpjetë’, ‘Për tek / drejt Terrenit’, ‘Përmbi / mbi Terren – Përpjetë’, ‘Drejtime të shumëfishta’, ‘Brenda në / në Terren’, ‘Ndryshim drejtimi’ ‘Prapsh tek / sërish në Terren’, ‘Përmes / përgjatë Terrenit’, ‘Më afër Terrenit’ dhe ‘Përpara’.

Shqipja zotëron më shumë folje të trajektores për disa lloje trajektoresh krahasuar me anglishten. Sipas përkufizimeve në fjalorë, foljet e ndryshme të trajektores brenda të njëjtit lloj trajektoreje mund të përdoren për Figura të caktuara apo edhe për Terrene të caktuara: ‘Për tek / drejt Terrenit (vendmbërritje, pikë fundore)’ *ankoroh* (‘për anijet’) arrij në port’, ‘Poshtë / poshtë nga Terreni – Tatëpjetë’ *fundosem*, *mbytem*, *zhytem*, *kridhem* tregojnë lëvizje poshtë ku terreni zakonisht është ujë.

Nga ana tjetër, foljet e trajektores të llojit “Pas Terrenit” në gjuhën angleze (*follow*, *hound*, *pursue* dhe *shadow*) e kalojnë numrin e homologeve të tyre në shqip (*ndehem*, *pasoj*, *qepem*). Siç u tha më parë *hound*, *pursue* dhe *shadow* duket se nënkuptojnë një lloj informacioni për mënyrën e lëvizjes: *hound* duket se thekson që Figura ndjek me këmbëngulje Figurën e dytë, *pursue* duket se shpesh nënkupton që ndjekësi synon ta kapë ose ta vrasë Figurën e dytë, por jo domosdoshmërisht; dhe *shadow* duket se nënkupton lëvizje të fshehtë. Nëse në analizën tonë këto tre folje do të ishin konsideruar si folje mënyre, shqipja do ta kishte tejkaluar anglishten edhe për këtë lloj trajektoreje.

Siç tregohet në tabelën e mësipërme, të dy gjuhët paraqesin numër të njëjtë foljesh për llojin e trajektores: ‘Jashtë/ nga/prej Terrenit’, përkatësisht një folje, *exit/dal*. Për më tepër, të dhënat tona tregojnë se llojet më të shpeshta të trajektores në të dy gjuhët janë ‘Larg nga Terreni’, ‘Poshtë / poshtë nga Terreni – Tatëpjetë’, ‘Për tek / drejt Terrenit’ dhe ‘Përmbi/mbi Terren – Përpjetë’. Kjo sugjeron se këto lloje të trajektores (lëvizje larg nga / drejt Terrenit dhe lëvizje përgjatë boshtit vertikal) janë veçori themelore hapësinore të cilat

leksikalizohen shpesh tek foljet e trajektores në anglisht dhe shqip, dhe mund të parashikojmë se ato mund të jenë edhe llojet më të shpeshta të trajektores edhe në gjuhë të tjera. Megjithatë nevojiten studime të mëtejshme për të provuar nëse në leksikun e tyre të foljeve të trajektores gjuhët kanë ndonjë preferencë për leksikalizimin e këtyre llojeve të trajektores ndaj llojeve të tjera. Nga ana tjetër, lloji më pak i shpeshtë i trajektores i vërejtur për anglishten dhe shqipen është ‘Jashtë nga Terreni’, i cili shprehet vetëm nga një folje në secilën gjuhë (exit/dal). Interesant është fakti se ‘Brenda në / në Terren’ (lëvizje në një enë), lloji i trajektores i kundërt me ‘Jashtë nga/prej Terrenit’, është më i shpeshtë në të dy gjuhët, veçanërisht në shqip, ku janë gjetur 5 folje trajektoreje që tregojnë lëvizje brenda në një Terren (*futem*, *hyj* ‘të shkosh në pjesën e brendshme’, *mbyll*, *bllokoj* ‘të vendosësh dikë a diçka në një vend të mbyllur’ *depërtoj* ‘arrij të futem diku, duke kapërcyer pengesa a vështirësi’). Nuk ka ndonjë arsye të dukshme pse lloji i trajektores ‘Jashtë nga/prej Terrenit’ është më pak i favorizuar për leksikalizim.

Në tërësi, ky kërkim në leksikun e foljeve të trajektores në shqip dhe anglisht ka filluar të ngushtojë hendekun në literaturën ekzistuese. Rezultatet tona sugjerojnë se, megjithëse leksiku i foljeve të trajektores në shqip është më i madh se në anglisht – sidomos për disa lloje të trajektores - të dy gjuhët janë në gjendje të shprehin të njëjtin lloj informacioni për trajektoren, siç tregohet nga shpërndarja e llojeve të trajektores në të dy gjuhët. Gjithashtu, është theksuar se në të dy gjuhët, disa lloje trajektoreje duket se leksikalizohen më shpesh tek foljet ndërsa të tjerët nuk preferohen. Në përgjithësi, studimi ynë mbështet pretendimin e Özçalışkan (2004) se leksikët e foljeve të trajektores nëpër gjuhë formojnë një kategori të mbyllur leksikore që nuk paraqet shumë përpunim, por nuk mbështet pretendimin e saj për madhësi të krahasueshme.

4.5. Foljet e mënyrës

Siç kemi parashtruar përgjatë këtij disertacioni, një pjesë të madhe e studimeve (p.sh., Berman & Slobin, 1994; Mora-Gutierrez, 2001; Slobin, 1996a, 1996b, 1997, 2004, 2006) kanë treguar se leksiku i foljeve të mënyrës në anglisht është shumë i pasur. Studimi ynë dëshmon se edhe leksiku i foljeve të mënyrës në gjuhën shqipe është gjithashtu shumë i pasur edhe pse numri i këtyre foljeve është relativisht më i vogël. Ky studim është i pari që përpiket të shqyrtojë llojin e informacionit më të imët mënyror që shprehin foljet e shqipes dhe anglishtes nga një këndvështrim krahasues. Në këtë seksion, do të synojmë të zbulojmë

nëse foljet e mënyrës në anglisht dhe në shqip shprehin hollësi të krahasueshme të mënyrës, pavarësisht nga fakti se foljet e mënyrës në anglisht i tejkalojnë ato të shqipes. Për më tepër, synimi është të zbulojmë llojet e veçorive të mënyrës që rezultojnë më prodhimtare në të dy gjuhët. Së fundi, ky studim kërkon të zbulojë (a) nëse leksiku i foljeve të mënyrës në anglisht dhe shqip është po aq i pasur dhe i larmishëm në të gjitha nënfushat e lëvizjes (p.sh., lëvizja e njeriut ose lëvizja me anën e mjeteve), dhe nëse jo, (b) nëse, në disa nënfusha të veçanta, leksiku i foljeve të mënyrës në shqip është më i pasur se ai i anglishtes.

Për të bërë një analizë sistematike që lejon krahasimet ndërgjuhësore, ne zgjedhëm t'i grupojmë foljet e mënyrës së lëvizjes sipas dy llojeve të lëvizjes që tregojnë foljet në përgjithësi: Lëvizje e Brendshme dhe Lëvizje Zhvendosëse. Krahas kësaj, kategoritë e mënyrës të renditura në pjesën e metodologjisë janë përfshirë brenda llojit përkatës të lëvizjes. Për ilustrim, 'Qëndrimi' është një kategori e mënyrës e cila pranohet se përshkruan lëvizje të brendshme, ndërsa 'Modeli Motor' (p.sh., eci, vrapoj) zakonisht përshkruan Lëvizje Zhvendosëse. Lexuesi duhet të ketë parasysh, siç është theksuar më herët, se kategoritë e mënyrës janë reciprokisht ekskluzive, që do të thotë, se foljet e mënyrës në përgjithësi tregojnë më shumë se një veçori të imët të mënyrës. Për shembull, *jog* mund të analizohet si folje e modelit motor 'Vrapoj' (Modeli Motor), me shpejtësi lëvizjeje të ngadalshme (Ritmi) dhe hapa të rregullt (Përdorimi karakteristik i pjesës të poshtme të trupit); *stroll* i përket modelit motor 'Eci' dhe kategorisë 'Gjendja e Figurës' (e lirshme), dhe kështu me radhë. Kjo krijon disa probleme kur foljet e mënyrës grupohen sipas kategorive të mënyrës të propozuara. Nëse marrim parasysh, për shembull, foljen *stroll*, pyetja që lind është: Në cilën kategori të mënyrës duhet të përfshihet kjo folje? Tek 'Modeli Motor'?, tek 'Gjendja e Figurës'? Apo një kombinim i të dyjave? Alternativa e fundit (një kombinim i të dyjave) do të kërkonte një listë të gjerë të të gjitha kombinimeve të kategorive të mënyrës që gjenden në korpusin tonë, gjë që, sipas mendimit tonë, do ta bënte më të vështirë krahasimin midis leksikut të foljeve të mënyrës në anglisht dhe shqip.

Për këto arsye, alternativa që ne kemi zgjedhur për analizën¹⁵ tonë është: Folja të përfshihet në një kategori të mënyrës duke marrë parasysh (a) nëse fjalorët konfirmojnë se një veçori e mënyrës qëndron mbi të tjerat; (b) nëse foljet tregojnë një model motor të

¹⁵Nevojiten studime të mëtejshme eksperimentale në të ardhmen për të provuar vlefshmërinë e analizës sonë, veçanërisht për të hedhur dritë mbi çështjen (a) nëse disa kategori të mënyrës (p.sh., 'Modeli motor', 'Kontakti') mund të jenë më të rëndësishme se disa veçori të tjera të mënyrës (p.sh., 'Ritmi', 'Gjendja e Figurës') për kategorizimin e disa folejeve të caktuara (p.sh., disa hollësi të mënyrës mund të shihen si veçori përcaktuese për folje të caktuara, por jo për të tjerat), ose (b) nëse të gjitha kategoritë e mënyrës janë të barazvlefshme në semantikën e foljeve të mënyrës së lëvizjes.

veçantë (Eci, Vrapoj, Hidhem) dhe veçori të tjera të mënyrës (p.sh., ‘Ritmin’, ‘Gjendjen e Figurës’, ‘Përdorimin karakteristik të pjesës së poshtme të trupit’), të cilat vetëm sa ofrojnë veçori të mëtejshme brenda çdo modeli motor, dhe (c) nëse foljet tregojnë kontakt ndërmjet Figurës dhe Terrenit dhe veçori të tjera të mënyrës të cilat i japin imtësi semantike foljeve të kësaj kategorie. Kështu, për ilustrim, *jog* do të kategorizohej në modelin motor ‘Vrapoj’, dhe *stroll* në modelin motor ‘Eci’.

Në nënseksionet e mëposhtme, do të fillojmë me semantikën e foljeve të mënyrës në anglisht, dhe pastaj do të vazhdojmë me semantikën e foljeve të mënyrës në shqip. Në fund, do të krahasojmë të dy leksikët e foljeve të mënyrës për të zbuluar dallimet dhe ngjashmëritë ndërgjuhësore.

4.5.1. Foljet e mënyrës në anglisht

Siç tregohet në seksionin 4.3.1, në korpusin tonë të foljeve të lëvizjes në anglisht u gjetën 203 folje të mënyrës (Lëvizje + Mënyrë); këto folje përbëjnë 68,35% të foljeve të lëvizjes në korpusin tonë të anglishtes. Për lehtësi shpjegimi, fillimisht do të trajtojmë foljet e mënyrës që zakonisht tregojnë lëvizje të brendshme (61 folje, 30.05% e foljeve të mënyrës në anglisht), dhe pastaj foljet e mënyrës të cilat në përgjithësi nënkuptojnë lëvizje zhvendosëse (142 folje, 69.95% e foljeve të mënyrës në anglisht).

Tabela 4.7 tregon shpërndarjen foljeve të mënyrës në anglisht që shprehin lëvizje të brendshme nëpër gjashtë kategori të mënyrës (p.sh., numri i foljeve brenda çdo kategorie të mënyrës dhe përqindjen e tyre në lidhje me të gjithë korpusin e foljeve të mënyrës në gjuhën angleze).

LEVIZJE E BRENDISHME	ANGLISHT	
	#	%
TUND, LËKUND, DREDH	18	8.87%
QËNDRIMI	17	8.37%
Përkul, Përdredh, Kthej	6	2.96%
Orientim vertikal lart	2	0.99%
Orientim vertikal poshtë	4	1.97%
Orientim horizontal	2	0.99%
Orientim në një anë	2	0.99%
Orientim i papërcaktuar	1	0.49%
RROTULLOJ, RROKULLIS, VËRTIS	13	6.40%
LËVIZJE E PAQËNDRUESHME	8	3.94%
ME KOKË POSHTË	4	1.97%
HIDHEM	1	0.49%
TOTAL	61	30.05%
NUMRI TOTAL I FOLJEVE TË MËNYRËS	203	100.0%

Tabela 4.8. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në anglisht (Lëvizje e brendshme)

Diskutimin tonë për foljet e mënyrës që zakonisht shprehin lëvizje të brendshme do ta fillojmë me ato kategori të mënyrës që leksikalizohen më shpesh nga foljet e mënyrës në anglisht:

- a. Tund, Lëkund, Dredh (18 folje, 8.87% e foljeve të mënyrës në anglisht): *flap, flick, flutter, jig2, quake, quiver, rock, shake, shiver, shudder, sway, swing, tremble, vibrate, wag, wave, wiggle, wobble*.

Kjo kategori e mënyrës përfshin lëvizjet përkundëse dhe dredhëse, krahas lëvizjeve të shkurtra, të papritura dhe zakonisht të përsëritura të Figurës. Disa folje tregojnë se Figura dridhet për shkak të ndjenjave të forta apo të ftohtit (p.sh., *quake, quiver, shudder, tremble*).

- b. Qëndrimi (17 folje, 8.37% e foljeve të mënyrës në anglisht):

Qëndrimi është një kategori e pasur e mënyrës pasi ai tregon pozicionet e ndryshme që merr trupi i njeriut/kafshëve ose objekteve që trajtohen si të krahasueshme me trupin. Nocionet e qëndrimit i përkasin dimensionit vertikal dhe horizontal, dmth, nëse Figura përfundon në një orientim vertikal (lart ose poshtë), ose në një orientim horizontal; por ato gjithashtu tregojnë nëse Figura përkulet, përdredh trupin e vet, përdridhet, lëviz trupin e saj në një anë, etj. Prandaj, kjo kategori e mënyrës mund të ndahet në grupet që vijojnë:

b.1. Përkul, Përdredh, Kthej: *bend, bow, slouch, twist, wind, wriggle*.

b.2. Orientim vertikal - lart: *arise, rise*.

b.3. Orientim vertikal - poshtë: *crouch, kneel, squat, stoop*.

b.4. Orientimi horizontal: *lean, recline*.

b.5. Në një anë: *careen1, dodge1*.

b.6. Orientim i papërcaktuar: *stretch*.

Në këtë grup foljesh të qëndrimit, *bend, bow, careen1, lean, recline, twist* dhe *wind* duket se përdoren edhe në formën veprorë, dmth, kur një veprues i jashtëm bën që Figura të marrë një pozicion ose orientim të caktuar të trupit.

c. Rrokullis, Rrotulloj, Vërtis (13 folje, 6.40% e foljeve të mënyrës në anglisht): *bowl, coil, pirouette, reel2, revolve, roll, rotate, spin, swirl, rundle, turn1, whirl, twine*.

Siç theksojnë Levin & Rappaport-Hovav (1992) dhe Levin (1993), foljet e kategorisë ‘Rrotulloj’ (dmth, foljet që paraqesin lëvizje rreth një aksi), mund të tregojnë lëvizje veprorë dhe joveprorë, dhe kur shoqërohen me një shprehje parafjalore, ato mund të përshkruajnë edhe lëvizje zhvendosëse. Në këtë grup foljesh, folja *pirouette* nuk përdoret në formën veprorë.

d. Lëvizje e paqëndrueshme (8 folje, 3.94% e foljeve të mënyrës në anglisht): *coggle, dodder, flounder, lurch, stagger, teeter, totter, reel1*.

Ky grup foljesh ka një natyrë të ndryshme. Sipas përkufizimeve në fjalorë, disa nga këto folje duket se tregojnë lëvizje të brendshme (*coggle, flounder* dhe *lurch*), ndërsa të tjerat tregojnë si lëvizje të brendshme ashtu edhe lëvizje zhvendosëse (*dodder, lurch, stagger, teeter, totter* dhe *reel1*). Kur përdoren me Figura të pajetë, foljet e grupit të fundit përshkruajnë lëvizje të brendshme. Në të kundërt, kur përdoren me Figura të gjalla, këto folje janë në gjendje të përshkruajnë të dyja llojet e lëvizjes (të brendshme dhe zhvendosëse); me fjalë të tjera, Figura mund të lëvizë në mënyrë të paqëndrueshme, pa ndryshuar vendndodhjen e saj, ose mund të lëvizë në të njëjtën mënyrë duke ndryshuar vendndodhjen e saj.

e. Me kokë poshtë (4 folje, 1.97% e foljeve të mënyrës në anglisht): *capsize, flip, keel, overturn*

Edhe këto katër folje mund të përdoren si veprorë, dmth, një veprues mund të bëjë që Figura të kthehet me kokë poshtë ose të kthehet përmbys.

f. Hidhem (1 folje, 0.36% e foljeve të mënyrës në anglisht): *bounce*.

Kjo folje tregon se Figura rikthehet pasi ka goditur një sipërfaqe. *Bounce* mund të përdoret edhe në formën veprorë.

Për sa i përket kategorive të mënyrës që kanë të bëjnë me lëvizjen zhvendosëse, Tabela 4.8 jep shpërndarjen e përgjithshme të foljeve të mënyrës, si dhe përqindjen e tyre në raport me leksikun e foljeve të mënyrës.

LËVIZJE ZHVEN DOSËSE	ANGLISHT	
	#	%
MODELI MOTOR	41	20.20%
Eci	29	14.29%
Hidhem	7	3.45%
Vrapoj	5	2.46%
MJET/INSTRUMENT	45	22.17%
RITMI	20	9.85%
i shpejtë / Rritës	15	7.39%
i ngadaltë / Zbritës	5	2.46%
VALLËZIM	14	6.90%
KONTAKT MIDIS FIGURËS & TERRENIT	7	3.45%
LËVIZJE E FSHEHTË	3	1.48%
GJENDJA E FIGURËS	3	1.48%
FORMA E TRAJEKTROES	2	0.99%
LËVIZJE E PENGUAR	2	0.99%
LËVIZJE E NGESHME	2	0.99%
LËVIZJE E BUTË	1	0.49%
LËVIZJE NË SPORT	1	0.49%
LËVIZJE E ZHURMSHME	1	0.49%
LËVIZJE E PAKONTROLLUAR	0	0.00%
LËVIZJE E NGATHËT	0	0.00%
LËVIZJE LOZONJARE	0	0.00%
LËVIZJE E NGESHME	0	0.00%
LËVIZJE E PAQËLLIMTË	0	0.00%
LËVIZJE NË RRJESHT	0	0.00%
PËRDORIM KARAKTERISTIK I Pjesës së POSHTME TË TRUPIT	0	0.00%
PËRDORIMI I DUARVE/KËMBËVE	0	0.00%
TOTAL	142	69.95%
NUMRI TOTAL I FOLJEVE TË MËNYRËS	203	100%

Tabela 4.9. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në anglisht (Lëvizje Zhvendosëse)

Siç shihet në tabelë, për disa kategori foljesh të mënyrës (nga ‘Lëvizja e Pakontrolluar’ tek ‘Përdorimi i duarve dhe këmbëve’) nuk është gjetur asnjë folje. Kjo nuk do të thotë se anglishtja nuk ka folje që i leksikalizojnë këto nocione, por foljet që shprehin

këto veçori të mënyrës janë grupuar në kategori të tjera të mënyrës, të tilla si ‘Modeli Motor’, të cilat mund të jenë më të rëndësishme për semantikën e foljes. Edhe një herë, duam të nënvizojmë se nuk duam të nxjerrim në pah se disa kategori të mënyrës janë më superiore se të tjerat; metodologjia e përdorur nuk na lejon pretendime të tilla. Megjithatë, analiza jonë është e dobishme pasi ajo mund të shërbejë si pikënisje për studime të mëtejshme eksperimentale që synojnë të zbulojnë vlefshmërinë psikologjike të analizës sonë semantike për faktin (a) nëse foljet shprehin informacionin semantik të propozuar dhe (b) nëse disa veçori të mënyrës mund të jenë më të rëndësishme se të tjerat për semantikën e një foljeje.

Analiza jonë tregon se shumica e foljeve të mënyrës në anglisht shprehin ‘Model Motor’ (Eci, Vrapoj dhe Hidhem), ‘Mjet/Instrument’, ‘Ritëm të lëvizjes’, ‘Vallëzim’ dhe ‘Kontakt midis Figurës dhe Terrenit’, ndërsa kategoritë e tjera të mënyrës duken më pak të favorizuara për leksikalizim të pavarur (dmth., ato duket se ndodhin së bashku me veçori të tjera të mënyrës). Shqyrtimin tonë të foljeve të mënyrës do ta fillojmë me kategoritë e mënyrës që leksikalizohen më shpesh në leksikun e foljeve të mënyrës në anglisht:

a. Modeli Motor (41 folje, 20.20% e foljeve të mënyrës në anglisht)

a.1. Eci (29 folje, 14.29% e foljeve të mënyrës në anglisht): *amble, clump, goosetstep, hike, limp, march1, march2, pace, parade, plod, promenade, prowl, ramble, roam, rove, shamble, shuffle, sleepwalk, somnambulate, stomp, stride, stroll, strut, tiptoe, toddle, tramp, trudge, walk, wander*.

Ky grup heterogjen foljesh, që nga fjalorët përcaktohen si mënyra për të ecur, duket se shpreh informacion specifik në lidhje me kategoritë e mëposhtme të mënyrës:

a.1.a. ‘Gjendja e Figurës’ (11 folje): tek folja *amble* Figura është e qetë dhe ecën me një ritëm të ngadalshëm; tek *limp*, Figura është e plagosur ose fizikisht e paafte, dhe si pasojë, mund të lëvizë në mënyrë të paqëndrueshme dhe të mundimshme; *march2* tregon se Figura ecën me vendosmëri ose e zemëruar; *pace* tregon se Figura është e shqetësuar ose e paduruar; *parade* shpreh të ecur me krenari si pjesë e një feste apo ekspozimit publik; *hike, promenade* dhe *stroll* tregojnë se Figura bën një shëtitje për shlodhje dhe kënaqësi; *strut* tregon se Figura ecën në mënyrë krenare dhe me besim; tek *somnambulate* dhe *sleepwalk*, Figura ecën ndërsa është në gjumë; *stomp* tregon se Figura ecën me hapa të rëndë për të treguar zemërim.

a.1.b. ‘Lëvizje e paqëllimtë’ (4 folje): *ramble, roam, rove* dhe *wander* në përgjithësi tregojnë se Figura ecën pa ndonjë qëllim nga një vend në një tjetër.

a.1.c. ‘Lëvizje e detyruar’ (3 folje): *plod* dhe *trudge* tregojnë se Figura lëviz me vështirësi dhe mundim të madh, me ritëm të ngadaltë, zakonisht me hapa të rëndë. *Clump* duket se shpreh këtë informacion së bashku me informacionin për lëvizje të zhurmshme.

a.1.d. ‘Përdorimi karakteristik i pjesëve të poshtme të trupit’ (8 folje): *goosestep* tregon se Figura lëviz me hapa të rregullt dhe me këmbët të ngritura lart dhe drejt. *March1* tregon se Figura lëviz me hapa të rregullt, zakonisht në mënyrë ushtarake. *Tramp* tregon se Figura ecën me hapa të rëndë, por ndryshe nga *trudge* dhe *plod* kjo folje nuk shpreh ‘Lëvizje të detyruar’. *Shuffle* tregon se Figura lëviz ngadalë pa i shkëputur këmbët nga toka, dhe mund të shprehë edhe informacion për tingullin që lëshon. *Tiptoe* tregon se Figura është duke ecur mbi majat e gishtërinjve, dhe mund të tregojë se Figura nuk dëshiron të bjerë në sy. Së fundi, *stride* tregon se Figura ecën me hapa të gjatë.

a.1.e. ‘Lëvizje e paqëndrueshme’ (1 folje): *Toddle* tregon se Figura ecën në mënyrë të paqëndrueshme. Tek foljet e të ecurit, në shumicën e rasteve lëvizja e paqëndrueshme shprehet së bashku me informacion të mëtejshëm semantik (p.sh., *limp*).

a.1.f. ‘Lëvizje e mundimshme’ (1 folje): *shamble* shpreh se Figura ecën me vështirësi dhe ngadalë. Për më tepër, kjo folje mund të tregojë lëvizje të paqëndrueshme.

a.1.g. ‘Lëvizje e fshehtë’ (1 folje): *prowl* tregon se Figura ecën tinëzisht, në mënyrë që të mos bjerë në sy.

a.1.h. ‘Lëvizje lëkundëse’ (1 folje): *waddle* përkufizohet si një mënyrë të ecuri që karakterizohet nga lëkundja e Figurës.

a.2. Hidhem (7 folje, 3,45%): *bound*, *hop*, *jump*, *leap*, *skip*, *somersault*, *vault*.

Brenda këtij grupi foljesh, *bound* dhe *leap* mund të tregojnë që Figura bën hedhje të larta dhe të mëdha. Folja *hop*, kur Figura është njeri, do të thotë të hidhesh me një këmbë, ndërsa, kur Figura është kafshë (lepur, karkalec, etj), do të thotë të hidhesh me dy ose më shumë këmbë. *Skip* tregon se Figura hidhet pas çdo hapi, hidhet me këmbë të alternuara ose përdor litar për t’u hedhur. *Somersault* i referohet një kërcimi akrobatik ku Figura kthehet përmbys. Së fundi, *vault* tregon se Figura përdor duart ose një mjet për lëvizjen e saj hedhëse.

Në tërësi, kjo kategori është shumë e lidhur me lëvizjen e brendshme, në kuptimin që kur Figura *jumps*, *hops*, etj., jo domosdoshmërisht ndryshon vendndodhjen e saj. Prandaj, kjo kategori mund të thuhet se përkufizohet me ngritje nga toka duke përdorur këmbët.

a.3. Vrapoj (5 folje, 2.48%): *gallop1*, *jog*, *run*, *sprint*, *trot*.

*Gallop*¹ dhe *trot* zakonisht i referohen vrapimit të një kali apo një kafshe me katër këmbë. Përveç kësaj, këto folje tregojnë ritëm të shpejtë lëvizjeje tek *gallop* dhe një ritëm të ngadalshëm në rastin e *trot*. *Jog* tregon vrapim të ngadaltë me shpejtësi të njëtrajtshme. *Sprint* do të thotë të lëvizësh me shpejtësi të madhe për një periudhë të shkurtër kohe.

Në dritën e këtyre të dhënave, duket se ‘Jump’/‘Hidhem’ përfshin më shumë folje se ‘Run’/‘Vrapoj’. Megjithatë, siç do ta theksojmë më poshtë, fakti që jo të gjithë fjalorët konfirmojnë nëse disa folje të mënyrës (p.sh., *dash*, *dart*, *hurry*, *hurtle*, *rush*, *spring*, *streak*, *whisk*, *whiz(z)*,) janë ose jo folje të të vrapuarit, na bëri që t’i vendosim këto folje në kategorinë ‘Ritmi’. Kjo mund të shpjegojë numrin më të vogël të foljeve të kategorisë ‘Run’/‘Vrapoj’ në krahasim me ‘Jump’/‘Hidhem’.

b. Mjet/Instrument (45 folje, 22.17% e foljeve të mënyrës në anglisht)

b.1. Mbi/me një kafshë (1 folje): *gallop*².

b.2. Mbi / me një mjet

b.2.1. Mjet i papërcaktuar (4 folje): *cruise*, *drive*, *journey*, *ride*.

b.2.2. Mjet/instrument i përcaktuar (34 folje): *balloon*, *bicycle*, *bike*, *boat*, *bobsleigh*, *bus*, *cab*, *canoe*, *caravan*, *chariot*, *coach*, *cycle*, *ferry*, *helicopter*, *jeep*, *motorbike*, *motorcycle*, *parachute*, *raft*, *rocket*¹, *rollerblade*, *ship*, *shuttle*, *skate*, *skateboard*, *ski*, *sledge*, *sled*, *sleigh*, *taxi*, *tram*, *trolley*, *truck*, *yacht*.

b.2.3. Pjesë e një mjeti (6 folje): *oar*, *paddle*², *pedal*, *sail*, *row*, *wheel*

Kjo kategori e gjerë grupon foljet që tregojnë lëvizje me/mbi kafshë, në/mbi mjete dhe në/mbi instrumente. *Gallop* tregon se Figura është duke lëvizur me/mbi një kalë. Brenda grupit të lëvizjes me/mbi mjete, vërejmë tre lloje kryesore foljesh: (a) Foljet që leksikalizojnë një mjet ose instrument të veçantë (folje emërore); (b) foljet që nënkuptojnë përdorimin e disa mjeteve dhe (c) foljet që leksikalizojnë pjesë të disa mjeteve, dhe, si pasojë, i referohen lëvizjes duke përdorur këto mjete. Për sa i përket mjeteve që nënkuptohen nga foljet, folja *cruise* nënkupton një anije (luksoze), por pjesa tjetër e foljeve mund të nënkuptojnë një gamë të gjerë mjetesh (p.sh., veturë, kamion, motoçikletë, biçikletë, etj). Grupi i fundit i foljeve (*oar*, *paddle*², *pedal*, *sail*, *row*, *wheel*) mund të konsiderohen si folje metonimike pasi një pjesë e një mjeti përfaqëson të gjithë mjetin (Lakoff & Johnson 1982: 38).

Kur analizuam këtë grup foljesh, vumë re se disa folje mjetesh mund të shfaqin lëvizje veprorë, dmth, mjeti mund të përdoret për të lëvizur subjektet nga një vend në tjetrin, ndërsa foljet e tjera të mjeteve nuk duket se janë në gjendje të shprehin lëvizje të shkaktuar -

të paktën sipas përkufizimeve në fjalorë.

Pasi vështruam nga afër foljet e mjeteve, konstatuam se të gjithë fjalorët konfirmojnë që (a) *bus, ferry, parachute, ship, shuttle* dhe *truck* mund të shfaqin sjellje veprorë ose lëvizje të shkaktuar, dhe se (b) *bobsleigh, cab, jeep, kayak, motorcycle/bike, rollerblade, skate, skateboard, ski* dhe *yacht* tregojnë vetëm se Figura përdor këto mjete ose instrumente për lëvizje. Kjo na bëri të supozojmë që mjetet e mëdha mund të shfaqin edhe lëvizje veprorë edhe lëvizje të brendshme, pasi ato mund të transportojnë njerëz, mallra, etj, kurse mjetet e vogla mund të përdoren vetëm nga Figurat si mjete për transportimin e tyre.

- c. Ritmi i lëvizjes (20 folje, 9.85% e foljeve të mënyrës në anglisht): *accelerate, clip, dart, dash, decelerate, hasten, hurl, hurry, hurtle, lumber, race, roar, rush, scramble, speed, spring, streak, tear, whisk, whiz*

Kjo kategori përfshin një larmi foljesh. Të gjitha ato shprehin informacion në lidhje me ritmin e lëvizjes, dhe disa prej tyre shprehin veçori shtesë të mënyrës. Brenda kësaj kategorie, 15 folje tregojnë ritëm të lartë të lëvizjes (p.sh., *clip, dart, dash, hurry*, etj), 3 folje shprehin rritje të shpejtësisë (përkatësisht, *accelerate, hasten, hurry*), 1 folje tregon ritëm të ngadaltët të lëvizjes (*lumber*), dhe 1 folje tregon ulje të shpejtësisë së lëvizjes (*decelerate*).

Duhet theksuar se shumë nga këto folje mund të grupoheshin në kategori të tjera. *Hurl* dhe *hurtle* mund të ishin përfshirë tek ‘Lëvizja e sforcuar’ pasi lëvizja e shprehur nga këto folje kërkon përpjekje për t’u kryer. *Scramble* mund të ishte përfshirë tek ‘Lëvizja e detyruar’, pasi ajo tregon se Figura lëviz apo ngjitet shpejt me vështirësi duke përdorur duart dhe këmbët. *Whiz(z)* mund të ishte përfshirë tek ‘Lëvizja e zhurmshme’ pasi e shpreh edhe këtë informacion semantik krahas shprehjes së ‘Lëvizjes së shpejtë’.

- d. Vallëzim (14 folje, 6.90% e foljeve të mënyrës në anglisht): *boogie, conga, dance, foxtrot, jig1, polka, quickstep, rumba, samba, squaredance, tango, tapdance, twist2* dhe *waltz*.

Ky grup foljesh të mënyrës do të thotë ‘të kërcesh vallëzimin e emërtuar nga folja’. Në përgjithësi, këto folje mund të tregojnë lëvizje të brendshme, pasi Figura jo domosdoshmërisht ndryshon vendndodhjen e saj të përgjithshme. Megjithatë, siç vihet në dukje në literaturë (p.sh., Narasimhan, 2003; Narasimhan et al 2006), foljet e të hedhurit mund të kombinohen me shprehje parafjalore që tregojnë drejtim, dhe në këtë mënyrë, të përcjellin lehtësisht lëvizjen zhvendosëse të Figurës.

- e. Kontakt midis Figurës dhe Terrenit: (7 folje) *crawl, creep2, glide, slide, slip1, skid* dhe

sweep.

Ky grup foljesh tregon se (a) trupi i Figurës është afër Terrenit (*crawl*, *creep2* dhe *sweep*); (b) Figura lëviz butësisht mbi Terren ose përgjatë Terrenit (*glide*, *slide*, *slip*); (c) Figura humbet kontrollin e lëvizjes mbi Terren ose përgjatë Terrenit (*skid*).

- f. Lëvizje e fshehtë (3 folje, 1.48% e foljeve të mënyrës në anglisht): *creep1*, *sidle*, *sneak*.

Këto folje tregojnë se Figura lëviz në mënyrë të fshehtë, për të mos u parë, dëgjuar apo rënë në sy. Disa prej këtyre foljeve, përkatësisht, *creep1* dhe *sneak*, duket se nënkuptojnë që Figura ecën, siç tregohet nga disa prej përkufizimeve të fjalorëve. Megjithatë, fjalorët zakonisht nuk ofrojnë shumë informacion në lidhje me modelin motor pasi ato priren që këto folje t'i përcaktojnë si 'Lëvizje e fshehtë'.

- g. Gjendja e figurës (3 folje, 1.48% e foljeve të mënyrës në anglisht): *storm*, *prance* dhe *tittup*.

Këto tre folje të lëvizjes shprehin gjendjen psikologjike të Figurës; tek folja *storm*, Figura është i/e mërzhitur dhe duket se e tregon zemërimin duke lëvizur me dhunë; tek *prance* dhe *tittup*, Figura lëviz në mënyrë ekspozuese. Përkufizimet e fjalorëve nuk janë të qarta për sa i përket modelit motor që nënkuptojnë këto folje të lëvizjes. Tek foljet *prance* dhe *tittup* nuk është e qartë nëse Figura është duke ecur, dhe në rastin e *prance*, nuk tregohet nëse Figura është duke ecur, duke u hedhur apo duke vrapuar.

- h. Forma e Trajektores (2 folje, 0.99% e foljeve të mënyrës në anglisht): *zigzag*, *circle*

Folja *zigzag*, një trajektore zikzake; dhe *circle*, një trajektore rreth diçkaje. Kjo kategori mund të jetë problematike pasi mund të thuhet se forma e Trajektores është një parametër trajektoreje dhe jo mënyre, prandaj nevojiten studime të mëtejshme për të hedhur dritë mbi këtë çështje.

- i. Lëvizje e penguar (2 folje, 0.99% e foljeve të mënyrës në anglisht): *trip*, *stumble*.

Këto dy folje tregojnë se Figura ka një pengesë në rrugën e vet, teksa ecën ose vrapon.

- j. Lëvizje e ngeshme (2 folje, 0.99% e foljeve të mënyrës në anglisht): *tour*, *travel*.

- k. Lëvizje e butë (1 folje, 0.49% e foljeve të mënyrës në anglisht): *float*.

Lëvizja e butë është një kategori e mënyrës që lidhet me lëvizjen zhvendosëse; Figura lëviz butësisht në lidhje me Terrenin, i cili, në këtë rast, mund të jetë ose ajri ose uji. Megjithatë, kjo folje nuk nënkupton që Figura lëviz përgjatë një trajektoreje, përveçse kur pasohet nga një shprehje parafjalore që tregon drejtim.

- l. Lëvizje në sport (1 folje, 0.49% e foljeve të mënyrës në anglisht): *dribble*
- m. Lëvizje e zhurmshme (1 folje, 0.49% e foljeve të mënyrës në anglisht): *thunder*.
Kjo folje përcaktohet si folje e lëvizjes e cila karakterizohet nga zëri apo zhurma e saj. Këtu është e nevojshme të theksohet se leksiku i foljeve të mënyrës në anglisht ka më shumë folje që shprehin këtë lloj informacioni mënyror, por ato zakonisht shprehin edhe veçori të tjera të mënyrës. Për shembull, *roar* dhe *whiz* përfshihen në kategorinë ‘Ritmi i lëvizjes’ por mund të ishin përfshirë edhe këtu.

4.5.2. Foljet e mënyrës në shqip

Në korpusin tonë të foljeve të shqipes kemi gjetur 146 folje për mënyrën e lëvizjes të cilat përfaqësojnë 51.03% të korpusit të foljeve shqipes. 61 folje të mënyrës (dmth., 41.22% e korpusit të foljeve të mënyrës në shqip) janë grupuar sipas kategorive që shprehin lëvizje të brendshme, ndërsa 85 folje të mënyrës (dmth., 57.43% e korpusit të foljeve të mënyrës në shqip) përmbajnë hollësi të mënyrës të cilat përgjithësisht shoqërohen me lëvizjen zhvendosëse.

Tabela 4.9 tregon shpërndarjen e foljeve të mënyrës në shqip duke renditur në shtatë kategori të mënyrës foljet që shprehin lëvizje të brendshme.

LËVIZJE E BRENDASHME	SHQIP	
	#	%
QËNDDRIMI	30	20.55%
Përkul, Përdredh, Kthej	5	3.42%
Orientim vertikal poshtë	8	5.48%
Orientim vertikal lart	3	2.05%
Orientim i papërcaktuar	4	2.74%
Orientim Horizontal	6	4.11%
Në një anë	4	2.74%
TUND, LËKUND, DREDH	16	10.96%
RROTULLOJ, RROKULLIS, VËRTIS	10	6.85%
LËVIZJE E PAQËNDRUESHME	2	1.37%
HIDHEM	2	1.37%
ME KOKË POSHTË	1	0.68%
LËVIZJE PËRSËRITËSE	0	0.00%
TOTAL	61	41.78%
NUMRI TOTAL I FOLJEVE TË MËNYRËS	146	100%

Tabela 4.10. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në shqip (Lëvizje e brendshme)

Siç tregohet më lart, foljet e mënyrës në shqip nuk shpërndahen në mënyrë uniforme nëpër kategori; në korpusin e shqipes rezulton se shumica e foljeve të mënyrës të cilat shprehin lëvizje të brendshme leksikalizojnë nocione që kanë të bëjnë me qëndrimin (dmth., 30 nga 61 folje):

- a. Qëndrimi (30 folje, 20.55% e foljeve të mënyrës në shqip): *anohem, batohem, çohem, drejtohem, gërmuqem, gjunjëzohem, kërrusem, kruspullohem, kthej, lëshohem, mbështetem, ngrihem, përdredh, përkthej, përkul, përkulem, përthyej, përulem, pjerrësoj, prehem, rehatohem, relaksohem, sforcoj, shtrëngo, shtrihem, shtrij, shtriqem, tendos, tërheq, ulem1, zgjeroj,*

Siç është theksuar, Qëndrimi është një kategori e pasur e mënyrës e cila tregon pozicionet e ndryshme që merr trupi i njeriut/kafshës apo objektet që trajtohen si të krahasueshme me trupin. Nocionet e qëndrimit i përkasin dimensionit vertikal dhe horizontal, dmth, nëse Figura përfundon në një orientim vertikal (lart ose poshtë) apo në një orientim horizontal; por ato gjithashtu tregojnë nëse Figura përkul, përdredh trupin apo lëviz trupin e saj në një anë, etj. Ashtu si në anglisht, foljet e qëndrimit mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- a.1. Përkul, Përdredh, Kthej (5 folje, 3.42% e foljeve të mënyrës në shqip): *kthej,*

përdredh, përkul, përthyej, shpërdredh

a.2. Orientim Vertikal - poshtë (8 folje, 5.48% e foljeve të mënyrës në shqip): *gërmuqem, gjunjëzohem, kërrusem, kruspullohem, përthyhem, përkulem, përulem, ulem*¹.

a.3. Orientim Vertikal – lart (3 folje, 2.05% e foljeve të mënyrës në shqip): *çohem, drejtohem, ngrihem*

a.4. Orientim Horizontal (6 folje, 4.11% e foljeve të mënyrës në shqip): *lëshohem, prehem, rehatohem, çtendosem, ndehem, shtriqem*

Të gjitha foljet e këtij grupi duket se nënkuptojnë që trupi i Figurës perfundon në një pozicion horizontal.

a.5. Orientim i Papërcaktuar (4 folje, 2.74 % e foljeve të mënyrës në shqip): *shtrij, tendos, tërheq, zgjeroj,*

Këto folje nuk tregojnë asnjë informacion për orientimin e trupit të Figurës në përfundim të lëvizjes.

a.6. Në një anë (4 folje, 2.74% të foljeve të shqipes): *anohem, batohem, mbështetem, pjerrësoj.*

Këto folje tregojnë se Figura lëviz trupin në njërën anë; ato mund të përdoren edhe në kontekste që nënkuptojnë se Figura lëviz trupin në njërën anë për të shmangur diçka.

Në përgjithësi foljet e Qëndrimit në shqip tregojnë lëvizje veprorë, por në formën vetvetore ose jo veprorë ato tregojnë lëvizje të brendshme.

Pjesa tjetër e foljeve që shprehin lëvizje të brendshme i përketin gjashtë kategorive të tjera të mënyrës. Ndryshe nga ‘Qëndrimi’, kategoritë e mëposhtme të mënyrës nuk duket se leksikalizohen shpesh në leksikun e foljeve të mënyrës në shqip:

b. Tund, Lëkund, Dredh (16 folje, 10.96% e foljeve të mënyrës në shqip): *dredh, fërgëlloj, kolovis, lëkund, luhatem, ngjethem, përkund, rrëqethem, shkund, tallandis, trazoj, troshit, tund, valëvit, valëzoj, përpëlitem, përqethem*

Kjo kategori e mënyrës përfshin lëvizjet përkundëse dhe dredhëse, krahas lëvizjeve të shkurtra, të papritura dhe zakonisht të përsëritura të Figurës (*p.sh., kolovitem, përkundem, valëvit, fërgëlloj, trazoj, lëkund, tund, troshit, shkund, luhatem, valëzoj*). Disa folje tregojnë se Figura dridhet për shkak të ndjenjave të forta apo të ftohtit (*p.sh., rënqethem, ngjethem, dridhem, përpëlitem*).

c. Rrotulloj, Rrokullis, Vërtis (10 folje, 6.85% e foljeve të mënyrës në shqip):

çmbështjell, mbështjell, mbledh, pështjelloj, qarkoj, rrotulloj, rrokullis, shtjelloj, sillem, vërtis, xhiroj, pleks

Siç theksojnë Levin & Rappaport-Hovav (1992) dhe Levin (1993), foljet e kategorisë ‘Rrotulloj’ (dmth, foljet që paraqesin lëvizje rreth një aksi), mund të tregojnë lëvizje veprore dhe joveprore, dhe kur shoqërohen me një shprehje parafjalore, ato mund të përshkruajnë edhe lëvizje zhvendosëse.

- d. Hidhem (2 folje, 1.37% e foljeve të mënyrës në shqip): *hidhem, kërcej*

Këto folje tregojnë se Figura rikthehet pasi ka goditur një sipërfaqe.

- e. Lëvizje e Paqëndrueshme (2 folje, 1.37% e foljeve të mënyrës në shqip): *luhatem, lëkundem* ‘lëviz sikur po rrëzohet’.

Kur përdoren me Figura të pajetë, foljet e këtij grupi përshkruajnë lëvizje të brendshme. Në të kundërt, kur përdoren me Figura të gjalla, këto folje janë në gjendje të përshkruajnë të dyja llojet e lëvizjes (të brendshme dhe zhvendosëse); me fjalë të tjera, Figura mund të lëvizë në mënyrë të paqëndrueshme, pa ndryshuar vendndodhjen e saj, ose mund të lëvizë në të njejtën mënyrë duke ndryshuar vendndodhjen e saj.

- f. Me kokë poshtë (1 folje, 0.68% e foljeve të mënyrës në shqip): *përmbys*

Edhe kjo folje mund të përdoret si veprore, dmth, një veprues mund të bëjë që Figura të kthehet me kokë poshtë ose të kthehet përmbys.

Lidhur me kategoritë e mënyrës që i përkasin lëvizjes zhvendosëse, Tabela 4.10 tregon shpërndarjen e përgjithshme të foljeve të mënyrës, si dhe përqindjen e tyre në raport me leksikun e foljeve të mënyrës në shqip.

LËVIZJE ZHVENDOSËSE	SHQIP	
	#	%
MODEL MOTOR	33	22.60%
Eci	22	15.07%
Hidhem	5	3.42%
Vrapoj	6	4.11%
MJET/INSTRUMENT	14	9.59%
RITËM	6	4.11%
i shpejtë/rritës	4	2.74%
i ngadaltë /zbritës	2	1.37%
FORMA E TRAJEKTROES	5	3.42%
LËVIZJE E ZHURMSHME	5	3.42%
GJENDJA E FIGURËS	5	3.42%
KONTAKT MIDIS FIGURËS & TERRENIT	4	2.74%
LËVIZJE E PENGUAR	3	2.05%
LËVIZJE LOZONJARE	3	2.05%
VALLËZIM	3	2.05%
LËVIZJE E FSHEHTË	2	1.37%
LËVIZJE NË SPORT	1	0.68%
LËVIZJE E BUTË	1	0.68%
LËVIZJE E SFORCUAR	0	0.00%
LËVIZJE E LIRSHME	0	0.00%
LËVIZJE NË RRJESHT	0	0.00%
LËVIZJE E PAKONTROLLUAR	0	0.00%
LËVIZJE E NGATHËT	0	0.00%
LËVIZJE E PAQËLLIMTË	0	0.00%
TOTAL	85	58.22%
NUMRI TOTAL I FOLJEVE TË MËNYRËS	146	100%

Tabela 4.11. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në shqip (Lëvizje Zhvendosëse)

Siç tregohet edhe në tabelë, shumica e foljeve të mënyrës në korpusin e shqipes shprehin ‘Modelin Motor’ (*eci, vrapoj dhe hidhem*) dhe ‘Mjet/instrument’, ndërsa kategoritë e tjera të mënyrës duken më pak të favorizuara për leksikalizim më vete (megjithëse ato mund të kombinohen me hollësi të tjera të mënyrës). Le të fillojmë me kategoritë të mënyrës që leksikalizohen më shpesh në leksikun e foljeve të mënyrës në shqip:

- a. Model Motor (33 folje, 22.60% e foljeve të mënyrës në shqip)
 - a.1. Eci (22 folje, 15.07% e foljeve të mënyrës në shqip): *baris, çaloj, eci, endem, gjezdis, kacavarem, kacavirem, kapardisem, krekosem, marshoj, ngutem, nxitoj, parakaloj1, rreshtoj, sorollatem, shëtis, shpejtoj, udhëtoj, vërdallisem,*

Ky grup heterogjen foljesh, që nga fjalorët përcaktohen si mënyra për të ecur, duket se shpreh informacion specifik në lidhje me kategoritë e mëposhtme të mënyrës të cilat kodohen tek foljet e të ecurit në korpusin e shqipes:

a.1.a. ‘Lëvizje e paqëllimtë’ (7 folje): *baris, endem, gjezdis, sorollatem, shëtis, udhëtoj, vërdallisem*.

Në përgjithësi këto folje tregojnë se Figura ecën pa ndonjë qëllim nga një vend në një tjetër.

a.1.b. ‘Gjendje e Figurës’ (5 folje) *fryhem, ngrefosem, ngrifem, kapardisem, krekosem*.

Foljet e këtij grupi shprehin se Figura ecën me krenari dhe vetëbesim.

a.1.c. ‘Ritëm-i shpejtë’ (3 folje): *nxitoj, ngutem, shpejtoj*, në fjalor përcaktohen si ecje e shpejtë.

a.1.e. ‘Përdorimi karakteristik i pjesës së poshtme të trupit’ (3 folje): *marshoj, parakaloj, rreshtoj*

Këto tre folje nënkuptojnë hapa të rregullt gjatë lëvizjes.

a.1.d. ‘Lëvizje e mundimshme’ + ‘Gjendje e Figurës’ (1 folje): *çaloj*,

Figura është e plagosur ose fizikisht e paaftë, dhe si pasojë, mund të lëvizë në mënyrë të paqëndrueshme dhe të sforcuar.

a.1.e. ‘Përdorimi i duarve/këmbëve’ (2 folje): *kacavarem, kacavirem*,

Figura lëviz duke përdorur këmbët dhe/ose duart.

a.1.g. ‘Lëvizje lëkundëse’ (1 folje): *luhatem* përkufizohet si një mënyrë të ecuri që karakterizohet nga lëkundja e Figurës.

a.2. Vrapoj (6 folje, 4.11% e foljeve të mënyrës në shqip): *fugoj, kris, rend, sprintoj, turrem, vërshoj, vrapoj*.

Këto folje tregojnë ritëm të shpejtë lëvizjeje. *Sprintoj* do të thotë të lëvizësh me shpejtësi të madhe për një periudhë të shkurtër kohe.

a.3. Hidhem (5 folje, 3.42% e foljeve të mënyrës në shqip): *brof, hidhem, kapërcej, kapërdihem, kërcej*3,

Në tërësi, kjo kategori është shumë e lidhur me lëvizjen e brendshme, në kuptimin që kur Figura *hidhet, kërcen, kapërcen* etj., jo domosdoshmërisht ndryshon vendndodhjen e saj. Prandaj, kjo kategori mund të thuhet se përkufizohet me ngritje nga toka duke përdorur këmbët. Këtu veçohet folja *kapërdihem* e cila i referohet një kërcimi akrobatik ku Figura kthehet përmbys.

Brenda kategorisë së mënyrës ‘Modeli Motor’ mund të vërehet se shumica e foljeve u

referohet mënyrave të të ecurit duke tejkaluar mënyrat e të vrapuarit dhe të hedhurit. Ndryshe nga anglishtja, e cila i shpreh keto modele motore në mënyrë më të imët, foljet e mënyrës në gjuhën shqipe nuk përmbajnë aq shumë informacion semantik për sa i përket mënyrës se si Figura lëviz ose ndryshon vendndodhjen.

Për sa i përket foljeve të të vrapuarit, krahas hiperonimeve *vrapoj* dhe *fugoj*, në korpusin e shqipes gjendet edhe një folje të tjetër, *sprintoj*, e cila shpreh lëvizje me shpejtësi të madhe për një periudhë të shkurtër kohe. Së fundi, lidhur me foljet e të hedhurit, gjenden edhe dy folje të tjera krahas hiperonimit *hidhem*. Një prej tyre, *kapërcej*, shpreh praninë e një pengese në kërcim, dhe tjetra, *kapërdihem*, i referohet një kërcimi akrobatik ku Figura kthehet përmbys. Sipas përcaktimeve të fjalorëve, foljet e të hedhurit duket se i referohen lëvizjes së brendshme; një Figurë mund të hidhet pa e ndryshuar vendndodhjen e vet. Megjithatë, nëse këto folje pasohen nga shprehje me parafjalë që tregojnë vendndodhje apo drejtim (*majtas*, *përpara*, *në të djathtë*, *etj.*), ato mund të shprehin edhe lëvizje zhvendosëse.

b. Mjet/Instrument (14 folje, 9.59% e foljeve të mënyrës në shqip)

b.1. ‘Me/mbi një kafshë’ (2 folje): *galopoj* ‘të ngasësh një kalë me galop’ dhe *kalëroj* ‘të ngasësh një kalë’.

b.2. Me/mbi një mjet:

b.2.1. Mjet i papërcaktuar (10 folje): *drejtoj2*, *hipi*, *i jap*, *lundroj*, *navigoj*, *ngas*, *ngjitem*, *pilotoj*, *shaloj*, *vozt*,

Në këtë grup, *ngas*, *drejtoj* ‘nis dhe e drejtoj gjatë ecjes një mjet transporti (veturën, kamionin, biçikletën, etj.)’, *hipi*, *ngjitem*, *shaloj* ‘vendosem mbi një mjet’, *navigoj*, ‘drejtoj një anije, aeroplan), *lundroj* ‘udhëtoj me anije, varkë, etj.’, *pilotoj* ‘drejtoj një avion, veturë, motor, etj.’.

b.2.2. Pjesë e një mjeti (2 folje): *rremoj* ‘ngas një mjet me rrema’ (varkë), dhe *pedaloj* ‘ngas një mjet me pedale’ (biçikletë, varkë),.

Kjo kategori e gjerë grupon foljet që tregojnë lëvizjen me/mbi kafshë, lëvizje mbi/me mjete/instrumente. Brenda grupit ‘lëvizje mbi/me mjete’, vërejmë (a) folje që tregojnë një mjet/instrument të përcaktuar dhe (b) ashtu si në anglisht, gjejmë folje metonimike që shprehin një pjesë të një mjeti të caktuar për t’iu referuar mjetit si e tërë: *pedaloj* ‘ngas një mjet me pedale’ (biçikletë, varkë), *rremoj* ‘ngas një mjet me rrema’ (varkë).

c. Ritmi (6 folje, 4.11% e foljeve të mënyrës në shqip): *frenoj*, *ngadalësoj*, *ngutem*, *nxitoj*, *përshejtoj*, *shpejtoj*,

Foljet e mënyrës që futen në këtë grup, përmbajnë informacion për ritmin e lëvizjes dhe shprehin nocione të tilla si rritja e shpejtësisë (*shpejtoj, përshpejtoj, nxitoj, ngutem,*) ose zvogëlimi i shpejtësisë (*ngadalësoj, frenoj*).

- d. Forma e Trajektores (5 folje, 3.42% e foljeve të mënyrës në shqip): *gjarpëroj, lakoj, përqarkoj, qarkoj, rrethoj*,

Figura ndjek një trajektore të lakuar, dredha-dredha ose një trajektore rreth diçkaje (*qarkoj, përqarkoj, rrethoj, lakoj*). Brenda këtij grupi foljesh gjejmë foljen *gjarpëroj* e cila tregon se Figura lëviz përgjatë një trajektoreje të lakuar ose zigzage si ajo e gjarpërit. Pra, duke përmbajtur emrin e një kafshe të caktuar, kjo folje tregon trajektoren e lëvizjes së kafshës në fjalë. Kjo kategori mund të jetë problematike pasi mund të thuhet se forma e Trajektores është një parametër i trajektores dhe jo i mënyrës, prandaj nevojiten studime të mëtejshme për të hedhur dritë mbi këtë çështje.

- e. Lëvizje e Zhurmshme (5 folje, 3.42% e foljeve të mënyrës në shqip): *kërcas, kërcëllij, rrapëllis, trokas, trokëllis*,

Këto folje përcaktohen si folje ku lëvizja shoqërohet me zhurmë.

- f. Kontakt midis Figurës dhe Terrenit (4 folje, 2.74% e foljeve të mënyrës në shqip): *rrëshqas, shkas, zvarritem, zhgërryhem*.

Për sa i përket informacionit semantik shtesë të shprehur prej tyre, folja *zvarritem* tregon kontakt të fortë të të gjithë trupit me Terrenin. Ndërsa në rastin e *rrëshqas* dhe *shkas* Figura lëviz lirshëm mbi Terren dhe një lëvizje e tillë mund të jetë e pakantrolluar, njësoj sikur të lëvizje mbi akull apo mbi një sipërfaqe të lagur.

- g. Lëvizje e Penguar (3 folje, 2.05% e foljeve të mënyrës në shqip): *ngatërrohem, rrëzohem, pengohem*.

Këto folje tregojnë se Figura has në pengesa gjatë lëvizjes (dmth., figura duhet të jetë duke lëvizur për diku). Prandaj, këto folje mund të tregojnë lëvizje zhvendosëse.

- h. Lëvizje lozonjare (3 folje, 2.05% e foljeve të mënyrës në shqip): *lodroj, luaj, loz*

- i. Vallëzim (2 folje, 1.37% e foljeve të mënyrës në shqip): *kërcej, vallëzoj*,

Ndryshe nga anglishtja, në korpusin e foljeve të gjuhës shqipe gjenden vetëm këto tre folje hiperonimike të cilat mund të kombinohen me emrat perkatës të llojeve të ndryshme të

vallëzimit, p.sh., kërcej samba, tango, twist, etj.

- j. Lëvizje e fshehtë (2 folje, 1.37% e foljeve të mënyrës në shqip): *fshihem, vidhem*,
- k. Lëvizje në sport (1 folje, 0.68% e foljeve të mënyrës në shqip): *dribloj*
- l. Lëvizje e butë (1 folje, 0.68% e foljeve të mënyrës në shqip): *lundroj*,
Kjo folje duket se nënkupton që figura lëviz lirshëm dhe pa pengesa.

4.5.3. Diskutim dhe përfundime

Grupi i tretë i pyetjeve studimore të parashtruara në fillim të kapitullit dhe gjithashtu në fillim të Seksionit 4.5. kërkon (a) nëse leksikët e foljeve të mënyrës në shqip dhe anglisht leksikalizojnë informacion të ngjashëm mënyror; (b) cilat kategori të mënyrës leksikalizohen zakonisht ose më shpesh në secilën gjuhë, dhe (c) nëse anglishtja shfaq një shkallë më të lartë të hollësive të mënyrës në të gjitha nënfushat e lëvizjes (p.sh., lëvizja e njeriut dhe e kafshëve, lëvizja e objekteve ose sendve të pajetë, lëvizja në/mbi mjete, lëvizja gjatë vallëzimit, qëndrimi, etj), dhe, nëse nuk është kështu, në cilën nënfushë/cilat nënfusha shqipja paraqet një shumëllojshmëri më të pasur të foljeve të mënyrës.

Ne mund të fillojnë tu përgjigjemi këtyre pyetjeve duke shikuar Tabelat 4.11 dhe 4.12, të cilat përmbledhin shpërndarjen e foljeve të mënyrës në korpusin tonë të anglishtes dhe shqipes sipas (a) llojit të lëvizjes të cilit i përket (dmth., Lëvizje e brendshme dhe Lëvizje zhvendosëse), dhe (b) sipas kategorive të imta të mënyrës që shprehin këto folje. Krahës kësaj, aty përfshihet edhe numri i foljeve dhe përqindja e tyre në të gjithë korpusin e foljeve të mënyrës, pjesë e të cilit janë.

LËVIZJE E BRENDISHME	ANGLISHT		SHQIP	
	#	%	#	%
TUND, LËKUND, DREDH	18	8.87%	16	10.96%
QËNDRIMI	17	8.37%	30	20.55%
Përkul, Përdredh, Kthej	6	2.96%	5	3.42%
Orientim vertikal lart	2	0.99%	3	2.05%
Orientim vertikal poshtë	4	1.97%	8	5.48%
Orientim horizontal	2	0.99%	6	4.11%
Orientim në një anë	2	0.99%	4	2.74%
Orientim i papërcaktuar	1	0.49%	4	2.74%
RROTULLOJ, RROKULLIS, VËRTIS	13	6.40%	10	6.85%
LËVIZJE E PAQËNDRUESHME	8	3.94%	2	1.37%
ME KOKË POSHTË	4	1.97%	1	0.68%
HIDHEM	1	0.49%	2	1.37%
TOTAL	61	30.05%	61	41.78%
NUMRI TOTAL I FOLJEVE TË MËNYRËS	203	100%	146	100%

**Tabela 4.12. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në anglisht dhe shqip
(Lëvizje e brendshme)**

LËVIZJE ZHVENDOSËSE	ANGLISHT		SHQIP	
	#	%	#	%
MODELI MOTOR	41	20.20%	33	22.30%
Eci	29	14.29%	22	14.86%
Hidhem	7	3.45%	5	3.38%
Vrapoj	5	2.46%	6	4.05%
MJET/INSTRUMENT	45	22.17%	14	9.46%
RITMI	20	9.85%	6	4.05%
I shpejtë rritës	15	7.39%	4	2.70%
I ngadalhtë zbritës	5	2.46%	2	1.35%
VALLËZIM	14	6.90%	3	2.03%
KONTAKT MIDIS FIGURËS & TERRENIT	7	3.45%	4	2.70%
LËVIZJE E FSHEHTË	3	1.48%	2	1.37%
GJENDJA E FIGURËS	3	1.48%	5	3.42%
FORMA E TRAJEKTROES	2	0.99%	5	3.42%
LËVIZJE E PENGUAR	2	0.99%	3	2.05%
LËVIZJE E NGESHME	2	0.99%	0	0.00%
LËVIZJE E BUTË	1	0.49%	1	0.68%
LËVIZJE NË SPORT	1	0.49%	1	0.68%
LËVIZJE E ZHURMSHME	1	0.49%	5	3.42%
LËVIZJE LOZONJARE	0	0.00%	3	2.05%
LËVIZJE E PAKONTROLLUAR	0	0.00%	0	0.00%
LËVIZJE E NGATHËT	0	0.00%	0	0.00%
LËVIZJE E PAQËLLIMTË	0	0.00%	0	0.00%
LËVIZJE NË RRJESHT	0	0.00%	0	0.00%
PËRDORIM KARAKTERISTIK I PJESËS SË POSHTME TË TRUPIT	0	0.00%	0	0.00%
PËRDORIMI I DUARVE/KËMBËVE	0	0.00%	0	0.00%
TOTAL	142	69.95%	85	58.22%
NUMRI TOTAL I FOLJEVE TË MËNYRËS	203	100%	146	100%

**Tabela 4.13. Shpërndarja e foljeve të mënyrës në anglisht dhe shqip
(Lëvizje zhvendosëse)**

Siç shihet më lart, të dy gjuhët në përgjithësi duket se janë në gjendje të leksikalizojnë një gamë të gjerë informacioni semantik që i përket mënyrave të lëvizjes së Figurës, ose duke ruajtur vendndodhjen e saj të përgjithshme, ose duke shkuar nga vendndodhja fillestare tek një tjetër.

Dy tabelat e mësipërme na ndihmojnë për të parë nëse ka ndryshim të ndjeshëm midis shpërndarjes së foljeve të mënyrës në shqip dhe anglisht sipas kategorive të lëvizjes së brendshme, nga njëra anë, dhe sipas kategorive të lëvizjes zhvendosëse, nga ana tjetër.

Rezultatet tona sugjerojnë se anglishtja dhe shqipja ndryshojnë në mënyrën se si i shpërndajnë foljet e tyre të mënyrës nëpër kategori të ndryshme në lëvizjen e brendshme.

Në përgjithësi, mund të vërehet se foljet e mënyrës në anglisht i tejkalojnë ato të shqipes (203 përkundrejt 146 folje). Në anglisht, 30.05% e foljeve të mënyrës lidhen me lëvizjen e brendshme, ndërsa 69.95% lidhen me lëvizjen zhvendosëse. Në të kundërt, në shqip, të dy kategoritë e lëvizjes janë më të ekuilibruara; 41.78% e foljeve të mënyrës i referohen lëvizjes së brendshme dhe 58.22% lëvizjes zhvendosëse.

Për sa i përket lëvizjes së brendshme, ‘Qëndrimi’ (shqip, 20.55%, anglisht, 8.37%) dhe ‘Tund, Lëkund, Dredh’ (shqip, 10.96%, anglisht 8.87%) janë kategoritë e leksikalizuara më shpesh për të dy gjuhët. Megjithatë, ‘Qëndrimi’ duket se shfrytëzohet më shpesh në leksikun e foljeve të shqipes. Siç është treguar tashmë, shqipja ka një numër të madh foljesh që shprehin ndryshimin e qëndrimit apo orientimit të Figurës; këto folje përgjithësisht vijnë prej foljeve veprorë të cilat përdoren si vetvetore (të gjalla) dhe joveprorë (të pajetë). Në të kundërt, foljet e qëndrimit në anglisht zakonisht tregojnë ‘të jesh në një pozicion të caktuar’ dhe kanë nevojë për një satelit për të treguar ‘të marrësh një pozicion të caktuar’ (Talmy, 2000b: 80).

Për të përfunduar diskutimin tonë rreth lëvizjes së brendshme, duam të nënvizojmë se disa folje brenda këtyre kategorive mund të gjenden edhe në lëvizjen zhvendosëse. Shumë shpesh përkufizimet e fjalorëve në të dy gjuhët përfshijnë kuptime që u përkasin të dy llojeve të lëvizjes; për shembull, në anglisht *slouch* nga shumica e fjalorëve përkufizohet si ‘të ecësh [lëvizje zhvendosëse], të ulësh ose të rriësh në këmbë me një qëndrim të venitur [lëvizje e brendshme]. Folja e anglishtes *roll* ‘rrokullis’ përkufizohet si ‘të lëvizësh rreth një aksi (dmth., lëvizje e brendshme) dhe ‘të lëvizësh përgjatë një sipërfaqeje duke u kthyer përmbys’ (dmth., lëvizje zhvendosëse). E njëjta sjellje është konstatuar edhe tek foljet që shprehin ‘Lëvizje të paqëndrueshme’ (p.sh., *dodder*, *stagger*, *teeter*, *totter*). E njëjta gjë ndodh me foljet *luhatem* dhe *lëkundem* në shqip, të cilat fjalorët i perkufizojnë si ‘qëndrojnë (lëvizje e brendshme) ose lëviz (lëvizje zhvendosëse) sikur po rrëzohet’. Këto vëzhgime mund të sugjerojnë që kufiri mes dy llojeve të lëvizjes është i ngushtë dhe mund të kapërcehet.

Për sa i përket lëvizjes zhvendosëse, 69.95% e foljeve të mënyrës në anglisht dhe 58.22% e foljeve të mënyrës në shqip në përgjithësi nënkuptojnë lëvizje zhvendosëse. Para se të vazhdojmë më tej, lexuesi duhet të ketë parasysh se foljet e të fluturuarit dhe foljet e të notuarit, që gjithashtu shprehin ‘Model Motor’, janë analizuar si folje që tregojnë Lëvizje plus dy përbërës shtesë: Mënyrën (‘Modeli Motor’) dhe Terrenin (përkatesisht ajri dhe uji).

Prandaj, ato nuk janë përfshirë në këtë seksion të foljeve të mënyrës, por janë përfshirë në Seksionin 4.3.1., ku janë trajtuar foljet që kombinojnë Lëvizjen, Terrenin dhe Mënyrën.

Siç tregohet në Tabelën 4.12, në korpusin tonë, për disa kategori të mënyrës, përkatësisht, ‘Lëvizje e paqëllimtë’, ‘Përdorimi karakteristik i pjesës së poshtme të trupit’ (informacion për gjatësinë e hapave, formën e këmbëve, etj), ‘Lëvizje e pakontrolluar’, dhe ‘Lëvizje e ngathët’, nuk është gjetur asnjë folje e lëvizjes në secilin prej këtyre dy gjuhëve. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që anglishtja dhe shqipja nuk kanë folje që leksikalizojnë këto nocione, por që foljet e mënyrës të cilat shprehin ndonjë nga këto hollësi të mënyrës së bashku me informacion shtesë për mënyrën, janë grupuar sipas informacionit shtesë. Siç u vu në dukje në fillim të Seksionit 4.5, foljet e mënyrës zakonisht shprehin më shumë se një hollësi të mënyrës. Kjo ka krijuar probleme gjatë grupimit të foljeve të mënyrës në kategoritë propozuara të mënyrës pasi nga kqyrja e përkufizimeve në fjalor nuk është e qartë nëse disa kategori të mënyrës (p.sh., ‘Modeli Motor’, ‘Kontakti midis Figurës dhe Terrenit’) janë më të rëndësishme se të tjerat (p.sh., ‘Ritmi’, ‘Lëvizja e fshehtë’, ‘Lëvizja e butë’) për përcaktimin e një foljeje të lëvizjes, apo nëse të gjitha kategoritë e mënyrës janë të barazvlefshme. Prandaj, në të ardhmen nevojiten studime empirike (a) për të testuar vlefshmërinë e analizës sonë, dmth, nëse foljet e mënyrës vërtetë shprehin informacionin semantik që ne kemi nxjerrë nga fjalorët; dhe (b) për të hedhur dritë mbi çështjen nëse, për kategorizimin e një foljeje të lëvizjes, disa kategori të informacionit mënyror mund të jenë më të rëndësishme se të tjerat (p.sh., disa kategori të mënyrës mund të shihen si veçori përcaktuese për disa folje të caktuara, por jo për të tjerat), apo nëse të gjitha kategoritë e mënyrës janë të barazvlefshme në semantikën e foljeve të mënyrës së lëvizjes.

Lidhur me kategoritë e mënyrës që leksikalizohen më shpesh në secilën gjuhë, për anglishten, ‘Mjet / Instrument’ (22.17%), ‘Modeli Motor’ (20.20%), ‘Ritmi’ (9.85%), dhe ‘Vallëzimi’ (6.90%), janë kategoritë më të shpeshta; nga ana tjetër, për shqipen kategoritë më të shpeshta janë ‘Modeli Motor’ (22.30%), ‘Mjet / Instrument’ (9.46%) dhe ‘Ritmi’ (4.05%). Edhe pse foljet e mënyrës në anglisht në përgjithësi i tejkalojnë foljet e mënyrës në shqip në pothuajse të gjitha kategoritë e mënyrës që nënkuptojnë lëvizje zhvendosëse, mund të vërehet se të dy gjuhët përdorin një pjesë të madhe të leksikut të foljeve të tyre për t’iu referuar modeleve të ndryshme motore (dmth., aftësive themelore të lëvizjes së njerëzve dhe kafshëve) dhe lëvizjes duke përdorur mjete.

Brenda kategorisë ‘Modeli Motor’ kemi vërejtur se foljet e të ecurit i tejkalojnë foljet e të vrapuarit dhe të hedhurit si në anglisht (29 për ‘Walk’, 7 për ‘Jump’ dhe 5 për ‘Run’) ashtu edhe në shqip (22 për ‘Eci’, 6 për ‘Vrapoj’ dhe 5 për ‘Hidhem’). Kjo sugjeron që të dy

gjuhët e organizojnë në të njëjtën mënyrë këtë pjesë të leksikut të foljeve të tyre, pavarësisht dallimeve sasiore; anglishtja dhe shqipja duket se i kushtojnë me shumë vëmendje leksikalizimit të informacionit të hollësishëm për mënyrën si ecën Figura se sa për mënyrën si vrapon apo hidhet ajo. Të ecurit është një veprimtari më themelore dhe e përditshme; njerëzit mund edhe të vrapojnë ose të hidhen ndonjëherë gjatë ditës, por shumicën e kohës ata ecin nga një vend në tjetrin. Kështu, mund të ngrihet hipoteza se shumica e gjuhëve ka më shumë gjasa të kenë një leksik më të gjerë foljesh të mënyrës për veprimtaritë e të ecurit se për të vrapuarit apo të hedhurit.

Për sa i përket informacionit semantik që shprehet në mënyrë tipike tek foljet e të ecurit, Tabela 4.13 përmbledh llojet e informacionit të imët mënyror që përcillet nga foljet e të ecurit në anglisht dhe shqip.

FOLJET E TË ECURIT	Anglisht		Shqip	
	#	%	#	%
Gjendja e Figurës	11	0.05	5	0.03
Lëvizje e paqëllimtë	4	0.02	7	0.05
Përdorimi karakteristik i pjesës së poshtme të trupit	8	0.04	3	0.02
Lëvizje e detyruar	3	0.01	0	0.00
Lëvizje e paqëndrueshme	1	0.00	1	0.01
Lëvizje e fshehtë	1	0.00	0	0.00
Lëvizje lëkundëse	1	0.00	2	0.01
Lëvizje e sforcuar	1	0.00	0	0.00
Përdorimi i këmbëve/duarve	0	0.00	2	0.01
Ritmi	0	0.00	3	0.02
Lëvizje përsëritëse	0	0.00	0	0.00
Lëvizje e zhurmshme	0	0.00	0	0.00
Kontakt midis Figures & Terrenit	0	0.00	0	0.00
TOTAL	30	0.15	23	0.16

Tabela 4.13. Kategoritë e imta të mënyrës për foljet e të Ecurit në anglisht dhe në shqip në raport me totalin e foljeve të mënyrës

Pavarësisht nga diferencat numerike, sidomos në kategoritë ‘Gjendja e figurës’ (anglisht 11 vs shqip 5 folje) dhe ‘Përdorimi karakteristik i pjesës së poshtme të trupit’ (anglisht 8 vs shqip 3 folje), në tërësi, duket se tek foljet e tyre të të ecurit të dy gjuhët leksikalizojnë informacion mënyror (a) për gjendjen fizike ose psikologjike të Figurës (edhe pse anglishtja e shfrytëzon shumë më shpesh këtë informacion semantik), (b) për mënyrën si

Figura lëviz këmbët (nëse Figura bën hapa të gjatë, ose të shkurtër, etj), dhe (c) nëse Figura lëviz në mënyrë të paqëllimtë (të cilën shqipja e shfrytëzon më mirë).

Përveç këtyre ngjashmërive midis anglishtes dhe shqipes, të dhënat tona tregojnë edhe disa dallime ndërgjuhësore në mënyrën e shpërndarjes së foljeve të tyre të të ecurit sipas 13 kategorive të imta të mënyrës të paraqitura në tabelë. Rezultatet tona treguan se anglishtja dhe shqipja ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në shpërndarjen e tyre. Nga njëra anë, në shqip ka disa folje që shprehin një lloj informacioni semantik i cili në anglisht duket se nuk leksikalizohet tek foljet e të ecurit në korpusin tonë: së pari, brenda kategorisë ‘Ritmi’, *nxitoj*, *ngutem*, *shpejtoj*, në fjalorët e shqipes përcaktohen si ecje me ritëm të shpejtë. Së dyti, në kategorinë ‘Përdorimi i këmbëve/duarve,’ shqipja ka dy folje: *kacavarem*, *kacavirem*, të cilat tregojnë se Figura lëviz duke përdorur këmbët dhe/ose duart. Nga ana tjetër, tek foljet e të ecurit në anglisht, ka disa folje që shprehin llojet ‘Lëvizje e mundimshme’, ‘Lëvizje e fshehtë’, ‘Lëvizje e detyruar’, që nuk duket se leksikalizohen tek foljet e të ecurit në shqip: së pari, në kategorinë ‘Lëvizje e detyruar’ *plod* dhe *trudge* tregojnë se Figura lëviz me vështirësi dhe mundim të madh, me ritëm të ngadaltë, zakonisht me hapa të rëndë ndërsa *clump* duket se shpreh këtë informacion së bashku me informacionin për lëvizje të zhurmshme; së dyti, në kategorinë, ‘Lëvizje e sforcuar’ *shamble* shpreh ecje të ngathët dhe të ngadaltë të Figurës, dhe së treti, në kategorinë ‘Lëvizje e fshehtë’ *prowl* tregon se Figura ecën tinëzisht përreth një vendi, për të mos rënë në sy. Për të përfunduar diskutimin tonë rreth foljeve të të ecurit, duhet të theksojmë se, megjithëse të dy gjuhët mund të leksikalizojnë informacion të ngjashëm semantik për hollësitë e mënyrës, anglishtja i shfrytëzon më shumë disa kategori të imta të mënyrës, siç tregohet nga numri më i madh i foljeve që leksikalizojnë gjendjen mendore të Figurës dhe hollësitë për mënyrën si Figura lëviz këmbët kur ecën.

Per sa i përket foljeve për modelet motore ‘Vrapoj’ dhe ‘Hidhem’, të dy gjuhët kanë më pak folje se sa për modelin motor ‘Eci’. Në korpusin tonë të shqipes janë identifikuar 6 folje për ‘Vrapoj’ (4.11%) dhe 5 folje për ‘Hidhem’ (3.42% e foljeve të mënyrës në shqip). Nga ana tjetër, në rastin e anglishtes, foljet për ‘Hidhem’ (7 folje, 3.45% e foljeve të mënyrës në anglisht) i tejkalojnë foljet për ‘Vrapoj’ (5 folje, 2.48% e foljeve të mënyrës në anglisht). Lidhur me faktin nëse disa folje që shprehin ‘Ritëm të shpejtë’ në anglisht dhe në shqip janë apo jo folje të të vrapuarit (p.sh., *canter*, *dash*, *dart*, *hurry*, *rush*, *spring*, *ngutem*, *nxitoj*, *përshpejtoj*, *shpejtoj*), të gjithë këto kandidatë të mundshëm për folje të modelit motor ‘Vrapoj’ janë përfshirë në kategorinë ‘Ritëm i shpejtë’. Studimi eksperimental i raportuar në kapitullin pasardhës do të trajtojë çështjen nëse këto folje mund të kategorizohen si folje të të

vrapiarit.

Për sa i përket informacionit semantik që leksikalizojnë foljet e modelit ‘Vrapoj’ dhe ‘Hidhem’ në anglisht, është vënë re se foljet e të vrapiarit kryesisht përfshijnë informacion për (a) për ‘Ritmin’ (i shpejtë si tek *galop* dhe *sprint*, ose i ngadalshëm si tek *trot* dhe *jog*). Foljet e të hedhurit duket se shprehin informacion për (a) gjatësinë ose lartësinë e kërcimeve (*bound, leap*), (b) për përdorimin e një ose më shumë këmbëve (*hop*), (c) për përdorimin e duarve ose shkopit (*vault*). Në të kundërt, foljet e shqipes për modelin motor ‘Vrapoj’ *fugoj, kris, turrem, vërshoj, vrapoj* tregojnë ritëm të shpejtë lëvizjeje ndërsa folja *sprintoj* do të thotë të lëvizësh me shpejtësi të madhe për një periudhë të shkurtër kohe.

Para se të kalojmë tek trajtimi i kategorive të tjera që leksikalizohen shpesh tek foljet e mënyrës në anglisht dhe në shqip, duam të ngrejmë çështjen e natyrës semantike të modelit motor ‘Hidhem’. Në tërësi, kjo kategori e modelit motor duket se është mjaft e lidhur me lëvizjen e brendshme, në kuptimin që kur Figura *hidhet* jo domosdoshmërisht ndryshon vendndodhjen e saj të përgjithshme. Megjithatë, në qoftë se foljet e të hedhurit pasohen nga shprehje parafjalore apo ndajfolje (në të majtë, në të djathtë, përpara, etj.) që tregojnë drejtim, ato mund të shprehin lëvizje zhvendosëse. Ndryshe nga ‘Eci’ dhe ‘Vrapoj’, të cilat duket se nënkuptojnë ndryshimin e vendndodhjes së Figurës, mund të thuhet se ‘Hidhem’ në anglisht dhe në shqip karakterizohet ose përcakohet prej ngritjes së Figurës nga toka duke përdorur këmbët, që mund të ndodhë në një vend të vetëm ose nga një vend në një tjetër. Kjo çështje do të trajtohet më gjërësisht në kapitullin pasardhës.

Në lidhje me kategorinë ‘Mjet/Instrument’, analiza jonë ka treguar se të dy gjuhët kanë folje të lëvizjes që shprehin lëvizje me/mbi kafshë, me/mbi mjete dhe me/mbi instrumente. Për më tepër, është theksuar se, brenda grupit të lëvizjes me/mbi mjete, të dy gjuhët kanë (a) folje që tregojnë një mjet ose instrument të veçantë (p.sh., *bus, taxi, lundroj*), (b) folje që nënkuptojnë përdorimin e disa mjeteve (p.sh., *drive, ngas, vozit, drejtoj*) dhe (c) folje që shprehin një pjesë të një mjeti për t’iu referuar mjetit si një e tërë (p.sh., *row, wheel, pedaloj, rremoj*). Foljet e grupit të fundit janë metonimike; ato i referohen një pjese të një mjeti për të treguar të tërë mjetin (Lakoff dhe Johnson, 1980, 1999; Cifuentes-Honrubia, 1999). Nga ana tjetër, në këtë nënfushë mund të theksohen edhe disa dallime ndërgjuhësore; anglishtja duket se është shumë elastike pasi pothuajse çdo emër¹⁶ mjeti e përdor si folje të lëvizjes. Një elasticitet i tillë duket se shpjegon leksikun më të pasur të foljeve të mënyrës në këtë fushë në krahasim me shqipen; kjo aftësi e anglishtes, përdorimi i emrave si folje, mund

¹⁶Duket se emra të tillë si *car* dhe *stroller* nuk mund të përdoren si folje të lëvizjes.

të shpjegojë edhe numrin e madh të emrave të vallëzimit që mund të përdoren si folje të lëvizjes.

Ashtu si shumica e foljeve të mjeteve në anglisht, foljet e kategorisë ‘Vallëzoj’ janë edhe folje emërore. Duket se në anglisht çdo emër vallëzimi mund të përdoret edhe si folje e lëvizjes. Në të kundërt, shqipja zotëron vetëm këto dy folje hiperonimike, *kërcej* dhe *vallëzoj* të cilat mund të kombinohen me emrat përkatës të llojeve të ndryshme të vallëzimit, p.sh., *kërcej*, *vallëzoj* samba, tango, twist, etj.

Për sa i përket kategorisë së mënyrës ‘Kontakti midis Figurës dhe Terrenit’ dhe ‘Lëvizje e zhurmshme’ vërejmë se, megjithë diferencën e vogël numerike, të dy gjuhët leksikalizojnë pothuajse të njejtat hollësi të imta të mënyrës. Më konkretisht, në anglisht, foljet e kategorisë ‘Kontakt’ (7 folje, 3.45% e foljeve të mënyrës në anglisht) shprehin që (a) trupi i Figurës është afër Terrenit (*crawl*, *creep*² dhe *sweep*); (b) Figura lëviz butësisht mbi/përgjatë Terrenit (*glide*, *slide*, *slip*) dhe (c) Figura humbet kontrollin gjatë lëvizjes nëpër Terren (*skid*). Nga ana tjetër, në shqip kemi 4 folje që tregojnë ‘Kontakt’ (2.70% e foljeve të mënyrës në shqip): në rastin e foljeve *rrëshqas* dhe *shkas* Figura lëviz lirshëm mbi Terren dhe një lëvizje e tillë mund të jetë e pakantrolluar, njësoj sikur të lëvizje mbi akull apo mbi një sipërfaqe të lagur, ndërsa *zvarritem* dhe *zhgërryhem* tregojnë kontakt të fortë të të gjithë trupit me Terrenin.

Më tej, foljet e shqipes i tejkalojnë ato të anglishtes në kategoritë ‘Lëvizje e zhurmshme’ (5 folje, 3.42% e foljeve të mënyrës në shqip), ‘Forma e trajektores’ (5 folje, 3.42% e foljeve të mënyrës në shqip) dhe ‘Gjendja e figurës’ (5 folje, 3.42% e foljeve të mënyrës në shqip). Në kategorinë ‘Lëvizje e zhurmshme’ foljet *kërcas*, *kërcëllij*, *rrapëllis*, *trokas*, *trokëllis*, përcaktohen si folje ku lëvizja e Figurës shoqërohet me zhurmë. Kjo lëvizje mund të jetë edhe e brendshme kur Figura lëviz me zhurmë por nuk ndryshon vendndodhjen; në kategorinë ‘Gjendja e figurës’ foljet *fryhem*, *ngrefosem*, *ngrifem*, *kapardisem*, *krekoem*, të cilat në fjalorë perkufizohen se shprehin që ‘Figura ecën (lëvizje zhvendosëse) ose qëndron (lëvizje e brendshme) me krenari dhe vetëbesim’. Në kategorinë ‘Forma e trajektores’ janë foljet *lako*, *përqarkoj*, *qarkoj*, *rrethoj*, ku Figura ndjek një trajektore të lakuar, dredha-dredha ose një trajektore, rreth diçkaje dhe *gjarpëroj*, e cila tregon se Figura lëviz përgjatë një trajektoreje të lakuar ose zigzage si ajo e gjarpërit. Pra, duke përmbajtur emrin e një kafshe të caktuar, kjo folje tregon trajektoren e lëvizjes së kafshës në fjalë. Kjo kategori mund të jetë problematike pasi mund të thuhet se forma e Trajektores është një parametër i trajektores dhe jo i mënyrës, prandaj nevojiten studime të mëtejshme për të hedhur dritë mbi këtë çështje.

Së fundi, në foljet e mënyrës në shqip është edhe kategoria ‘Lëvizje lozonjare’ ku

janë evidentuar 3 folje (2.05%% e foljeve të mënyrës në shqip) ndërsa anglishtja nuk rezultoi ta leksikalizojë këtë kategori.

Në përgjithësi, analiza jonë e leksikut të foljeve të mënyrës në anglisht dhe shqip ka hedhur dritë si mbi ngjashmëritë ndërgjuhësore ashtu edhe mbi dallimet midis dy gjuhëve. Megjithatë leksiku i foljeve të mënyrës në anglisht është më i madh se ai i shqipes, dhe rrjedhimisht, i shfrytëzon disa kategori të mënyrës më tepër se shqipja, kemi vënë re se të dy gjuhët janë në gjendje të leksikalizojnë lloje të ngjashme informacioni mënyror. Analiza jonë ka treguar gjithashtu se të dy gjuhët e shpërndajnë leksikun e tyre të foljeve të mënyrës në forma të ndryshme. Për sa i përket dy llojeve të lëvizjes, kemi theksuar se foljet e mënyrës që nënkuptojnë lëvizje zhvendosëse i tejkalojnë foljet që tregojnë lëvizje të brendshme, por ky dallim është më pak i theksuar në shqip. Kjo mund të shkaktohet pjesërisht nga përqindja e lartë e foljeve të qëndrimit në shqip (20.55% e korpusit të foljeve të mënyrës në shqip). Nga ana tjetër, për sa i përket lëvizjes zhvendosëse, të dy gjuhët e përdorin pjesën më të madhe të leksikut të foljeve të tyre për t'iu referuar modeleve të ndryshme motore (dmth., aftësive themelore të lëvizjes së njerëzve dhe kafshëve), por sërish ato i ndajnë leksikët e tyre në mënyra të ndryshme si brenda kategorisë 'Modeli Motor' edhe midis kategorive të tjera të mënyrës. Në rastin e gjuhës angleze, 'Mjet/Instrument', 'Ritmi', dhe 'Vallëzimi' janë kategoritë më të shpeshta të mënyrës krahas 'Modelit Motor', ndërsa në shqip, kategoritë më të shpeshta të mënyrës janë 'Model Motor' dhe 'Mjet/Instrument' ndërsa më pak të shpeshta janë kategoritë 'Ritmi' dhe 'Forma e trajektores', 'Lëvizje e zhurmshme' dhe 'Gjendja e figurës'. Në tërësi, mund të konkludojmë se leksiku i foljeve në anglisht paraqet një larmi më të madhe të foljeve të mënyrës se leksiku i foljeve të shqipes, të paktën në tre nënfusha të lëvizjes: (a) lëvizja e njerëzve dhe kafshëve, (b) lëvizja me mjete dhe (c) lëvizja gjatë vallëzimit.

4.6. Përfundime

Ky kapitull ka trajtuar tre pyetje kryesore kërkimore të studimit lidhur me shpërndarjen e përgjithshme semantike të leksikut të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip, me foljet e tyre të trajektores dhe foljet e tyre të mënyrës.

1. *Cilat nocione semantike shprehen në foljet e lëvizjes në anglisht dhe shqip?*

2. *A kanë të dy gjuhët leksikë të krahasueshëm të foljeve të trajektores?*

2.1. *A janë të krahasueshëm të dy leksikët në numrin e foljeve të trajektores?*

2.2. *A janë të dy leksikët të krahasueshëm në natyrën e tyre semantike?*

2.2.1. *Cilat lloje të nocioneve të trajektores leksikalizohen zakonisht në anglisht?*

2.2.2. *Cilat lloje të nocioneve të trajektores leksikalizohen zakonisht në shqip?*

3. *A leksikalizojnë këto dy gjuhë tek foljet informacion të ngjashëm për mënyrën e lëvizjes?*

3.1. *Cilat lloje të hollësive të mënyrës leksikalizohen zakonisht në anglisht?*

3.2. *Cilat lloje të hollësive të mënyrës leksikalizohen zakonisht në shqip?*

3.3. *A shfaq anglishtja një shkallë më të madhe hollësish të mënyrës në të gjitha nënfushat e lëvizjes? Nëse jo, në cilën nënfushë /cilat nënfusha shqipja shfaq një shkallë më të madhe hollësish të mënyrës?*

Pyetja e parë dhe më e përgjithshme ishte *Cilat nocione semantike shprehen në foljet e lëvizjes në anglisht dhe shqip në korpusin tonë?* Gjetjet tona sugjerojnë se kombinimi i Lëvizjes plus një përbërës semantik shtesë (ose Mënyra ose Trajektorja) është më kombinimi karakteristik në të dy leksikët e foljeve të lëvizjes. Në të kundërt, foljet që shprehin vetëm Lëvizjen, dhe foljet që kombinojnë dy ose tre përbërës semantikë së bashku me Lëvizjen, mund të thuhet se janë më pak përfaqësuese. Në përgjithësi, foljet e lëvizjes në shqip dhe anglisht duket se shprehin një gamë të gjerë informacioni semantik që ka të bëjë si me ngjarjen kryesore të Lëvizjes ashtu edhe me Bashkëngjarjen. Megjithatë, shumica e modeleve leksikalizuese të evidentuara në korpusin tonë të foljeve të lëvizjes duket se janë modele të vogla në këto gjuhë, që do të thotë, se ato nuk janë tipike për anglishten ose shqipen. Këto modele përfshijnë, Lëvizje+Figurë, Lëvizje+Terren, Lëvizje+Shkak, dhe kombinime më komplekse të marrëdhënieve të Figurës, Terrenit dhe Bashkëngjarjeve. Sa i përket dallimeve ndërgjuhësore, është vërejtur se disa modele të vogla leksikalizuese shfaqen në një tërësi gjuhë, por jo në tjetrën; megjithatë, një kampion më i madh foljesh të lëvizjes mund të mos japë asnjë dallim midis dy gjuhëve në këtë drejtim. Krahas kësaj, në foljet e saj të lëvizjes shqipja priret të shprehë Terrenin, të kombinuar vetëm me Lëvizjen ose me elemente të tjera semantike, shumë më shpesh sesa anglishtja (dmth., 31 folje ose 12.06% e korpusit të shqipes, kundrejt 17 foljeve ose 4.55% e korpusit të anglishtes). Në tërësi, këto rezultate kundërshtojnë spekulimet e Talmy për mungesën e kombinimeve të Terrenit në leksikun e foljeve të lëvizjes. Është e vërtetë se foljet që kombinojnë Terrenin në anglisht dhe shqip nuk formojnë sistemin thelbësor për shprehjen e Lëvizjes, por ky duket se është një model më i vogël në të dy gjuhët.

Grupi i dytë i pyetjeve kërkimore të studimit synonte përgjigje në lidhje me madhësinë dhe natyrën semantike të leksikut të foljeve të trajektores në gjuhët angleze dhe shqipe. Pyetja e parë ishte *A janë të krahasueshëm të dy leksikët në numrin e foljeve të*

trajektores? Gjetjet tona tregojnë se ato nuk janë të tillë; foljet e trajektores në shqip i tejkalojnë ndjeshëm foljet e trajektores në anglisht. Në korpusin e shqipes janë gjetur 89 folje të trajektores, kurse në korpusin e anglishtes, janë gjetur 44 folje të trajektores. Në dritën e të dhënave tona, numri më i madh i foljeve të trajektores në shqip mund t'i atribuohet një grupi foljesh të trajektores që e kanë origjinën nga ndajfoljet (p.sh., *largoj* nga 'larg', *lartësoj* dhe *lartoj* nga 'lart', *smbraps* nga 'mbrapa', *prapsoj* nga 'prapa', *mënjanoj* nga 'mënjane', *afroj* nga 'afër', *përparoj* nga 'përpara', *veçoj* nga 'veç') dhe emrat (p.sh., *distancohem* nga 'distancë', *zbarkoj* 'barkë', *fundos* nga 'fund', *shkallëzohet*³ dhe *përshkallëzohet* nga 'shkallë', *bllokoj* nga 'bllok', *zbyth* nga 'bythë', *bishtnoj* nga 'bisht', *kryqëzoj* nga 'kryq', *gjurmoj* nga 'gjurmë'). Pyetja e dytë kërkimore ishte *A janë të dy leksikët të krahasueshëm në natyrën e tyre semantike?* Pas një shqyrtimi të veçantë të llojeve të trajektores që shprehen nga foljet e trajektores në anglisht dhe shqip në korpusin tonë, kemi konstatuar se, megjithëse të dy leksikët e trajektores ndryshojnë në madhësi, ato janë në gjendje të shprehin të njëjtat lloje informacioni për trajektoren; në veçanti, të dy gjuhët kanë folje të trajektores që shprehin të 13 llojet e trajektores të përdorura në analizën tonë dhe shpërndarja e foljeve në të gjithë këto lloje të trajektores nuk ndryshon në mënyrë të ndjeshme. Në të dy gjuhët, llojet më të shpeshta të trajektores janë 'Larg nga Terreni', 'Poshtë / poshtë nga Terreni – Tatëpjetë', 'Për tek / drejt Terrenit' dhe 'Përmbi/mbi Terren – Përpjetë'. Këto katër lloje të trajektores përbëjnë veçori themelore hapësinore të cilat pritet të jenë llojet më të shpeshta të trajektores për gjuhët në përgjithësi. Nevojiten studime të mëtejshme për të provuar nëse gjuhët kanë ndonjë preferencë për të leksikalizuar këto lloje të trajektores mbi të tjerat. Në tërësi, studimi ynë i leksikëve të foljeve të trajektores në anglisht dhe shqip mbështet pretendimin e Seyda Özçalışkan (2004) se leksikët e foljeve të trajektores në gjuhë të ndryshme formojnë një kategori leksikore të mbyllur, por ky studim nuk mbështet pretendimin e saj për madhësi të krahasueshme të leksikëve të trajektores midis dy llojeve të gjuhës.

Grupi i tretë i pyetjeve kërkimore u përqendrua tek foljet e mënyrës së lëvizjes dhe pyetjet ishin si vijon: *A leksikalizojnë anglishtja e dhe shqipja tek foljet informacion të ngjashëm për mënyrën e lëvizjes? Cilat lloje të hollësive të mënyrës leksikalizohen zakonisht në anglisht? Cilat lloje të hollësive të mënyrës leksikalizohen zakonisht në shqip? A shfaq anglishtja një shkallë më të madhe hollësish të mënyrës në të gjitha nënfushat e lëvizjes? Nëse jo, në cilën nënfushë /cilat nënfusha shqipja shfaq një shkallë më të madhe hollësish të mënyrës?*

Në përgjithësi, të dyja gjuhët duket se janë në gjendje të leksikalizojnë një gamë të

gjerë informacioni semantik lidhur me mënyrat në të cilat Figura lëviz duke ruajtur vendndodhjen e saj të përgjithshme (dmth., lëvizje e brendshme), ose kur Figura shkon nga vendndodhja e saj fillestare tek një tjetër (p.sh. , lëvizje zhvendosëse). Gjatë analizës së foljeve të mënyrës së lëvizjes ne bëmë një dallim kategorik ndërmjet këtyre dy llojeve të lëvizjes. Kështu, të gjitha foljet e mënyrës së lëvizjes janë përfshirë në njërën nga këto dy kategori. Gjithsesi, gjetjet tona sugjerojnë se kufiri midis lëvizjes së brendshme dhe asaj zhvendosëse është i paqartë, dmth., në fjalorë, disa folje të lëvizjes përkufizohen se tregojnë të dy këto lloje të lëvizjes.

Në anglisht, pjesa më e madhe e foljeve të mënyrës në korpusin tonë i referohet lëvizjes zhvendosëse, ndërsa në shqip, raportet e foljeve që shprejnë lëvizje të brendshme dhe lëvizje zhvendosëse janë më të balancuara. Për sa i përket lëvizjes së brendshme, ‘Qëndrimi’ dhe ‘Tund, lëkund, dredh’ janë kategoritë e leksikalizuara më shpesh si në foljet e mënyrës të anglishtes edhe në ato të shqipes. Megjithatë, ‘Qëndrimi’ duket se shfrytëzohet shumë më shpesh në leksikun e foljeve të mënyrës në shqip, ndërsa ‘Rrokullis, Rrotulloj, Vërtis’, ‘Lëvizje me kokëposhtë’ dhe ‘Lëvizje e paqëndrueshme’ shprehen më shpesh nga foljet e mënyrës në anglisht.

Për sa i përket lëvizjes zhvendosëse, ‘Modeli Motor’, ‘Mjet/Instrument’, ‘Ritmi’ dhe ‘Vallëzimi’ janë kategoritë më të shpeshta të mënyrës për gjuhën angleze; ndërsa ‘Modeli Motor’ dhe ‘Mjet/ Instrument’ janë dy kategoritë më të shpeshta për shqipen. Edhe pse foljet e mënyrës në anglisht në përgjithësi i tejkalojnë foljet e mënyrës në shqip në të gjitha kategoritë e mënyrës që nënkuptojnë lëvizje zhvendosëse, kemi vërejtur se, një pjesë të madhe të leksikut të tyre të foljeve të mënyrës, të dy gjuhët ia kushtojnë aftësive themelore të lëvizjes së njerëzve dhe kafshëve (dmth., model motor) dhe lëvizjes duke përdorur mjete/instrumente.

Lidhur me kategorinë ‘Model motor’, kemi konstatuar se foljet e të ecurit i tejkalojnë foljet e të vrapuarit dhe të hedhurit si në anglisht edhe në shqip. Kjo gjetje sugjeron që të dy gjuhët e organizojnë leksikun e foljeve të tyre në drejtime të njëjta, pavarësisht dallimeve në numrin e foljeve të mënyrës; megjithëse foljet e të ecurit, të vrapuarit dhe të hedhurit në anglisht i tejkalojnë ato të shqipes, të dy gjuhët duket se i kushtojnë më shumë vëmendje leksikalizimit të informacionit të hollësishëm për mënyrën si ecën Figura se sa atij për mënyrën si vrapon apo hidhet ajo. Gjithashtu, është vërejtur që foljet e të ecurit në anglisht dhe shqip shprehin informacion të ngjashëm mënyror, por që anglishtja është shumë më e prirur të shfrytëzojë disa kategori të imta të mënyrës, në veçanti, informacionin e mënyrës për

gjendjen mendore dhe fizike të Figurës dhe hollësitë për mënyrën si Figura lëviz këmbët kur ecën. Lidhur me foljet e lëvizjes duke përdorur një mjet/instrument, analiza jonë ka treguar se të dy gjuhët zotërojnë folje të lëvizjes që shprehin lëvizje me/mbi kafshë, me/mbi mjet dhe me/mbi instrumente. Për më tepër, është vënë në dukje se, brenda grupit ‘Lëvizje me/mbi mjet’, të dyja gjuhët kanë (a) folje që *tregojnë* një mjet ose instrument të veçantë (p.sh., *bus, taxi, vozit, lundroj*), (b) folje që *nënkuptojnë* përdorimin e disa mjeteve (p.sh., *drive, ngas, drejtoj*) dhe (c) folje që shprehin një pjesë të një mjeti për t’iu referuar mjetit si një e tërë (p.sh., *row, wheel, pedaloj, rremoj*). Sërish, ndryshe nga shqipja, anglishtja duket se është shumë më elastike pasi pothuajse çdo emër mjeti e përdor si folje të lëvizjes; ky elasticitet shtrihet edhe në përdorimin e emrave të vallëzimeve si folje të lëvizjes. Prandaj, mund të konkludojmë se leksiku i foljeve të lëvizjes në anglisht ka një shumëllojshmëri më të madhe foljesh të mënyrës sesa leksiku i foljeve të lëvizjes në gjuhën shqipe, të paktën në tre nënfusha të lëvizjes: lëvizja e njerëzve dhe e kafshëve, lëvizja duke përdorur një mjet, dhe lëvizja gjatë vallëzimit.

Analiza semantike e leksikëve të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip krijon një themel të fortë gjuhësor dhe tipologjik për një eksplorim të semantikës së foljeve të lëvizjes nga një këndvështrim eksperimental. Analiza jonë ka ngritur një pyetje kryesore lidhur me natyrën semantike të foljeve të lëvizjes: A kanë foljet e lëvizjes atë kuptim që thonë fjalorët? Kjo, nga ana e saj, ngre çështje të veçanta për sa i përket realitetit psikogjuhësor të rezultateve të analizës sonë. Për ilustrim, në rastin e foljeve të cilat janë analizuar se shprehin Lëvizje + Trajektore + Mënyrë (p.sh., *climb, dive, plummet, plunge, slink / mësyj, sulmoj, ngulem, çaj, etj.*), do të ishte interesante të testohet nëse, sipas folësve amëtarë, këto folje shprehin informacion edhe për Trajektoresh dhe për Mënyrën, siç do pritej nga analizat tona, apo nëse këto folje thjesht shprehin Mënyrën e lëvizjes që veçanërisht ndodh me trajektore të veçanta të lëvizjes dhe, rrjedhimisht, Trajektorja e lëvizjes është thjesht një interpretim që del nga konteksti. Detyrat e emërimit dhe gjykimit të tipologjisë duke përdorur videoklipe me trajektore të ndryshuara dhe mënyra të ndryshuara mund të ndihmojnë për zbulimin e natyrës semantike të këtij grupi foljesh. Për shembull, a do të emërtohej një ngjarje nga folja *dive/zhytem* apo do të gjykohej ajo ngjarje si tipike e *diving/të zhyturit* në qoftë se (a) Figura nuk lëviz në mënyrë të shpejtë dhe shumë energjike (b) nëse Figura nuk ndjek një trajektore me drejtim poshtë? Në rastin e foljeve të Trajektores, është vërejtur se disa folje të anglishtes, përkatësisht *hound, pursue* dhe *shadow*, duket se shprehin informacion për mënyrën krahas llojit të trajektores ‘Pas T’. Edhe kjo mund të testohet në mënyrë empirike.

Megjithatë, trajtimi i gjithë këtyre pyetjeve del jashtë kufijve të këtij disertacioni dhe mund të jetë subjekt i studimeve të tjera në të ardhmen.

Në përfundim, metodologjia e përdorur na ka mundësuar të krahasojmë foljet e lëvizjes në shqip dhe anglisht dhe të hedhin dritë mbi mënyrat si e organizojnë këto dy gjuhë leksikun e foljeve të tyre të lëvizjes. Përveç shumë ngjashmërive në shpërndarjen e përgjithshme të foljeve të lëvizjes, në foljet e tyre të trajektores dhe në foljet e tyre të mënyrës, janë nxjerrë në pah edhe dallimet ndërgjuhësore. Ne përfundojmë me atë që Berman & Slobin (1994: 118) vunë në dukje në studimin e tyre se ‘nuk duhet harruar që karakterizimet tipologjike shpesh pasqyrojnë tendenca më shumë se dallime absolute midis gjuhëve’.

KAPITULLI V

NJË VËSHTRIM EKSPERIMENTAL MBI FOLJET E LËVIZJES SË NJERIUT

5.1. Hyrje

5.2. Kuptimi i foljeve Lëviz, Eci, Vrapoj, Hidhem

5.2.1. Hyrje

5.2.2. Metodologjia

5.2.3. Rezultatet

5.2.4. Diskutim dhe përfundime

5.3. Foljet e të ecurit, të vrapuarit, dhe të hedhurit

5.3.1. Hyrje

5.3.2. Metoda

5.3.3. Rezultatet

5.3.4. Diskutim dhe përfundime

5.4. Përfundime

5.1. Hyrje

Leksiku i foljeve të lëvizjes shfaq një natyrë semantike shumë të ndërlikuar. Analiza semantike e leksikut të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip në kapitullin e mëparshëm ka krijuar një bazë të shëndoshë gjuhësore dhe tipologjike për eksplorimin e semantikës së foljeve të lëvizjes nga një këndvështrim eksperimental. Analiza semantike e bazuar në fjalorë ose në vëzhgimet e gjuhëtarit nuk e lejon një studiues të flasë për përfaqësimet mendore që kuptimet e foljeve të lëvizjes kanë tek folësit. Një analizë semantike kaq e hollësishme duhet konsideruar thjesht si mjet për paraqitjen e produkteve të analizës gjuhësore dhe jo si pasqyrë e mendjes së folësit (Sandra & Rice, 1995). Në mënyrë që të merren si tregues të kuptimeve të fjalëve, këto analiza duhen provuar edhe eksperimentalisht. Prandaj, nevojitet të përdoren folës amtarë të gjuhës si edhe një punë e kujdesshme empirike me qëllim që të mësojmë se çfarë ndodh në të vërtetë në mendjet e tyre.

Ky kapitull do të përqendrohet tek foljet e lëvizjes së njeriut¹. Fusha e lëvizjes së njeriut është një përvojë universale dhe mund të strukturohet rreth tre modeleve motore që kanë të bëjnë me lëvizjen në tokë: anglisht ‘Walk’ – shqip ‘Eci’, anglisht ‘Run’ – shqip ‘Vrapoj’, dhe anglisht ‘Jump’ – shqip ‘Hidhem’. Të ecurit është modeli motor themelor dhe më i rëndësishëm si edhe mënyra e zakonshme e lëvizjes për njerëzit, ndërsa të vrapuarit dhe të hedhurit janë më periferike, pasi njerëzit zakonisht nuk vrapojnë apo hidhen për të shkuar diku. Ky kapitull paraqet dy studime eksperimentale mbi lëvizjen e njeriut dhe qëllimet kryesore të tij janë (a) të shqyrtojë veçoritë përcaktuese për çdo model motor të njeriut (p.sh., ‘Walk’, ‘Run’ dhe ‘Jump’ / ‘Eci’, ‘Vrapoj’ dhe ‘Hidhem’ krahas kategorisë së përgjithshme ‘Move’/‘Lëviz’) , (b) të sigurojë prova eksperimentale për pretendimin se anglishtja dhe shqipja e organizojnë në mënyra të ngjashme leksikun e tyre të foljeve të lëvizjes së njeriut (p.sh., numër më i madh foljesh për të ecurit krahasuar me foljet për të vrapuarit apo të hedhurit).

Në studimin e parë (Detyra e Përkufizimit dhe Renditjes së Veçorive), folësve amtarë të anglishtes dhe shqipes iu kërkua të përkufizonin foljet (‘Move’, ‘Walk’, ‘Run’ dhe ‘Jump’ / ‘Lëviz’, ‘Eci’, ‘Vrapoj’ dhe ‘Hidhem’) dhe të rendisnin veçoritë e tyre përcaktuese (dmth, llojet e informacionit mënyror të cilat bëjnë që një veprim i caktuar të emërtohet nga këto folje). Ky studim synon të nxjerrë në pah atë që mendojnë folësit për kuptimin e këtyre

¹Lexuesi duhet të vërejë se shumë folje të mënyrës së lëvizjes, dmth., *walk*, *run*, *jump* / *eci*, *vrapoj*, *hidhem* dhe disa nga hiperonimet e tyre, i përkasin lëvizjes së njerëzve dhe të kafshëve.

foljeve. Në studimin e dytë (Detyra e Renditjes së Lirë të Foljeve), folësve amtarë të anglishtes dhe shqipes iu kërkua që brenda një minute të rendisnin foljet me qëllim që (a) të provonim eksperimentalisht pretendimin se të dy gjuhët e organizojnë leksikun e tyre në mënyra të ngjashme, dhe (b) të zbulonim folje prototipike për kategorinë e përgjithshme ‘Move’/‘Lëviz’, si dhe për tre kategoritë e modelit motor ‘Walk’, ‘Run’ dhe ‘Jump’ / ‘Eci’, ‘Vrapoj’ dhe ‘Hidhem’.

5.2. Kuptimi i foljeve Move, Walk, Run dhe Jump / Lëviz, Eci, Vrapoj dhe Hidhem

5.2.1. Hyrje

Siç u tha më herët, për të mësuar rreth përfaqësimeve mendore të foljeve të lëvizjes është e nevojshme t’u referohemi përdoruesve të gjuhës. Përmes metodave sasiore dhe eksperimentale, në këtë seksion, do të paraqesim rezultatet e një studimi eksperimental në të cilin u kemi kërkuar folësve amtarë të anglishtes dhe shqipes të përkufizojnë katër foljet e lëvizjes (*move-lëviz*, *walk-eci*, *run-vrapoj* dhe *jump-hidhem*) dhe të rendisin veçoritë e tyre përcaktuese. Kështu, fillojmë të nxjerrim në pah atë që ndodh në mendjet e përdoruesve të gjuhës; krahas kësaj, kërkuam të provojmë nëse dallimet e imta semantike të përdorura në Kapitullin 4 janë ose jo të vlefshme për folësit, duke shikuar përmendjen e tyre të qartë në përkufizimet e dhëna.

Parashikimet tona bazohen tek analiza semantike e bërë në kapitullin e mëparshëm: së pari, *move-lëviz* pritet të përkufizohet edhe si lëvizje zhvendosëse edhe si lëvizje e brendshme; Figura mund të lëvizë duke ruajtur vendndodhjen e saj të përgjithshme ose duke e ndryshuar atë. Së dyti, *walk-eci* pritet të përshkruhet si modeli motor më themelor, me vëmendje të veçantë tek përdorimi i këmbëve nga Figura si mjet lëvizjeje për të ndryshuar vendndodhjen (dmth., lëvizje zhvendosëse); së treti, *run-vrapoj* pritet të përkufizohet si folje e lëvizjes zhvendosëse e karakterizuar nga një mënyrë e shpejtë lëvizjeje duke përdorur këmbët; dhe së fundi, *jump-hidhem* pritet të përkufizohet edhe si lëvizje e brendshme edhe si lëvizje zhvendosëse, e karakterizuar nga shtytja energjike e Figurës prej Terrenit.

5.2.2. Metodologjia

Pjesëmarrësit në studim

Në total, në studim morën pjesë 51 anglishtfolës amtarë (12 për *move*, 13 për *walk*, 14 për *run* dhe 12 për *jump*)) dhe 60 shqipfolës amtarë (16 për *lëviz*, 16 për *eci*, 14 për *vrapoj* dhe 14 për *hidhem*). Anglishtfolësit ishin studentë në American University, Washington DC (SHBA); shqipfolësit ishin studentë në Universitetin Marin Barleti, Tiranë (Shqipëri). Të gjithë pjesëmarrësit janë angazhuar vullnetarisht në këtë studim.

Procedura

Pjesëmarrësit anglishtfolës u pyetën '*What is to move / walk / run / jump?*'. Dmth, '*which are the features that define the action of moving / walking / running / jumping?*' dhe pjesëmarrësit shqipfolës u pyetën '*Çfarë do të thotë lëviz / eci / vrapoj / hidhem?*', dmth., '*cilat janë veçoritë që përcaktojnë veprimin e të lëvizurit / të ecurit / të vrapuarit / të hedhurit?*' (Shih Shtojca 3). Çdo pjesëmarrës u pyet vetëm për njërin nga katër foljet dhe iu kërkua që përgjigjet t'i shkruante në fletën e dhënë. Kjo detyrë nuk kishte afat kohor.

5.2.3. Rezultatet

Në përgjithësi, përgjigjet e pjesëmarrësve për të katër foljet e lëvizjes përmbanin informacionin e mëposhtëm semantik: llojin e lëvizjes (lëvizje e brendshme dhe lëvizje zhvendosëse), veprueshmërinë (lëvizje vetvetore, joveprore, veprore), Figurën (njerëzore, jonjerëzore), Mënyrën (përdorimi i këmbëve; përdorimi i krahëve; shtyjtja nga terreni në ajër; ritmi, lëvizja e sforcuar) dhe Trajektoresh (çdo trajektore, trajektore vertikale, trajektore horizontale). Për ta bërë më të lehtë krahasimin ndërgjuhësor kemi paraqitur tabela më vete për çdo folje të lëvizjes; tabelat grupojnë rezultatet nga të dy grupet gjuhësore dhe të dhënat brenda çdo tabele janë renditur sipas veçorive të përmendura më shpesh në anglisht.

Move/ Lëviz

Tabela 5.1 tregon veçoritë semantike që gjenden në përkufizimet e pjesëmarrësve për foljen angleze *move* dhe për foljen shqip *lëviz*, si dhe përqindjen e pjesëmarrësve nga secila gjuhë që kanë përfshirë seciliën veçori në përgjigjet e tyre.

Move - Lëviz	Anglisht	Shqip
Lëvizje Zhvendosëse	26.92%	42.86%
Lëvizje Veprore	19.23%	17.89%
Figurë Jonjerëzore	19.23%	3.57%
Figurë Njerëzore	11.54%	7.14%
Lëvizje Vetëvevatore	7.69%	3.57%
Lëvizje e Brendshme	7.69%	21.40%
Çdo Trajektore	3.85%	0.00%
Mënyrë	3.85%	3.57%
TOTAL	100%	100%

Tabela 5.1. Informacioni semantik i përfshirë në përkufizimet e pjesëmarrësve për *move* / *lëviz*

Siç u parashikua, pjesëmarrësit anglishtfolës dhe shqipfolës mendojnë se këto folje i referohen lëvizjes zhvendosëse dhe lëvizjes së brendshme. Për më tepër, në përkufizimet e tyre të dy grupet gjuhësore shprehen se këto folje tregojnë lëvizje vetvetore, lëvizje të Figurave njerëzore dhe jonjerëzore (si kafshët) dhe lëvizje në një Mënyrë të veçantë. Si pjesëmarrësit shqipfolës ashtu edhe pjesëmarrësit anglishtfolës iu referuan pothuajse në mënyrë të barabartë edhe përdorimeve veprore të *move-lëviz* (p.sh., ‘zhvendosja e një objekti fizik në kohë apo hapësirë mund të realizohet me anë të forcave të jashtme ose të brendshme’) dhe mundësisë së Figurës për të ndjekur çdo Trajektore (p.sh., ‘to go in many directions’, ‘të shkosh në drejtime të ndryshme’).

Walk / Eci

Siç ilustron Tabela 5.2, anglishtja *walk* dhe shqipja *eci* në përgjithësi përkufizohen si mënyra të veçanta të lëvizjes duke lëvizur këmbët për të shkuar diku; ‘Përdorimi i këmbëve’ dhe ‘Lëvizja Zhvendosëse’ ishin veçoritë më të shpeshta përcaktuese në të dy grupet gjuhësore. Këto rezultate mbështesin parashikimet tona. Gjithashtu duhet theksuar se një përqindje më e lartë e pjesëmarrësve shqipfolës kanë folur për ‘Lëvizje Zhvendosëse’ (dmth., shqip, 41.18% përkundrajt anglisht, 26.32%). Krahas kësaj, këto folje janë përkufizuar edhe me ritëm të ngadaltë të lëvizjes (p.sh., ‘ritëm jo i tensionuar’, ‘ritëm i ngadalshëm’), dhe përmendja e qartë e Figurës njerëzore ishte e zakonshme, megjithëse pjesëmarrësit shqipfolës përfshijnë edhe kafshët në përkufizimet e tyre: ‘Veprim që nënkupton lëvizje të kafshës ose njeriut duke përdorur këmbët’. Ndryshe nga folja *walk*,

shqipja *eci* përshkruhet edhe si folje e lëvizjes vetvetore (p.sh., ‘Të ndryshosh vendndodhjen e dikujt vullnetarisht’) në të cilën Figura mund të ndjekë çdo Trajektore (p.sh., ‘në çdo drejtim’).

Walk - Eci	Anglisht	Shqip
Perdorimi i këmbëve	47.37%	29.41%
Lëvizje Zhvendosëse	26.32%	41.18%
Ritmi	21.05%	5.88%
Figurë Njerëzore	5.26%	5.88%
Çdo Trajektore	0.00%	5.88%
Figurë Jonjerëzore	0.00%	5.88%
Lëvizje Vetvetore	0.00%	5.88%
TOTAL	100%	100%

Tabela 5.2. Informacioni semantik i përfshirë në përkufizimet e pjesëmarrësve për *walk / eci*

Run / Vrapoj

Shtatë pjesëmarrës anglishtfolës e përkufizojnë *run* si *walking/të ecur* dhe tre e përkufizojnë si *jogging*². Pesë pjesëmarrës shqipfolës e përkufizojnë *vrapoj* si *të ecur*³. Tabela 5.3 përmbledh veçoritë semantike që përmbajnë përkufizimet e pjesëmarrësve për këto folje dhe përqindjen e përgjithshme të pjesëmarrësve që kanë përmendur secilen veçori.

²Për shembull, pjesëmarrësit anglishtfolës dhanë këto përkufizime: ‘it is similar to walking but faster’ lit. ‘është e njësoj si të ecurit por më i shpejtë’, ‘to run is to use one’s legs as a form of locomotion, but at a faster rate than walking’ lit. ‘të vraposh do të thotë të përdorësh këmbët si formë lëvizjeje por me ritëm më të shpejtë se të ecurit’, ‘to run is to move faster than jogging’ lit. ‘të vraposh do të thotë të lëvizësh më shpejt se jogging’.

³Për ilustrim, pjesëmarrësit shqipfolës dhanë përkufizime të tilla si: ‘të ndryshosh shpejt vendndodhjen’, ‘të ecësh shumë shpejt’, ‘mënyrë e natyrshme e lëvizjes së njeriut, e ngjashme me eci’.

Run - Vrapoj	Anglisht	Shqip
Ritmi	30.77%	41.18%
Përdorimi i këmbëve	20.51%	17.65%
Lëvizje zhvendosëse	15.38%	32.35%
Përdorimi i krahëve	12.82%	0.00%
Figurë Njerëzore	7.69%	2.94%
Çdo Trajektore	5.13%	2.94%
Figurë Jonjerëzore	5.13%	0.00%
Shtytje nga toka në ajër	2.56%	2.94%
TOTAL	100%	100%

Tabela 5.3. Informacioni semantik i përfshirë në përkufizimet e pjesëmarrësve për *run* / *vrapoj*

Në tërësi, ‘Ritmi’ është veçoria më e shpeshtë përcaktuese në të dy gjuhët. Për më tepër, pjesëmarrësit shpesh i përshkruajnë *run* dhe *vrapoj* si folje të lëvizjes që tregojnë se Figura shkon nga një vend në një tjetër (p.sh., lëvizje zhvendosëse). Kështu, sipas parashikimit, ritmi i lartë i lëvizjes dhe lëvizja zhvendosëse duket se janë pjesë e kuptimit të *run* dhe *vrapoj*. Ashtu si në rastin e *walk-eci*, pjesëmarrësit shqipfolës kanë folur për ‘Lëvizje zhvendosëse’ më shpesh se pjesëmarrësit anglishtfolës (p.sh., shqip, 32,35% përkundërt anglisht, 15.38%). Krahë kësaj, në përkufizimet e tyre pjesëmarrësit anglishtfolës përcaktojnë mënyrën në të cilën Figura lëviz krahët, të tillë si ‘krahët lëvizin para e prapa duke u përkulur në bërryl’ dhe ‘të vraposh do të thotë të lëvizësh shpejt, duke përkulur këmbët. Të përdorësh edhe krahët dhe të ikësh shumë shpejt’.

Jump / Hidhem

Tabela 5.4 përmbledh informacionin semantik që gjendet në përkufizimet e pjesëmarrësve për *jump* dhe *hidhem* dhe përqindjen e pjesëmarrësve të cilët kanë përmendur secilën veçori në përkufizimet e tyre.

Jump - Hidhem	Anglisht	Shqip
Shtytje nga toka në ajër	29.63%	27.03%
Trajektore vertikale	25.93%	21.62%
Lëvizje e detyruar	18.52%	10.81%
Përdorimi i këmbëve	18.52%	27.03%
Figurë njerëzore	3.70%	0.00%
Përdorimi i krahëve	3.70%	0.00%
Shmangia e një pengesë	0.00%	2.70%
Trajektore horizontale	0.00%	5.41%
Ritmi i lëvizjes	0.00%	2.70%
Lëvizje zhvendosëse	0.00%	2.70%
TOTAL	100%	100%

Tabela 5.4. Informacioni semantik i përfshirë në përkufizimet e pjesëmarrësve për *jump / hidhem*

Siç e pamë në rastin e *run-vrapoj*, pjesëmarrësit i përshkruan foljet e lëvizjes duke përdorur folje të tjera të lëvizjes; një pjesëmarrës anglishtfolës e përkufizoi foljen *jump/hidhem* duke përdorur foljen *hop*⁴ dhe një tjetër duke përdorur *bounce*⁵. Këto folje janë folje të mënyrës së lëvizjes; e para është analizuar në kapitullin 4, si një mënyrë të hedhuri (kategoria ‘Modeli Motor’ në lëvizjen zhvendosëse) ndërsa e dyta është përfshirë tek kategoria ‘Hidhem’ në lëvizjen e brendshme. Në shqip, një pjesëmarrës e përkufizon *hidhem* duke e lidhur atë me *eci*⁶.

Në tërësi, katër veçoritë e renditura të parat në tabelë, domethënë: ‘Shtytje nga toka në ajër’, ‘Trajektore vertikale’, ‘Përdorimi i këmbëve’ dhe ‘Lëvizje e detyruar’ ishin veçoritë e përmendura më shpesh në përkufizimet e pjesëmarrësve në të dy gjuhët. Krahës kësaj, pjesëmarrësit anglishtfolës përmendin qartësisht Figurën e njeriut që mund të përdorë krahët për t’u hedhur më lart; në përkufizimet e tyre pjesëmarrësit shqipfolës përfshijnë mundësinë e shmangies së një pengese, trajektoren horizontale (përpara) dhe shpejtësinë e lëvizjes. Ndryshe nga përkufizimet e *move-lëviz*, *walk-eci* dhe *run-vrapoj*, vetëm një pjesëmarrës shqipfolës përmend se *hidhem* tregon ndryshimin e vendndodhjes së Figurës (‘Lëvizje

⁴Përkufizimi i pjesëmarrësve ishte: ‘Hop. Moving up and down on your two feet in place. Movement of the two feet and legs at the same time’ lit. ‘Hidhem. Lëviz lart e poshtë në vend mbi dy këmbët e tua. Lëvizje e të dy këmbëve në të njëjtën kohë’.

⁵Përkufizimi i pjesëmarrësve ishte: ‘Bouncing up and down, being lifted off the ground by one’s own force. A person going up off the ground, then coming back down’ lit. ‘Hidhem lart e poshtë duke u ngritur nga toka me forcën tënde. Një person që ngrihet nga toka dhe pastaj kthehet sërish poshtë’.

⁶Përkufizimi i pjesëmarrësve ishte: ‘të ndyshosh vendndodhjen e dikujt duke bërë kërcime, të ecësh duke bërë kërcime’.

Zhvendosëse'). Prandaj, mund të arrijmë në përfundimin se lëvizja zhvendosëse nuk duket të jetë veçori përcaktuese për foljen *jump*, të paktën sipas pjesëmarrësve tanë anglishtfolës, edhe pse mund të jetë e tillë për shqipen *hidhem*.

5.2.4. Diskutim dhe përfundime

Në përputhje me parashikimet tona, *move* dhe *lëviz* janë folje të lëvizjes që tregojnë lëvizje zhvendosëse dhe lëvizje të brendshme; *walk* dhe *eci* zakonisht përkufizohen si modeli motor më themelor i njeriut për të ndryshuar vendndodhjen; *run* dhe *vrapoj* janë folje të lëvizjes zhvendosëse që karakterizohen nga lëvizja e shpejtë duke përdorur këmbët; dhe *jump* e *hidhem* janë folje të lëvizjes që përcaktojnë se Figura shtyn tutje terrenit.

Pavarësisht nga ngjashmëritë në përkufizimet e tyre, vihen re edhe disa dallime ndërgjuhësore. Në veçanti, në përkufizimet e tyre anglishtfolësit përfshijnë informacion në lidhje me mënyrën si Figura lëviz krahët teksa ecën, dhe herë pas here teksa vrapon e hidhet. Përmendja e qartë e këtij lloji të informacionit mënyror mungon në përkufizimet e shqipfolësve. Kjo sugjeron se folësit e shqipes mund t'i kushtojnë më pak vëmendje veçorive të tjera të mënyrës së të ecurit, të vrapuarit ose të hedhurit. Për më tepër, vihet re se në përkufizimet e tyre, pjesëmarrësit shqipfolës në përgjithësi përmendin 'Lëvizjen Zhvendosëse' më shpesh se pjesëmarrësit anglishtfolës; kjo mund të sugjerojë se ndryshimi vendndodhjes së Figurës është një pjesë më e spikatur e semantikës së këtyre foljeve të lëvizjes në shqip. Së fundi, u konstatua se, në dallim nga përkufizimet e *move-lëviz*, *walk-eci* dhe *run-vrapoj*, vetëm një pjesëmarrës shqipfolës përmend se *hidhem* tregon ndryshimin e vendndodhjes së Figurës ndërsa tek pjesëmarrësit anglishtfolës asnjë. Për pasojë, mund të thuhet se lëvizja zhvendosëse nuk duket të jetë veçori përcaktuese për *jump*, por mund të jetë e tillë për homologen e saj shqipe. Duke u kthyer sërish tek diskutimi ynë rreth këtyre foljeve në kapitullin e mëparshëm, duhet kujtuar se përkufizimet e fjalorëve për foljet *jump* dhe *hidhem* përfshinin referenca si për lëvizjen zhvendosëse edhe për lëvizjen e brendshme, ndërsa ne argumentuam se foljet e të hedhurit lidhen më shumë me lëvizjen e brendshme, pasi Figura jo domosdoshmërisht ndryshon vendndodhjen e saj gjatë kryerjes së këtyre veprimtarive. Si përfundim, mund të thuhet se *jump* dhe *hidhem* janë veprimtari të lëvizjes së brendshme të cilat mund ose nuk mund të ndodhin gjatë lëvizjes zhvendosëse të Figurës (p.sh., ndërsa ecën, vrapon, etj), kurse *walk-eci* dhe *run-vrapoj* zakonisht janë veprimtari të lëvizjes zhvendosëse.

Është mjaft interesant fakti se pjesëmarrësit anglishtfolës dhe shqipfolës i

përkufizojnë foljet *jump-hidhem* dhe *run-vrapoj* me anën e foljeve të tjera të lëvizjes. *Run* dhe *vrapoj* përkufizohen me anën e të ecurit duke përmendur qartas shpejtësi më të madhe; kjo mund të interpretohet sikur *run* dhe *vrapoj* janë mënyra të shpejta të të ecurit. Në anglisht *jump* përkufizohet duke përmendur dy folje të veçanta të mënyrës (*hop* dhe *bounce*), ndërsa në shqip folja *hidhem* përkufizohet në lidhje me foljen ‘eci’. Kjo sugjeron që *hidhem* mund të shihet si një mënyrë e veçantë lëvizjeje e cila tenton të ndodhë gjatë të ecurit, dhe kështu, kjo mund të shpjegojë pse, ndryshe nga homologu i saj në anglisht *jump*, shqipja *hidhem* përkufizohet si folje e lëvizjes zhvendosëse.

Në tërësi, ky studim eksperimental na ofron njohuritë e para për përfaqësimin që folësit u bëjnë disa foljeve themelore të lëvizjes. Krahas kësaj, ai analizon mënyrat se si mund të shfrytëzohen llojet e ndryshme të informacionit semantik të përdorura për analizën semantike në Kapitullin 5 për të shqyrtuar përkufizimet e folësve për këto folje të lëvizjes.

5.3. Foljet e të ecurit, të vrapuarit dhe të hedhurit

5.3.1. Hyrje

Analiza semantike e leksikut të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip në kapitullin paraardhës ka treguar se të dy gjuhët shfaqin imtësi më të madhe të mënyrës tek foljet e të ecurit krahasuar me foljet e të vrapuarit dhe të hedhurit. Në këtë seksion do të raportohet një studim eksperimental i cili synon të sjellë dëshmi eksperimentale për këto gjetje. Metoda e përdorur njihet si ‘Renditja e Lirë’ ose ‘Metoda e Prodhimit’. Studimet kategorizuese gjatë viteve 70 (Battig & Montague, 1969; Freedman & Loftus, 1971, Rosch, 1973, 1975) treguan se pjesëmarrësit rendisin të parët shembujt më të mirë apo anëtarët prototipikë të një kategorie. Për më tepër, rezulton se (a) njësitë që renditen të parat janë më të ngulitura dhe përdoren më shpesh se ato që renditen më pas ose që nuk renditen fare, dhe se (b) numri mesatar i njësive të renditura lidhet me numrin e përgjithshëm të njësive të kategorisë. Prandaj, pjesëmarrësit do të rendisin më shumë njësi për kategoritë më të gjëra (p.sh., ‘Move’/‘Lëviz’) se sa për ato më të ngushta (p.sh., ‘Jump’/‘Hidhem’).

Pyetjet hulumtuese të këtij studimi janë (1) *A do të rendisin anglishtfolësit më shumë folje të mënyrës së lëvizjes për të gjitha kategoritë krahasuar me shqipfolësit*; (2) *A do të përmbajë kategoria ‘Move’/‘Lëviz’ në të dy gjuhët shumëllojshmëri më të madhe foljesh të mënyrës së lëvizjes*, dhe (3) *A do të jetë kategoria ‘Walk’/‘Eci’ më e pasur apo më e ndryshme për sa i përket foljeve të mënyrës krahasuar me kategoritë ‘Run’/‘Vrapoj’ ose*

‘Jump’/‘Hidhem’. Krahas kësaj, përpos foljeve prototipike për kategorinë mbizotëruese ‘Move’/‘Lëviz’, do të dëshironim të identifikonim foljet prototipike për çdo kategori të modelit motor.

Parashikimet tona janë si më poshtë: së pari, për secilën kategori anglishtfolësit do rendisin më tepër folje të mënyrës se pjesëmarrësit shqipfolës, pasi leksiku i foljeve të mënyrës në anglisht është më i pasur. Së dyti, në të dy gjuhët, pjesëmarrësit do të rendisin më shumë folje të mënyrës për kategorinë ‘Move’/‘Lëviz’ se për tre kategoritë e tjera, pasi ‘Move’/‘Lëviz’ është folje mbizotëruese. Së treti, për kategorinë ‘Walk’/‘Eci’ do të renditen një numër më i madh foljesh të mënyrës krahasuar me kategoritë ‘Run’/‘Vrapoj’ dhe ‘Jump’/‘Hidhem’, pasi hipoteza është që të ecurit është veprimtari më themelore e lëvizjes së njeriut se të vrapuarit dhe të hedhurit.

5.3.2. Metodologjia

Pjesëmarrësit në studim

Pjesëmarrësit në Studimin 2 (Detyra e Përkufizimit dhe Renditjes së Lirë) ishin të njëjtët pjesëmarrës që morën pjesë edhe në studimin e parë. U tregua kujdes që ata të mos merrnin të njëjtën folje në të dy detyrat. Në studim morën pjesë 64 anglishtfolës amtarë (19 për ‘Move’/‘Lëviz’, nga 15 për secilën nga kategoritë ‘Walk’/‘Eci’, ‘Run’/‘Vrapoj’ dhe ‘Jump’/‘Hidhem’) dhe 68 shqipfolës amtarë (17 për çdo kategori foljore). Anglishtfolësit ishin studentë të American University në Washington DC (SHBA); Shqipfolësit ishin studentë në Universitetin ‘Marin Barleti’ Tiranë (Shqipëri). Të gjithë pjesëmarrësit morën pjesë vullnetarisht në studim.

Procedura

Pjesëmarrësit anglishtfolës u pyetën *‘In what ways can a human move / walk / run / jump?’* dhe pjesëmarrësit shqipfolës u pyetën *‘Në çfarë mënyrash mund të lëvizë / ecë / vrapojë / hidhet njeriu?’* Secili pjesëmarrës u pyet vetëm për njerën nga katër foljet (ose *move-lëviz* ose *walk-eci* ose *run-vrapoj* ose *jump-hidhem*). Pyetjet u dhanë me shkrim (shih Shtojca 3). Pjesëmarrësve iu kërkua të shkruanin në fletën e dhënë të gjitha foljet që i përgjigjeshin pyetjes. Koha e dhënë për përgjigjen ishte 1 minutë.

5.3.3. Rezultatet

Njësitë e listuara

Për qartësi paraqitjeje do të fillojmë me përgjigjet që dhanë anglishtfolësit kur u pyetën për secilën kategori foljore dhe pastaj do të vazhdojmë me përgjigjet e shqipfolësve. Më tej, do të paraqitet një tabelë përmbledhëse (Tabela 5.5).

‘Move’/‘Lëviz’

19 pjesëmarrës anglishtfolës renditën 186 njësi, nga të cilat 168 ishin të gjitha folje të lëvizjes (90.32% e përgjigjeve të pjesëmarrësve, 63 lloje foljesh). 18 njësitë e tjera (9.68% e përgjigjeve të pjesëmarrësve) ishin: 5 folje jo të lëvizjes (*babble, darf, sing, talk, touch, write*), 3 ndajfolje (*quick, fast, slow*), 2 shprehje emërore (*both feet, one foot*), dhe 5 ndajfolje⁷ (*backwards, forwards, sideways, upside down, rightside up*). Brenda foljeve të lëvizjes, *exercise, fight, kick, knee, nod* dhe *punch* u renditën krahas 3 llojeve të foljeve të trajektores *fall, go, reach* dhe 53 llojeve të foljeve të mënyrës. Foljet e mënyrës arrijnë në 155 raste (83.33% e përgjigjeve): *bend* (2)⁸, *bicycle, bike, bounce* (2), *climb, crawl, dance* (6), *drive* (3), *duck-walk, flee, fly* (5), *glide* (2), *hop* (6), *jog* (10), *jump* (12), *leap* (2), *pace, run* (18), *shake* (2), *shiver, shuffle, skate* (2), *ski* (3), *skip* (9), *slide* (3), *slither, snowboard, spring, sprint, squat, step, stomp, stretch, stroll* (3), *strut, stumble, sway* (2), *swim* (6), *swing* (2), *teeter, throw, tiptoe* (2), *totter, trip* (2), *trot, turn* (2), *twirl, twist, waddle, walk* (16), *waltz* (2), *wave, wiggle, wobble* (2).

‘Walk’/‘Eci’:

15 pjesëmarrës anglishtfolës renditën 90 njësi, nga të cilat 71 ishin folje të lëvizjes (78,89% e përgjigjeve të pjesëmarrësve) dhe 19 njësi (21.11%, 12 lloje) ishin ndajfolje që shprehin mënyrën (11 lloje: *angry, brisk* (2), *goofy, loud, quick* (2), *soft, tiresome, slowly, hurriedly, slow* (3), *fast* (4)) dhe një folje jo të lëvizjes (*think*). Brenda foljeve të lëvizjes u renditën 2 shprehje foljore komplekse (*drag your feet, make your way*), 2 folje veprare (*lift, carry*), folja e përgjithshme e lëvizjes *move* (5 raste), 2 folje të Trajektores (*go, fall*), folja *walk* dhe 34 lloje të foljeve të mënyrës (65,56% e totalit të përgjigjeve, 59 raste). *amble, careen, frolick, gallop* (3), *glide, hop* (3), *jog* (3), *jump, limp, lope, lumber, march, moonwalk, pace* (2), *powerwalk, propel, run* (7), *saunter, sidle, skip* (4), *slide, slither* (2),

⁷Ky grup ndajfoljesh tregon se Figura lëviz përgjatë një trajektoreje të papërcaktuar e cila duket se përcaktohet në lidhje me kornizën referuese të Figurës, dhe në lidhje me një kornizë referuese të jashtme. Megjithatë, mund të thuhet se ato i referohen edhe mënyrës si lëviz Figura, për shembull, tek *backwards* Figura lëviz me fytyrë në drejtimin e kundërt.

⁸Numri në kllapa i referohet numrit të rasteve, dmth, numrit të herëve që njësia është renditur nga pjesëmarrësit. Kur një njësi nuk pasohet nga një numër, do të thotë se ajo është renditur vetëm një herë nga pjesëmarrësit.

sneak, sprint, stamp, step (2), *storm, stretch, stride* (2), *stroll* (3), *strut* (4), *travel, trot, waddle*. Kujtoni që folja *eci* u rendit një herë.

‘Run’/‘Vrapoj’:

15 pjesëmarrës anglishtfolës renditën 52 njësi, nga të cilat 24 ishin folje të lëvizjes (46.15% e përgjigjeve të pjesëmarrësve, 12 lloje foljesh) dhe 28 njësi (53.85%, 15 lloje) ishin: 1 emër (*interior*), 6 satelitë (*away, up, to, into, from, down*), 18 raste ndajfoljesh (*quickly, slowly, quietly, powerfully, fast, slow*) dhe dy shprehje parafjalore (*around the block, in shoes*). Gjithashtu, në kuadër të grupit të foljeve të lëvizjes u renditën folja *move* (1 rast) dhe 11 lloje folje të mënyrës me një total prej 23 rastesh (44.23% të të gjitha përgjigjeve): *dart, gallop* (2), *hop, jog* (5), *leap, race* (2), *skip* (3), *speed, sprint* (3), *trample, walk* (3).

‘Jump’/‘Hidhem’:

15 pjesëmarrës anglishtfolës renditën 95 njësi, nga të cilat 42 ishin folje të lëvizjes (44.21% e përgjigjeve të pjesëmarrësve, 13 lloje foljesh) dhe 53 njësi (57.61%, 39 lloje) ishin si vijon: 1 folje jo të lëvizjes (*make air*), 18 raste ndajfoljesh dhe mbiemrash (*one-legged, aggressive, elongated, graceful, long, loud, mass up, pretty, short, weak, fast, high, slow, low*), 22 raste satelitësh (*above, across, around, away, down, from, into, off, onto, out, over, round, to, under, up*), dhe 12 raste ndajfoljesh (*back, backward, far, forward, forward and backward, near, side-to-side, sideways, up and down*). Këto njësi përbëjnë 57.61% të përgjigjeve të pjesëmarrësve anglishtfolës. Brenda foljeve të lëvizjes, folja *jump* u rendit një herë, 2 folje të tjera të lëvizjes (*push, release*), 2 folje të Trajektores (*lift* (2), *rise*) dhe 9 lloje foljesh të mënyrës u renditën me një total prej 36 rastesh (*bounce* (5), *bound* (2), *flip, glide, hop* (9), *leap* (8), *run, skip* (7), *spring* (2)). Foljet e mënyrës përbëjnë 37.89% të përgjigjeve të pjesëmarrësve.

‘Lëviz’:

17 pjesëmarrësit shqipfolës renditën 145 njësi të cilat ishin folje të lëvizjes (98.62% e përgjigjeve, 45 lloje foljesh). Në kuadër të këtyre foljeve, 2 folje jo të lëvizjes (ndërroj, luaj), 7 shprehje foljore komplekse (bëj përpara, bëj gjeste, i jap një shtytje, shkoj në majë të gishtave (2 raste), iki këmbadoras, hidhem me këmbë, largohem duke lëvizur këmbët), 19 raste të 7 llojeve të foljeve të trajektores (iki, hyj, ngjitem, dal, zhytem, kthehem, sorollatem), 2 folje të përgjithshme të lëvizjes (lëviz, zhvendosem) dhe 32 lloje të foljeve të mënyrës. Këto folje të

mënyrës përbëjnë 113 raste, dmth, 77,93% e përgjigjeve të pjesëmarrësve: *çaloj*, *drdhem*, *eci* (16), *fluturoj*, *fugoj* (3), *hidhem* (16), *ia mbath*, *kapërcej* (3), *lëkundem*, *ngas*, *ngrihem*, *notoj* (4), *nxitoj*, *pedaloj*, *përkulem*, *përkundem*, *përulem*, *rëshkas* (3), *rrotullohem*, *shëtis* (6), *shkallëzohet*, *shkas*, *shkoj* (7), *tërhiqem*, *udhëtoj* (3), *ulem*, *vallëzoj* (4), *vërdallosem*, *vrapoj* (17), *zvarritem* (5), *zvarritem* (6), *zhytem* (3).

‘Eci’:

17 pjesëmarrës shqipfolës renditën 82 njësi, nga të cilat 68 ishin folje të lëvizjes (82,93% e përgjigjeve të pjesëmarrësve, 26 lloje foljesh) dhe 14 njësi (17.07% e përgjigjeve të pjesëmarrësve, 8 lloje) ishin 1 folje jo të lëvizjes (*ngurroj*), 6 raste të 2 ndajfoljeve (*ngadalë*) dhe 7 raste të shprehjeve parafjalore (*këmbadoras*, *në këmbë*, *së prapthi* (2), *në majë të gishtave* (2), *në gjunjë*). Më tej, në kuadër të foljeve të lëvizjes, pjesëmarrësit renditën *eci* (3 raste), *lëviz*, 1 folje të lëvizjes që shpreh terren të papërcaktuar (*sorollatem* (2 raste), 1 folje të Trajektores (*kaloj*), 3 shprehje foljore komplekse (*me kërcime*, *poshtë e lart*, *tërheq këmbët zvarrë*) dhe 18 lloje foljesh të mënyrës. Foljet e mënyrës përbëjnë 57 raste (69.51% të përgjigjeve të pjesëmarrësve): *baris* (2), *çaloj*, *eci* (12), *endem* (7), *fugoj*, *gjezdis* (2), *hidhem* (2), *hidhem* (9), *kaloj*, *kërcej*, *pedaloj*, *rrëshkas*, *sprintoj* (2) *turrem* (4), *vërdallosem*, *vërtitem*, *vrapoj* (5), *zvarritem* (4).

‘Vrapoj’:

17 pjesëmarrës shqipfolës renditën 63 njësi, nga të cilat 45 ishin folje të lëvizjes (71.43% e përgjigjeve të pjesëmarrësve, 19 lloje foljesh) dhe 18 njësi (28.57% e përgjigjeve të pjesëmarrësve, 14 lloje) ishin 12 raste ndajfoljesh dhe mbiemrash (*i shpejtë* (3), *i ngadalë* (2), *ngadalë*, *avash*, *shumë ngadalë*, *tepër ngadalë*, *tepër shpejt* (2)) dhe 6 raste të shprehjeve parafjalore (*me hapa të shkurtër*, *me hapa të gjatë*, *me kërcime*, *me ndihmën e dikujt*, *me vrap*). Brenda foljeve të lëvizjes u renditën 4 shprehje foljore komplekse (*bëj vrap* (3), *shkoj me ngut*), folja e përgjithshme *lëviz*, folja *vrapoj* dhe 15 lloje foljesh të mënyrës. Këto folje të mënyrës përbëjnë 36 raste (57.14% e përgjigjeve të pjesëmarrësve): *eci* (3), *fugoj* (10), *hidhem* (2), *hidhem*, *ia mbath*, *kaloj*, *kapërcej*, *ngutem* (2), *nxitoj* (2), *sprintoj* (2), *shëtis*, *shkoj* (5), *shpejtoj* (3), *turrem*, *zvarritem*.

‘Hidhem’:

17 pjesëmarrësit shqipfolës renditën 68 njësi, nga të cilat 43 ishin folje (63,24% e përgjigjeve të pjesëmarrësve, 25 lloje foljesh) 25 njësitë e mbetura (36,76%, 25 lloje) ishin 2 shprehje

emërore, (me të dy këmbët, me kërcime të gjata), 13 raste ndajfoljesh dhe mbiemrash (i lartë, i ulët, i mirë, afër, pranë, i dobët, i fortë, i gjatë, larg, shumë, shumë poshtë, shumë i lartë, pak), 6 shprehje parafjalore që shprehin mënyrën (me litar, me një këmbë, me të dy këmbët, me hapa të gjatë, me kokë, me të shpejtë), dhe 4 shprehje parafjalore¹⁰ (me drejtim lart, drejt përpara, së prapthi, në një anë). Gjithashtu u renditën 6 shprehje foljore komplekse (të hapësh këmbët, të lëvizësh këmbët, ta bësh me rradhë, të bësh kërcime, të shtrish këmbët, të përkulësh këmbët), 3 folje të Trajektores (ngjitem, avitem, përparoj (2)), 2 folje të përgjithshme të lëvizjes (lëviz dhe zhvendosem), folja hidhem dhe 13 lloje foljesh të mënyrës (25 njësi, 36,76% e totalit të përgjigjeve). Foljet mënyrës që u renditën janë si vijon: çaloj, eci, fugoj, hidhem, kërcej (7), kërrusem (1), kthehem (2), ngulem (2), përkundem, rikthehem, rrotullohem (3), valëzoj (2), vrapoj (2).

Tabela 5.5 përmbledh përqindjen e foljeve të lëvizjes të renditura dhe njësive të tjera të renditura nga pjesëmarrësit për secilën gjuhë dhe kategori foljore. Për më tepër, aty tregohet edhe përqindja e përgjithshme e përgjigjeve për foljet e mënyrës.

ANGLISHT	%	SHQIP	%
MOVE		LËVIZ	
Njësi të tjera	9.68%	Njësi të tjera	1.38%
Folje të Lëvizjes	90.32%	Folje të Lëvizjes	98.62%
Folje të mënyrës	83.33%	Folje të mënyrës	77.93%
WALK		ECI	
Njësi të tjera	21.11%	Njësi të tjera	17.08%
Folje të Lëvizjes	78.89%	Folje të Lëvizjes	82.93%
Folje të mënyrës	69.56%	Folje të mënyrës	69.51%
RUN		VRAPAJ	
Njësi të tjera	53.85%	Njësi të tjera	28.57%
Folje të Lëvizjes	46.15%	Folje të Lëvizjes	71.43%
Folje të mënyrës	44.74%	Folje të mënyrës	57.15%
JUMP		HIDHEM	
Njësi të tjera	55.79%	Njësi të tjera	36.76%
Folje të Lëvizjes	44.21%	Folje të Lëvizjes	63.24%
Folje të mënyrës	37.89%	Folje të mënyrës	36.76%

Tabela 5.5. Shpërndarja e përgjithshme e njësive të renditura për secilën kategori foljore në anglisht dhe në shqip

Në përgjithësi, duke lëvizur poshtë në tabelë nga kategoria ‘Move’/‘Lëviz’ tek kategoria ‘Jump’/‘Hidhem’ mund të vihet re një rënie e përgjithshme në renditjen e foljeve të lëvizjes dhe, në veçanti, e foljeve të Mënyrës së lëvizjes. Në të dy gjuhët, pjesëmarrësit renditën përqindje më të lartë për foljet e lëvizjes dhe foljet e mënyrës në kategorinë ‘Move’/‘Lëviz’; megjithatë, kur iu kërkua të rendisin folje për kategoritë ‘Walk’/‘Eci’, ‘Run’/‘Vrapoj’ dhe ‘Jump’/‘Hidhem’, pjesëmarrësit ishin të prirur shumë më shpesh të rendisnin njësi të tjera (p.sh., folje jo të lëvizjes, ndajfolje, shprehje parafjalore).

Foljet prototip (foljet e renditura si njësi e parë)

Një nga pikësynimet kërkimore të këtij studimi ishte të gjendeshin foljet e lëvizjes që janë më prototipike për kategoritë ‘Move’/‘Lëviz’, ‘Walk’/‘Eci’, ‘Run’/‘Vrapoj’ dhe ‘Jump’/‘Hidhem’ në anglisht dhe në shqip. Siç u tha më herët, studimet kategorizuese (p.sh., Rosch, 1973, 1975) kanë treguar se pjesëmarrësit rendisin të parët shembujt më të mirë apo anëtarët prototipikë të një kategorie. Kështu, duke shqyrtuar foljet e lëvizjes të renditura si njësi e parë, mund të dallohen foljet prototipike për këto katër kategori.

Tabela 5.6 tregon të gjitha foljet e lëvizjes, por edhe njësitë e tjera leksikore (p.sh., foljet jo të lëvizjes, ndajfoljet), të cilat janë renditur si njësi e parë për secilën kategori foljore dhe për secilën gjuhë. Për më tepër, ajo tregon edhe numrin e rasteve apo dhe frekuencën si njësi e renditur e para ndër të gjithë pjesëmarrësit.

ANGLISHT			SHQIP		
Kategoria e foljes	#	%	Kategoria e foljes	#	%
MOVE	19	100%	LËVIZ	17	100%
walk	7	36.84%	eci	9	52.94%
jump	5	26.32%	hidhem	4	23.53%
run	4	21.05%	vrapoj	3	17.65%
bike	1	5.26%	shkoj	1	5.88%
dance	1	5.26%			
Të tjera:	1	5.26%			
quick					
WALK	15	100%	ECI	17	100%
stroll	3	20.00%	vrapoj	5	29.41%
move	3	20.00%	eci	3	17.65%
hop	2	13.33%	hidhem	2	11.76%
march	1	6.67%	shkoj	2	11.76%
strut	1	6.67%	endem	1	5.88%
walk	1	6.67%			
run	1	6.67%			
Të tjera:	3	20.00%	Të tjera:	4	23.53%
quick, fast, slow			hezitohet, ngadalë, shpejt, në këmbë		
RUN	15	100%	VRAPOJ	17	100%
jog	4	26.27%	turrem	7	41.18%
walk	2	13.33%	hidhem	2	11.76%
gallop	1	6.67%	fugoj	1	5.88%
move	1	6.67%	eci	1	5.88%
race	1	6.67%	nxitoj	1	5.88%
			shpejtoj	1	5.88%
			rend	1	5.88%
			zvarritem	1	5.88%
Të tjera	6	40%	Të tjera	2	11.76%
fast (3), quicky (2)			shpejt, me kërcime		
JUMP	15	100%	HIDHEM	17	100%
hop	3	20.00%	hidhem	5	29.41%
skip	2	13.33%	hidhem	3	17.65%
leap	2	13.33%	vrapoj	2	11.76%
rise	1	6.67%	shtyj	2	11.76%
jump	1	6.67%	lëkundem	1	5.88%
Të tjera	6	40.00%	Të tjera	4	23.53%
			duke kërcyer me një këmbë shumë, lart, kërcim i gjatë		

**Tabela 5.6. Foljet e lëvizjes dhe satelitët e renditur si njësi e parë
(sipas kategorisë dhe gjuhës)**

Move / Lëviz

Për këtë kategori, si pjesëmarrësit anglishtfolës ashtu edhe ata shqipfolës renditën *walk-eci*, *jump-hidhem*, dhe *run-vrapoj* si njësitë e para më të shpeshta. Çuditërisht, pjesëmarrësit renditën si njësi e parë më shpesh *jump-hidhem* (anglisht: 26.32%; shqip: 23.53%) se sa *run-vrapoj* (anglisht, 22.22%, shqip, 17.65%). Në anglisht, pjesëmarrësit renditën si njësi të para foljen *dance/vallëzoj* dhe një emër mjete (bike), gjë që përputhet mirë me vëzhgimet tona për përdorimin pjellor të emrave të mjeteve dhe emrave të vallëzimeve si folje të lëvizjes në këtë gjuhë.

Walk / Eci

Në të dy gjuhët, pjesëmarrësit renditën si njësi të para *run/vrapoj*, *hop* dhe *jump/hidhem*; për më tepër, ata madje renditën edhe të njëjtën folje për të cilën ishin pyetur. Mbi të gjitha, foljet më të shpeshta si njësi të para ishin *run* dhe *stroll* për anglishten dhe *vrapoj* dhe *eci* për shqipen. Përveç këtyre foljeve, pjesëmarrësit anglishtfolës renditën tre folje të hollësive të mënyrës, dmth, *stroll* ('Lëvizje e ngeshme', 'Gjendja e Figurës - e relaksuar'), *march* ('Përdorim karakteristik i pjesës së poshtme të trupit - hapa të rregullt') dhe *strut* (Gjendja e Figurës-krenare), dhe pjesëmarrësit shqipfolës renditën '*shkoj*' (larg nga Terreni) dhe '*endem*' (Lëvizje e ngeshme).

Run / Vrapoj

Siç e kemi parë me kategoritë e mëparshme, pjesëmarrësit renditën folje që nuk konsiderohen mënyra të të vrapuarit; pjesëmarrësit anglishtfolës renditën *walk* dhe *move* ndërsa pjesëmarrësit shqipfolës renditën *hidhem* dhe *eci*. Gjithashtu, ata renditën folje më specifike të mënyrës: *jog* ('Ritëm i ngadalshëm dhe i rregullt'), *gallop* ('Ritëm i shpejtë') dhe *race* ('Ritëm i shpejtë') për gjuhën angleze, dhe për gjuhën shqipe foljet *nxitoj*, *rend* (Ritëm e shpejtë) dhe *shpejtoj* ('Ritëm i shpejtë në rritje'). Vetëm një pjesëmarrës shqipfolës ka renditur edhe foljen për të cilën është pyetur.

Jump / Hidhem

Edhe një herë, pjesëmarrësit u përgjigjën si njësi e parë me të njëjtën folje për të cilin ishin pyetur. Përveç kësaj, pjesëmarrësit shqipfolës renditën *vrapoj* si mënyrë të hedhuri, dhe një pjesëmarrës anglishtfolës renditi foljen *rise* ('Orientim me tokën: lart') si mënyrë të hedhuri. Krahas këtyre foljeve, në anglisht, pjesëmarrësit renditën më shpesh si njësi të parë foljet e mëposhtme: *hop* ('Përdorim karakteristik i pjesës së poshtme të trupit: me dy këmbë

për kafshët dhe me një këmbë për njerëzit'), *skip* ('Përdorim karakteristik i pjesës së poshtme të trupit: një kërcim pas çdo hapi'), dhe *leap* ('Përdorim karakteristik i pjesës së poshtme të trupit: një kërcim i gjatë, i lartë'); në shqip, pjesëmarrësit renditën *hidhem* si njësia e parë më e shpeshtë, por edhe foljen *shtyj* 'e lëviz diçka a e zhvendos më tutje' dhe *lëkundem* (Lëvizje e paqëndrueshme).

Leksikët e foljeve të mënyrës së lëvizjes

Tani që dimë cilat janë foljet më prototipike për të katër kategoritë e lëvizjes, le të vazhdojmë raportimin për analizën e subjekteve dhe njësive, e cila ka për qëllim t'u japë përgjigje pyetjeve të këtij studimi. Siç u tha edhe në hyrje, pyetjet janë si më poshtë: (1) *A do të rendisin anglishtfolësit më shumë folje të mënyrës së lëvizjes për të gjitha kategoritë foljore se shqipfolësit?* (2) *A do të përmbajë kategoria 'Move'/'Lëviz' shumëllojshmëri më të madhe të mënyrës në të dy gjuhët?* dhe (3) *A dotë jetë kategoria 'Walk'/'Eci' më e pasur se kategoritë 'Run'/'Vrapoj' ose 'Jump'/'Hidhem' në të dy gjuhët?*

Kujtoni se për pjesëmarrësit ishte e zakonshme të rendisnin ndajfolje, satelitë dhe folje të tjera të lëvizjes. Disa prej tyre nuk renditën asnjë folje të mënyrës; i tillë ishte rasti i 14 pjesëmarrësve anglishtfolës (2 për 'Walk', 6 për 'Run' dhe 6 për 'Jump'), dhe i 4 pjesëmarrësve shqipfolës (1 për 'Vrapoj' dhe 3 për 'Hidhem'). Duhet theksuar se analizat që pasojnë përqendrohen vetëm tek foljet e mënyrës së lëvizjes; në këto analiza nuk janë përfshirë foljet e lëvizjes së përgjithshme, foljet e trajektores dhe shprehjet foljore komplekse. Për më tepër, kur pjesëmarrësit janë përgjigjur me të njëjtën folje mbizotëruese për të cilën ishin pyetur, folja nuk është llogaritur në këto analiza.

Analiza e njësive

Në lidhje me llojet e foljeve të mënyrës, në të dy gjuhët kategoria 'Move'/'Lëviz' përfshin shumëllojshmëri më të madhe foljesh të mënyrës, e ndjekur nga 'Walk'/'Eci', pastaj nga 'Run'/'Vrapoj' dhe në fund 'Jump'/'Hidhem'. Për më tepër, ka pasur një dallim të vogël në numrin e llojeve të foljeve të mënyrës të renditura nga pjesëmarrësit shqipfolës dhe anglishtfolës. Një numër më i madh llojesh të foljeve të mënyrës u renditën në anglisht për kategoritë Move/Lëviz (anglisht = 53; shqip = 32) dhe Walk/Eci (anglisht = 34; shqip = 18), ndërsa më shumë lloje foljesh të mënyrës u renditën në shqip për kategorinë Run/Vrapoj (anglisht = 11; shqip = 15) dhe Jump/Hidhem (anglisht = 9; shqip = 13).

Në këtë analizë, janë përfshirë të gjitha foljet e mënyrës të renditura nga

pjesëmarrësit (shih Shtojca 4 për listën e foljeve të mënyrës për secilën gjuhë dhe kategori). Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të përgjigjeve të pjesëmarrësve për Run/Vrapoj dhe Jump/Hidhem, vërejtëm se ata renditën disa folje të mënyrës të cilat në analizën e korpusit tonë nuk kodohen si folje të të vrapuarit apo të të hedhurit. Duke e kufizuar analizën tonë vetëm tek ato folje, që sipas fjalorëve janë folje të të vrapuarit dhe folje të të hedhurit, sërish konstatuam se (a) në të dy gjuhët ishin renditur një shumëllojshmëri më e madhe foljesh të të vrapuarit se foljesh të të hedhurit, dhe se (b) foljet e të vrapuarit në shqip i tejkalojnë ato të anglishtes. Megjithatë, një model pak më i ndryshëm u vu re tek foljet e të hedhurit; përkatësisht, foljet e të hedhurit në anglisht i tejkalojnë ato të shqipes. Së fundi, duhet nënvizuar se kjo analizë është më shumë një produkt i përkufizimeve të fjalorëve se i konceptualizimeve të folësve.

5.3.4. Diskutim dhe përfundime

Në tërësi, është vërejtur se, krahas foljeve të lëvizjes, pjesëmarrësit shpesh kanë renditur edhe ndajfolje, satelitë, shprehje emërore dhe shprehje parafjalore, sidomos kur janë përgjigjur për mënyrat si njerëzit ecin, vrapojnë dhe hidhen. Është konstatuar një rënie e përgjithshme në listën e foljeve të lëvizjes dhe, në veçanti, i foljeve të mënyrës së lëvizjes nga kategoria ‘Move’/‘Lëviz’ tek kategoria ‘Jump’/‘Hidhem’. Në përgjithësi, në kategorinë ‘Move’/‘Lëviz’ pjesëmarrësit anglishtfolës dhe shqipfolës kanë renditur një numër më të madh foljesh të lëvizjes dhe foljesh të mënyrës; megjithatë, numri i foljeve të lëvizjes dhe foljeve të mënyrës bie në kategorinë ‘Walk’/‘Eci’, zbret më tej në kategorinë ‘Run’/‘Vrapoj’ dhe akoma më shumë në kategorinë ‘Jump’/‘Hidhem’. Rënia e numrit të foljeve të lëvizjes shoqërohet me një rritje të numrit të njësive të tjera të renditura.

Një synim dytësor i këtij studimi ishte të gjendeshin foljet prototipike të lëvizjes për secilën nga kategoritë. Në rastin e ‘Move’/‘Lëviz’, i njëjti model është gjetur në të dyja gjuhët: *Walk/Eci* ishin njësitë e para të renditura më shpesh, të ndjekura nga *Jump/Hidhem* dhe *Run/Vrapoj*. Për gjuhën angleze, *bike* dhe *dance* duket se janë folje prototipike edhe për këtë kategori; kjo sugjeron që foljet e mjeteve dhe foljet e vallëzimit shumë mirë mund të bëjnë pjesë në kategorinë mbizotëruese ‘Move’/‘Lëviz’. Në lidhje me tre kategoritë e modelit motor, prirja ishte që në përgjigjet e tyre të dilnin të tre foljet të cilat emërtojnë kategoritë; me fjalë të tjera, pjesëmarrësit renditën si njësi të parë të njëjtën folje për të cilën po pyeteshin (p.sh., *walk/eci* kur u pyetën për mënyrat e të ecurit). Gjithashtu, është vërejtur se brenda secilës kategori të modelit motor ndonjëherë janë renditur edhe dy foljet e

modeleve të tjera motore; p.sh., për kategorinë ‘Walk’/‘Eci’ në anglisht dhe në shqip, dy foljet që më shpesh u renditën të parat ishin *run* dhe *vrapoj*, gjë që tregon se pjesëmarrësit nuk i konsideronin këto dy veprime (të ecurin dhe të vrapuarin) si dy ngjarje të veçuara të lëvizjes.

Sa i përket modeleve motore “Run/Vrapoj” dhe ‘Jump’/‘Hidhem’, disa folje të tjera ishin shembujt më të mirë të këtyre kategorive: *jog* për ‘Run’/‘Vrapoj’; *hop* për ‘Jump’/‘Hidhem’. Folje të tjera të renditura si njësi e parë, dmth, si shembuj të mirë të tre kategoritve të modelit motor, janë foljet në vijim: për anglishten *stroll*, *march* dhe *strut* dhe për shqipen ‘*shkoj*’ (larg nga Terreni) dhe ‘*endem*’ (Lëvizje e ngeshme) për modelin motor ‘Walk’/‘Eci’; *gallop*, *race* në anglisht dhe foljet *nxitoj*, *rend* e *shpejtoj* në shqip për ‘Run’/‘Vrapoj’; anglisht: *skip*, *leap*, *rise* dhe shqip: *shtyj* e *lëkundem* për ‘Jump’/‘Hidhem’. Një e metë e këtij studimi është numri i kufizuar i pjesëmarrësve për secilën kategori foljore, gjë që rezulton në një numër të kufizuar foljesh të lëvizjes si njësi të para. Do të nevojitej një kampion shumë më i madh pjesëmarrësish për të mësuar më shumë folje prototipike për këto kategori dhe për të kuptuar nëse foljet e gjetura në këtë studim janë vertetë foljet prototipike për këto kategori në të dy gjuhët.

Lidhur me parashikimet tona për dallimet sasiore në organizimin e leksikut të foljeve të mënyrës, rezultatet tona mbështesin pjesërisht parashikimin tonë të parë, i cili parashtronte se për secilën kategori anglishtfolësit do të rendisnin më shumë folje të mënyrës se sa pjesëmarrësit shqipfolës. Konstatohet se pjesëmarrësit anglishtfolës kanë renditur më shumë folje të mënyrës se sa pjesëmarrësit shqipfolës vetëm për dy prej katër kategorive, më konkretisht, për ‘Move’/‘Lëviz’ dhe ‘Walk’/‘Eci’. Ndryshe nga parashikimi, në shqip u renditën më shumë folje të mënyrës për kategorinë ‘Run’/‘Vrapoj’ dhe ‘Jump’/‘Hidhem’ se sa në anglisht. Një shpjegim i mundshëm për këtë mund të kërkohej në faktin se më shumë se gjysma e përgjigjeve në anglisht për kategoritë ‘Run’/‘Vrapoj’ dhe ‘Jump’/‘Hidhem’ ishin njësi të tjera (p.sh., folje jo të lëvizjes, me një total prej 53.85% për ‘Run’/‘Vrapoj’ dhe 55,79% për ‘Jump’/‘Hidhem’), ndërsa përqindja e foljeve të lëvizjes të renditura në shqip për kategoritë “Run/Vrapoj” dhe ‘Jump’/‘Hidhem’ i tejkalon ato të njësive të tjera. Kjo mund të tregojë ose që (a) për shkak të afatit kohor prej një minute për këtë detyrë, pjesëmarrësit anglishtfolës mund të kenë qenë më të shqetësuar për të dhënë *çfarëdo* përgjigje (b) ata mund ta kenë pasur të vështirë të evidentojnë leksikun e foljeve të mënyrës për këto dy kategori, (të cilat janë më pak qendrore për përvojën njerëzore sesa ‘Walk’/‘Eci’) ose (c) të dyja, pra, për shkak të kufizimit kohor, ata mund ta kenë pasur të vështirë të evidentojnë leksikun e foljeve të mënyrës për këto dy kategori dhe prandaj u janë drejtuar njësive të tjera.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit anglishtfolës kanë renditur njësi të tjera për secilën kategori shumë më shpesh se pjesëmarrësit shqipfolës, gjë që mund të tregojë se pjesëmarrësit anglishtfolës nuk i kanë ndjekur me vëmendje udhëzimet e dhëna.

Për më tepër, ishte parashikuar që, në të dy gjuhët, pjesëmarrësit do të rendisnin më shumë folje të mënyrës për kategorinë “Move/Lëviz” se për tre kategoritë e tjera, dhe që, brenda kategorive të modelit motor, ata do të rendisnin një numër më të madh foljesh të mënyrës për kategorinë ‘Walk’/‘Eci’ se sa për ‘Run’/‘Vrapoj’ dhe ‘Jump’/‘Hidhem’. Këto dy parashikime tashmë janë vërtetuar. *Move* dhe *Lëviz* si folje mbizotëruese të *walk*, *run*, *jump*, dhe *eci*, *vrapoj*, *hidhem*, kanë dhënë një shumëllojshmëri foljesh të mënyrës ndjeshëm më të lartë në të dy grupet gjuhësore dhe një numër më të madh rastesh të foljeve të mënyrës. Gjithashtu, në përputhje me parashikimet tona, *walk/eci* ka gjeneruar më shumë folje të mënyrës se dy modelet e tjera motore më pak bazike. Edhe pse nuk kishte ndonjë parashikim për dallimet në numrin e foljeve të mënyrës për kategoritë ‘Run’/‘Vrapoj’ dhe ‘Jump’/‘Hidhem’, rezultatet tona tregojnë se, për të dy grupet gjuhësore, kategoria ‘Run’/‘Vrapoj’ paraqet një shumëllojshmëri më të madhe foljesh të mënyrës se sa kategoria ‘Jump’/‘Hidhem’ (shih Shtojcën 4 për një listë të plotë të këtyre foljeve në rend alfabetik).

Për ta përmbledhur, ky studim sjell prova eksperimentale për pretendimin se anglishtja dhe shqipja e organizojnë leksikun e tyre të foljeve të lëvizjes së njeriut në të njëjtën mënyrë. Pavarësisht nga dallimet sasiore në numrin e foljeve të mënyrës në leksikët e tyre, të dy gjuhët kanë më shumë folje të mënyrës që specifikojnë mënyra të ndryshme të të ecurit se sa mënyra të të vrapuarit e të të hedhurit.

5.4. Përfundime

Ky kapitull ka paraqitur dy studime eksperimentale për foljet e lëvizjes së njeriut në anglisht dhe shqip. Siç argumentohet në Hyrje, analiza semantike e kryer në Kapitullin 4 nuk shpreh përfaqësimet mendore të folësve për foljet e lëvizjes. Megjithatë, kjo analizë hedh themelet të forta aq të nevojshme për të filluar studimet eksperimentale në fushën e lëvizjes.

Studimi i parë (Detyra e Përkufizimit dhe Renditjes së Veçorive) ofron njohuri të para mbi përfaqësimet e folësve amtarë për disa folje themelore të lëvizjes në anglisht dhe shqip, përkatësisht, *move/lëviz*, *walk/eci*, *run/vrapoj* dhe *jump/hidhem*. Në përgjithësi, *move* dhe *lëviz* janë përcaktuar si folje të lëvizjes të cilat tregojnë si lëvizje zhvendosëse ashtu edhe lëvizje të brendshme; *walk* dhe *eci* si modeli motor më themelor i njeriut për të ndryshuar vendndodhjen; *run* dhe *vrapoj* si folje të lëvizjes zhvendosëse që karakterizohen nga një

mënyrë e shpejtë lëvizjeje duke përdorur këmbët; dhe, *jump* e *hidhem* si folje të lëvizjes të përcaktuara nga shtytja që bën Figura nga terreni.

Studimi i dytë (Detyra e Renditjes së Lirë të Foljeve) jep dëshmitë e para eksperimentale të disa vëzhgimeve që rezultojnë nga analiza jonë semantike. U konstatua se anglishtja dhe shqipja e organizojnë leksikun e tyre të foljeve të lëvizjes së njeriut në mënyra të ngjashme, dmth, të dy gjuhët kanë një numër më të madh foljesh të të ecurit krahasuar me foljet e të vrapuarit dhe të hedhurit, siç tregohet nga numri më i madh i foljeve të mënyrës të renditura për *walk* dhe *eci*.

Në tërësi, gjetjet tona shpjegohen me faktin se të ecurit është mënyra e parazgjedhur e lëvizjes për njerëzit; ajo është një veprimtari e përditshme më themelore se të vrapuarit dhe të hedhurit. Në ditët e sotme njerëzit mund të vrapojnë për të kapur autobuzin apo trenin, apo të hidhen mbi një pengesë, por më shpesh ato ecin nga njëri vend në tjetrin. Prandaj, siç thuhet edhe në Kapitullin 5, mund të supozojmë se gjuhët në përgjithësi kanë më shumë gjasa të zotërojnë një leksik më të gjerë foljesh të mënyrës për veprimtarinë e të ecurit se sa për të vrapuarit apo për të hedhurit. Për më tepër, ky pretendim mund të shtrihet përtej foljeve të mënyrës edhe në njësi të tjera gjuhësore të cilat gjithashtu mund të përcjellin informacion për mënyrën e lëvizjes.

Në përfundim, ky kapitull paraqet përpjekjet tona të para për të eksploruar leksikun e foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip nga një këndvështrim psikogjuhësor. Një disertacion nuk do të mjaftonte për të zbuluar semantikën e të gjitha foljeve të lëvizjes të përfshira në korpusin tonë, ose për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve që dolën nga analiza semantike. Studimi eksperimental i raportuar këtu, sidoqoftë, besojmë se ka trajtuar në mënyrë të kënaqshme një nënfushë të rëndësishme të lëvizjes, atë të lëvizjes së njeriut. Ai ka ofruar të dhëna interesante nga pjesëmarrësit në studim për mënyrat si anglishtja dhe shqipja e organizojnë leksikun e tyre si edhe për natyrën komplekse semantike të foljeve të lëvizjes së njeriut.

KAPITULLI VI

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

6.1. Përfundimet kryesore të studimit

6.2. Drejtimet e mundshme kërkimore për të ardhmen

6.3. Kontribute

6.1. Përfundimet kryesore të studimit

Puna e përshkruar në këtë disertacion përqendrohet kryesisht tek semantika e foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip nga një këndvështrim krahasues, duka u bazuar në teorinë e Talmy për modelet leksikalizuese në fushën e lëvizjes (Kapitulli 2). Talmy ishte një nga pionierët e gjuhësisë njohëse, e cila lindi si reagim ndaj përqasjeve formale të gjuhës.

Gjatë tre dekadave të fundit vepra e Talmy ka nxitur studime dhe debate të shumta në literaturën për përshkrimet e ngjarjeve të lëvizjes (Kapitulli 3). Studimet gjuhësore mbi shprehjen e lëvizjes kanë dokumentuar mënyrat e zakonshme të të folurit dhe të shkruarit në lidhje me lëvizjen të cilat kanë shërbyer si bazë për studime të mëtejshme mbi mënyrat se si fëmijët i fitojnë këto modele semantike specifike të gjuhës, mbi ndikimet e këtyre modeleve në përpunimin e gjuhës, dhe mbi faktin nëse këto ndikime kanë luajtur rol në njohjen jogjuhësore. Megjithë numrin e madh, studimet mbi ngjarjet e lëvizjes shpesh e kanë anashkaluar faktin, se krahas Trajektores së lëvizjes dhe Mënyrës së lëvizjes, foljet e lëvizjes mund të shprehin edhe lloje të tjera informacioni semantik dhe se mund të ndodhin edhe modele të tjera leksikalizuese më të vogla. Për më tepër, studiuesit shpesh kanë lënë pas dore studimin e foljeve të trajektores dhe janë përqëndruar më shumë tek foljet e mënyrës, pasi shprehja e mënyrës deri tani ka qenë pika më interesante dalluese midis gjuhëve me kornizë satelitore dhe atyre me kornizë foljore. Së Fundi, pothuajse asnjë studim nuk ka bërë një analizë të thellë semantike të leksikut të foljeve të lëvizjes në gjuhët me kornizë satelitore dhe foljore përveç atyre foljeve të lëvizjes që janë gjetur në romane apo që janë mbledhur gojarisht (p.sh., Jovanovic & Martinović-Zic, 2005; Özçalışkan, 2004; Slobin, 2005).

Studimet e foljeve të lëvizjes me prejardhje të ndryshme teorike (Kapitulli 4, Seksionet 4.2, 4.3. dhe 4.4) kanë sjellë të dhëna të vlefshme rreth natyrës sintaksore dhe semantike të foljeve të lëvizjes. Prirja e përgjithshme në këto klasifikime ka qenë ndarja e foljeve të trajektores nga foljet e mënyrës. Foljet e trajektores shpesh janë ndarë në klasa sipas trajektoreve që përshkruajnë apo sipas arritjes ose jo të pikës fundore. Foljet e mënyrës janë grupuar në dy klasa, përkatësisht, foljet e lëvizjes zhvendosëse dhe foljet e lëvizjes së brendshme, megjithëse janë dhënë edhe klasifikime sipas kategorive më të imta të mënyrës që rezultojnë nga studimet për fushën e lëvizjes.

Ky disertacion kishte për qëllim të kontribuonte në studimet ndërgjuhësore të ngjarjeve të lëvizjes duke analizuar një pjesë të konsiderueshme të leksikut të foljeve të lëvizjes në anglisht dhe shqip. Vëmendje e veçantë i është kushtuar llojeve të kombinimeve të cilat mund të gjenden në këto folje të lëvizjes krahas nocioneve të trajektores dhe

informacionit më të hollësishëm mënyror që përcjellin foljet e lëvizjes në këto dy gjuhë. Në këtë disertacion kemi zbatuar qasjen e analizës zbërthyesë për semantikën e foljeve të lëvizjes, e cila ka mundësuar zbulimin e dallimeve dhe ngjashmërive ndërgjuhësore midis dy gjuhëve. Ky kuadër fillon me përbërësit e përgjithshëm të ngjarjes së lëvizjes të identifikuar nga Talmy, por përfshin edhe një listë me llojet e trajektores si edhe një listë me parametrat e mënyrës që lejojnë një analizë më të hollësishme të semantikës së foljeve të lëvizjes. Gjithashtu, ky disertacion ndërmerr edhe një eksplorim të foljeve të lëvizjes së njeriut duke përdorur metoda sasiore dhe eksperimentale (Kapitulli 5), duke përfshirë një studim për përkufizimin dhe renditjen e veçorive të foljeve dhe një studim për renditjen e lirë të foljeve të lëvizjes së njeriut. Këto dy studime kanë sjellë të dhëna interesante për mënyrën si anglishtja dhe shqipja organizojnë leksikët e tyre dhe për semantikën komplekse të foljeve të lëvizjes së njeriut; për më tepër, ato kanë dhënë mbështetje eksperimentale për disa nga gjetjet e analizës gjuhësore.

Krahasimi midis dy gjuhëve ka çuar në identifikimin e disa prirjeve apo ngjashmërive: (a) kombinimi i Lëvizjes plus një përbërës semantik shtesë, Mënyrë ose Trajektores është modeli leksikalizues më karakteristik i leksikut të foljeve të lëvizjes në të dy gjuhët; (b) të dy gjuhët kanë folje të Trajektores që shprehin të paktën 13 lloje të ndryshme të trajektores; midis tyre, llojet e trajektores që leksikalizohen më shpesh në të dy gjuhët janë ‘Larg nga Terreni’, ‘Poshtë / poshtë nga Terreni – Tatëpjetë’, ‘Për tek / drejt Terrenit’ dhe ‘Përmbi/mbi Terren – Përpjetë’, ndërsa lloji më i rrallë është ‘Jashtë nga Terreni’ (c) të dy gjuhët zotërojnë më shumë folje të të ecurit se sa folje të të vrapuarit dhe të hedhurit. Këto tendenca tregojnë se ka ngjashmëri të rëndësishme në mënyrën se si anglishtja dhe shqipja, dhe mbase edhe gjuhë të tjera me kornizë satelitore dhe foljore, e leksikalizojnë fushën e lëvizjes në foljet e tyre. Gjithashtu, janë vërejtur edhe dallime ndërgjuhësore: (a) Foljet e mënyrës së lëvizjes në anglisht i tejkalojnë ato të shqipes dhe priren të shfrytëzojnë disa parametra mënyrorë më shpesh se foljet e mënyrës në shqip (p.sh., informacion mënyror për gjendjen mendore dhe fizike të Figurës dhe hollësi për mënyrën si Figura lëviz këmbët duke ecur, për lëvizjen duke përdorur mjete dhe lëvizjen gjatë vallëzimit), dhe (b) foljet e trajektores në shqip i kalojnë në numër ato të anglishtes, megjithëse të dy gjuhët janë në gjendje të shprehin lloje të ngjashme trajektoreje.

6.2. Drejtimet e mundshme kërkimore për të ardhmen

Në të ardhmen, ne synojmë të vazhdojmë me shqyrtimin e semantikës së foljeve të

lëvizjes duke përdorur metodat eksperimentale. Analiza semantike e bërë në Kapitullin 5 ka ngritur çështjen nëse foljet e lëvizjes kanë atë kuptim që thonë fjalorët. Me fjalë të tjera, përfaqësimet semantike për foljet e lëvizjes në anglisht dhe shqip që kanë rezultuar nga analiza jonë kërkojnë një vlerësim psikogjuhësor.

Për më tepër, kemi hasur disa raste konfliktuale dhe disa probleme të cilat duhet të trajtohen në studimet e ardhshme. Së pari, grupi i foljeve të cilat shprehin Lëvizje+Trajektore+Mënyrë është një nga më interesantët për kërkime të mëtejshme. Ne kemi argumentuar se për shumë folje nuk është e qartë (p.sh., *dive*, *plummet*, *plunge* dhe *zhytem*, *ngulem*) nëse ato shprehin edhe Trajektoren edhe Mënyrën (krahas Lëvizjes), apo nëse ato shprehin vetëm Mënyrën dhe Trajektorja thjesht nënkuptohet (dmth., këto folje zakonisht ndodhin me trajektore të caktuara). Studimet me detyra emërtuese dhe detyra tipizuese mund të ndihmojnë për zbulimin e natyrës semantike të këtij grupi foljesh. Për shembull, a do të emërtohej një ngjarje e lëvizjes nga folja *dive/zhytem* apo a do të gjykohej ajo ngjarje si tipike e *diving/të zhyrurit* nëse (a) Figura nuk lëviz në mënyrë të shpejtë dhe shumë energjike? ose (b) nëse Figura nuk ndjek një trajektore me drejtim poshtë? Së dyti, Një grup tjetër foljesh që mund të studiohen duke përdorur të njëjtën metodë është grupi i foljeve të anglishtes *hound*, *pursue* dhe *shadow*, *ndjek*, *gjurmoj* dhe *gjëmoj*: këto folje, krahas Trajektores së lëvizjes, mund të shprehin edhe informacion për Mënyrën e lëvizjes. Në këtë disertacion këto folje janë klasifikuar si folje të trajektores (dmth. lloji i trajektores ‘Pas Terrenit’), por *hound* duket se thekson që Figura ndjek pandërprerë një Figurë të dytë, *pursue* duket se shpesh nënkupton që ndjekësi synon ta kapë ose ta vrasë një Figurë të dytë dhe *shadow*, *gjurmoj* dhe *ndjek* duket se nënkuptojnë lëvizje të fshehtë, ndërsa folja *gjëmoj* duketse nënkupton ndjekje me ritëm të shpejtë. Së treti, kur eksploruam foljet e mjeteve në anglisht vërejtëm se fjalorët jo gjithmonë pajtohen se këto folje lejojnë edhe përdorime veprare, me përjashtim të dy grupeve të mëposhtme të foljeve të mjeteve: (a) *bus*, *ferry*, *parachute*, *ship*, *shuttle* dhe *truck*, të cilat duket se lejojnë përdorimin vepror, dhe (b) *bobsleigh*, *bobsled*, *cab*, *dogsled*, *gondola/e*, *jeep*, *kayak*, *motorcycle/bike*, *rickshaw*, *rollerblade*, *skate*, *skateboard*, *ski* dhe *yacht*, të cilat duken se tregojnë vetëm që Figura përdor këto mjete ose instrumente për të lëvizur. Nevojiten kërkime të mëtejshme për të testuar hipotezën se mjetet e mëdha (p.sh., grupi parë) mund të lejojnë edhe lëvizje veprare edhe lëvizje të brendshme, pasi ato mund të transportojnë njerëz, mallra, etj., kurse mjetet e vogla (p.sh., grupi i fundit) mund të përdoren nga Figura vetëm si mjete për lëvizjen e vet. Së fundi, është vërejtur se kufiri midis lëvizjes zhvendosëse dhe lëvizjes së brendshme është i paqartë, sidomos për disa kategori të mënyrës të tilla si ‘Lëvizja e paqëndrueshme’. Kjo

mund të ndodhë sepse (a) një folje shpreh natyrshëm një lloj të veçantë lëvizjeje (b) kuptimi rrjedh nga një kornizë e caktuar sintaksore si në rastin e kornizës së lëvizjes zhvendosëse në anglisht (dmth, folje e mënyrës+satelit i trajektore).

Mund të nevojitet një tjetër drejtim kërkimor për të hedhur dritë mbi peshën semantike të parametrave mënyrorë që përbëjnë kuptimin e një foljeje. Kur grupuam foljet e lëvizjes në kategori të mënyrës, u shtrua pyetja nëse disa veçori të mënyrës janë më të rëndësishme se të tjerat për përkufizimin e një foljeje apo të gjitha kategoritë e mënyrës janë të barazvlefshme. Për ilustrim, *roar*, *whiz* dhe *zoom* përmbajnë informacion për shpejtësinë e lëvizjes dhe për zhurmën që shkaktohet nga lëvizja. Kështu, a kategorizohen ngjarjet e përshkruara nga këto folje më mirë si (a) veprimtari të zhurmshme, (b) si veprimtari me shpejtësi të madhe, apo (c) të dyja?

Së fundi, për studimin ndërgjuhësor do të ishte me vlerë të testohej nëse prirjet e përshkruara më lart për anglishten dhe shqipen vlejnë edhe për gjuhë të tjera me kornizë satelitore dhe foljore. Në mënyrë të veçantë, (a) a kanë gjuhët ndonjë preferencë për të leksikalizuar disa lloje trajektoreje ndaj disa të tjerave dhe (b) a kanë gjuhët një numër më të madh foljesh që përshkruajnë mënyra të ndryshme për të ecurit e Figurës se foljet që përshkruajnë mënyra të të vrapuarit dhe të hedhurit?

6.3. Kontribute

Ky disertacion mund të kontribuojë në tre fusha kryesore të veçanta: (1) për kërkime të mëtejshme në fushën e studimit të shprehjes së lëvizjes ndër gjuhë, (2) për mësimin e gjuhës dhe (3) për përkthim.

Së pari, studiuesit që lëvrojnë fushën e lëvizjes mund të përfitojnë në disa mënyra. Përjasja e paraqitur në këtë disertacion mund të shtrihet në studimin e leksikut të foljeve të lëvizjes të gjuhëve të tjera me kornizë satelitore dhe foljore si edhe në studimin e njërive të tjera gjuhësore të cilat gjithashtu mund të shprehin informacion për trajektoren dhe/ose mënyrën, të tilla si satelitët, pjesëzat foljore, etj. Për më tepër, kjo fushë kërkimore do të përfitonte nga kuptimi më i mirë i semantikës së foljeve të lëvizjes në anglisht e shqip dhe nga prirjet e përgjithshme të vërejtura në dy gjuhët e trajtuara nga ky disertacion. Shumë studime psikogjuhësore të lëvizjes, duke përfshirë edhe ato që lidhen me relativizmin gjuhësor, zënë fill nga të dhëna gjuhësore të cilat jo gjithmonë janë konfirmuar si të vlefshme. Studime si ky ofrojnë një themel më të fortë për kërkime të mëtejshme

psikogjuhesore.

Së dyti, përfaqësimet semantike të foljeve të lëvizjes të propozuara në këtë disertacion mund të gjejnë zbatime të dobishme për mësimdhënien e gjuhës angleze si gjuhë e dytë, në veçanti, për mësimdhënien e gjuhës angleze për folësit e gjuhës shqipe. Studentët e anglishtes e kanë të vështirë të mësojnë dhe zotërojnë masën e madhe të foljeve të mënyrës në anglisht. Nëse foljet e mënyrës u paraqiten studentëve në kategori dhe pastaj hulumtohen sipas informacionit mënyror shtesë që ato mbartin, studentët do ta kenë më të lehtë për të kuptuar semantikën e tyre.

Së fundi, ky disertacion mund t'i shërbejë edhe fushës së përkthimit pasi aty zbulohet dhe krahasohet natyra komplekse semantike e një numri të madh foljesh të lëvizjes në anglisht dhe shqip. Bazuar në këtë krahasim, përkthyesit mund të zgjedhin foljen më semantikisht të barasvlefshme nëse konteksti i ligjëritimit e lejon përdorimin e saj, ose mund ta përcjellin foljen e lëvizjes me mjete të tjera gjuhësore në mënyrë që të jenë sa më besnikë ndaj origjinalit, ndërkohë që tingëllojnë të natyrshëm në gjuhën e përkthyer.

REFERENCA

- Battig, W. & Montague, W. (1969). Category norms for verbal items in 56 categories: A replication and extension of the Conneticut category norms. *Journal of Experimental Psychology*. (Monograph).
- Berman, R. & Slobin, D. I. (1994). *Relating events in narrative: A crosslinguistic developmental study*. Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates.
- Berthele, R. (2004). The typology of motion and posture verbs: a varitionist account: In B. Kortmann (Ed.), *Dialectology meets Typology. Dialect Grammar from a Cross-linguistic Perspective*. Berlin/New York, pp. 93- 126.
- Boas, F. (1938). Language. In F. Boas, *General anthropology*. New York: Heath, pp. 124-145.
- Boas, F. (1966). *Handbook of American Indian Languages*. Lincoln, NE: University of Nebraska Press.
- Boroditsky, L., Schmidt. (2003). Sex, Syntax, and Semantics. In D. Gentner & S. Goldin-Meadow (Eds.), *Language in mind: Advances in the study of language and cognition*. Cambridge, MA: MIT Press, pp. 61-80.
- Bowerman, M. & Choi, S. (2001). Shaping meanings for language: universal and language specific in the acquisition of spatial semantic categories. In M. Bowerman & S. Levinson (Eds), *Language acquisition and conceptual development*. Cambridge: Cambridge University Press, pp. 475-511.
- Bowerman, M. & Choi, S. (2003). Space under construction: Language-specific categorization in first language acquisition. In D. Gentner & S. Goldin-Meadow (Eds.), *Language in mind: Advances in the study of langue and thought*. Cambridge, MA: The MIT Press, pp. 387-427.
- Casasola, M. (2005). Can Language Do the Driving? The Effect of Linguistic Input on Infants' Categorization of Support Spatial Relations. *Developmental psychology*, 41: 1, 183-192.
- Casasola, M., Bhagwat, J. & Ferguron, K. T. (2006). Precursors to verb learning: Infants' understanding of motion events. In K. Hirsh-Pasek & R. M. Golinkoff (Eds.), *Action meets word: How children learn verbs*. New York, NY: Oxford University Press.
- Choi, S. & Bowerman, M. (1991). Learning to express motion events in English and Korean: the influence of language-specific lexicalization patterns. *Cognition*, 41, 83-121.

- Choi, S., Mcdonough, L., Bowerman, M. & Mandler, J.M (1999). Early sensitivity to language to language specific spatial categories in English and Korean. *Cognitive Development*, 14, 83-121.
- Chomsky, n. (1957). *Syntactic Structures*. The Hague: Mouton de Gruyter.
- Chomsky, N. (1965). *Aspects of the theory of syntax*. Cambridge, MA: MIT Press.
- Cifuentes Férez, P. & Gentner, D. (2006). Naming motion events in Spanish and English. *Cognitive Linguistics Linguistics*, 17: 4, 443-462.
- Clark, E. V. & Clark, H. H. 1979. When nouns surface as verbs. *Language*, 55, 767-811.
- Dik, S. C. (1980). *Studies in Functional Grammar*, New York: Academic Press.
- Dik, S. C. (1997). *The Theory of Functional Grammar, I*. Berlin: Mouton de Gruyter.
- Evans, V., Bergen, B. & Zinken, J. (2007). The Cognitive Linguistics enterprise: An overview. In V. Evans, B. Bergen, & J. Zinken (Eds.). *The Cognitive Linguistics Reader*. London: Equinox.
- Evans, V. & Green, M. (2006). *Cognitive Linguistics: An Introduction*. Edinburgh: Edinburgh University Press.
- Faber, P. B. & Mairal Usón, R. (1999). *Constructing a Lexicon of English Verbs*. Functional Grammar Series 23. Berlin/New York: Mouton de Gruyter.
- Fauconier, G. (1994). *Mental Spaces: Aspects of Meaning Construction in Natural Language*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Fauconnier, G. & Turner, M. (2002). *The Way We Think: Conceptual Blending and the Mind's Hidden Complexities*. New York: Basic Books.
- Fillmore, C. (1977). Topics in Lexical Semantics. In R.W. Cole (Ed.), *Current Issues in Linguistic Theory*. Bloomington, London: Indiana University Press, pp. 76-138
- Fillmore, C. (1982). Toward a Descriptive Framework of Spatial Deixis. In R. J. Jarvella & W. Klein (Eds.), *Speech, Place and Action*. London: John Wiley.
- Fillmore, C. (1985). Frames and the semantics of understanding. *Quaderni di Semantica*, 6, 222-254.
- Freedman, J. & Loftus, E. (1971). Retrieval of Words from Long-Term Memory. *Journal of verbal learning and verbal behaviour*, 10, 107-115.

- Fodor, J. A. (1975). *The Language of Thought*. New York: Crowell.
- Fodor, J. A. (1983). *The modularity of mind*. Cambridge, MA: MIT Press.
- Gentner, D. & Goldin-Meadow, S. (2003), *Language in mind: Advances in the study of language and thought*. Cambridge, MA: MIT Press.
- Gentner, D. & Goldin-Meadow, S. (2003). Whither Whorf? In D. Gentner, & Goldin-Meadow, S. (Eds.), *Language in mind: Advances in the study of language and thought*. Cambridge, MA: MIT Press, pp. 3-14.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995, 270.
- Gumperz, J. J. & Levinson, S. C. (1996). *Rethinking linguistic relativity*. Cambridge, MA: Cambridge University Press.
- Hale , K. L. & Keyser, S. J. (1987). A View from the Middle. *Lexicon Project Working Papers*, 10. Center for Cognitive Science. Cambridge, MA: MIT.
- Hale , K. L. & Keyser, S. J. (1992). The Syntactic Character of Thematic Structure. In I. M. Roca (Ed.), *Thematic Structure: Its Role in Grammar*. Berlin & New York: Foris, pp. 107-143.
- Ibarretxe-Antuñano, I. (2003). What translation tells us about motion: A contrastive study of typologically different languages. *International Journal of English Studies*, 3: 2, 153-178. Ibarretxe-Antuñano, I. (2004a). Motion events in Basque Narratives. In S. trömqvist & L. Verhoeven (Eds.), *Relating Events in Narrative. Typological and Contextual Perspectives*. Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum, pp. 89-112.
- Ibarretxe-Antuñano, I. (2005). Leonard Talmy. A windowing into conceptual structure and language: Part 1: Lexicalisation and typology. *Annual Review of Cognitive Linguistics*, 3, 325-347.
- Ibarretxe-Antuñano, I. (2006b). *Manner of motion in some verb-framed languages*. Paper presented at the V International Conference of the Spanish Cognitive Linguistics Association, University of Murcia, Spain, October.
- Ibarretxe-Antuñano, I. (2006c). Leonard Talmy. A windowing into conceptual structure and language: Part 2: Language and cognition: Past and future. *Annual Review of Cognitive Linguistics*, 4, 253-268
- Jackendoff, R. (1985). Multiple Subcategorization and the Theta-Criterion: The Case of Climb. *Natural Language and Linguistic Theory*, 3, 271-295.

- Jackendoff, R. (2002). *The foundations of language*. Oxford/New York: Oxford University Press.
- Johnson, M. (1987). *The Body in the Mind: The Bodily Basis of Meaning, Imagination, and Reason*. Chicago: University of Chicago Press.
- Kopecka, A. & Pourcel, S. (2005). *Figuring out figures' role in motion conceptualisation*. Paper given at the 9th International Cognitive Linguistics Conference, Seoul, Korea, July.
- Lagji, K. (2005). Studime filologjike: Paraqitja semantiko kognitive e foljes 'ngjitem'.
- Lakoff, G. (1987). *Women, Fire and Dangerous Things. What Categories Reveal about the Mind*. Chicago: University of Chicago Press.
- Lakoff, G. & Johnson, M. (1982). *Metaphors We Live By*. Chicago: Chicago University Press.
- Langacker, R. W. (1987). *Foundations Of Cognitive Grammar: Theoretical Prerequisites*. Stanford: Stanford University Press.
- Langacker, R. W. (1999). The Contextual Basis of Cognitive Semantics. In J. Nuyts & E. Pederson (Eds), *Language and Conceptualization*. Cambridge: Cambridge University Press, pp. 229-252.
- Langacker, R. W. (2005). Construction Grammars: Cognitive, Radical and Less so. In F. J. Ruiz de Mendoza Ibáñez & M^a S. Peña Cervel (Eds.) *Cognitive Linguistics: Internal Dynamics and Interdisciplinary Interaction*. Berlin and New York: Mouton de Gruyter. Cognitive Linguistics Research 32, pp. 101-159.
- Levin, B. (1993). *English Verb Classes and Alternations: A preliminary investigation*. Chicago: The University of Chicago Press.
- Levin, B. & Rappaport Hovav, M. (1992). The lexical semantics of verbs of motion: the perspective from unaccusativity. In I. M. Roca (Ed.), *Thematic Structure: Its Role in Grammar*, Berlin & New York: Foris, pp. 247-269.
- Levin, B. & Rappaport Hovav, M. (2005). *Argument Realizaion*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Levinson, S. (1997). Language and cognition: The cognitive consequences of spatial description in Guugu Yimithirr. *Journal ofLinguistic Anthropology*, 7, 98-131.
- Levinson, S.C., Kita, S., Haun, D.B.M. & Rasch, B. J. (2002). Returning the tables: language affects spatial reasoning. *Cognition*, 84: 2, 155-188.

- Li, P., & Gleitman, L. (2002). Turning the tables: Language and spatial reasoning. *Cognition*, 83, 265-294.
- Loewenstein, J. & Gentner, D. (2005). Relational language and the development of relational mapping. *Cognitive Psychology*, 50, 315-353
- Lucy, J.A. (1992). *Language diversity and thought*. Cambridge: University Press.
- Lucy, J.A. (1997). Linguistic relativity. *Annual review of anthropology*, 26, 291- 312.
- Mandler, J. (1992). How to Build a Baby: II. Conceptual Primitives. *Psychological Review*, 99: 4, 587-604.
- Mandler, J. (2004). *The Foundations of Mind: Origins of Conceptual Thought*. Oxford: Oxford University Press.
- Martín Mingorance, L. (1998). *El modelo lexemático-funcional: el legado lingüístico de Leocadio Martín Mingorance*. Granada: Universidad de Granada.
- Memushaj, R. (2008). *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë, Botimet Toena, f. 169.
- Memushaj, R. (2002). Hyrje në gjuhësi. Shtëpia botuese Toena f. 160
- Özçalışkan, Ş. (2004). Typological variation in encoding the manner, path, and ground components of a metaphorical motion event. *Annual Review of Cognitive Linguistics*, 2, 73-102.
- Pederson, E., Danzinger, E., Wilkins, D., Levinson, S., Kita, S. & Senft, G. (1998). Semantic typology and spatial conceptualisation. *Language*, 74: 3, 557-589.
- Pinker, S. (1989). *The language instinct*. New York: Morrow.
- Pourcel, S. (2002). Investigating linguistic relativity: A research methodology. *Durham Working Papers in Linguistics*, Vol. 8, pp. 125-138.
- Pourcel, S. (2004a). Motion in language and cognition. In A. Soares da Silva, A. Torres & M. Gonçalves (Eds.), *Linguagem, cultura e cognição: estudos de lingüística cognitiva*, vol. 2. Coimbra: Almedina, pp. 75-91.
- Pourcel, S. (2004b). Rethinking 'Thinking for Speaking'. *Proceedings of the 29th annual meeting of the Berkeley Linguistics Society*, 349-358.
- Pourcel, S. (2005). *Relativism in the linguistic representation and cognitive conceptualisation of motion event across verb-framed and satellite-framed languages*. Unpublished doctoral dissertation, University of Durham, UK.

- Rosch, E. (1973). Natural categories. *Cognitive Psychology*, 4, 328-350
- Rosch, E. (1975). Cognitive representation of semantic categories. *Journal of Experimental Psychology*, 104, 328-350.
- Rojo, A. & Valenzuela, J. (2003). Fictive Motion in English and Spanish. *International Journal of English Studies*, 3: 2, 123-150.
- Sandra, D. & Rice, S. (1995). Network analyses of prepositional meaning: Mirroring whose mind—the linguist's or the language user's ? *Cognitive Linguistics*, 6: 1, 89-130.
- Sapir, E. (1929). The status of linguistics as a science. *Language*, 5:4, 207-214.
- Schank, R. C. & Abelson, R. P. (1977). *Scripts, Plans, Goals and Understanding*. Hillsdale, N.J.: Lawrence Earlbaum Associates.
- Slobin, D. I. (1991). Learning to think for speaking: Native language, cognition, and rhetorical style. *Pragmatics*, 1, 7-26.
- Slobin, D. I. (1996a). From 'thought and language' to 'thinking for speaking'. In J. Gumperz & S. C. Levinson (Eds.), *Rethinking Linguistic Relativity*. Cambridge: Cambridge University Press, pp. 195-217.
- Slobin, D. I. (1997). Mind, code and text. In J. Bybee, J. Haiman, & S. A. Thompson (Eds.), *Essays on language function and language type: Dedicated to T. Givón*. Amsterdam: John Benjamins, pp. 437-467.
- Slobin, D. I. (2003). Language and thought online: Cognitive consequences of linguistic relativity. In D. Gentner & S. Goldin-Meadow (Eds.), *Language in mind: Advances in the investigation of language and thought*. Cambridge, MA: the MIT Press, pp. 157-191.
- Slobin, D. I. (2005) Narrating Events in Translation. In D. Ravid & H. B. Shyldkrot (Eds.), *Perspectives on language and language development: Essays in honor of Ruth A. Berman*. Dordrecht: Kluwer, pp. 115-129
- Slobin, D. I. (2006a). What makes manner of motion salient? In M. Hickmann & S. Robert (Eds.), *Space in languages: Linguistic systems and cognitive categories*. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins, pp. 59-82.
- Snell-Hornby, M. (1983). *Verb-descriptivity in German and English: A contrastive study in semantic fields*. Heidelberg: Carl Winter Universitätsverlag.

- Stefanllari, I. (2011). A course of english lexicology, Shtëpia botuese "GEER ", f. 63.
- Talmy, L. (1985). Lexicalization patterns: Semantic structure in lexical forms". In T. Shopen (Ed.), *Language typology and lexical descriptions: Vol. 3. Grammatical categories and the lexicon*. Cambridge: Cambridge University Press, pp. 36-149.
- Talmy, L. (2000a). *Toward a cognitive semantics: Vol. I: Concept Structuring System*. Cambridge, MA: MIT Press.
- Talmy, L. (2000b). *Toward a cognitive semantics: Vol. II: Typology and process in concept structuring*. Cambridge, MA: MIT Press.
- Thomai, Jani. (1989). Prejardhja semantike në gjuhën shqipe f.107.
- Ungerer, F. & Schmid, H. J. (1996): *An Introduction to Cognitive Linguistics*, London & New York: Longman.
- Wälchli, B. (2001). A typology of displacement (with special reference to Latvian). *Sprachtypologie und Universalienforschung*, 54, 298-323.
- Whorf, B. L. (1956) [1940]. *Language, Thought, and Reality: Selected Writings of Benjamin Lee Whorf*, Ed. by John B. Carroll. New York: Technology Press of M.I.T. and John Wiley & Sons.

FJALORË

- Cambridge Advanced Learner's Dictionary*, CD-Rom version 1.1. Cambridge University Press. 2003.
- Cambridge Klett Compact*, CD-Rom version 1.0b. Cambridge University Press. 2002.
- Longman Language Activator*. Pearson Education. 2002.
- Oxford English Dictionary*, second edition, online version.
- Merriam-Webster Online*, online version
- Roget's thesaurus of English words and phrases*, online version.
- The Free Dictionary by Farlex*, online version.
- Fjalor i gjuhës shqipe*. Instituti i Shkencavet. Tiranë. 1954.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Akademia e shkencave e RPSSH.Tiranë. 1980.
- Fjalor i shqipes së sotme*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Botimet Toena. 2002.

Fjalor i gjuhës shqipe. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë. 2006.

Dhima, A. Tupja, E. Ymeri, E. (2002). *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe.* Botimet Toena.

SHTOJCA 1
FOLJET E LËVIZJES NË GJUHËN SHQIPE

Foljet e lëvizjes në shqip	Lloji i lëvizjes	LV ¹	Përbërësit semantikë	# i përbërësve	Hollësi të trajektore	Hollësi të mënyrës	Fjalori i gjuhës së sotme shqipe 1980	Fjalori i gjuhës shqipe 1954	Fjalori i shqipes së sotme 2002
afroj	Zhvendosëse	LV	Trajektore	1	Më afër terrenit		Kal. , e shpie afër dikujt ose diçkaje tjetër; sjell pranë njëri-tjetrit. Afrohem: vetv.shkoj afër dikujt a diçkaje, vete më pranë.	Ft. Sjëll afër. Afrohem, fm. Shkoj më afër.	Kal.e çoj më afër dikujt a diçkaje; sjell pranë njëri tjetrit. Afrohem, vetv. Shkoj afër dikujt a diçkaje, vete më pranë.
ankoroj	Zhvendosëse	LV	Trajektore	1	Drejt terrenit (vendmbrritje)		Kal. , hedh hekurin e anijes në fund të detit për ta mbajtur atë në një vend të ndalur, lëshoj spirancën.	Nuk u gjet.	Kal. Hedh spirancën në ujë për të ndaluar anijen. Ankorohem, vetv. Hedh spirancën në ujë për të qëndruar në vend.
anoj	E brendshme	LV	Mënyrë	1		Qëndrim (në një anë)	Jokal. ,vetv. , anohem: përkulem nga njëra anë, varem nga njëra anë; shkoj mënjanë.	Fint. Prirem nga një anë.	Jokal. Anon nga njëri krah. Anohem. Vetv. Përkulem a varem nga njëra anë, shkoj mënjanë.
arratisem	Zhvendosëse		Trajektore	1	Larg nga terreni		Vetv. , iki fshehurazi nga një vend ku më mbajnë mbyllur për dënim ose kundër dëshirës.	Fm. Iki tinës nga vendi im.	Vetv. Iki fshehurazi nga një vend ku më mbajnë mbyllur për dënim ose kundër dëshirës
arrij	Zhvendosëse		Trajektore	1	Drejt terrenit (vendmbrritje)		1. Jokal. , vij ose shkoj me këmbë a me një mjet në vendin për ku isha nisur, sosem në pikën e fundit të udhëtimit; mbërrij.	Fint. Sos ne një vend të caktuar.	Jokal. Vij ose shkoj në vendin për ku isha nisur, mbërrij (edhe për mjetet e udhëtimit.
avancoj	Zhvendosëse						Libr. Lëviz në drejtimin përballë meje, eci a iki përpara.	Nuk u gjet.	Jokal. Lëviz a eci përpara.
avis	Zhvendosëse		Trajektore	1	Më afër terrenit		Kal. , bised. 1. Afroj. Vetv. , avitem: bised. Afrohem	Ft. Afroj, fm. Avitem, afrohem	Kal. Afroj. Avitem. Vetv. Afrohem.
bares	Zhvendosëse		Mënyrë	1		Mm-eci (lëvizje e paqëllimtë)	Jokal. , bised. 1. Eci; lëviz nga një vend në një tjetër.	Fint. Eci, shëtiit, endem.	Jokal. Eci, endem poshtë e perpjete, eci me nxitim.
batoj	E brendshme	LV	Mënyrë	1		Qëndrim (në një anë)	Kal.1. E anoj gati për ta përmbysur; e përmbys, e kthej në anën tjetër. Batohet: vetv. Anohet gati për t'u përmbysur, i merr ana.	Ft. E kthej në anën tjetër. Batohet: fm. Anohet gati për t'u përmbysur.	Kal. E anoj gati për ta përmbysur; e përmbys, e kthej në anën tjetër. Batohet, jokal. Vet, veta 3 varet, anon.

¹ LV qëndron për Lëvizje Veprorë, dmth., një veprues tjetër shkakton lëvizjen e Figurës.

bie	Zhvendosë se		Trajektore	1	Poshtë nga terreni, tatëpjetë		Jokal. , 1. Rrëzohem nga një vend i lartë në një vend më të ulët, këputem nga lart poshtë.	Fint. Këputem, lëshuhem nga lart poshtë i tërhequr nga pesh e trupit tim.	Jokal. 1. Rrëzohem nga një vend i lartë në një vend më të ulët, këputem nga lart poshtë.
bishtnoj	Zhvendosë se		Trajektore	1	Ndryshim drejtimi		Jokal. , i shmangem takimit me dikë a diçka të padëshiruar; iki tinëz.	Fint. I bëj bisht, i iki, i dredhoj duke nxjerrë shkaqe të kota.	Jokal. I shmangem dikuajt a diçkaje të padëshiruar, iki tinëz.
blokoj	Zhvendosë se	LV	Trajektore	1	Brenda në terren		Kal. 3. Ndaloj qarkullimin e diçkaje ose veprimet me të; pezulloj veprimet me diçka.	Ft. Rrethoj një vend a një armik.	Kal. 2. Ndaloj lëvizjen, zë kalimin, ambush me diçka. Blokohem, vetv. Ngec, nuk jam më në gjendje të lëviz.
braktis	Zhvendosë se	LV	Trajektore	1	Larg nga terreni		Kal. Largohem prej një vendi, e lë përgjithnjë a për një kohë të gjatë, largohem prej dikuajt, e lë vetëm.	Ft. E lë fare, e lë për një kohë të gjatë a për gjithnjë.	Kal. Largohem nga një vend a nga dikush përgjithnjë.
bredh	Zhvendosë se		Mënyrë	1		Mm-eci (lëvizje e paqëllimtë)	Jokal. Endem në vende të ndryshme, shëtiti andej këndej.	Fint. 2. Sillem, endem.	Jokal. Endem në vende të ndryshme, shëtiti andej këndej.
brof	Zhvendosë se		Mënyrë	1		Mm-hidhem	Jokal. 1. Ngrihem menjëherë më këmbë, çohem me rrëmbim, hidhem shpejt më këmbë; kërcej përpjetë.	Path. Tregon të nriturit përnjëherë në këmbë.	Jokal. Ngrihem menjëherë në këmbë, çohem me rrëmbim, ngrihem me vull e shpejt; turrem drejt diçkaje.
cek	Zhvendosë se	LV	Trajektore	1	Drejt terrenit (vendmbërritje)		Kal. Prek lehtë.	Çik, prek.	Kal. Prek lehtë, çik.
çaj	Zhvendosë se		Trajektore + mënyrë	2	Brenda në terren	Lëvizje e sforcuar	8. Jokal. Iki me shpejtësi, largohem me vrap në një drejtim.	Fint. Çau, iku.	Jokal. 5. Shkoj përpara ose ddal përtej duke mposhtur vështirësitë, iki me shpejtësi në një drejtim.
çaloj	Zhvendosë se		Mënyrë	1		Mm-eci (lëvizje e mundimshme)	Jokal. Eci duke u mënjanuar nagqë kam njërën këmbë më të shkurtër ose ngaqë i kam këmbët të shtrembra a të sëmura.	Fint. Eci çalthi	Jokal. Eci duke anuar mbi njërën këmbë ose herë mbi njërëne herë mbi tjetrën.

çap	Zhvendosëse		Figurë + mënyrë	2		Lëvizje e sforcuar, gjendje e figures (i/e plagosur)	Jokal. Shkoj diku, nisem për të vajtur në një vend.	Jokal. Endem në vende të ndryshme, shëtit andej këndeje.	Jokal. Shkoj a nisem për diku, çapitem.
çapitem	Zhvendosëse		Figurë + mënyrë	2		Lëvizje e sforcuar, gjendje e figures (i/e plagosur)	Jokal. Bised.1. Eci me ngadalë ose rëndë, hedh hapat, hedh këmbët; shkoj ngadalë ose me vështirësi, çapitem.	Fm. Nis të eci, hedh hapat e para (thuhet për foshnjen kur fillojnë të hedhin çapat e para).	Jokal. Hedh hapat e parë ose mezi hedh hapat, eci me ngadalë ose mezi hedh këmbën.
çliroj	E brendshme	LV	Mënyrë	1		Rrotulloj, rrokullis, vërtis	Kal. 4. E bëj më të lirë diçka që ishte lidhur a shtrënguar fort, e liroj; e heq nga diçka që e kishte kapur e shtrënguar fort. Çlirohem, vetv. 3. Zbërthej dhe heq diçka që më kishte shtërnguar.	Ft. Shpëtoj vendin nga robëria.	Kal. 4. E bëj më të lirë diçka që ishte lidhur a shtrënguar fort, e liroj; e heq nga diçka që e kishte kapur e shtrënguar fort. Çlirohem, vetv. 3. Zbërthej dhe heq diçka që më kishte shtërnguar.
çmbështjell	E brendshme	LV	Mënyrë	1		Qëndrim (përkul, përdredh, kthej)	Kal. 1. Hap diçka që ka qenë e mbledhur a e mbështjellë si rrotull, shtrij a tërheq drejt diçka që ka qenë e mbledhur si lëmsh rreth diçkaje. Çmbështillem, vetv. Veta 3. Hapet diçka që ka qenë e mbledhur.	Ft. Shtrij a tërheq drejt diçka që ka qenë e mbledhur.	Kal. 1. Hap diçka që ka qenë e mbledhur a e mbështjellë, shtrij. Çmbështillem, vetv. Hapet diçka që ka qenë e mbledhur a e mbështjellë.
çmbledh	E brendshme	LV	Mënyrë	1		Qëndrim (përkul, përdredh, kthej)	Kal. Hap diçka që ka qenë e mbledhur si lëmsh a si rrotull. Çmbledhem, vetv. Vet. Veta iii. Hapet a shtrihet diçka që ka qenë e mbledhur.	Ft. Shpleks diçka të pleksur.	Kal. Shtrij a prishdiçka të mbledhur a të palosur. Çmbledhem, vetv. Veta iii. Shtrihet a prishdiçka të mbledhur a të palosur.
çoj1	Zhvendosëse	LV	Figurë + bashkëlëvizje	2			Kal. E marr me vete dhe e përcjell deri në një vend tjetër, e shpie.	Ft. Shpie, përcjell.	Kal. E marr me vete, e përcjell, e mbart a e nis me një njeri, mjet në një vend tjetër.
çoj2	E brendshme		Mënyrë	1		Qëndrim (orientim vertikal lart)	Kal. Ngreh lart. Çohem, vetv. 1. Ngrihem në këmbë, marr qëndrim drejt pasi isha ulur diku a kisha rënë përdhe, ngrihem; kaloj nga gjendja e shtrirë në qëndrimin pingul. Çohet,	Fm. Ngrihem, zgjohem.	Kal. E zhvendos dikë a diçka nga poshtë lart ose nga një vend më i ulët dhe e mbaj pezull në duar ose e vë lart, drejtoj lart. Çohem, vetv. 1. Ngrihem në këmbë pasi isha ulur diku a

							vetv.veta 3. 4. Shkëputet nga toka ose nga një sipërfaqe tjetër; shton lartësinë, ngrihet.		kisha rënë përdhe, ngrihem e largohem nga vendi ku jam duke bërë diçka Vetv. Veta 3 4. Shkëputet nga toka ose nga një sipërfaqe tjetër, shton lartësinë, fillon të ngrihet.
çrrotulloj	E brendshme	LV	Mënyrë	1		Rrotulloj, rrokullis, vërtis	Kal. E sjell rrotull a e rrotulloj diçka në anë të kundërt. Çrotullohem, vetv. Sillem rrotull a rrotullohem në anë të kundërt.	Ft. Rrotulloj në anë të kundërt.	Kal. E bie rrotull a e rrotulloj diçka në anë të kundërt. Çrotullohem, vetv. Vij rrotull a rrotullohem në anë të kundërt.
çthur /shthur	E brendshme	LV	Mënyrë	1		Qëndrim (përkul, përdredh, kthej)	Kal. Prish a shpleks diçka të thurur. Çthurem/shthurem, vetv. Vet. Veta iii. Priset a shplekset vetiu diçka e thurur.	Ft. Çmbledh, zbledh diçka të thurur.	Shthur; kal. Prish a shpleks një gjë të thurur. Çthurem. Vetv. Veta 3. Priset a shplekset vetiu diçka e thurur.
dal	Zhvendosë se		Trajektore	1	Jashtë terrenit		Jokal. , 1. Shkoj nga brenda jashtë; largohem nga një vend ku kam qenë, nga një mjedis i caktuar.	Fint. 1. Vete nga brenda jashtë.	Jokal. Shkoj nga brenda jashtë, vete diku, largohem nga një mjedis.
davaris	Zhvendosë se	LV	Trajektore	1	Drejtime të shumëfishta (një pikënisje)		Kal.1. Përhap diçka andej e këtej, shpërndaj në të katër anët. Davaraitem, vetv. Përndahem.	Ft. Përhap, përndaj.	Davarit, kal. Shpërndaj, përhap. Davaritem, vetv. Veta 3. Shpërndahet, përhapet.
degdis	Zhvendosë se	LV	Trajektore + terren	2	Larg nga terreni (vend)		Kal. Bised.1. E dërgoj një njeri diku larg, zakonisht pa dëshirën e tij. Degdisem, vetv. Bised.1. Shkoj në një vend të largët a të panjohur, iki diku larg.	Ft. E nis për diku, e dërgoj larg. Degdisem, shkoj larg, arrij në një vend të largët.	Kal. E çoj dikë a diçka në një vend të largët, e flak diku. Degdisem. Vetv. Shkoj në një vend të largët.
depërtoj	Zhvendosë se		Trajektore	1	Brenda në terren		Jokal. , 1. Edhe fig. Arrij të futem diku, duke kapërcyer pengesa a vështirësi.	Ft. Shpoj tej e tej, e kaloj, e përshkoj. Fint. Futem, hyj.	Jokal. Arrij të futem diku, futem e zë vend diku.
devijoj	Zhvendosë se	LV	Trajektore	1	Ndryshim drejtimi		Kal. , 1. Libr. Largojj, mënjanoj bëj që të mos ngjasë, parandaloj. Shmangem, vetv. Largohe, dal a hiqem mënjane.	Fint. Bëj devijim.	Kal. Ndërroj rrugën ose drejtimin, bëj mënjane. Shmangem, jokal. Lëviz me shkathtësi për t'i shpëtuar diçkaje.
dezertoj	Zhvendosë se		Trajektore	1	Larg nga terreni		Jokal. , 1. Ush. Iki pa leje dhe fshehurazi nga ushtria ose fusha e betejës.	Fint. Iki fshehtas nga shërbimi ushtarak ose i shmangem thirrjes nën armë.	Jokal. Ush. Iki pa leje dhe fshehurazi nga ushtria ose fusha e betejës.

dëboj	Zhvendosëse	LV	Trajektore + terren	2	Larg nga terreni		Kal. , 1. Detyroj dikë të largohet nga një vend i caktuar me forcë a me të keq; përzë, ndjek, largoj, shporr.	Ft. Ndjek, qit jashtë me forcë, zboj, përzë.	Kal. E largoj dikë me detyrim nga shtëpia, vendi, etj, e nxjerr jashtë.
dorëz	Zhvendosëse	LV	Figurë	1			Kal.1. Ia jap dikujt në dorë diçka.	Ft. Lë një gjë nën zotërim të një tjetri.	Kal. Ia jap dikujt në dorë diçka; e kthej atje ku duhet diçka që nuk është e imja.
dredh	E brendshme	LV	Mënyrë	1		Tund, lëkund, dredh	Kal. , e kthej a rikthej diçka duke e lëvizur rreth vetes a rreth një boshti. Dridhem, vetv. , veta iii.: merr trajtë të valëzuar, bëhet dredha-dredha, përdridhet. Dridhem, vetv. Më zënë të dridhurat, rrëqethem nga ethet a të ftohtët.	Ft. 2. Sjell rrotull një trup rreth boshtit të tij. Dridhem, fint. Kthehem. Ft. Bëj të dridhet. Dridhem, fm. Më tronditet shtati padashur me lëvizje të shpejta, të njëpasnjëshme, nga të ftohtët, nga frika.	Kal. Sjell rrotull një a më shumë fije për të bërë një fill të fortë, përdredh. Dridhem, vet. Veta iii. Rrotullohet disa herë rreth vetes në një drejtim që shtërngohet, përdridhet; rrotullohem nga njëra anë në tjetrën.
dredhoj	Zhvendosëse		Trajektore	1	Ndryshim drejtimi		Jokal. , 3. Bëj një lëvizje të shpejtë e shkathët për t'i shpëtuar dikujt a diçkaje.	Fint. Kthej rrugë, kthehem.	Jokal. 2. Eci a vrapoj duke bërë dredha, bëj një lëvizje të shpejtë për t'i shpëtuar diçkaje.
drejtoj1	E brendshme	LV	Mënyrë	1		Qëndrim (orientim vertikal lart)	Kal. , bëj të drejtë diçka që ka qenë e shtrembër, e lakuar, e pjerrët a me dredha. Drejtohem, vetv. Veta 3. Bëhet e drejtë diçka që ka qenë e lakuar a me dredha.	Fr. 1. Ve, kthej drejt një gjë të shtrembët.	Kal. , bëj të drejtë diçka që ka qenë e shtrembër, e përkulur, a me dredha, e strij. Drejtohem, vetv. Veta 3. Bëhet e drejtë diçka që ka qenë e shtrembër.
drejtoj2	Zhvendosëse	LV	Mënyrë	1		Mjet/instrument i pacaktuar	Kal. Libr. Ngas një automjet ose aeroplan.	Ft. Ngas një mjet, makinë, etj.	Kal. Libr. Ngas një automjet ose aeroplan.
drejtoj3	Zhvendosëse	LV	Figurë + bashkëlëvizje	2			Kal. E çoj te dikush, i tregoj rrugën dikujt.	Nuk u gjet.	Kal. E çoj te dikush, i tregoj rrugën dikujt.
drithërohem	E brendshme		Mënyrë	1		Tund, lëkund, dredh	Jokal. , 1. Më zënë të dridhura të lehta nga të ftohtët a nga një ndjenjë e fortë; dridhem, rrëqethem.	Fint. Më dridhet zemra.	Vetv. Dridhem, rrëqethem.

dyndem	Zhvendosëse		Trajektore + mënyrë	2	Drejt terrenit	Ritëm i shpejtë	Dyndem, 3. Vet. Veta iii. Vjen me shumicë e me vrull, lëviz me shpejtësi në një drejtim.	Fm. Dyndem, shkulem, ngrihem në këmbë për një qëllim të caktuar.	Vetv. 2. Vërshoj me shumicë e me vrull drejt një vendi.
eci	Zhvendosëse		Mënyrë	1		Mm-eci	Jokal. , 1. Shkoj më këmbë e me hapa të zakonshëm nga një pikë në një pikë tjetër; lëviz më këmbë, bëj hapa në drejtime të ndryshme.	Fint. Shkoj me këmbët e mia prej një vendi në një vend tjetër.	Jokal. 1. Shkoj me hapa të zakonshëm nga një pikë në një pikë tjetër ose në drejtime të ndryshme.
emigroj	Zhvendosëse		Trajektore + terren	2	Larg nga terreni	Lëvizje e sforcuar	Jokal. Largohem nga atdheu im për shkaqe politike, ekonomike etj. Dhe vendosem përkohësisht a përgjithmonë në një vend të huaj, mërgohem.	Fint. Shkulem nga vendi im dhe shkoj e zë vend në dhe të huaj.	Jokal. Mërgoj, largohem nga atdheu im për shkaqe politike, ekonomike, etj.
endem	Zhvendosëse		Mënyrë	1		Mm-eci (lëvizje e paqëllimtë)	Jokal. , 2. Sillem poshtë e lart pa ndonjë qëllim të caktuar, sillem kot, brend andej këndeje.	Sillem poshtë e lart.	Jokal. Shkoj e vij pa ndonjë qëllim të caktuar.
fërgëlloj	E brendshme		Mënyrë	1		Tund, lëkund, dredh	Jokal. , vet. Veta 3. Lëkundet valë-valë, dridhet lehtë, fërfëllin.	Fint. Dridhem prej ethesh.	Jokal. , vet. Veta 3. Lëkundet valë-valë, dridhet lehtë, fërfëllin.
fluturoj	Zhvendosëse		Terren	1			Jokal. , vet. Veta 3, ngrihet, lëviz në ajër me anë të krahëve (për zogjtë dhe kandrat) ose me ndihmën e një force shtytëse me motor, etj.	Fint1. Ngrihet e pershkon ajrin me krahë (zogu, aeroplani).	Jokal. Vet. Veta 3. Ngrihet, lëviz në ajër me anë të krahëve (për zogjtë dhe kandrat) ose me ndihmën e një forcë shtytëse me motor, etj., zhvendoset në ajër me shpejtësi.
frenoj	Zhvendosëse		Mënyrë	1		Ritëm në zbritje	Kal.1. Ndaloj a ngadalësoj me anë të frenave lëvizjen e një automobili ose të një mjeti tjetër lëvizës.	Ft. Ngadalësoj vrullin, e nda fare lëvizjen e një maqine.	Kal. Ndaloj a ngadalësoj lëvizjen me anë të frenave.
fryhem	Zhvendosëse		Mënyrë	1		Mm-eci (gjendje e figurës)	6. Mbahem ose eci më të madh, krekosem.	Fint. Mbahem me të madh, krekosem.	Jokal. Mbahem ose eci më të madh, krekosem.

fshihem	Zhvendosëse		Mënyrë	1		Lëvizje e fshehtë	Vetv.1. Shkoj në një vend ku nuk dukem a që nuk e di njeri që të mos më gjejnë dot	Fm. Shkoj ose futem në një vend që të mos më gjejë njeri.	Vetv.1. Shkoj a futem në një vend të fshehtë që të mos më gjejnë dot ose për t'u ruajtur nga një rrezik
fugoj	Zhvendosëse		Mënyrë	1		Mm-vrapoj	Jokal. , iki me nxitim, vrapoj.	Fint. Iki me vrap, harboj	Jokal. Vrapoj, nxitoj.
fundos	Zhvendosëse	LV	Trajektore	1	Drejt terrenit (vendmbrritje)		Kal. , 1. Zhys dikë a diçka në fund të detit, të liqenit, etj. Fundosem, vetv. Zhytet në fund të detit.	Ft. Hedh në fund të ujit. Fm. Fundosem, bie në fund.	Kal. , 1. Zhys dikë a diçka në fund të detit, të liqenit. Fundosem, vetv. Zhytet në fund të detit.
fut/fus	Zhvendosëse	LV	Trajektore	1	Brenda në terren		Kal. , e shtie diçka a e vë diçka brenda në një vend (në një orendi, në një vend tjetër të mbyllur. Futem, vetv. Hyj në një vend të mbyllur, të mbrojtur a të fshehtë.	Ft. Vë brenda, fm. Futem, hyj brenda.	Kal. , e shtie diçka a e vë diçka brenda në një vend (në një orendi, në një vend tjetër të mbyllur. Futem, vetv. Hyj në një vend të mbyllur, të mbrojtur a të fshehtë.
gërmuqem	E brendshme		Mënyrë	1		Qëndrim (orientim vertikal poshtë)	Vetv. , përkul shpinën; më përkulet kurrizi (nga pleqëria, nga puna e rëndë a nga ndonjë sëmundje); kërrusem.	Fr. Kërruesem, më përkulet kurrizi (nga pleqëria, nga një sëmundje).	Vetv. Përkul shpinën, kërruesem, më del kurrizi.
gërshetoj	E brendshme		Mënyrë			Përkul, përdredh, kthej	Kal. , thur gërshet; bëj si gërshet.	Ft. Bëj gërshet, thur, pleks.	Kal. Thur gërshet; bëj si gërshet.
gremis	Zhvendosëse	LV	Trajektore	1	Poshtë nga terreni, tatëpjetë		Kal. , 1. E rrëzoj dikë nga një vend i lartë; shtyj dikë me forcë dhe e rrëzoj; e hedh a e lëshoj poshtë. Gremisem, vetv. Rrëzohem nga një vend i lartë.	Ft. Rrëzoj. Fm. Gremisem, rrëzohem.	Kal. , 1. E rrëzoj dikë nga një vend i lartë; shtyj dikë me forcë dhe e rrëzoj. Gremisem. Vetv. Bie nga një vend i lartë, rrëzohem.
grushtoj	Zhvendosëse	LV	Figurë	1			Kal.1. I bie dikujt a diçkaje me grusht, e qëlloj me grushte.	Ft. Godas me grusht.	Kal. I bie dikujt a diçkaje me grusht, qëlloj me grusht.
gjarpëroj	Zhvendosëse		Mënyrë	1		Forma e trajektores	Vet. , veta 3. Shkon a lëviz duke bërë dredha, ecën në një vijë me lakime të njëpasnjëshme.	Fint. Eci duke bërë dredha siç bën gjarpri.	Jokal. Vet. Veta 3. Shkon a lëviz duke bërë dredha, dredhon.
gjezdis	Zhvendosëse		Mënyrë	1		Mm-eci (lëvizje e paqëllimtë)	Jokal. Dhe kal. Bised. Shëtit pa ndonjë qëllim, kot.	Fint. Shetit.	Jokal. Shëtit, bredh.

gjëmoj	Zhvendosë se	LV	Trajektore + mënyrë	2	Pas terrenit	Ritëm i shpejtë	Kal. Dhe jokal. Ndjek nga pas me vrap; gjurmoj.	Fint, ft. Gjimoj, ndjek, vrapoj.	Kal. Dhe jokal. Ndjek nga pas me vrap.
gjunjëzoj	E brendshme	LV	Mënyrë	1		Qëndrim (orientim vertikal poshtë)	Kal. Ul në gjunjë dikë, e bëj të bjerë në gjunjë, përgjunj. Gjunjëzohem, vetv. Bie ose ulem në gjunjë para dikujt a diçkaje, përgjunjem.	Fm. Bie në gjunjë, përgjunjem..	Kal. E detyroj dikë të bjerë në gjunjë, përgjunj. Gjunjëzohem, vetv. Bie në gjunjë para dikujt a diçkaje, përgjunjem.
gjurmoj	Zhvendosë se	LV	Trajektore + mënyrë	2	Pas terrenit	Levizje e fshehtë	Kal. I shkoj pas fshehurazi dikujt për ta përgjuar.	Ft. I shkoj pas gjurmës.	Kal. Shkoj pas gjurmëve të dikujt a diçkaje; ndjek a kërkoj dikë për ta zënë ose për ta asgjësuar, apo për ta përgjuar.
Hallakas / hallakat	Zhvendosë se	LV	Trajektore	1	Drejtime të shumëfishta (një pikënisje)		Kal. Shpërndaj andej këndeje një grumbull a një tufë. Hallakatem, vetv. Bised. Shpërndahet andej këndeje një grumbull a një tufë.	Ft. Shpërndaj një grumbull, fm. Hallakatem.	Kal. Shpërndaj andej këndeje. Hallakatem, vetv. Bised. Shpërndahem andej këndeje.
hapërdaj	Zhvendosë se	LV	Trajektore	1	Drejtime të shumëfishta (një pikënisje)		Kal. Shpërndaj, përhap andej-këndeje, hallakat. Hapërdahem, vetv. Bised. Shpërndahem, përhapem andej-këndeje, hallakatem.	Ft. Shpërndaj, hallakat, hapërdahem.	Kal. Shpërndaj, hallakat. Hapërdahem, vetv. Bised. Shpërndahem, hallakatem.
hidhem	Zhvendosë se dhe e brendshme		Mënyrë	1	Mm hidhem	Rrotulloj, rrokullis, vërtis	Vetv.1. Kërcej me vrull e me shpejtësi përpjetë a në një drejtim tjetër, zakonisht pa u mbështetur gjëkund; lëshohem shpejt nga lart poshtë.	Ft. Flak, vërvit, hardhoj. Hidhem, fint. Hov, kercej.	Vetv. 1. Kërcej me vrull e me shpejtësi përpjetë a në një drejtim tjetër, lëshohem shpejt nga lart poshtë.
hipi	Zhvendosë se		Trajektore	1	Mbi terren, përpjetë		Jokal. 1. Edhe kal. , zhvendosem nga poshtë lart; vendosem në një vend më të lartë nga ku jam; ngjitem, lëviz lart.	Ft. Gjitem, vete nga një vend në një vend më të lartë.	Zhvendosem nga një vend më i ulët në një vend më të lartë, ngjitem lart në hapësirë.
